



# Raport vjetor 2008



Inspektorati  
Policor i Kosovës



# Inspektorati Policor i Kosovës



## Raport vjetor 2008





**Qeveria e Kosovës**  
**Ministria e Punëve të Brendshme**

**Rr. "Lidhja e Pejës", p.n**  
**12000, Fushë Kosovë**  
**038 552 510 / 038 200 185 10**  
**[info.ipk@ks-gov.net](mailto:info.ipk@ks-gov.net)**





# **Inspektorati Policor i Kosovës**

## **2008**

**I prezantuar Ministrit të Punëve të Brendshme në  
bazë të nenit 21.2 të Ligjit për Inspektoratin Policor të  
Kosovës**





## Shkurtesat

<b>DAK</b>	Drejtoria e Analizës së Krimit
<b>DKKO</b>	Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar
<b>DME</b>	Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave
<b>DPZH</b>	Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim
<b>DRP</b>	Departamenti i Rendit Publik
<b>EPAC</b>	Partneriteti Evropian Kundër Korrupsionit
<b>IPK</b>	Inspektorati Policor i Kosovës
<b>INIOP</b>	Rrjeti Ndërkombëtar i Mbikëqyrjeve Policore
<b>KEEP</b>	Kodi Evropian i Etikës Policore
<b>KKSB</b>	Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi
<b>KELDP</b>	Këshilli për Emërime të Larta dhe Disiplinë Policore
<b>MIK</b>	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>NJTR</b>	Njësia e Trafikut Regjional
<b>NJOM</b>	Njësia Operative Mbështetëse
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>PKK</b>	Pika e Kalimit Kufitar
<b>QKSPEZH</b>	Qendra Kosovare për Siguri Publike, Edukim e Zhvillim
<b>UNMIK</b>	Misioni Civil i Kombeve të Bashkuara në Kosovë



# Përmbajtja

## Fjala hyrëse e Ministrit

## Përmbledhja ekzekutive e Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së

### **PJESA I:** Aktivitetet e Departamentit të Inspektimit

1. Menaxhimi i armëve të zjarrit dhe municionit në SHPK
2. Menaxhimi i buxhetit, financave dhe prokurimit në SHPK
3. Menaxhimi i planeve lokale policore
4. Menaxhimi i trajnimeve në SHPK
5. Planifikimi për reagim policor në situata emergjente
6. Menaxhimi i policisë kufitare
7. Menaxhimi i trafikut rrugor nga Policia e Kosovës
8. Hetimi i krimit të organizuar

### **PJESA II:** Aktivitetet e Departamentit të Hetimeve



## Fjala hyrëse e Ministrit

I bindur se besimi i publikut te Policia është i ndërlidhur në masë të madhe me qëndrimin dhe sjelljen që ka Policia ndaj komunitetit në përgjithësi, e në veçanti me respektimin e dinjitetit njerëzor dhe të drejtave të lirive themelore të individit, kam kënaqësinë e veçantë të paraqes raportin vjetor të punës së Inspektoratit Policor të Kosovës për vitin 2008 i cili me të dhënat që përmban pasqyron të arriturat dhe sfidat që duhet adresuar.



Ndërtimi i një organizate Policore efektive dhe efikase është i mundur vetëm nëse kemi institucione të pavarura dhe profesionale të cilat përkujdesen për arritjen e qëllimeve në fushën e sigurisë si dhe menaxhim të disiplinës në mënyrë të pavarur. Së këndejmi, për të realizuar këtë është e rëndësishme të kemi edhe mekanizma që garantojnë zbatimin e këtyre parimeve.

Ky ka qenë vit i përkushtimit tonë në ngritjen e kapaciteteve të Inspektoratit Policor përmes ndërtimit të mekanizmave tjerë përcjellës si dhe infrastrukturës legale që mundësojnë përcaktimin e qartë të funksioneve dhe autorizimeve që ka Inspektorati Policor në bazë të standardeve dhe parimeve më të përparuara.

Ky raport pasqyron të arriturat e Inspektoratit Policor gjatë vitit 2008, rezultati i arritur përmes angazhimit dhe përkushtimit të të punësuarve në këtë institucion si dhe mbështetjes së fuqishme nga partnerët ndërkombëtar të cilëve ne u jemi shumë mirënjohës.

Duke qenë të vetëdijshëm se periudha para nesh kërkon realizimin dhe përmbushjen e shumë obligimeve dhe qëllimeve përkundër të arriturave të deritashme, lenë të kuptojmë se nuk ka vend për vetë kënaqësi, por kërkohet më shumë përkushtim, sakrificë dhe angazhim profesional.

Themelimi dhe funksionalizimi i KELDP si mekanizëm për disiplinën dhe emërimet e Larta në Polici ka pasur ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv në ngritjen e efikasitetit të Inspektoratit Policor dhe të Policisë e sidomos ngritjen e profesionalizmit, objektivitetit, paanshmërisë, mosdiskriminimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut nga Policia.

Ne do të angazhohemi që pjesëtarët e Policisë së Kosovës përveç asaj që duhet të duken mirë siç edhe po duken tani, të vazhdojnë të jenë edhe më të dashur

për qytetarët dhe më të pranuar për ta, në mënyrë që misioni i tyre të jetë në funksion të filozofisë së shërbimit ndaj komunitetit.

Ministria e Punëve të Brendshme ka vendosur lart në kuadër te prioriteteve të saja funksionalizimin dhe ngritjen e kapaciteteve të Policisë së Kosovës. Tanimë kemi kompletuar infrastrukturën ligjore duke miratuar Ligjin për Policinë dhe duke emëruar stafin e lartë menaxhues në përputhje me Ligjin e ri.

Ne jemi të përkushtuar të zhvillojmë politika të qarta për ngritjen profesionale të mëtutjeshme të Policisë së Kosovës përmes ngritjes së kapaciteteve humane, përmirësimit të kushteve të punës, pajisjen më të mirë, që do të mundësoj ndërtimin e një Policie efektive dhe efikase, të përgatitur mirë, numerikisht jo shumë të madhe por të shpërblyer më mirë e që njëherit është edhe vizioni ynë.

Ne do të angazhohemi që pjesëtarët e Policisë së Kosovës përveç asaj që duhet të duken mirë siç edhe po duken tani, të vazhdojnë të jenë edhe më të dashur për qytetarët dhe më të pranuar për ta, në mënyrë që misioni i tyre i shenjtë të jetë sa më i realizueshëm duke i ngritur kapacitetet e tyre dhe duke i përmirësuar performancën vazhdimisht. Në arritjen e këtij objekti padyshim se rol kyç do të luajë edhe Inspektorati Policor i Kosovës duke dhënë rekomandime për ngritjen e performancës së pjesëtarëve të Policisë së Kosovës në përputhje me Ligjin për Policinë dhe ligjet tjera organike.

Të arriturat e Policisë së Kosovës dëshmojnë se përkundër faktit se pjesëtarët e saj nuk kanë qenë të stimuluar materialisht, kanë dëshmuar shkallë të lartë të profesionalizmit. Motivi për t'i shërbyer qytetarëve dhe për të mbrojtur jetën dhe pronën e tyre i tejkalon kufizimet e natyrave tjera që mund të kenë eprorët dhe zyrtarët policor të Policisë së Kosovës.

Padyshim se sistemi i drejtësisë penale luan një rol kyç në ruajtjen e rendit ligjor dhe se Policia ka pjesën e saj të përgjegjësisë. Është me rëndësi jetike që brenda këtij sistemi të kemi mekanizma efikas demokratik të cilët do të kujdesën që Policia të përmbushë misionin e saj në mënyrë të drejtë dhe në bazë të parimeve të demokracisë dhe sundimit të ligjit në përgjithësi. Duke u nisur nga ky parim presim që Inspektorati Policor të ketë rol të rëndësishëm në arritjen e këtij qëllimi duke ndjekur në vazhdimësi parimet e profesionalizmit, objektivitetit, paanshmërisë politike, mosdiskriminimit dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

**Zenun Pajaziti**

Ministër

Ministria e Punëve të Brendshme

## Përmbledhja ekzekutive nga Kryeshefi Ekzekutiv

**Inspektorati Policor i Kosovës filloi së ekzistuari nga data 3 korrik 2006, që ishte dita e parë e trajnimit, me ndihmën e Ekipit Implementues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian. Inspektorati Policor i Kosovës është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2005/54 dhe Urdhërësës Administrative 2006/9, si agjencion ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme**

Bazuar në nenin 21.2 të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës, kam nderin t’iu prezantoj Raportin e tretë vjetor (2008) të Inspektoratit Policor të Kosovës. Ky dokument i rëndësishëm si publikim i rregullt i Ministrisë së Punëve të Brendshme, paraqet njërën nga metodat primare të Ministrisë së Punëve të Brendshme të sigurimit të asaj që shërbimi policor është i përgjegjshëm ndaj qytetarëve të cilëve iu shërben.



Edhe pas dy vite e gjysmë aktiviteti, kontributi i IPK-së ka qenë evident dhe është vlerësuar nga faktori vendor dhe ai ndërkombëtar. Raportet e inspektimeve dhe hetimit të ankesave edhe këtë vit i kanë ofruar Ministrit, instrumentin e identifikimit të çështjeve në drejtim të ngritjes së performancës policore.

Nga korriku i vitit 2008 ka hyrë në fuqi Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës që përcakton organizimin, funksionet dhe autorizimet e Inspektoratit Policor të Republikës së Kosovës. Inspektorati Policor i Republikës së Kosovës është agjencion ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i pavarur nga Policia e Republikës së Kosovës”.

Inspektorati Policor i Kosovës ka dizajnuar dhe funksionalizuar një strukturë organizative funksionale bazuar në mandatin e saj. Departamentet operative kanë vazhduar me misionin e tyre në mbikëqyrjen e mënyrës së kryerjes së detyrave nga Policia e Kosovës, duke u përkujdesur që ligji të zbatohet në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase.

Duke kombinuar dy funksionet primare në ndjekje të parimeve të përgjegjësisë dhe transparencës, këtë vit IPK-ja përmes Departamentit të Inspektimeve ka funksionalizuar tetë (8) inspektime të zakonshme dhe shtatë (7) të jashtëzakonshme, ndërsa Departamenti i Hetimeve ka proceduar rreth 2.024 lëndë (ankesa) të pranuar. Në këtë raport nuk janë prezantuar materiale nga inspektimet e jashtëzakonshme, që konform Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës (neni 21.1) konsiderohen të “ndjeshme” por të cilat iu janë prezantuar autoriteteve kompetente.

Në ngritjen e efikasitetit të agjencionit tonë e sidomos në ngritjen e profesionalizmit të Policisë ka pasur ndikim të rëndësishëm themelimi dhe funksionalizimi i Këshillit për Emërime të Larta dhe Disiplinë Policore (KELDP), i cili shqyrton lëndët e hetuara nga inspektorët policor, duke marrë parasysh rekomandimet për masat e propozuara.

Në vazhden e ngritjes së vazhdueshme profesionale, IPK-ja në përkrahje të OSBE-së

ka angazhuar personelin në trajnime të vazhdueshme të zhvilluara nga konsulent vendor e ndërkombëtar, si njohës të mirë të fushave të burimeve njerëzore, teknikave të intervistimit dhe fushave tjera me interes.

Viti që lëmë pas do të jetë vit edhe i një suksesi tjetër të organizatës, ngase në planin e infrastrukturës ligjore, Inspektorati Policor i Kosovës është kompletuar përveç se me ligjin edhe me „Procedurat Standarde të Operimit”. Pjesëmarrja jonë ka qenë aktive edhe në grupet punuese për hartimin e akteve nënligjore që burojnë nga ligji: Këshillit për Emërime të Larta dhe Disiplinë Policore (KELDP) dhe kategorizimi i shkeljeve të rënda dhe të lehta.

Megjë agjencioni ynë ka kaluar fazën e ndërtimit të kapaciteteve kadrovike dhe në fazën e zhvillimit të mëtutjeshëm të saj, ka rritur bashkëpunimin me agjencione dhe organizata të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Vlen përmendur thellimin e bashkëpunimit me gjykatat, prokurorinë, doganat, OSBE-në, Agjencionin Kundër Korrupsionit, UNDP-në, etj. Në përkrahje të vazhdueshme të Misionit të OSBE-së në Kosovë, është përfaqësuar në Konferencën e “Partneritetit Evropian Kundër Korrupsionit dhe Mbikëqyrjeve Policore” (EPAC). Përkrahja e tillë nuk ka ngecur edhe nga UNDP-ja e cila në bashkëpunim me MPB-në ka mbështetur pjesëmarrjen e agjencionit tonë në punëtorinë e organizuar në Shqipëri, mbi prezantimin e projekteve prioritare të agjencioneve. Mbetet sfida në të ardhmen anëtarësimi në Rrjetin Ndërkombëtar të Mbikëqyrjeve Policore (INIOP).

**Enver Rrustemi**

Kryeshef Ekzekutiv

Inspektorati Policor I Kosovës



# PJESA I:

## AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË INSPEKTIMIT

- Departamenti i Inspektimeve ka filluar aktivitetin në korrik të vitit 2006, me fillimin e implementimit të programit të OSBE-së në ngritjen e kapaciteteve të para kadrovike të Inspektoratit Policor të Kosovës.
- Strukturimi i Departamentit të Inspektimit në kuadër të agjencionit, parashihet me Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës, në nenin 5, pika 5.1 (Organizimi dhe struktura e Inspektoratit Policor të Republikës së Kosovës).
- Në bazë të nenit 10 të ligjit, pika a, (Autorizimet e përgjithshme të Inspektoratit Policor), Inspektorati Policor i Republikës së Kosovës ka autorizim të zhvilloj inspektime ndaj Policisë së Republikës së Kosovës dhe të raportoj mbi punën dhe efikasitetin në arritjen e qëllimeve.
- Në nenin 17 të ligjit, përcaktohen fushat e menaxhimit policor të cilat do të jenë objekt i inspektimeve të Departamentit të Inspektimeve.







# MENAXHIMI I ARMËVE TË ZJARRIT DHE MUNICIONIT



### MENAXHIMI I ARMËVE TË ZJARRIT DHE MUNICIONIT

#### 1. HYRJE

1.1 Inspektimi i parë i zakonshëm i SHPK-së në vitin 2008 është i bërë me datën 10, 11, 14, 15 janar, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9. Ky inspektim u përqendrua në kryerjen e detyrave nga ana e menaxhmentit në fushën e armëve të zjarrit dhe është ndërmarrë nga Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ekipit prej 17 inspektorëve policorë. Përveç Shtabit Kryesor të SHPK-së, janë vizituar edhe të gjitha komandat regjionale dhe një numër i stacioneve policore. Kemi hasur në një bashkëpunim dhe gatishmëri të plotë nga ana e personelit të SHPK-së.

1.2 Që nga themelimi i saj në vitin 1999, SHPK-ja ka operuar sipas stilit civil e jo ushtarak (xhandarmërisë). Ky dallim është i rëndësishëm kur merret parasysh mënyra se si SHPK-ja përdorë armët e zjarrit gjatë kryerjes së detyrave policore. Një numër i shteteve përfshirë edhe shtetet e BE-së kanë zhvilluar modelin e organizimit policor në formë të xhandarmërisë. Struktura e xhandarmërisë është strukturë që është në mes të strukturës ushtarake dhe asaj civile duke përmbajtur në vete elemente të të dyja strukturave. Xhandarët më shumë angazhohen në intervenime ushtarake, sidoqoftë SHPK-ja ka strukturë civile policore, ashtu si dhe shumica e policive në shtetet e EU-së, ku mundohet që të minimizoj përdorimin e armëve gjatë kryerjes së detyrave policore por në të njëjtën kohë është në fazën fillestare të përgatitjes së njësive speciale të saja edhe në koncepte të intervenimeve të armatosura duke marrë disa koncepte trajnimi nga MSU-ja italiane të cilat në Kosovë për shkak të infrastrukturës dhe gjendjes aktuale po konsiderohen si më efikase por pa rrezikuar modelin civil të organizatës.

1.3 Qëllimi i këtij inspektimi është të bëhen rekomandime se si menaxherët e lartë të SHPK-së do të mund të përmirësonin paraqitjen në menaxhimin e armëve të zjarrit në ndjekje të qëllimeve në vijim:

- Pëlqimi me standardet relevante brenda Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP),
- Pajtueshmëria me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/54, Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36, Urdhëresën Administrative 2003/2 dhe legjislacionin përkatës
- Të inkurajohet menaxhimi profesional.
- Të ndihmohet furnizimi me kostot më efektive dhe përdorim i sigurt i armëve të zjarrit nga ana e policëve të SHPK-së, dhe
- Të identifikohen dhe përhapen praktikat më të mira.

1.4 Gjatë inspektimit, pjesëtarët e inspektoratit policor vizituan dhe intervistuan pjesëtarët e SHPK-së në vijim:

- Ndhmës i Zëvendës Komisarit për Operativë;
- Drejtori i Drejtorisë për Buxhet e Financa;
- Drejtori i Departamentit të Njësive të Specializuara;
- Komandantët Regjional;
- Kryesuesit e Njësive Regjionale për Përkrahje Operative;
- Komandantët e Stacioneve Policore;
- Zyrtarët e lartë të Departamentit të Trajnimeve në Shkollën e Shërbimit Policor;
- Personeli për trajnime me armë të zjarrit në Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës (QKSPEZH).

1.5 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike i cili parim është i mbështetur në nenin 19 të Kodit Evropian të Etikës Policore.

## **2. KRYERJA E DETYRAVE NË MENAXHIMIN E ARMËVE TË ZJARRIT**

### **Organizimi aktual**

2.1 Shërbimi Policor i Kosovës është organizatë e cila si funksion themelor të saj ka zbatimin e ligjit, në baza ditore ofron shërbime të përgjithshme mbi sigurinë e jetës, pronës dhe rendit publik për qytetarët e Kosovës. Ky mision fisnik i kësaj organizate shpesh është i karakterit urgjent ku për të arritur efikasitet në kryerjen e detyrave, zyrtarët policorë të saj duhet që të jenë të pajisur me njohuri të bollshme ligjore dhe me pajisje adekuate për të arritur objektivat e kërkuara. Zyrtarëve policorë iu janë besuar një numër i armëve të zjarrit të llojit të ndryshëm si: Glllok 9x19, Glllok 9x17, AK-47 dhe MP-5, për të cilat janë kurset dhe certifikimet për të cilat pjesëtarët e ndryshëm të SHPK-së trajnohen në bazë të njësiveve në të cilat shërbejnë. Përveç armëve të zjarrit zyrtarët policor janë të pajisur edhe me pajisje tjera mbrojtëse si sprej, shufra metalike, jelek anti plumb, helmëta, automjete të blinduara, etj.

2.2 Shërbimi Policor i Kosovës, bazuar në strukturën organizative të saj është e ndarë në tri (3) shtylla kryesore ku hyjnë Shtylla e Krimin, Shtylla e Administratës dhe Shtylla e Operativës, ku në këtë të fundit hyjnë edhe Njësitë e Specializuara të cilat së bashku me Departamentin e Policisë Kufitare bartin barrën kryesore lidhur me menaxhimin me detyrat dhe operacionet me rrezikshmëri të lartë dhe si të tillë ata në përdorim kanë edhe armët më specifike sesa njësitet tjera. Në kuadër të shtyllës operative hyjnë këto njësi të specializuara: Njësia Operative Mbështetëse (NJOM), Njësia për Mbrojtje të Afërt (NJMA), Njësiti i Parë Intervenues (FIT), Njësiti i Qenve (K-9), Njësiti për Kontrollimin e Mjeteve Eksplozive (IEDD), Njësia për Sigurimin e Objekteve të Rëndësishme të Veçantë (DSSHPK) dhe Njësia e Analizave, Inteligjencës dhe Negociatave (AIN). Njësitet të cilat kanë armë të zjarrit më të specializuara janë: NJOM, NJMA, FIT dhe Policia Kufitare. Përveç revoles Glllok 9X19 me të cilën janë

të trajnuar të gjithë pjesëtarët e uniformuar të SHPK-së, ata kanë edhe armët AK-47 dhe MP-5 për të cilat ekzistojnë kurset e trajnimit, por kanë edhe armë tjera në posedim për të cilat nuk ekziston ndonjë kurs i veçantë trajnimi nga Departamenti i Trajnimit si: snajper dhe pushkë Shotgun.

2.3 Strukturimi dhe shpërndarja e këtyre njësive si dhe trajnimi i tyre është bërë në atë mënyrë që të ketë sa më shumë efikasitet për të ndërhyre në rastet e urgjencës kur rrezikohet jeta, prona apo rendi publik i qytetarëve të Kosovës. NJOM është e ndarë në gjashtë regjione dhe ajo kryen, përveç punëve të zakonshme policore, edhe të gjitha detyrat e parashtruara nga Komanda Regjionale dhe Departamenti i Njësive Speciale të Komandës Kryesore Policore. Policët e NJOM-së, përveç që janë të trajnuar me konceptin MSU Italiane për ballafaqim me trazira, ata janë të trajnuar me AK-47, 38 zyrtarë policorë dhe MP-5, 79 zyrtarë policorë. NJMA ka përgjegjësinë e sigurimit dhe përcjelljes së personaliteteve vendore dhe ndërkombëtare dhe në këtë kuadër ka operacione të rregullta (gjatë vitit 2007 ka pasur 31 operacione speciale të përcjellës së delegacioneve të ndryshme ndërkombëtare që kanë vizituar Kosovën, dhe 10 aktivitete operative të përcjelljes së personaliteteve vendore). Kjo njësi ka të kryer trajnime për sigurimin e personaliteteve sipas sistemit MSU italian dhe nga 88 pjesëtarë të uniformuar ku prej tyre 86 kanë kryer edhe kursin për AK-47.

2.4 Njësia më delikate dhe më elite në përdorimin e armëve në SHPK pa dyshim është Njësiti FIT i cili sipas Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së (P-4.55, pika 2) "Misioni i këtij njësiti është të ushtroj veprimtarinë dhe t'i kryej detyrat e saj policore në situatat më të rënda dhe më të rrezikshme policore". Kjo njësi edhe pse nuk ka ndonjë paketë të plotë trajnimi për t'u ballafaquar me situata të llojllojshme të rrezikshme, ata kanë të kryera disa trajnime për taktika intervenuese, ushtrime fizike dhe manipulim me armë dhe me litarë. Armët me të cilat janë të kualifikuar janë: AK-47 dhe MP-5, 15 zyrtarë policorë edhe pse në posedim kanë edhe pushkë Shotgun, snajper dhe pajisje tjera të cilësisë mjaft të lartë ato nuk përdoren. Ka zhvilluar 23 operacione, ku 15 prej tyre kanë qenë operacione intervenimi.

2.5 Të gjitha këto njësi të specializuara ishin të pajisura me PSO-të e tyre (të cilat kishin hyrë në fuqi me datë 13.07.2007) dhe përmbanin rregullat e angazhimit dhe procedurat tjera të punës. Këto procedura edhe pse sipas të intervistuarve iu duhej kohë për t'u dëshmuar funksionaliteti i tyre, prapë se prapë ishin një lehtësim për personelin e këtyre njësive.

## **Gjendja aktuale**

2.6 Që nga viti 1999 e këtej, nëntë (9) zyrtarë policorë janë vrarë gjatë kryerjes së detyrës. Këto humbje të dhimbshme jete japin një pasqyrim të nivelit të veprave penale ku përfshihet dhuna dhe të cilat ndërlidhen edhe me numrin e madh të armëve ilegale të zjarrit në duart e qytetarëve në Kosovë. Shërbimi Policor i Kosovës në posedim të vetin ka disa lloje të armëve mbrojtëse me të cilat ajo iu shërben dhe i mbron qytetarët si pjesë e misionit të saj në një shoqëri me një numër mjaft të madh të armëve ilegale. Menaxhimi i incidenteve nga ana e SHPK-së në rastet që përfshijnë zbrazjen e armës nga zyrtarët policorë dhe metodat e menaxhimit të mirëmbajtjes së tyre duke përfshirë edhe trajnimin dhe shpenzimet e bëra janë fusha në të cilat Inspektorati Policor është i interesuar. Në tabelë do të paraqesim arsenalin e armëve në posedim nga SHPK-ja.

<b>Tabela 1: Informacione mbi armët në posedim të SHPK-së</b>	
<b>Lloji i armës</b>	<b>Sasia</b>
Glllok 9x19	7.660
Glllok 9x17	45
AK- 47	451
Armë gjysmë automatike	9
MP-5	64
Armë të ndryshme	21 (në depo të logjistikës)

2.7 Shpërndarja e këtyre armëve ishte bërë duke u bazuar në rëndësinë operative të njësiteve të caktuara në strukturën organizative dhe në Parimet dhe Procedurat e SHPK-së. Në tabelën e mëposhtme shohim se Policia Kufitare, FIT-i, NJMO dhe SHSHPK-Departamenti i Trajnimit janë njësitet të cilat përveç se me revole Glllok, janë të pajisur edhe me armë tjera si: MP-5, AK-47, pushkë Shotgun, pushkë Sniper, ku për këto dy të fundit nuk ekziston ndonjë kurs i veçantë i trajnimit në Departamentin e Trajnimit.

<b>Tabela 2: Shpërndarja e armëve në SHPK</b>										
<b>Arma</b>	<b>Regjionet përfshirë edhe NJOMR-të</b>						<b>DPK</b>	<b>Njësitë Speciale (Shtab)</b>		<b>Departa. trajnimit</b>
	<b>Pr</b>	<b>Pz</b>	<b>Gj</b>	<b>Fe</b>	<b>Pe</b>	<b>Mi</b>	<b>Pol. kuf.</b>	<b>FIT</b>	<b>NJMA</b>	<b>SHSHPK</b>
<b>MP-5</b>	5	5	5	5	5	5	-	5	29	-
<b>AK-47</b>	-	-	-	-	9+11	-	35	12	-	31
<b>Shotgun</b>	-	-	-	-	1	-	-	6	-	-
<b>Sniper</b>	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-
<b>Glllok</b>	1.401	844	692	524	874	936	1.103	26	87	126

### **Rekomandimi nr. 1**

IPK rekomandon se për të gjitha armët në përdorim nga SHPK-ja, sa më shpejt të përpilohen dhe të aplikohen kurset e trajnimit para se ato t'u jepen në përdorim zyrtarëve policorë.

2.8 Siç shihet në tabelë, të gjitha NJMO-të janë të pajisura me nga pesë (5) MP-5 përveç NJMO-së nga Peja e cila ka edhe nëntë (9) AK-47, një (1) pushkë hekler dhe një pushkë Shotgun. Në Regjionin e Pejës gjegjësisht në Stacionin Policor të Gjakovës ekzistonin 12 armë të gjata (11 armë AK-47, një pushkë hekler dhe një pushkë Shotgun) të cilat ishin të mbyllura në një dollap të hekurt në zyre të kujdestarisë dhe që më parë ishin përdorur nga një njësit stacioni jashtë strukturës organizative para tranzicionit e që tani janë jashtë funksioni me urdhër të Komandës Regjionale të Pejës.



2.9 Menaxhimi me armët e zjarrit në posedim të SHPK-së janë të parapara në një varg të Parimeve dhe Procedurave të kësaj organizatë. Parimi "Ruajtja e armëve" (P-3.60), "Dhënia e armëve të zjarrit/ trajnimi" (P-4.13), "Zbrazja e armës dhe hetimi mbi policin e përfshirë" (P-4.17) janë disa nga parimet dhe procedurat të cilat duhet që ta rregullojnë këtë fushë. Inspektorati Policor vërejti se menaxhmenti i SHPK-së ende nuk ka përvetësuar apo zhvilluar një metodologji të vetme në lidhje me inspektimin e armëve të zjarrit ku do të kishte një sistem në të cilin çdo armë e zjarrit do të duhej t'i nënshtrohej një kontrollimi mujor të obliguar, duke përdorur një formular zyrtar të SHPK-së që do të evidentoheshin në bazën regjionale/qendrore të cilat do të shërbenin si të dhëna të cilat do të identifikonin trendet e paraqitjes dhe sjelljes së zyrtarëve policor. Kjo situatë ishte e njëjtë në të gjitha regjionet.

## Rekomandimi nr. 2

IPK rekomandon fuqishëm që SHPK-ja të zhvilloj një metodologji të vetme në lidhje me inspektimin e armëve të zjarrit në të gjitha regjionet. Ky sistem duhet të bazohet në parimin se çdo armë e zjarrit duhet t'i nënshtrohet një kontrollimi të obliguar mujor, duke përdorur një formular zyrtar të SHPK-së dhe të evidentohen në bazën e të dhënave regjionale/qendrore. Këto të dhëna mund të analizohen për të identifikuar trendet e sjelljes së SHPK-së (në lidhje me armët e zjarrit) dhe rezultatet e tyre mund të përdoren për të marrë vendime në lidhje me trajnimin, testimin dhe ndëshkimet disiplinore.

2.10 Si formë e vetme për të vërtetuar funksionalitetin e armës zyrtare ishte kujdesi personal i policëve dhe koha kur ata i nënshtroheshin ricertifikimit kur dhe kanë mundësinë për të provuar armën e tyre e cila do të duhej të ndodhte çdo 10-14 muaj, fatkeqësisht ky ricertifikim nuk zbatohet ashtu siç është paraparë. Për t'u kujdesur për armët me defekt të cilat i paraqesin policët në baza individuale kur ata vërejnë ndonjë defekt në armën e tyre, SHPK në shërbim të tij ka pesë (5) serviser të armëve të zjarrit dhe një (1) teknik të municionit, prej të cilëve tre (3) janë të kualifikuar nga kompania austriake "Glllok". Këta serviser veprojnë në bazë të dërgesave të cilat u dërgohen nga Njësitet për Mirëmbajtjen e Armëve në kuadër të Logjistikës së SHPK-së, të cilat bëjnë evidentimin e armëve të zjarrit, rastet e prishjes së armës si dhe të dhënat tjera përcjellëse si municioni, këllëfët, qeset e municionit, etj.

2.11 Gjatë inspektimit, Inspektorati Policor përdori një tabelë në të cilën kërkoheshin të dhëna në lidhje me përdorimin e armëve të zjarrit nga pjesëtarët e SHPK-së gjatë vitit 2007 nga e cila tabelë ishte vërejtur se SHPK-ja ka një numër të konsiderueshëm të rasteve të përdorimit të armës së zjarrit. Në tabelë është vërejtur një kontrast në lidhje me numrin e rasteve nga regjioni në regjion si dhe me vetë të dhënat që ka prezantuar shtabi. Gjatë vitit 2007 sipas të dhënave të marrura nga shtabi kemi pasur 34 raste të nxjerrjes së armës nga policët si dhe 34 raste të shkrepjes së armës nga policët, gjatë vitit 2006 kishte 48 raste të nxjerrjes së armës së zjarrit me 48 raste të shkrepjes së armës, kjo tregon se në të gjitha rastet e nxjerrjes së armës nga policët është shtënë me armë dhe na sjellë te përfundimi se SHPK-ja nuk regjistron të dhënat e vetëm të nxjerrjes së armës ose ato regjistrohen vetëm kur të shtihet me armë. Me Parimin P-4.13, kapitulli 4, pika B, është e paraparë që "përpos gjatë mirëmbajtjes dhe gjatë ushtrimeve, policët nuk guxojnë ta nxjerrin armën apo ta tregojnë armën e zjarrit vetëm nëse rrethanat krijojnë situatë të tillë që lejon të besohet se mund të jetë e domosdoshme të përdoret arma në pajtim me këtë parim".

### Rekomandimi nr. 3

IPK rekomandon që SHPK-ja të dalloj qartë konceptin e nxjerrjes së armës dhe shkrepjes së armës dhe këto kategori të jenë të dallueshme dhe të evidentohen si të vetme.

Tabela 3: Përdorimi i armëve të zjarrit në SHPK						
Lloji i incidentit	Regjionet					
	Prishtinë	Mitrovicë	Prizren	Gjilan	Pejë	Ferizaj
Numri i rasteve të nxjerrjes së armës nga policët	/	97	/	2	1	/
Numri i rasteve të shkrepjes së armës nga policët	/	5	10	2	/	6
Numri i operacioneve për të cilat ka qenë e autorizuar ndërhyrja njësiteve speciale	/	94	/	43	/	55
Numri i incidenteve me armë zjarri ku janë të përfshira njësitë për reagim taktik-FIT	/	1	/	/	/	/
Numri i zbrazjeve aksidentale nga oficer të pa specializuar	/	/	/	/	/	/
Numri i zbrazjeve aksidentale të armëve nga njësitet e specializuara	/	/	/	/	/	/
Numri i policëve të vrarë me armë zjarri	/	/	/	/	/	/
Numri i policëve të lënduar me armë zjarri	/	2	/	/	/	/
Numri i qytetarëve të vrarë nga armë zjarri policore	/	1	/	/	/	/
Numri i qytetarëve të lënduar nga armë zjarri policore	/	/	/	/	/	/
Numri i ankesave nga qytetarët në lidhje me përdorimin e armëve nga policia	/	/	/	/	/	/

2.12 Regjioni i Mitrovicës dallon nga regjionet tjera në evidentimin e rasteve të përdorimit të armëve të zjarrit. Ky regjion bënë evidentim më të saktë të rasteve të ndryshme të përdorimit të armëve dhe statistikat tregojnë se ekziston një numër shqetësues i nxjerrjes së armës nga zyrtarët policore ku vetëm gjatë vitit 2007 kemi pasur 97 raste të nxjerrjes së armës, dy (2) zyrtarë policorë të lënduar me armë

zyrtare zjarri dhe një (1) qytetarë të vrarë nga armë zjarri policore, ndërsa gjithsej janë pesë (5) raste të shkrepjes së armës nga zyrtarët policorë. Regjionet tjera siç shihet edhe nga tabela nuk kanë ndonjë evidencë të tillë, ata kanë arritur që të japin përgjigje vetëm pjesërisht në pyetjet e protokollit ku të dhënat më të kompletuara janë në numrin e rasteve “të shkrepjes së armës nga policët”, ku Gjilani ka dy (2) raste të evidentuara, Prizreni (10), Ferizaj (6), ndërsa Peja ka 1 rast të evidentuar të nxjerrjes së armës.

#### **Rekomandimi nr. 4**

IPK rekomandon që SHPK-ja të aplikoj një metodologji të evidentimit të përdorimit të armëve si në nivelin regjional ashtu edhe në atë qendror që do të bazohet në një mbikëqyrje strikte të policëve gjatë kryerjes së detyrave të tyre nga ana e mbikëqyrësve. Praktika e mirë nga Regjioni i Mitrovicës mund të jetë një bazë fillestare e aplikimit të kësaj metodologjie .

2.13 Në bazë të procedurave të SHPK-së, çdo polic i cili ka përdorur armën duhet që të përpiloj një raport në lidhje me çfarëdo zbrazje të armës së tij- qoftë zbrazje aksidentale apo ndryshe- sa më shpejt që të jetë e mundur dhe çdo herë para se polici ta përfundoj orarin e tij të punës, në ditën kur ka ndodhur incidenti. Raporti i paraqitet mbikëqyrësit të drejtpërdrejt dhe brenda 7 ditëve i dërgohet Zëvendës Komisarit për Administratë (nëpërmjet komandantit të stacionit dhe komandantit regjional). Në të njëjtën kohë një kopje e raportit i dërgohet “Komisionit për vlerësimin e përdorimit të forcës” për të vlerësuar dhe përcaktuar sasinë e përdorimit të forcës. Nëse ekzistojnë dëshmi ‘prima facie’ (e mbështetur në përshtypjen e parë) për ta përkrahur procedurën disiplinore, raporti i dërgohet Komisionit për Përdorimin e Forcës dhe IPK-së.

#### **Rekomandimi nr. 5**

IPK rekomandon që të hartohet një doracak i cili do të përmbaj informata njoftuese ku zyrtarët policorë do të njoftohen mbi rregullat e angazhimit dhe të përdorimit të forcës dhe t’i shpërndahen të gjithë oficerëve policorë

2.14 SHPK posedon rregulloren për trajnim të obligueshëm ricertifikues në përdorim të armëve të zjarrit që do të thotë që së paku një herë në vit çdo zyrtarë i SHPK-së i cili është i autorizuar të mbajë armën e zjarrit, duhet t’i nënshtrohet trajnimit përkatës dhe testimit në mënyrë që t’i rifreskoj njohuritë mbi përdorimin e forcës, të testoj armën e tij dhe të ngritë vetëbesimin në nivelin e sigurisë së tij. Trajnimi ricertifikues sikurse edhe vitin e kaluar vazhdon të jetë një sfidë e madhe për zyrtarët e lartë të SHPK-së, duke ditur se trajnimi dhe testimi i tillë përmes ricertifikimit duhet të jetë një parakusht i nevojshëm për vendimin e autorizimit të zyrtarit policorë, në mënyrë që ai të jetë kompetent në mbajtjen e armës së zjarrit.

2.15 Në kursin e ricertifikimit gjatë vitit 2007 gjatë muajit janar-tetor, kanë qenë 84 grupe me gjithsej 1.810 pjesëmarrës nga të gjitha regjionet, në SHSHPK, si dhe 13 grupe me gjithsej 138 pjesëmarrës nga niveli regjional në Ferizaj. Ricertifikim gjatë dy muajve të 2007 ishte ndërprerë për shkak të mungesës së municionit dhe poligoneve.

Në vend të saj, gjatë periudhës tetor-nëntor ka pasur një kurs një ditor rifreskues për armë zjarri për 222 pjesëtarë të SHPK-së, vetëm në simulatorin "FATS". Të gjithë së bashku kapin numrin prej 2.170 personave të cilët kanë marrë pjesë në një mënyrë a tjetër në ricertifikim dhe përqindja e të ricertifikuarve është 29% e të gjithë zyrtarëve të uniformuar të SHPK-së. Sipas tabelës vetëm regjionet pa Prishtinën dhe pa njësitet e specializuara kanë 2.083 të ricertifikuar, gjë që vë në dyshim përputhshmërinë e shifrave në mes të SHSPK-së dhe të dhënave të marra nga regjionet.

#### Rekomandimi nr. 6

IPK rekomandon SHPK-në që të përcaktoj si prioritet kryesor ricertifikimin e pjesëtarëve policorë duke u siguruar kushte dhe hapësirë të nevojshme.

**Tabela 4: Ricertifikimi nëpër regjione**

	Prishtinë	Prizren	Gjilan	Ferizaj	Pejë	Mitrovicë
Numri i zyrtarëve policor	/	844	692	524	874	936
Numri i të ricertifikuarve	/	801	341	306	260	375
Numri i të pa ricertifikuarve	/	43	351	218	614	561

2.16 Një fushë tjetër e interesimit është ruajtja aktuale e armëve dhe municionit të SHPK-së, në kuptimin e sigurisë së shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës. Në disa vende, sigurimi i vendeve për ruajtjen e armëve ishte jo adekuat, p.sh në Regjionin e Ferizajt, armët dhe municioni ruhen (janë të vendosura) në vende jo të përshtatshme, në sirtar dokumentesh të materialit jo të fortë, në zyrat e mbikëqyrësve të njërive të cilat shpesh ngelin pa kurrfarë kujdesi kur ata largohen nga ato zyre. Regjioni i Prishtinës kishte instaluar disa arka për vendosjen e armëve të cilat ishin të siguruara me kode elektronike e që ishte një fakt mjaft inkurajues. Regjionet tjera përgjithësisht nuk kishin kushtet për sigurim të armëve të cilat kishte Regjioni i Prishtinës, përkundrazi ato ishin në gjendje mjaft të keqe në sigurimin e armëve. Probleme me municion kishin pothuajse të gjitha regjionet edhe pse gjatë inspektimit, inspektorët policor kishin hasur në një fushatë të ndërrimit të municionit nga SHPK-ja. Problem kryesor me municion ishte gëzhoja e dobët e plumbave 9 mm. Si pasojë e ndërrimit të municionit, tani zyrtarët policor kanë në përdorim disa lloje të municionit si NPA 1, NPA 2, MEN 081 dhe tani ishte duke u shpërndarë MAN 07 J 0082. Ky ndërrim i municionit ishte paraparë që të kryhej sipas orarit deri me 22 janar 2008. Problem më i madh gjatë këtij viti kishte qenë mungesa e municioneve si pasojë e së cilës kishte ngecur edhe procedura e ricertifikimit.

#### Rekomandimi nr. 7

IPK për ruajtjen e armëve rekomandon që sa më shpejt të përdoret praktika e mirë e Regjionit të Prishtinës mbi ruajtjen e armëve në arka të siguruara me kode elektronike.

2.17 Financat apo shpenzimet për municion ishin gjithsej 326.739 € dhe obligimi i mbetur për shpenzimet e transportit të këtij municioni është rreth 27.000 €, apo nëse shprehet kjo në përqindje, nga buxheti i ndarë për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është 2.6 %. Ndërsa për pajisje policore dhe armë të zjarrit, planifikimi për vitin 2007 ishte në shumë prej 2.400.000 €, prej tyre disa kanë mbetur si fonde për bartje për vitin 2008 sepse nuk ka qenë e mundur pranimi apo liferimi i tyre me kohë ngase për këto pajisje apo për shumicën prej tyre kërkohet aprovimi i PSSP-së dhe Nju Jorkut që zgjatë shumë dhe vjen situata që nuk mund të realizohen brenda vitit fiskal, njëra pjesë e tyre janë të deklaruara për bartje d.m.th që të pranohen dhe të paguhen në vitin 2008, me mjetet e vitit 2007.

2.18 Përqindja e mjeteve të ndara për pajisje policore dhe armë të zjarrit nëse krahasohet me shumën e investimeve kapitale për vitin 2007 është 17.5 %. Ndërsa planifikimi për vitin 2008 për blerje të municionit është gjithsej 850,000 € por limiti i lëshuar nga MFE-ja është 300,000 €, që sipas SHPK-së nuk mjafton as për së afërmi nevojat e SHPK-se për municion pasi që dihet se çdo pjesëtar i SHPK-se është i obliguar të ricertifikohet çdo 10-14 muaj, d.m.th duhet të gjuaj me armë për t'u ricertifikuar. Me datë 03.07.2007 ishte nënshkruar marrëveshja në mes të kompanisë gjermane "NOËAR" dhe SHPK-së për 1.000.000 (një milion) fishek "MAN" 9 mm për revole "Glo" dhe "MP-5" me vlerë prej 258.292.00 €, ku për një fishek është paguar 0.25 cent. Bazuar në këtë çmim, nëse 7.300 polic ricertifikohen në vit dhe gjatë atij ricertifikimi shpenzojnë nga 60 fishek, kjo don të thotë se ata do të shpenzonin 438.000 fishek e që do t'i kushtonin SHPK-së 109.500 €, d.m.th se ricertifikimi mund të realizohet nga aspekti i municionit. Ndërsa planifikimi për pajisje policore dhe armë zjarri për vitin 2008 ishte 10.400.000 € që përmban pajisje policore si: jelek anti plumb, pajisje specifike për hetuesi, barrikada të rrugës, shufra gome, bateri ,auto blinda, automjete të blinduara, armë zjarri, etj.

### Rekomandimi nr. 8

IPK rekomandon që SHPK-ja dhe institucionet tjera përgjegjëse të kujdesen që zyrtarët policorë t'i furnizoj me rregull me pajisje dhe municion, në mënyrë që të mos përsëriten rastet sikur rasti i vitit 2007 që në mungesë të municionit një numër i madh i pjesëtarëve të SHPK-së të mos mund të përfundojnë ricertifikimin për armë të zjarrit.

### Politikat dhe strategjia

2.19 Sikurse gjatë viteve të kaluara edhe gjatë vitit 2007, Shërbimi Policor i Kosovës ende nuk ka politika dhe strategji të qarta mbi menaxhimin me armët e zjarrit të SHPK-së e të cilat ndërlidhen me mungesën e një strukture ligjore mbi përdorimin e forcës. Sikurse edhe vitin e kaluar, Inspektorati Policor është dëshmitar i zbrazëtirës ligjore e cila ka tash tetë vite që nuk është zgjidhur edhe duke ditur se një ndër parimet themelore të policive demokratike është që gjithmonë duhet të ekzistoj baza ligjore para se të veprojnë policia si ekzekutuese e ligjeve.

2.20 Ligji mbi Policinë është para përfundimit, ku grupet punuese vetëm se kanë dalë me draftet e tyre përfundimtare, e cila përveç shumë çështjeve vitale për SHPK-në do të rregulloj edhe përdorimin e forcës ku do të ia jap edhe kornizën ligjore të përdorimit të saj dhe njëkohësisht do të lehtësoj punën e zyrtarëve policor në zbatimin

e ligjeve të vendit duke ofruar përkrahjen e duhur ligjore. Ky ligj pritet që shpejt të miratohet nga Kuvendi i Kosovës.

2.21 Parimi 4.14 fillon me shpjegimet se zyrtarët policor nuk duhet të përdorin më tepër forcë sesa është e nevojshme për të arritur objektivin legjitim të zbatimit të ligjit dhe se pranon se përdorimi i forcës është akt legjitim dhe pjesë e pa ndashme e zbatimit të detyrave të policit. Në këtë parim shpjegohen qëllimet dhe procedurat për aplikimin e forcës, obligimin për përdorimin e forcës minimale dhe proporcionale, udhëzimet e parashikuara për përdorim të forcës, përdorimi i forcës jo-vdekjeprurëse dhe përdorimin e armëve të zjarrit. Në përdorimin e armëve të zjarrit shprehet seria e forcave vijuese që duhet të ndiqet përveç se ndonjë rrezik më i madh i kanoset policit, ato janë: prezenca e policit si pengesë, urdhrat gojore, kontrolli me duar të hapura (taktikat vetëmbrojtëse, vetëpërmbytjet), spreji OC, shkopi i policit, arma e zjarrit.

2.22 Siç pamë deri më tani nuk kemi asnjë ndryshim në parimet dhe procedurat që nga viti i kaluar mbi përdorimin e forcës. Vitin e kaluar kemi përmendur paragrafin 29 të KEEP-it që thekson: “trajnimi praktik mbi përdorimin e forcës dhe kufizimeve në lidhje me parimet e përcaktuara të të drejtave të njeriut, e veçanërisht me Konventat Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe se e drejta e saj si presidente duhet të përfshihet në të gjitha nivelet e trajnimeve policore”. Prandaj përpilimi i programit trajnues për armë të zjarrit për të gjithë pjesëtarët policore të SHPK-së duhet të bazohet në dispozitat KEEP-it dhe të përfshijë shembuj të hollësishëm në lidhje me atë se si duhet të veprojnë në praktikë parimi i forcës së arsyeshme. Si shkathtësi të cilat ishin veçuar ishin përgatitja e madhe fizike, shkathtësitë e mira psikologjike dhe të atyre për marrje të vendimeve.

2.23 Mungesa e palestrave sportive për të mbajtur lartë nivelin e përgatitjes fizike të oficerëve policorë, ambientet jo të mira të punës dhe stërvitjes, trajnimet dhe ricertifikimet e rralla, komunikimi jo i qartë i kompetencave, janë vetëm disa nga treguesit të cilët ndikojnë që përgatitja fizike, shkathtësitë psikologjike dhe vendimmarrja tek zyrtarët policorë të mos jenë në nivel të kënaqshëm. PSO-të për njësitet e specializuara të SHPK-së kishte vetëm 5 muaj që ishin hyrë në fuqi, ku në disa regjione as që ishin në dijeni për ekzistimin e tyre edhe pse NJMA dhe NJOM kishin adaptuar sisteme unike trajnimi nga MSU italiane.

#### Rekomandimi nr. 9

IPK rekomandon që SHPK-ja të përcaktoj si prioritet të saj përkrahjen për njësitet speciale operative me salla për stërvitje dhe trajnime të ndryshme lidhur me detyrat e tyre të përditshme të cilat do të përfshiheshin në planet aktuale për renovimin dhe ndërtimin e stacioneve të reja.

2.24 Njësitë më elit që ka SHPK-ja- FIT-i, nuk kishte një trajnim i cili do të vinte me një pako trajnimi i cili do të përfshinte një mori të gjerë fushash trajnuese, gjithmonë duke pasur në konsideratë misionet e tyre të ndërlikuara. Përkundrazi, ata kishin kryer trajnime të ndryshme sa që rrezikonte funksionimin e tyre si ekip. Ata edhe pse posedonin një arsenal mjaft të pasur të pajisjeve dhe armëve të zjarrit, certifikimet e tyre ishin të kufizuara. Hapësira ku ata ishin vendosur, në një objekt edhe pse të ri nuk kishte kushtet e nevojshme për të mbajtur në kondicion fizik dhe mendor, komponentë këto të cilat janë vendimtare në marrjen e vendimeve ashtu siç e kërkon

edhe detyra e tyre. Praktikimi i stërvitjeve me armë zjarri dhe ushtrimeve tjera ishte shumë i rrallë, ata ankoheshin në mungesën e një poligoni të dizajnuar për konceptin e tyre të trajnimit si dhe për mungesën e ushtrimeve ku do të përfshiheshin edhe njësi tjera për të koordinuar veprimet në mes tyre.

#### **Rekomandimi nr. 10**

IPK rekomandon që SHPK-ja gjegjësisht Departamenti i Trajnimeve të përcaktoj një pako të kompletuar të trajnimit për njësitin më elit FIT dhe të siguroj kushtet për punë në mënyrë që ky njësit të jetë në gjendje të mbajë në nivelin e duhur aftësitë e tyre fizike, psiqike dhe profesionale.

2.25 Departamenti për Trajnime i SHPK-së që nga viti i kaluar nuk ka pasur shumë ndryshime në konceptin e tij lidhur me trajnimet. Trajnimi themelor për armë të zjarrit është pjesë e programit gjashtë (6) mujor të trajnimit themelor në SHSHPK (QKSPEZH) dhe përbëhet nga një numër i synimeve të mësimin, teorik dhe praktik, gjatë një periudhe 10 ditore. Kadetët e SHPK-së njoftohen me parimet e forcës së arsyeshme (siç përshkruhet në “Doracakun e Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së”), me teknikat e dhënies së ndihmës së parë, përdorimin e sigurt të pistoletës “Glllok” 9 mm, i nënshtrohen vlerësimit të shkathtësive në marrjen e vendimeve në ushtrimet simuluese në pajisjet “FATS” dhe në testet e gjuajtjes me armë në poligonet e gjuajtjes. Vlerësimi formal bëhet në tri fusha: testi teorik me shkrim (përqindja minimale 70 %), shkathtësitë në gjuajtje (minimumi 80 %) dhe ushtrimet në marrjen e vendimit në pajisjet e FATS-it (minimum 3 vendime të suksesshme).

2.26 Ngritja e funksioneve të reja në SHPK, pasurimi i saj me disa njësite të specializuara në përdorimin e armëve, vetëm sa ka rritë fluksin e angazhimeve të këtij departamenti. Trajnimet për armët AK-47 dhe MP-5 janë në kontinuitet për njësitet speciale dhe policinë kufitare. Gjatë periudhës janar-tetor 2007 janë trajnuar gjithsej 246 pjesëtarë të policisë kufitare, në një trajnim me dy ditë teori dhe 8 ditë praktikë (gjuajtje në poligon). Për MP-5 këtë vit nuk ka pasur trajnime për shkak të mungesës së municionit 9 mm.

2.27 Në ish Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës (QKSPEZH) ku është e vendosur Drejtoria për Trajnime Mandatore në kuadër të Departamentit të Trajnimit gjendet edhe Sektori i Armëve të Zjarrit si pjesë e Drejtorisë për Trajnime Mandatore. Ekzistonin paqartësi në lidhje me kompetencat dhe statusin e kësaj qendre nga zyrtarët policor që shërbenin atje. Në një objekt të vetëm ishin të vendosur OSBE-ja, SHPK-ja dhe QKSPEZH-i. Sektori i Armëve të Zjarrit përveç trajnimit të pjesëtarëve të SHPK-së me armë zjarri, ajo bënte trajnimin edhe për shumë institucione tjera si: PTK-në, Shërbimin Korrektues të Kosovës, Shërbimin Doganor, etj. Bazuar në “Planin Strategjik 2007-2010”, QKSPEZH paraqet strategjitë kryesore të saj:

- Përfundimin e tranzicionit nga OSBE-ja në MPB;
- Akreditimin dhe licencimin e qendrës nga MASHT-i;
- Vendosjen e marrëveshjeve të punës me Universitetin e Prishtinës dhe universitetet e licencuara private;
- Vazhdimin e trajnimit themelor për SHPK-në, rishqyrtimin e kurseve sipas nevojës;



- Vazhdimin dhe zgjerimin e trajnimit të specializuar të ofruar për të gjitha organizatat e përfshira në sigurinë publike;
- Ngritjen e kapaciteteve të personelit të qendrës, marrjen e burimeve të nevojshme.

2.28 Gjatë intervistave, IPK-ja kuptoi se me objekt, pajisje dhe para menaxhon QKSPEZH-i ndërsa trajnimet bëhen nga pjesëtarët e SHPK-së, gjë që shkaktonte pakënaqësi dhe probleme tek zyrtarët e SHPK-së të cilët shpesh kishin edhe probleme të identifikonin edhe zinxhirin komandues që ekzistonte atje. Ata gjatë gjithë kohës merrnin detyra nga QKSPEZH-i pa ditur statusin tyre ligjor, p.sh në Sektorin e Armëve struktura organizative kishte 16 instruktor të armëve të zjarrit si pjesëtar të SHPK-së, armëtari ishte pjesëtar i OSBE-së dhe një asistent ishte i QKSPEZH-it. Kjo formë e strukturimit, mosndryshimet në plan programet nga viti i kaluar, trajnimet e mbajtura ekskluzivisht nga SHPK-ja, tregonte se është bërë pak në funksionalizimin e atyre strategjive të lartcekura e që dëmton rëndë SHPK-në, si organizatë që ka nevoja të mëdha në trajnimin, ngritjen e kapaciteteve të veta dhe nuk ka kapacitete të trajnoj edhe organizata tjera.

#### Rekomandimi nr. 11

IPK rekomandon që sa më shpejt të qartësohen marrëdhëniet dhe kompetencat në mes të SHPK-së dhe QKSPEZH-it dhe kjo e fundit të definoj statusin e saj dhe të zbatoj sa më shpejt pikat nga "Plani Strategjik i MPB-së 2007-2010"

2.29 Poligonet e gjuajtjes është një problem që përcjell SHPK-në në vazhdimësi tash e 8 vite, që nga krijimi. Inspektorati Policor vërejti se ekzistonin dy projekte për dy poligonet e Qendrës për qitje me armë. Njëri sipas planit do të duhej të ishte fushor, ndërsa tjetri i mbyllur në objektin e QKSPEZH-it. Në poligonin e hapur që është paraparë që ndërtohet afër Mitrovicës (në fshatin Cërrnush) më parë ishte shfrytëzuar nga SHPK-ja dhe do të ndërtohet nga KFOR-i francez, në bazë të marrëveshjes së bërë në mes të QKSPEZH-it, KFOR-it francez dhe Komunës së Mitrovicës. Poligoni i mbyllur kishte mbetur vetëm në letër dhe nuk kishte ndonjë lëvizje për të realizuar atë edhe pse ishte shumë i nevojshëm sipas të intervistuarve.

2.30 Lidhur me problematikën e poligoneve të gjuajtjes kishte edhe një plan që çështja e trajnimit me armë zjarri të zbres në nivel regjional, ku ishte bërë një planifikim i gjetjes së poligoneve për secilin regjion dhe për të cilat ishin siguruar dokumentacionet nga kuvendet komunale (se këto poligone janë në pronësi të SHPK-së). Poligonet janë caktuar për secilin regjion sipas kësaj renditjeje:


- Departamenti i Trajnimit në QKSPEZH dhe Regjioni i Mitrovicës do të përdornin poligonin në fshatin Cërrnush afër Mitrovicës;
- Regjioni i Gjilanit do të përdorte poligonin e Kamenicës i cili ishte duke u riparuar nga KFOR-i amerikan dhe ai grek;
- Regjioni i Prishtinës do të përdorte poligonin e Goleshit i cili më parë ishte në përdorim nga KFOR-i;



- Regjioni i Pejës do ta përdorte poligonin e Dubravës që gjendet në rrethojën e Burgut të Dubravës;
- Regjioni i Ferizajt do të përdorte poligonin “Agim Ramadani” i cili tani administrohet nga KFOR-i amerikan.

#### **Rekomandimi nr. 12**

IPK rekomandon zyrtarët e lartë të SHPK-së që sa më shpejt të marrin parasysh ndërtimin e poligoneve të mbyllura për gjuajtje nëpër regjione, si objekte të rëndësisë primare, që do të mundësonte zbatimin e planit të SHPK-së për trajnime ricertifikuese.





# MENAXHIMI I BUXHETIT, FINANCAVE DHE PROKURIMIT



## Raport i inspektimit të zakonshëm, nr. 2/2008

### MENAXHIMI I BUXHETIT, FINANCAVE DHE PROKURIMIT

#### 1. HYRJE

1.1 Inspektimi i dytë i zakonshëm mbi SHPK-në në vitin 2008, është kryer me datë 12, 13 dhe 14 maj, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9. Ky inspektim i përqendruar në menaxhimin e buxhetit, financave dhe prokurimit në SHPK, është ndërmarrë nga z. Enver Rustemi, Kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ekipet e inspektorëve policor. Inspektimet janë zhvilluar në Shtabin Qendror të SHPK-së, komandat regjionale dhe në një numër të stacioneve policore. Zyrtarët e Inspektoratit Policor hasën në bashkëpunim dhe gatishmëri të plotë nga ana e personelit të SHPK-së.

1.2 Për funksionimin e çdo organizate buxhetore, menaxhimi i burimeve financiare dhe njerëzore paraqet një ndër elementet kryesore të funksionimit dhe organizimit të tyre. Rëndësia e menaxhimit financiar në SHPK, në pajtim me ligjin në këto fusha është një garanci e një zhvillimi të shëndoshë, efektiv dhe të sigurt të SHPK-së, si organizatë serioze dhe e përgjegjshme, para taksapaguesve. SHPK-ja deri më sot ka arritur një shkallë të zhvillimit, konsolidimit dhe tranzicionit, në drejtim të marrjes së përgjegjësive shtesë. Si rezultat i transferimit të kompetencave nga ndërkombëtarët, që nga viti 2006 buxheti përgatitet dhe menaxhohet nga pjesëtarët e SHPK-së.

1.3 Qëllimi i këtij inspektimi është:

- Verifikimi i implementimit të rekomandimeve nga viti i kaluar të dhëna nga IPK-ja;
- Pajtueshmëria me dispozitat përkatëse të Rregullores 2005/54, Politikave të MPB-së dhe Doracakut të Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së;
- Pajtueshmëria me standardet relevante të Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP);
- Verifikimi i respektimit të ligjeve në fuqi (Ligji i Prokurimit Publik 2003/17, Ligji i Menaxhimit të Financave Publike 2003/2, Instruksioni Administrativ mbi Menaxhimin dhe Regjistrimin e Pasurive Qeveritare nr. 2005/11, etj);
- Të bëhen rekomandime për atë se si zyrtarët e SHPK-së mund të përmirësojnë kryerjen e mëtutjeshme të detyrave policore në drejtim të planifikimit buxhetor, shpenzimit racional dhe të arsyeshëm të mjeteve efikas të shfrytëzimit të mjeteve buxhetore.

1.4 Inspektorët e Departamentit të Inspektimit janë shërbyer me protokollin zyrtar nga fusha „Menaxhimi i buxhetit, financave dhe prokurimit”. Me këtë rast janë intervistuar:

- Zëvendës Komisar i SHPK-së;
- U.d. i Kryesuesit të Shtyllës së Shërbimeve Mbështetëse;
- Asistenti i Zëvendës Komisarit për Krime;
- Drejtori i Drejtoratit të Buxhetit dhe Financave;
- Drejtori i Prokurimit;
- Drejtori i Drejtoratit për Menaxhimin e Objekteve;
- Udhëheqësi i Njesisë së Inspektimit dhe Auditimit;
- Komandantët regjional dhe të stacioneve;
- Shefat e Shërbimeve Mbështetëse Regjionale;
- Zyrtarët financiar në menaxhimin e „Fondit për Operacione të Fshehta”.

1.5 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike, (neni 19) të Kodit Evropian të Etikës Policore.

1.6 Zonat e inspektimit:

- Udhëheqja e SHPK-së;
- Rregullat dhe strategjia e SHPK-së;
- Personeli dhe burimet e SHPK-së dhe
- Paraqitja e SHPK-së.

## 2. UDHËHEQJA E SHPK-së

### Organizimi dhe gjendja aktuale

2.1 Shërbimi Policor i Kosovës që nga themelimi deri më tani i është nënshtruar një zhvillimi dhe transformimi të vazhdueshëm. Në kuadër të këtyre zhvillimeve ka filluar edhe bartja graduale e përgjegjësisë tek vendoret e cila periudhë ka vënë në pah nevojën e ristrukturimit dhe riorganizimit edhe në fushën financiare. Në këtë drejtim, Drejtorati për Buxhet e Financa dhe ai i Prokurimit në kuadër të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse (i cili departament ka zhvilluar aktivitetin në kuadër të Shtyllës së Administratës), pas një ndryshimi në strukturën e organizimit të brendshëm të SHPK-së, funksionojnë në kuadër të Shërbimeve Mbështetëse si shtyllë në vete organizative, jashtë Shtyllës së Administratës.

2.2 Shtylla e Shërbimeve Mbështetëse, përveç Drejtoratit të Buxhetit e Financave si dhe atij të Prokurimit, në përbërjen e saj ka edhe Drejtoratin e Logjistikës, Drejtoratin e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK), Drejtoratin e Laboratorit të Krim Teknikës dhe Drejtoratin e Menaxhimit të Objekteve (DMO).

2.3 Drejtorati për Buxhet e Financa përbëhet nga tre sektor: sektori i buxhetit, sektori i pagave dhe sektori i kontabilitetit. Në kuadër të këtij drejtorati funksionojnë edhe tri zyra financiare: zyra e të hyrave nga dënimet, zyra e menaxhimit të aseteve dhe zyra për mbajtjen e parave të imëta.

2.4 Udhëheqësi i Drejtoratit për Buxhet e Financa ka përfshirje të plotë sidomos viteve të fundit, në të gjitha aktivitetet financiare brenda organizatës. Në nivele regjionale, përgjegjës për buxhet e financa janë komandantët regjional, zëvendës komandantët për administratë, shefat e shërbimeve mbështetëse dhe zyrtarët financiar.

2.5 Deri para disa viteve, buxheti është përcaktuar në bazë të parashikimeve të stafit ndërkombëtar, duke mos marrë parasysh kërkesat e njësive buxhetore, që ka bërë që buxhetet e kaluara të mos jenë mirë të planifikuara. Nga viti 2006, aktivitetet rreth përgatitjes së projekt buxhetit janë intensifikuar në masë të madhe tek personeli vendor në nivel qendror, që ka rezultuar me atë që personeli relevant vendor në çështjet financiare të mund të ketë qasje më aktive. Niveli i transferimit të buxhetit tek regjionet ka qenë në shkallë të ulët. Regjionet menaxhojnë vetëm me paratë e imëta deri në 2.500,00 €, kurse kohëve të fundit vërehen zhvillime pozitive në drejtim të pjesëmarrjes në aktivitetet e përgatitjes apo planifikimit të buxhetit por jo edhe të menaxhimit të tij.

2.6 Ligji i aplikueshëm në Kosovë, parasheh që MPB-ja duhet të marrë rolin udhëheqës në buxhetin dhe financat e SHPK-së. Legjislacioni parasheh që MPB-ja duhet të marrë rolin udhëheqës në drejtimin e çështjeve financiare dhe buxhetore të SHPK-së, në bashkëpunim me MEF-in. Sipas legjislacionit të cekur<sup>1</sup>, roli i ministrisë duhet të përfshijë pjesëmarrjen aktive në planifikimin e buxhetit dhe zhvillimin e një strategjie afatgjate e cila do të sigurojë që SHPK-ja është në gjendje të ofroj shërbime në mënyrën më të leverdishme. Derisa, këtë rol të potencuar më parë nuk e ka marrë MPB-ja më herët, një ndryshim vërehet kohëve të fundit ku roli i MPB-së është në rritje e që shihet në ofrimin e bashkëpunimit të ndërsjellë me instancat relevante të SHPK-së në fushën e buxhetit dhe financave.

2.7 Bazuar në nenet e Rregullores 2005/54, kërkohet nga nivelet më të ulëta se niveli qendror, që të përgatisin plane lokale policore për zonat e kontrolluara, përfshirë prioritetet për atë vit, resurset njerëzore dhe financiare. Nenet e kësaj rregulloreje në këtë mënyrë kërkojnë nga këto nivele të jenë të angazhuara aktivisht në procesin e planifikimit buxhetor të SHPK-së. Nëse nisemi nga këto rregulla, nga viti i kaluar jemi të njohur me shqetësimet e këtyre niveleve për mungesën e konsultimeve përkatëse dhe mos përfshirjen e tyre në vendimet buxhetore dhe financiare. Për dallim nga viti i kaluar, në bazë të intervistave të kryera nga ekipet e inspektorëve në terren, vërehen deri diku ndryshime pozitive në qasjen e menaxhmentit policor në planifikimin buxhetor por mbetet ende për tu bërë në këtë drejtim që do të duhej të rezultonte me një mobilizim të përgjithshëm në procesin buxhetor.

### 3. RREGULLAT DHE STRATEGJIA

#### Buxheti

3.1 Deri në tetor të vitit 2006, nuk ka ekzistuar ndonjë rregull lidhur me përgatitjen e buxhetit, meqenëse të gjithë hapat lidhur me planifikimet buxhetore janë ndërmarrë nga personeli ndërkombëtar i UNMIK-ut, ndërsa në vazhden e kalimit të përgjegjësive më të mëdha nga ndërkombëtarët tek vendoret, në të gjitha aktivitetet rreth planifikimit dhe përgatitjes së buxhetit janë të inkuadruar pjesëtarët e SHPK-së.

3.2 Planifikimi strategjik paraqet procesin me anën e të cilit një organizatë planifikon të ardhmen dhe harton procedurat e operacionet për arritjen e saj.

<sup>1</sup> Aneksi XVI i Rregullores nr. 2005/53

Është prezantuar një Plan Strategjik tre vjeçar 2007-2009<sup>2</sup>, si përmbledhje planesh afatmesme financiare. Nga drejtorati janë prezantuar Planet Vjetore Buxhetore, bazuar në Planin Afatmesëm Strategjik (2007-2009). Hartimi i këtij plani është iniciuar nga Asistenti i Zëvendës Komisarit për Administratë, i përkrahur nga stafi i tij dhe Drejtoria për Planifikim, Parime dhe Çështje Ligjore. Sipas këtij plani, strategjia e buxhetit dhe financave është sigurimi i burimeve financiare përmes Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, me qëllim të përdorimit adekuat të tyre për kryerjen e misionit të Shërbimit Policor të Kosovës, marrja e masave të duhura që të gjitha mjetet e shpërndara në departamente policore të shpenzohen në mënyrë ligjore dhe me përgjegjësi, konform Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike. Planin Strategjik është rezultat i përpjekjeve kolektive të të gjitha departamenteve të cilat kanë ofruar objektivat dhe aktivitetet për të ardhmen.

3.3 Gjithashtu, është prezantuar edhe një Plan Strategjik 2008-2010<sup>3</sup>, sipas të cilit në mesin e prioriteteve strategjike financiare do të jenë: planifikimi, mirëmbajtja dhe mbikëqyrja e shpenzimeve, përmirësimi i menaxhimit të automjeteve, pajisjeve si dhe krijimi i strategjisë për shërbime mbështetëse. Këtë vit, Shërbimi Policor i Kosovës, përmes Drejtoratit për Buxhet e Financa ka përgatitur edhe dokumentin buxhetor si pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2009-2011, të iniciuar nga niveli qeveritar në të cilin janë shtruar synimet dhe objektivat për periudhën e ardhme. Dokumenti përmban planifikimet buxhetore për nivelin qendror dhe regjional për periudhën e ardhme tre vjeçare.

3.4 Bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësi 2003/2, neni 17.5, angazhimet brenda organizatave buxhetore për përgatitjet e planeve buxhetore fillojnë me nismën e Ministrit të Ekonomisë e Financave. Çdo vit kalendarik nga muaji prill, drejtorëve financiar të të gjitha organizatave buxhetore të financuara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK), u dorëzohen qarkoret buxhetore. Janë këta doracak që ofrojnë informata dhe udhëzime mbi metodologjinë dhe formatet të cilat do të përdoren nga organizatat buxhetore gjatë përgatitjes së propozim buxhetit, kërkesat e tyre për përvetësime për vitin e ardhshëm fiskal dhe afatet kohore (kalendar buxhetor) për dorëzimin e këtyre kërkesave<sup>4</sup>. Në këtë mënyrë, drejtorët financiar do të jenë përgjegjës për përgatitjen e propozim buxheteve dhe kërkesave për përvetësime në përputhje me informatat dhe udhëzimet e parashtruara me qarkore dhe dorëzimin e propozim buxheteve dhe kërkesave për përvetësime tek Ministri i Ekonomisë dhe Financave, brenda afateve të caktuara kohore<sup>5</sup>.

3.5 Drejtorati për Buxhet e Financa në vazhden e përgatitjes së propozim buxhetit pas njoftimit për kufijtë buxhetor, njofton të gjitha nivelet duke filluar nga ai qendror e deri tek ai regjional për fillimin e procesit buxhetor, duke bërë edhe shpërndarjen e formularëve të buxhetit. Stacionet policore dorëzojnë në regjione kërkesat e tyre. Pas grumbullimit të tyre, regjionet dorëzojnë kërkesat buxhetore në Drejtoratin për Buxhet e Financa. Kërkesat e niveleve regjionale sipas komandantëve regjional dhe atyre të stacioneve nuk janë marrë shumë parasysh në të kaluarën, për shkak të mos komunikimit të nivelit qendror me atë regjional dhe mundësive të kufizuara financiare të cilat diktohen nga Ministria për Ekonomi e Financa, bazuar në Rekomandimet e mekanizmave ndërkombëtar financiar (FMN, Banka Botërore) me qëllim të mbështetjes së disiplinës fiskale dhe qëndrueshmërisë buxhetore.

3.6 Këtë vit, Zëvendës Komisari i SHPK-së ka formuar komisionin qendror për përgatitjen e projekteve të SHPK-së për Konferencën e Donatorëve, i cili në përbërjen e vet ka pasur drejtorin e Drejtoratit për Buxhet e Financa, përfaqësuesin nga Shtylla

2 Planin Strategjik tre vjeçar 2007-2009, Administrata e SHPK-së, Prishtinë, shkurt 2007.

3 Planin Strategjik 2008-2010.

4 Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nr. 2003/2, faqe 14.

5 Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nr. 2003/2, faqe 14, neni 17.6



e Shërbimeve Mbështetëse, përfaqësuesin nga Zyra e Zëvendës Komisarit të SHPK-së, përfaqësuesin nga Shtylla e Policisë Kufitare, përfaqësuesin nga Shtylla e Policisë Kriminale, përfaqësuesin nga Shtylla e Personelit dhe Trajnimeve dhe përfaqësuesin nga Shtylla e Operatives<sup>6</sup>.

3.7 Drejtorati për Buxhet e Financa përgatitë draft buxhetin në bazë të kërkesave të njëjësive buxhetore të ndara në kategoritë ekonomike të standardizuara. Organizata buxhetore sipas kalendarit buxhetor, dorëzon draftin fillestar buxhetor. Më pas, MEF lëshon Qarkoren e dytë buxhetore me kufijtë të ashtuquajtur të „fortë” buxhetor. Për të përgatitur një plan buxhetor sa më të qëndrueshëm brenda afateve të përcaktuara me këto qarkore, organizata merr pjesë edhe në dëgjimet buxhetore të organizuara nga ana e ekipit qeveritar. Një praktikë e mirë është marrë edhe brenda SHPK-së, me departamentet por jo edhe me nivelet më ulëta, andaj dëgjimet buxhetore do të ishte praktikë e mirë të organizoheshin edhe me nivelet më të ulëta (regjionet dhe stacionet). Hapat e mëtejshëm që ndërmerren janë edhe pranimi i Qarkores së tretë dhe në pjesën e dytë të vitit, bëhet dorëzimi i draft propozim- buxhetit.

3.8 Me planet buxhetore qoftë vjetore apo afatmesme janë të njoftuar një pjesë e menaxhmentit relevant të SHPK-së përmes takimeve të organizuara apo edhe përmes të prezantimit të buxhetit në dokumentet që janë transparente për opinion siç janë librat e shtypur të njohur si raporte financiare, libra buxheti, etj.

3.9 Planifikimi buxhetor kërkon profesionalizëm e qasje serioze të menaxhmentit financiar të kyçur në këtë proces buxhetor. Kur kësaj i shtohet edhe fakti se diku rreth 1/12 e Buxhetit të Kosovës është pjesë e dedikuar për SHPK-në, del edhe rëndësia e përkushtimit të kujdesshëm të menaxhmentit në këto aktivitete. Tabela prezanton pasqyrën e buxhetit të aprovuar të SHPK-së<sup>7</sup>. (shih tabelën 1).

Tabela 1: Buxheti i aprovuar për tri vitet e fundit						
Kategoria	2006	%	2007	%	2008	%
Paga e mëditje	26.508.256	46.63	27.990.051	49.42	27.929.154	46,51
Shërbime e mallra	14.766.925	25.97	13.236.324	23.36	13.836.232	23,04
Komunali	1.000.000	1.76	1.150.000	2.03	1.350.000	2,25
Investime kapitale	14.471.000	25.46	14.169.105	25.01	16.834.718	28.04
Subven. & transf.	100.000	0.18	100.000	0.18	100.000	0,16
<b>Buxheti fillestar-SHPK</b>	<b>56.846.181</b>	<b>100.0</b>	<b>56.645.475</b>	<b>100.0</b>	<b>60.050.104</b>	<b>100.0</b>

3.10 Pjesa më e madhe e buxhetit të SHPK-së që përfshinë gati gjysmën e buxhetit vjetor, është e ndarë në kodin paga dhe mëditje duke pasur parasysh numrin e madh të pjesëtarëve të inkuadruar. Buxheti i vitit 2006 dhe 2007 është diç më i balancuar në krahasim me buxhetin e vitit 2008. Buxheti i vitit 2008 është për 6 % më i lartë se buxheti i vitit 2007 dhe mbi 5 %, se buxheti i vitit 2006 dhe rritja e buxhetit ka ardhur si rezultat i rritjes së Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës por edhe rritjes së kërkesave për investime dhe mirëmbajtje të IT-së, shtimit të objekteve policore, mirëmbajtje të objekteve policore, furnizimit me automjete dhe mirëmbajtje të tyre, etj, por edhe bartjes së disa mjeteve për investime kapitale nga viti 2007 në 2008 në vlerë prej

<sup>6</sup> Vendimi mbi formimin e komisionit për përgatitjen e projekteve për Konferencën e Donatorëve, datë 21.03.08.

<sup>7</sup> Raporti final i inspektimit nr.3/2007 nga fusha „Menaxhimi i buxhetit dhe financave”, faqe 5 dhe Buxheti Vjetor i SHPK-së 2008, në të gjitha kategoritë shpenzimeve.

1.574,718 €, të cilat janë futur në kuadër të investimeve kapitale<sup>8</sup>. Nëse analizojmë kategorinë e pagave dhe mëditjeve për vitet 2006/2007, shihet se kemi ndryshime për shkak të ngritjes së pagave të disa gradave të stafit policor në vitin 2007, që është përcjellë me reduktimin e buxhetit në kodin shërbime e mallra në vitin 2007. Për shpenzime komunale janë ndarë thuajse nivel i njëjtë i mjeteve buxhetore kurse kemi lëvizje me trend të ngritjes në vitet 2007-2008, në kodin investime kapitale, afërsisht rreth 15 %.

3.11 Pasqyrë tjetër më analitike na prezantohet në tabelat e mëposhtme ku kemi një shpërndarje buxhetore sipas programeve buxhetore (departamenteve) për vitet 2006, 2007 dhe 2008. Pasqyra e tillë e prezantuar paraqet një bazë reale për indikacione në

drejtim të ndërrimit të kësaj strukture organizative buxhetore me qëllim të zbërthimit të buxhetit me programe dhe nën programe të reja me funksionale në mënyrë që njësitë buxhetore të kenë qasje më të mirë dhe me transparente lidhur me buxhetin (shih tabelat 2, 3 dhe 4).

Tabela 2: Buxheti i aprovuar për vitin 2006 sipas programeve (departamenteve)

Programi	Paga e mëditje	Mallra e shërbime	Komunali	Investime kapitale	Subven transfer	Totali
Menaxhimi	-	136.387	-	623.000	-	759,387
Operativa	-	675.515	-	264.000	-	939,515
Oper. sp.	-	323.500	-	2.131.000	-	2.454,500
Hetuesitë	-	126.869	-	442.000	-	568,869
Shër. adm.	26.508.256	423.842	-	95.000	100.000	27.127,098
Shër. përk.	-	11.774.912	1.000.000	9.281.000	-	22.055,912
Trajnime	-	699.600	-	751.000	-	1.450,000
Policia kuf.	-	606.300	-	884.000	-	1.490,300
<b>Totali</b>	<b>26.508.256</b>	<b>14.766.925</b>	<b>1.000.000</b>	<b>14.471.000</b>	<b>100.000</b>	<b>56.846,181</b>

Tabela 3: Buxheti i aprovuar për vitin 2007 sipas programeve (departamenteve)

Programi	Paga e mëditje	Mallra e shërbime	Komunali	Investime kapitale	Subven. transfer	Totali
Menaxhimi	-	148.318	-	10.300	-	158.618
Operativa	-	496.279	-	750.000	-	1.246,279
Operac. sp.	-	392.903	-	2.304.402	-	2.697,305
Hetuesitë	-	329.569	-	1.060.000	-	1.389,569
Shër. adm.	27.990.051	225.644	-	50.500	100.000	28.366,195
Shër. përk.	-	10.946.951	1.150.000	9.240.900	-	21.337,851
Trajnime	-	456.772	-	233.900	-	690.672
Policia kuf.	-	239.888	-	519.102	-	758.990
<b>Totali</b>	<b>27.990.051</b>	<b>13.236.324</b>	<b>1.150.000</b>	<b>14.169.105</b>	<b>100.000</b>	<b>56.645,480</b>

Tabela 4: Buxheti i aprovuar për vitin 2008 sipas programeve (departamenteve)

<sup>8</sup> Bartja e këtyre mjeteve ka bërë që kategoria ekonomike e investimeve kapitale të shënoj rritje të konsiderueshme në krahasim me vitin 2006 dhe 2007, rreth 16 % respektivisht 18 % (15.260,000 + 1.574,718 €)=16.834,718

Programi	Paga e mëditje	Mallra e shërbime	Komunali	Investime kapitale	Subven. transfer.	Totali
Menaxhimi	-	110.000	-	-	-	110.000
Operativa	-	419.000	-	623.983	-	1.042.983
Operac. sp.	-	250.000	-	1.982.631	-	2.232.631
Hetuesitë	-	385.000	-	2.059.102	-	2.444.102
Personeli	27.929.154	227.600	-	-	100.000	28.256.754
Shërb. përk	-	11.594.632	1.350.000	11.865.798	-	24.810.430
Trajnime	-	450.000	-	75.665	-	525.665
Policia kuf.	-	400.000	-	227.539	-	627.539
<b>Totali</b>	<b>27.929.154</b>	<b>13.836.232</b>	<b>1.350.000</b>	<b>16.834.718</b>	<b>100.000</b>	<b>60.050.104</b>

3.12 Zyra për Menaxhimin e Aseteve në kuadër të Drejtoratit për Buxhet e Financa, aktivitetet e saj synon ti kryej konform Instruksionit Administrativ 2005/11. Dihet se qëllimi i IA 2005/11 është që të bëjë sigurimin dhe menaxhimin efektiv të pasurisë qeveritare, mbajtjen dhe mirëmbajtjen e saktë të të dhënave mbi pasuritë me qëllim të vlerësimit dhe raportimit të vlerës së tyre...<sup>9</sup>.

## Prokurimi

3.13 Sipas Drejtoratit të Prokurimit, misioni i tij është që të bëjë prokurimin e të gjitha mallrave, shërbimeve dhe punëve për tërë SHPK-së, çdo herë duke respektuar LPP-ne i cili siguron mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen.

3.14 Bazë e kryerjes me sukses të aktiviteteve prokuruese duhet të jetë Ligji mbi Prokurimin Publik të Kosovës. Në Planin Strategjik tre vjeçar 2007-2009, krahas rezultateve evidente janë përmendur edhe vështirësitë në kryerjen e aktiviteteve si prokurimi i pajisjeve të veçanta për nevojat e SHPK-së (armatimi, municioni dhe pajisje për njësitë speciale, etj). Vështirësitë paraqiten për shkak të procedurave shumë të vështira për futjen e këtij malli në Kosovë e që shpesh ka rezultuar me anulim projekti si pasojë e mungesës së ofertuesve të përgjegjshëm.

3.15 Për të pasur më të lehtë kryerjen e aktiviteteve prokuruese, Drejtorati i Prokurimit ka përgatitë çdo vit Planin e Prokurimit, konform neneve 7.1 dhe 7.2 të LPP. Verzioni final i këtij plani pason pas dorëzimit të një versioni preliminar dhe pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për vitin fiskal, dorëzohet në Agjensionin e Prokurimit Publik (APP). IPK-së i janë prezantuar kopjet e Planeve të Prokurimit për vitet 2006, 2007 dhe 2008. Dy të parat janë dorëzuar në muajin janar të vitit 2006 dhe 2007 kurse ai i vitit 2008 është dorëzuar më vonë, shkak i aprovimit të vonshëm të buxhetit, që ka ardhur si rezultat i konsolidimit të pushtetit qendror.

<sup>9</sup> Instruksioni Administrativ 2005/11, Menaxhimi dhe Regjistrimi i Pasurive Qeveritare, neni 1.

## 4. PERSONELI DHE BURIMET E SHPK-së

4.1 SHPK-ja në rrugën e saj tranzicionale është ballafaquar me sfidën e financimit të aspekteve të krijuara kohëve të fundit dhe atyre ekzistuese të një organizate e cila është duke kaluar nëpër ndryshime. Kjo sfidë përfshinë detyrën e vështirë të sigurimit të fondeve të mjaftueshme për përmirësimin e kushteve në objekte policore, investim në teknologji informative dhe aspekte tjera. Këto problematika kërkojnë kreativitet, profesionalizëm të menaxhmentit të SHPK-së për të punuar në drejtim të përmbushjes së synimeve.

4.2 Menaxhimi i suksesshëm financiar, mund të mendohet nëse përforcohet ngritja e performancës së personelit në planin financiar. Meqenëse, buxheti, financat dhe prokurimi janë shumë të koncentruar në nivelin qendror, mund të thuhet se këto fusha janë në masë të dukshme të centralizuara. Në këtë kontekst, del se edhe personeli i cili merret me kryerjen e aktiviteteve financiare dhe prokurorese është përqendruar në këtë nivel, gjë që ka bërë që në regjione të jetë i angazhuar ndonjë zyrtar financiar. Personeli i prokurimit nuk funksionon në nivel regjional.

### Rekomandimi nr. 1

IPK rekomandon që të shqyrtohet mundësia e decentralizimit të fushave si buxheti, prokurimi, flota e automjeteve, logjistika,.. deri në atë shkallë që konsiderohet si e mundur duke ndryshuar skemën e menaxhimit financiar, për të kaluar nga sistemi departament- program, në regjion- program. Drejtorati i Buxhetit e Financave do të luante rol në menaxhim dhe mbikëqyrje të përgjithshme. Ky model do të ishte më funksional dhe efektiv. Në fazën e planifikimit buxhetor rekomandohet menaxhmenti i lartë që të ketë qasje më aktive edhe personeli financiar nga regjionet duke qenë pjesë edhe e dëgjimeve buxhetore në mbrojtjen e kërkesave të tyre.

4.3 Drejtorati për Buxhet e Financa momentalisht udhëhiqet nga Drejtori i Drejtoratit për Buxhet e Financa. Drejtorati ka të angazhuar 13 pjesëtar, ku prej tyre: sektori i buxhetit (2), sektori i pagave (2), sektori i kontabilitetit (2). zyra e të hyrave nga dënimet në trafik (3), zyra e menaxhimit të asetëve (2) dhe zyra për mbajtjen e parave të imëta (1). Drejtorati i Prokurimit udhëhiqet nga Drejtori i Prokurimit. Ky drejtorat në përbërjen e vet ka 14 pjesëtar, nga të cilët: zyrtar të lartë të prokurimit (9), zyrtar prokurimi (2), zyrtar ligjor (1), asistent prokurimi (2). Derisa rreth 70 % e personelit të inkuadruar në aktivitetet financiare është me përgatitje superiore, në anën tjetër tek personeli në aktivitetet prokurorese, ky koeficient silllet rreth 67 %.

4.4 Për dallim nga periudha e mëhershme kur Njësia e Inspektimit dhe Auditimit ka funksionuar në kuadër të Shtyllës së Administratës, pas disa ndryshimeve të bëra në strukturën organizative, kjo njësi aktivitetin e saj e kryen nën autoritetin e Zëvendës Komisarit të SHPK-së. Kjo njësi ka në përbërje shtatë (7) pjesëtar ku prej tyre, rreth 43 % janë me përgatitje superiore shkollore.

4.5 Menaxhmenti i lartë i SHPK-së është i kënaqur me paraqitjen personale të zyrtarëve brenda këtyre drejtorateve. Meqenëse, tek i tërë personeli i SHPK-së aplikohet Rishikimi i Paraqitjes Personale (RPP), ky proces bëhet edhe tek menaxhmenti financiar dhe i prokurimit i kyçur në kuadër të drejtorateve, në periudha kohore vjetore.

4.6 Personeli i Drejtoratit për Buxhet e Financa dhe Prokurimit përveç Free Balance-it (ku kanë qasje persona të autorizuar), nuk posedon ndonjë sistem

(softuer) të menaxhimit intern të informatave. Ndihet nevoja për të krijuar një softuer për mbajtjen e të dhënave interne lidhur me: planifikimin buxhetor, listat e pagave, kontabilitetin, shpenzimet, asetet, evidencën logjistike etj.

4.7 Sipas informatave të marra, ndihet nevojë për trajnime të vazhdueshme të këtyre drejtorateve, ngase ato të cilat janë vijuar nuk mjaftojnë për një aktivitet të suksesshëm. Drejtorati i Buxhetit dhe Financave më pak i është nënshtruar trajnimeve të vazhdueshme (rast konkret është Zyra për Menaxhimin e Aseteve, pjesëtarët e së cilës kanë të kryer vetëm një trajnim treditor të organizuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave lidhur me Modulin e Aseteve), kurse pjesëtarët e Drejtoratit të Prokurimit, i ndjekin trajnimet e organizuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), vetëm sa për të kryer procesin e çertifikimit të tyre si zyrtar të prokurimit.

## Rekomandimi nr. 2

IPK rekomandon që Departamenti i Trajnimeve i Shërbimit Policor të Kosovës, ti kushtoj rëndësi trajnimeve të vazhdueshme, personelit të inkuadruar në Drejtoratin e Buxhetit e Financave, Drejtoratin e Prokurimit dhe atyre të inkuadruar në çështjet e shfrytëzimit të mjeteve dhe kontrollit të shfrytëzimit të tyre.

## 5. PARAQITJA E SHPK-së

5.1 Gjatë inspektimit të kryer, nga ana e Drejtoratit të Buxhetit dhe Financave janë prezantuar pasqyrat financiare lidhur me të hyrat (Fondin e Përgjithshëm të alokuar) dhe shpenzimet për vitet 2006/ 2007. Këto informata janë përmbledhur në këto tabela (shih tabelat 5, 6, 7 dhe 8).

Nr	Emërtimi	Fondi i Përgjithshëm i alokuar		Donacione	Totali
		Të hyra vet.	Granti qever.		
a	b	c	d	e	f
1.	Të hyrat	1.741.951,92	55.946.182,30	921.785,62	58.609.919,84
2.	Shpenzime	972.820,26	49.858.941,86	72.010,70	50.903.772,82
3.	Të hyrat e pashpen	769.131,66	6.087.240,44	849.774,92	7.706.147,02
4.	Mjetet e bartura	769.131,66	0,00	849.774,92	1.618.906,58

Kategoria ekonomike	Buxheti i korigjuar	Alokimet buxhetore	Shpenzimet	Buxheti i pashpenz.	Alokimi i pashpenz.
a	b	c	d	e = (b - d)	f = (c - e)
Paga mëd.	26.955.348,00	26.955.348,00	26.886.970,21	68.377,79	68.377,79
Mall. shërb.	14.575.183,00	14.450.441,00	12.249.711,53	2.325.471,47	2.200.729,47
Komunali	1.191.742,00	1.191.742,00	1.137.676,05	54.065,95	54.065,95
Sub. & tran	172.470,00	172.470,00	89.881,30	82.588,70	82.588,70
Inv. kapitale	14.471.000,00	13.176.131,30	9.494.702,77	4.976.297,23	3.681.478,53
<b>Totali</b>	<b>57.365.743,00</b>	<b>55.946.182,30</b>	<b>49.858.941,86</b>	<b>7.506.801,14</b>	<b>6.087.240,44</b>

Tabela 7: Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2007					
Nr	Emërtimi	Fondi i Përgjithshëm i alok.		Donacione	Totali
		Të hyra vet.	Granti qever.		
a	b	c	d	e	f
1.	Të hyrat	388.392,00	56.346.474,00	904.688,00	57.639.554,00
2.	Shpenzime	212.455,00	51.898.968,00	73.301,00	52.184.724,00
3.	Të hyrat e pashpenz.	175.937,00	4.447.506,00	831.387,00	5.454.830,00
4.	Mjetet e bartura	175.937,00	1.574.718,00	831.387,00	2.582.042,00

Tabela 8: Pasqyra e ekzekutimit të buxhetit në vitin 2007 (granti qeveritar)					
Kategoria ekonomike	Buxheti i korigjuar	Alokimet buxhetore	Shpenzimet	Buxheti i pashpenz.	Alokimi i pashpen.
a	b	c	d	e = (b - d)	f = (c - e)
Paga mëd.	28.105.051,00	28.105.051,00	28.103.354,00	1.697,00	1.697,00
Mall. shër.	13.121.323,00	13.121.323,00	12.100.846,00	1.020.477,00	1.020.477,00
Komunalitë	1.450.000,00	1.450.000,00	1.431.341,00	18.659,00	18.659,00
Sub. & tran	105.000,00	105.000,00	21.212,00	83.788,00	83.788,00
Inv. kapital.	13.565.100,00	13.565.100,00	10.242.214,00	3.322.886,00	3.322.886,00
<b>Totali</b>	<b>56.346.474,00</b>	<b>56.346.474,00</b>	<b>51.898.968,00</b>	<b>4.447.506,00</b>	<b>4.447.506,00</b>

2.2 Nga informacionet e marra dhe të krahasuara del se është një trend i ngritjes së shpenzimeve të përgjithshme për 4 % në krahasim me vitin 2006, pikërisht në kodet ekonomike, paga e mëditje dhe investime kapitale. Por në anën tjetër, duke analizuar shpenzimet në mënyrë individuale shihet se ekziston një tendencë e dukshme pozitive e uljes së shpenzimeve të derivateve dhe mirëmbajtjes së automjeteve. Kemi trend të rënies tek këto shpenzime afërsisht për 19 %. Ky është një sinjal i mirë nga ana e SHPK-së për uljen e këtyre shpenzimeve, sidomos pas shqetësimeve të paraqitura nga Inspektorati Policor i Kosovës, kohë më parë. Tek shpenzimet telefonike të vitit 2006 nuk prezantohet gjendje reale e këtyre shpenzimeve në krahasim më periudhën 2007, për arsye se në vitin 2006, këto shpenzime janë paguar nga kode të ndryshme andaj edhe nuk kemi mundur të bëjmë krahasimin e tyre për këto periudha. (shih tabelën 9)

Tabela 9: Pasqyra e shpenzimeve në disa kode për vitin 2006/2007			
	Shpenzimet	2006	2007
1	Shpenzimet telefonike	16.852,24	88.955,11
2	Derivate për vetura, ngrohje, gjenerator	5.244.663,60	4.232.430,40
3	Mirëmbajtja e automjeteve	1.918.377,18	1.545.808,67

5.3 Brenda SHPK-së ekzistojnë disa burime të inkasimit të të hyrave vetanake, të cilat do të paraqesim në tabelën e mëposhtme. Të hyrat e inkasuara nga ana e Shërbimit Policor të Kosovës, në periudha të caktuara kohore transferohen nga llogaria e SHPK-së, në kuadër të BKK-së dhe varësisht nga marrëveshjet me Ministrinë e Ekonomisë e Financave, ato alokohen për shfrytëzim nga organizata policore. Nga tabela del se edhe pse kemi rënie të inkasimit të të hyrave nga polisat e sigurimit, kemi rritje të inkasimit për shërbimet e ndryshme policore (shitjet nga ankandet,...) dhe kemi një të hyrë të re e cila është inkasuar në vitin 2007, (taksat nga lejet e armëve). Nëse i

referohemi totalit të përgjithshëm për periudhat krahasuese 2006/2007, del se kemi trend pozitiv të inkasimit të të hyrave për 14 %. (shih tabelën 10)

Tabela 10: Pasqyra e të hyrave vetanake të inkasuara për vitin 2006 dhe 2007				
	Të hyrat	2006	2007	Trendi në %
1.	Taksat nga lejet e armëve	0,00	124.966,00	+ 100.0
2.	Shërbimet e ndryshme policore	368.933,12	388.392,63	+ 5.01
3.	Polisat e sigurimit	99.214,03	34.887,71	- 64.8
Totali		468.147,15	548.246,34	

5.4 Zyra për Menaxhimin e Aseteve ballafaqohet me vështirësi rreth mbajtjes së saktë të të dhënave mbi asetet. Kjo është një gjendje e trashëguar që nga koha kur ky aktivitet është udhëhequr nga personeli ndërkombëtar. Personeli në fjalë, deri në mars të vitit 2005 ka mbajtur një evidencë të të dhënave mbi asetet („lotus notes”) i cili pas largimit të tyre ka mbetur jofunksional. Kjo zyrë është munduar të bëjë një bartje informacionesh nga ky sistem por sukcesi ka qenë mjaft i vogël. Për të pasë një gjendje deri diku solide, zyrës i është dashur të angazhohet në grumbullimin e informatave në të gjitha zyrat policore dhe ato të transferuara nga regjionet për të marrë të dhëna mbi asetet nga kopjet e pranimit- dorëzimeve të asetëve nga e kaluara. Zyra në fjalë posedon një listë të asetëve (bazë të dhënave) që nuk është adekuate dhe e cila sipas tyre nuk azhurohet sa duhet. Në nivel regjional, me evidencën e asetëve merret Logjistika Regjionale (MTO).

5.5 Zyra për Menaxhimin e Aseteve nuk ka bërë futjen e të dhënave në Free Balance në mungesë të softuerit i cili është më se i nevojshëm për evidentimin e pasurive (shih paragrafin 4.6). Nuk kemi hasur në ndonjë dëshmi për ekzistimin e Komisionit për Vlerësimin e Asetëve, të cilën e parasheh neni 4 i Instruksionit Administrativ 2005/11. Ky komision i caktuar ad hoc do të duhej të bënte vlerësimin e të gjitha pasurive që i kontrollon organizata policore, vlerësimin e pasurive të dëmtuara dhe vlerësimin e kërkesave për tjetërsim të pasurisë<sup>10</sup>.

5.6 Drejtorati i Prokurimit gjatë një viti arrin të prokuroj mallra, shërbime dhe punë me vlera disa milionëshe euro. Kjo është edhe një tregues i mirë që shtynë që në të ardhmen të mendohet që ky segment të mund të reformohet duke iu nënshtruar procesit të decentralizimit.

5.7 Gjatë kontrollimit të dosjeve të prokurimit, Inspektorati Policor i Kosovës ka hasur në dosje që kanë të bëjnë me ankande publike. Është vërejtur se për periudhën 2006-2008, janë shpallur katër (4) ankande publike për të cilat janë udhëhequr procedura që nuk kanë mbështetje në Ligjin mbi Prokurimin Publik të Kosovës. Në të ardhmen, për të kryer aktivitete rreth ankandëve të tilla, duhet kërkuar rrugëdalje përmes përdorimit të procedurave tjera që do të kishin mbështetje në ligjet e aplikueshme e assesit të kërkohet nga Drejtorati i Prokurimit të udhëhiqet procedurë e cila nuk do të kishte mbështetje në LPP.

5.8 Kur flitet për organizmin e ankandëve, doemos duhet të potencojmë edhe problematikën e shitjes së automjeteve jofunksionale. Sipas personelit të angazhuar, jemi njoftuar se automjetet të cilat janë jofunksionale deri në 70 %, duhet të largohen nga përdorimi pasi tu hiqen pjesët të cilat mund të shërbejnë si pjesë rezervë për automjetet tjera. Sipas dëshmimeve të prezantuara në Drejtorinë e Logjistikës, zakonisht për të vlerësuar gjendjen e tyre teknike mblidhet një komision teknik i cili jep mendimin rreth automjeteve, të cilin ia paraqet Komisionit për Shqyrtimin e Pronës.

<sup>10</sup> Instruksioni Administrativ 2005/11, Menaxhimi dhe Regjistrimi i Pasurive Qeveritare, neni 4.4

Ky komision zakonisht bën vetëm shqyrtimin e pronës si automjete. Në të ardhmen, me çështjet e vlerësimit (shqyrtimit) të pronës do të duhej të merrej Komisioni për Vlerësim të Pasurisë (Aseteve).

### **Rekomandimi nr. 3**

IPK rekomandon që të përfillen procedurat e parapara me Instruksionin Administrativ 2005/11, lidhur me menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive.

5.9 Shqetësim në masë të madhe tek komandantët regjional është paraqitur edhe pamundësia e pjesëmarrjes së regjioneve në mbikëqyrjen e ekzekutimit të projekteve kapitale<sup>11</sup>. Janë paraqitur vërejtje nga ana e tyre lidhur me kontratat mbi ekzekutimin e punëve, sipas të cilave operatorët ekonomik ka qenë dashur që edhe gjatë periudhës garantuese të mënjanojnë defektet e paraqitura në projektet e realizuara.

### **Rekomandimi nr. 4**

IPK rekomandon menaxhmentin e lartë që Drejtoria për Menaxhimin e Objekteve të shqyrtoj mundësinë që niveleve regjionale të iu mundësohet të kenë qasje në mbikëqyrjen e përbashkët të projekteve investive të cilat realizohen.

5.10 Njësia për Inspektim dhe Auditim ka zhvilluar aktivitet të dukshëm për këtë periudhë kohore kurse IPK-së i janë prezantuar raportet e revizioneve të kryera në Drejtoratin e Prokurimit, Buxhetit dhe Financave, etj. Në raporte janë prezantuar të gjeturat gjatë kontrollit dhe janë dhënë rekomandimet. Gjatë inspektimit të këtyre dokumenteve, Inspektorati Policor përkrahë një pjesë të konsiderueshme të rekomandimeve të dhëna nga ana e kësaj njësie. Inkurajuese është puna e kësaj njësie dhe rekomandimet e dhëna me rastin e inspektimeve dhe auditimeve të kryera qojnë në drejtim të përmirësimit të performancës së personelit të SHPK-së në përgjithësi.

<sup>11</sup> Shqetësimet janë paraqitur në Regjionin e Pejës, nga komandantët e stacioneve policore: Gjakovë, Istog dhe Klinë. Informacionet janë siguruar nga ekipi i inspektorëve që kanë kryer inspektimin në këtë regjion.





# ADMINISTRIMI I PLANEVE TË AKTIVITETEVE POLICORE



### ADMINISTRIMI I PLANEVE TË AKTIVITETEVE POLICORE

#### HYRJE

1.1 Inspektimi i tretë i zakonshëm mbi SHPK-në është kryer nga data 4 deri më 10 prill të vitit 2008, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9. Inspektimi i përqendruar në administrimin e planeve të aktiviteteve policore, është ndërmarrë nga z. Enver Rrustemi, Kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës dhe është funksionalizuar nga ekipet e inspektorëve policor. Inspektimet janë zhvilluar në Shtabin Qendror të SHPK-së, Komandat Regjionale, në një numër të stacioneve policore dhe Kuvendeve Komunale. Zyrtarët e Inspektoratit Policor janë ndarë të kënaqur me bashkëpunimin e plotë të personelit të SHPK-së, kryetarët e Kuvendeve Komunale dhe me gatishmërinë e tyre për të ndihmuar.

1.2 Policia është e organizuar që të gëzojë respektin e publikut si një strukturë profesionale për mbrojtjen e ligjit dhe sigurimin e shërbimeve për publikun. Si e tillë duhet të jetë e organizuar në mënyrë që të vendosë marrëdhënie të mira me publikun, si dhe sa herë që nevojitet, një bashkëpunim të efektshëm me agjencionet tjera, komunitetet lokale, organizatat joqeveritare dhe grupe të tjera përfaqësuese të publikut, duke përfshirë grupe të pakicave kombëtare<sup>1</sup>.

1.3 Rregullorja 2005/54 kërkon partneritet lokal në mes të komandantëve të policisë dhe autoriteteve komunale në përgatitjen e planeve vjetore të policisë, të cilat përmbajnë strategji për sigurinë e komuniteteve me qëllime dhe objektiva të qarta. Plani vjetor i policisë i cili kërkohet nga Komandantët e Stacioneve Policore sipas Rregullores 2005/54 duhet të planifikohet në kuadër të strategjisë për një periudhë mesatare, duke përmbledhur këtu kahjen strategjike të SHPK-së në nivel lokal. Plani vjetor duhet të përfshijë qëllimet dhe objektivat e përgjithshme të Komisarit, që ka për SHPK-në dhe të përmbajë që të dyja si prioritetet operative po ashtu edhe jo operative. Në mënyrë të qartë duhet të tregohen objektivat dhe caqet kryesore të SHPK-së së bashku me vlerësimin për burimet e pasojave. Planet lokale të aktiviteteve policore duhet të jenë të përkrahura nga planet e divizioneve dhe departamenteve të cilat reflektojnë atë se si duhet që ato të kontribuojnë në objektivat e përgjithshme të SHPK-së. Ato gjithashtu duhet që të reflektojnë (tregojnë) edhe prioritetet e identifikuar nga strategjitë e ndryshme për sigurinë në komunitet të vendosura nga partneriteti përgjegjës i Autoriteteve Komunale në rajon. Si shtesë, plani duhet të tregojë se si SHPK-ja ka për qëllim të shpërndajë fitimet efektive. SHPK duhet të jetë në gjendje që të demonstrojë se si këto kërkesa të ndara bashkohen nga një proces koherent i planifikimit strategjik. Secili planifikim lokal i aktiviteteve policore duhet që të prezantohet përmes konsultimeve të gjëra të brendshme dhe të jashtme.

1.4 Qëllimi i inspektimit nën këtë protokoll është që të jepen rekomandime se si menaxherët e lartë të SHPK-së do të mund të përmirësonin administrimin dhe paraqitjen e menaxhmentit të administrimit të planeve të aktiviteteve policore në ndjekje të qëllimeve në vijim:

- Të sigurohet përputhshmëri me Kodin Evropian të Etikës Policore;

<sup>1</sup> Kodi Evropian i Etikës Policore (KEEP)

- Të sigurohet përputhshmëri me Rregulloren 2005/54 dhe dispozitat relevante të ligjit të aplikueshëm;
- Të inkurajojë menaxhment profesional të burimeve policore në nivel lokal;
- Të inkurajojë konsultimet e SHPK-së me komunitetet lokale si pjesë e procesit;
- Të planifikojë aktivitetet policore;
- Të identifikoj dhe përhapë praktikat më të mira në planifikimin e aktiviteteve policore.

1.5 Inspektorët e Departamentit të Inspektimit janë shërbyer me protokollin zyrtar nga fusha 'Administrimi i planeve të aktiviteteve policore'. Me këtë rast janë intervistuar dhe vizituar:

- Asistenti i Zëvendës Komisarit për Operativë;
- Kryetarët apo Zëvendëskryetarët e Kuvendeve Komunale;
- Udhëheqësi i Drejtorisë për Analizë të Politikave të SHPK-së;
- Udhëheqësi i Departamentit të Rendit Publik;
- Udhëheqësi i Njesisë për Policinë në Komunitet;
- Udhëheqësi i Departamentit për Çështje të Komunitetit;
- Komandantët Regjionalë, Komandantët e Stacioneve Policore;
- Udhëheqësit e Njësive të Policisë në Bashkësi.

1.6 Zonat e inspektimit:

- Udhëheqja e SHPK-së;
- Rregullat dhe strategjia e SHPK-së;
- Personeli i SHPK-së;
- Partneriteti dhe burimet
- Rezultatet.

1.7 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike, (neni 19) të Kodit Evropian të Etikës Policore.

## UDHËHEQËSIA E SHPK-së

### Organizimi dhe gjendja aktuale

2.1 Shërbimi Policor i Kosovës funksionon sipas strukturës organizative të ndërtuar me një bazë të qëndrueshme, duke zhvilluar veprimtarinë e vet në dy nivele të organizimit: në atë qendror dhe atë lokal (përfshirë atë regjional). Meqenëse, fushë e cila është inspektuar është administrimi i planeve të aktiviteteve policore, vlen të qartësohet se aktivitetet e atyre niveleve janë të lidhura kryekëput me hartimin e planeve policore dhe administrimin e tyre.

2.2 Shtylla Operative përgjithësisht është e angazhuar në të gjitha çështjet operacionale të cilat implementohen në kuadër të SHPK-së, duke marrë parasysh edhe koordinimin dhe bashkëpunimin me shtyllat tjera brenda SHPK-së si dhe agjensionet tjera jashtë organizatës. Në kuadër të Departamentit të Rendit Publik, veç tjerash, zhvillon aktivitetet edhe Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim.

2.3 Drejtoria për Planifikim e Zhvillim është themeluar në kuadër të Departamentit të Rendit Publik, për t'i adresuar çështjet operative në realizimin e detyrave të ofrimit të shërbimeve të përditshme ndaj qytetarëve, të parandalimit të krimeve dhe të ruajtjes dhe mbrojtjes së rendit publik<sup>2</sup>.

2.4 Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim (DPZH) angazhohet për përpilimin e planeve operative dhe kujdeset për monitorimin e tyre. Zakonisht DPZH-ja përpilon plane kur janë të përfshira në implementim dy e më shumë regjione, kur ka të bëjë me situatat shumë serioze, etj. Në rastet kur barrën e monitorimit të implementimit e mban niveli qendror, regjionet raportojnë për mbarëvajtjen e atyre planeve.

2.5 Përveç planeve të përpiluara nga ana e kësaj Drejtorie, e të cilat janë obligative për implementim nga regjionet/ stacionet/ njësitë, ekzistojnë edhe planet të cilat hartohen nga nivelet më të ulëta të cilat implementohen nga ana e tyre, por që nuk kërkojnë miratim nga niveli qendror (për këto plane, niveli qendror vetëm njoftohet). Planifikimi lokal i aktiviteteve policore në nivel më të ulët bie në kompetencë të Komandantit Regjional dhe Shtyllën e Operativës e cila në koordinim me planet dhe strategjitë të cilat vijnë nga niveli qendror bënë implementimin e tyre në regjionin përkatës dhe ka autonominë e hartimit të planeve vetanake në nivel lokal. Për administrimin e planeve lokale të aktiviteteve policore, përgjegjës janë komandantët e stacioneve. Në tabelën e mëposhtme kemi prezantuar të dhënat lidhur me planet e hartuara/ realizuara gjatë vitit 2006 dhe 2007. Tabela pasqyron planet e përpiluara nga niveli qendror dhe ai regjional (përfshirë këtu edhe atë lokal). Për dallim nga Regjioni i Gjilanit ku numri i planeve të hartuara është më i madh në vitin 2006, në regjionet tjera numri i planeve të hartuara është dukshëm më i madh në vitin 2007 (shih tabelën 1).

Nr	Regjioni	2006	2007
1	Regjioni i Prishtinës	92	191
2	Regjioni i Pejës	63	111
3	Regjioni i Prizrenit	70	141
4	Regjioni i Gjilanit	123	106
5	Regjioni i Mitrovicës	22	42

<sup>2</sup> Procedurat Standarde të Operimit të Drejtorisë për Planifikim e Zhvillim, faqe 3, janar 2007, Prishtinë

6	Regjioni i Ferizajt	58	153
7	Shtabi i Përgjithshëm	17	35

2.6 Planet operative mund të jenë të hartuara vetëm për një operacion policor, që mund të ketë kohëzgjatjen e realizimit vetëm disa orë, por edhe mund të jenë plane që zgjasin më shumë (plani operativ „Siguria e rreptë”; „Statusi”; „Siguria e nxënësve në trafik”, etj). Janë këto plane të hartuara dhe të monitoruara nga niveli qendror. Shumica e planeve të hartuara kanë pasur të bëjnë me angazhimin e përgjithshëm, në ofrimin e sigurisë dhe rendit publik, përmes shtrirjes së patrullimeve me qëllim të mbulimit të terrenit në përgjegjësi, ngritjen e sigurisë në komunikacion e arritur përmes koncentrimin të shtuar në lokacione të ndjeshme, në angazhimin e përcjelljes dhe sigurimit të delegacioneve të ndryshme, etj.

2.7 Çdo polici demokratike duhet të jetë në gjendje t'i shërbejë komunitetit të vet në ofrimin e vazhdueshëm të qetësisë, parandalimin dhe reduktimin e krimit, zbulimin e kryerësve të veprave penale, respektimin e ligjit, mbrojtjen e pronës dhe pasurisë së qytetarëve, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe sigurimin e rendit dhe qetësisë publike. Standardet evropiane kërkojnë një organizim të policisë në mënyrë që të sigurojë policim të mirë në marrëdhëniet me publikun dhe të ketë bashkëpunim efektiv e të përshtatshëm me institucione tjera, kuvendet komunale, bashkësitë lokale, organizatat joqeveritare dhe përfaqësues të tjerë të publikut, përfshirë edhe grupet minoritare etnike<sup>3</sup>.

2.8 SHPK-ja është e përkushtuar në përmirësimin e kualitetit të jetës së të gjithë qytetarëve në fushën e sigurisë. Në vazhden e ofrimit sa më afër me qytetarëve, në kuadër të SHPK-së vepron Njësia për Policinë në Komunitet (NJPK), si njësi e posaçme organizative e cila me aktivitetin e saj angazhohet në shumicën e planeve policore. Organizimi dhe veprimtaria e kësaj Njësie është konform organizimit të njësive si motra të SHPK-së, përkatësisht në nivelin qendror, regjional dhe atë lokal dhe funksionon si një shërbim unik me një komandë qendrore. Qëllimi i themelimit të kësaj njësie është për të reflektuar përkushtimin e Shërbimit Policor të Kosovës, për të punuar me komunitetin të cilit i shërben, për t'u kujdesur dhe për ta mbrojtur atë. Njësia ka zyrën qendrore në Shtabin Kryesor të Policisë, në çdo Regjion nga një zyrë, të vendosura në zyrat e Shtabeve Regjionale dhe në secilin stacion të policisë nga një zyrë.

2.9 Njësia synon:

- t'i bëj komunitetet më të sigurta duke identifikuar dhe adresuar brengat e tyre përmes zgjidhjes dhe parandalimit të problemeve;
- të ofroj një prezencë të dukshme efektive në komunitet;
- zbatimin e projekteve për veprim policor në komunitet dhe zhvillimin e partneriteteve që janë në funksion të promovimit të sigurisë së komunitetit.

2.10 Këto Njësi edhe pse kanë kryer shumë aktivitete, nuk përfillen sa duhet nga menaxherët e stacioneve dhe duke pasur parasysh kontaktet e tyre me komunitetin, nuk konsultohen dhe nuk shfrytëzohen sa duhet nga njësitet tjera, për t'i paraprirë veprimeve të njësive në aspektin parandalues. Ka raste kur komandantët e stacioneve i ngarkojnë ata me detyra të tjera të karakterit reaktiv, të cilat dëmtojnë prestigjin e këtyre policëve, të cilët si armë të vetme kanë respektin që gëzojnë tek komuniteti

<sup>3</sup> KEEP, neni 18, f.32.

dhe që bie ndesh edhe me Parimin 5.12, sipas të cilit „policët e kësaj njësie nuk do të caktohen në detyra dhe punë tjera operative, përveç rasteve emergjente”.

2.11 Është e pashmangshme të flitet për planet lokale e të mos potencohet roli i KKSB-ve dhe SHPK-së në këtë aspekt. Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi janë grupe konsultative, të planifikuara për të ndihmuar bashkëpunimin në mes të SHPK-së, autoriteteve komunale dhe përfaqësuesve të bashkësive, për ngritjen e sigurisë së pjesëtarëve të të gjitha bashkësive në çdo komunë<sup>4</sup>. Vitin e kaluar IPK-ja ka zhvilluar një inspektim të jashtëzakonshëm në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 7, të Rregullores 2005/54 (Marrëdhëniet me bashkësinë), me theks të veçantë emërimi i komandantëve të stacioneve policore në bazë të nenit 7.11 dhe 7.12 dhe mbi obligimet ligjore që dalin për kryetarët e komunave për themelimin e KKSB-ve dhe mbi obligimin e komandantëve të stacioneve policore për raportimin dhe dorëzimin e Planit Vjetor të ky këshill.

2.12 Gjatë vitit 2007 në pjesën dërmuese të komunave kanë qenë të themeluara këto këshilla dhe kanë mbajtur disa takime me komandantët e stacioneve. Mirëpo, gjendja është ndryshe në këtë vit. Deri në muajin e katërt (prill) në shumicën e komunave nuk janë themeluar këto këshilla. Ka pasur disa takime të organizuara nga OSBE-ja, SHPK-ja dhe ICITAP-i, për t'i informuar kryetarët e komunave për rolin dhe rëndësinë e këtyre këshillave, gjë që IPK-ja e vlerëson kontributin e tyre që kanë dhënë në këtë drejtim. Gjithashtu, IPK-ja i kupton rrethanat se në disa komuna ka pasur zgjedhje të raundit të dytë, e cila mund të ketë ndikuar që themelimi i këtyre këshillave të bëhet me vonesë, por çështja e sigurisë duhet të jetë prioritet për të gjithë dhe kryetarët e komunave duhet t'i formojnë sa më shpejtë që të jetë e mundur, pasi që është në interes të sigurisë së komunitetit dhe të krijojnë partneritet me SHPK-në për çështje të sigurisë ashtu siç e parasheh Rregullorja 2005/54.

#### **Rekomandimi nr. 1**

IPK rekomandon themelimin e KKSB-ve dhe inkurajon palët (kuvendet komunale dhe SHPK-në) që të krijojnë partneritet për çështje të sigurisë.

2.13 Gjatë këtij viti, Komisari i Policisë ka themeluar KLSP-të (Këshillat Lokale për Siguri Publike) në rajone më të vogla në kuadër të komunave në ato vende ku ka qenë në interes të kryerjes së efektshme të detyrave të policisë dhe të marrëdhënieve të mira me të gjitha bashkësitë, veçanërisht duke e pasur parasysh përbërjen demografike të rajonit në fjalë. KLSP-të mund të diskutojnë çdo çështje lidhur me politikat dhe rendin e sigurinë publike në atë lokalitet, por në secilin rast duhet të konsultohen për: planin e detyrave të policisë në atë lokalitet dhe paraqitjen e rezultateve të arritura, vendet në atë lokalitet ku duhet të themelohen nënstacione të policisë në fshatra dhe përbërjen e policisë të caktuar në lokalitet.

2.14 Në tabelën e mëposhtme prezantojmë informatat mbi themelimin e KKSB-ve dhe KLSP-ve në shumicën e komunave, në përjashtim të disa komunave të Regjionit të Mitrovicës (shih Tabelën 2).

<sup>4</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2005/54, neni 7.3

Tabela 2: Të dhënat lidhur me themelimin e KKSB-ve dhe KLSP-ve					
Regjioni policor	Komuna	KKSB		KLSP	
		2007	2008	2007	2008
Prishtina	Prishtinë	po	jo	jo	jo
	Podujevë	po	jo	jo	jo
	Fushë Kosovë	po	jo	po	jo
	Drenas	po	jo	jo	jo
	Obiliq	po	jo	jo	jo
	Lipjan	po	jo	po	po
Pejë	Pejë	po	jo	po	po
	Gjakovë	jo	po	jo	jo
	Deçan	po	jo	jo	jo
	Istog	po	po	jo	jo
	Klinë	po	po	jo	jo
Gjilan	Gjilan	po	jo	po	jo
	Viti	jo	jo	po	jo
	Kamenicë	po	jo	po	jo
	Novo Bërdë	po	jo	jo	jo
Ferizaj	Ferizaj	jo	po	po	Jo
	Kaçanik	po	jo	jo	jo
	Shtime	po	jo	po	jo
	Shtërpcë	jo	jo	po	jo
Prizren	Prizren	po	jo	jo	jo
	Suharekë	po	jo	jo	jo
	Rahovec	po	jo	jo	jo
	Malishevë	po	po	jo	jo
	Mamushë	po	po	jo	jo
	Dragash	po	po	jo	jo
Mitrovicë	Mitrovicë	po	jo	jo	jo
	Vushtrri	po	po	po	po
	Skënderaj	po	po	po	po

## RREGULLAT DHE STRATEGJITË

3.1 Procesi i hartimit të politikave dhe strategjive është një proces që nënkupton një konsultim më të gjerë me të gjithë faktorët relevant për të arritur deri tek përcaktimi i prioriteteve për një periudhë kohore të caktuar. Planet lokale duhet të jenë të bazuara në planin strategjik dhe nëse i referohemi Planit Strategjik 2008-2010, prioritetet strategjike renditen si në vijim:

- **Ofrimi i sigurisë për qytetarët:** krijimi i strategjive të cilat në mënyrë efektive do t'i qaseshin krimit, do të merreshin me problemet e komunitetit si dhe zhvillimi dhe implementimi i programeve parandaluese proaktive për evitimin e viktimizimit të qytetarëve nga krimi;



- **Mbrojtjen – përkujdesjen për të rinjtë:** qasja koordinuese me faktorët e nevojshëm me qëllim të krijimit të një mjedisi të sigurt në institucionet shkollore, vendet publike dhe në ato rekreative;
- **Përgatitja për situata emergjente:** zhvillimi i kapaciteteve dhe i mundësive në bashkëpunim me qeverinë dhe komunitetin, në përgjigje emergjente;
- **Qasja ndaj komunitetit:** ndërtimi dhe thellimi i besimit të komunitetit, zhvillimi dhe implementimi i strategjisë për siguri të komuniteteve;
- **Siguria në rrugë:** hartimi dhe zhvillimi i planeve për qarkullim të sigurt, zvogëlimin e aksidenteve të trafikut<sup>5</sup>.

3.2 Rregullorja 2005/54, Parimet dhe Procedurat e SHPK-së janë baza e veprimit të SHPK-së në përgjithësi dhe baza e hartimit të planeve lokale policore në veçanti. Për t'i arritur këto synime, SHPK-ja është e detyruar që në përputhje me këto dokumente, të dalë me plane lokale të aktiviteteve policore në zonat e përgjegjësive së vet.

3.3 Nëse i referohemi të dhënave nga inspektimi i jashtëzakonshëm i zhvilluar në prill të vitit 2007, IPK ka gjetur shumë pak dëshmi lidhur me atë që komandantët e stacioneve respektojnë dispozitat e nenit 7.13 b<sup>6</sup>. Edhe pse në disa zona, komandantët e stacioneve ia dërgojnë KKSB-ve, planet vjetore regjionale të SHPK-së, këto plane nuk i plotësojnë kushtet që kërkohen në nenin 7.13. E njëjta gjë është vërejtur edhe gjatë inspektimit të këtij viti. Një numër i stacioneve policore ka dorëzuar planet policore me gjithë të metat e potencuara, por ekziston edhe një numër i tyre që fare nuk i kanë dorëzuar këto plane. Disa stacione policore kanë planet dhe prioritetet për vitin vijues, por ato janë të hartuara pa konsultime me faktorët tjerë relevant. Njëherit, nuk figurojnë si pjesë e Planit Vjetor që duhet dorëzuar KKSB-ve.

## Rekomandimi nr. 2

IPK rekomandon menaxherët e lartë të SHPK-së që gjatë procesit të hartimit të prioriteteve dhe planeve të kenë një konsultim më të gjerë me të gjithë faktorët relevant për të arritur deri tek përcaktimi i prioriteteve për një periudhë kohore të caktuar. Njëherit këto plane lokale duhet të jenë pjesë e Planit Vjetor i cili duhet dorëzuar në KKSB.

## PERSONELI I SHPK-së

4.1 Ajo që është vërejtur në disa stacione është mungesa e stafit për të plotësuar strukturën organizative. Nëpër disa stacione policore kjo mungesë e personelit ka ndikuar që të mos arrihet efikasiteti i dëshiruar. Këtë e bazojmë në faktin se në disa stacione policore, planet mund të mos konkretizohen për shkak të mungesës së personelit.

<sup>5</sup> Plani Strategjik i Shërbimit Policor të Kosovës 2008-2010, faqe 10.

<sup>6</sup> Raporti i inspektimit të jashtëzakonshëm „Inspektimi i SHPK-së lidhur me pajtueshmërinë me nenin 7, të Rregullores 2005/54”, paragrafi 3.4, faqe 11.

4.2 Problem tjetër paraqet bojkotimi i punës së disa policëve serbë që ka ndikuar në shtimin e orëve të punës për policët tjerë. Pas shpalljes së pavarësisë një numër i madh i policëve serbë bojkotuan punën në shenjë pakënaqësie dhe me arsyetimin se ata njohin si të vetmin autoritet në vend policinë ndërkombëtare të UNMIK-ut, duke përjashtuar autoritetin e SHPK-së.

### Rekomandimi nr. 3

IPK rekomandon menaxherët e lartë të SHPK-së që të bëjnë një analizë të gjendjes së tanishme pas bojkotimit të punës nga ana e policëve të minoritetit serb dhe të hartojnë një plan për zgjidhjen e këtij problemi duke e bërë një mbulim të territorit me polic dhe mbështetje logjistike në mënyrë proporcionale me numrin e banorëve dhe shkallën e kriminalitetit.

4.3 IPK-ja ka vërejtur mosharmonizim në përpilimin e planeve ndërmjet shtyllave, departamenteve dhe drejtorateve të SHPK-së. Kjo bëhet edhe për arsye se SHPK-ja nuk ka investuar sa duhet që personelin përgjegjës për hartimin e planeve ta pajisë me trajnimet e nevojshme apo të duhura. Vërejtjet nga regjionet dhe stacionet kanë të bëjnë me atë se planet nga Shtabi përpilohen pa konsultime, apo pa i marrë në konsideratë nevojat dhe sugjerimet e stacioneve dhe të bashkësisë dhe nuk ka planifikime mbi mënyrën dhe koston e realizimit.

### Rekomandimi nr. 4

IPK-ja rekomandon që SHPK-ja t'i dërgojë në trajnim menaxherët që merren me hartimin e planeve policore lokale dhe që planet e saja t'i përcjell me afate kohore të implementimit të cilat do të përfshinin një monitorim më vigjilent të zbatimit dhe vlerësimit të efikasitetit të tyre.

## PARTNERITETI DHE BURIMET

5.1 IPK ka vërejtur se pas zgjedhjeve të organizuara në nivel lokal dhe atë qendror, në shumicën e komunave nuk është arritur që të themelohen Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB) apo të vazhdojnë punën nga KKSB-të e mëparshme. Në disa komuna/ stacione policore, takimet e javës që mbahen për siguri janë identifikuar me KKSB-të, gjë që nuk është e njëjtë. Takimet javore për siguri janë takime të rregullta që organizohen nga KFOR-i dhe kanë për qëllim sigurinë e përgjithshme që është në mandat të KFOR-it. Ndërsa, takimet e KKSB-së ku merr pjesë kryetari i komunës, komandanti i stacionit policor dhe anëtarë të tjerë të këshillit, janë takime që mbahen për të diskutuar, informuar apo raportuar për problemet dhe gjetjen e mundësive për t'i luftuar dukuritë negative në bashkësi si: armët, droga, trafikimi i qenieve njerëzore, krimi i organizuar, etj.

5.2 Partneriteti ndërmjet SHPK-së, KKSB-ve dhe komunitetit është i domosdoshëm për parandalimin dhe luftimin e krimit. Shërbimi Policor i Kosovës duhet të bashkëpunojë plotësisht me autoritetet komunale dhe me përfaqësuesit e bashkësive për ngritjen e sigurisë së pjesëtarëve të të gjitha bashkësive në çdo komunë. Në disa komuna bashkëpunimi ndërmjet SHPK-së dhe KKSB-ve është kuptuar si një bashkëpunim vartësie dhe jo partneritetit. SHPK-ja dhe KKSB-ja janë të obliguara që të bashkëpunojnë në bazë të ligjit. SHPK-ja është në shërbim të

komunitetit por është e pavarur nga çdo trupë dhe vepron në mënyrë të paanshme. Siç dihet çdo bashkëpunim obligon palët në bazë të kornizave ligjore të cilat parashohin një bashkëpunim të caktuar dhe këto marrëdhënie, patjetër duhet që ta ruajnë karakterin e përcaktuar ligjor.

#### **Rekomandimi nr. 5**

IPK-ja rekomandon komandantët e stacioneve dhe kryetarët e komunave që të qartësojnë rolin dhe përgjegjësitë e tyre në bazë të ligjit në fuqi.

## **REZULTATET**

6.1 Sipas Rregullores 2005/54 Komandantët e stacioneve (dhe komandantët regjional) në fillim të vitit duhet të njoftohen me synimet e qarta të KKSB-së për vitin e ardhshëm, pastaj në fund të vitit komandantët duhet t'i raportojnë KKSB-së lidhur me sukseset e tyre në arritjen e këtyre synimeve. Ky proces lë të kuptohet se synimet duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme dhe reale.

6.2 Policimi me komunitetin është një mënyrë e cila e përfshin të gjitha bashkësitë në parandalimin e krimit në veçanti, por edhe në zbulimin e krimit. Në përgjithësi SHPK-ja është duke treguar një nivel të kënaqshëm në lidhje me menaxhimin e planeve lokale policore. Mirëpo, standardet evropiane kërkojnë një organizim më të përgjithshëm të policisë në një mënyrë që të sigurojë policim të mirë në marrëdhëniet me publikun dhe të ketë bashkëpunim efektiv dhe të përshtatshëm me institucione të tjera, kuvendet komunale, bashkësitë lokale, organizatat joqeveritare dhe përfaqësues të tjerë të publikut, përfshirë edhe grupet minoritare etnike.





# MENAXHIMI I TRAJNIMEVE



# MENAXHIMI I TRAJNIMEVE NË SHËRBIMIN POLICOR TË KOSOVËS

## 1. HYRJE

1.1 Bazuar në Rregulloren 2005/54 dhe Urdhëresën Administrative 2006/9, Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Republikës së Kosovës ka autorizuar inspektimin e zakonshëm, lidhur me menaxhimin e trajnimeve në kuadër të policisë. Inspektimi i zakonshëm i funksionalizuar nga Departamenti i Inspektimit, është kryer nga data 15.05.2008 deri më 27.05.2008. Inspektimi i kësaj fushe të menaxhimit shënon një hap të rëndësishëm, sepse për herë të parë kjo fushë inspektohet nga zyrtarët e IPK-së.

1.2 Më 6 shtator të vitit 1999, Misioni i OSBE-së në Kosovë në pajtim me Rezolutën e Kombeve të Bashkuara 1244, pas hapjes së Shkollës së Policisë, ka filluar trajnimin e kandidatëve për pjesëtarë të Shërbimit Policor të Kosovës. Rezoluta në fjalë kishte përcaktuar sundimin e rendit dhe ligjit si segment në të cilin duhej investuar në shumë aspekte, për të krijuar parakushte elementare për krijimin e policisë vendore. Departamenti i OSBE-së për Edukim dhe Trajnim të Policisë ka patur për detyrë të zhvillojë dhe trajnojë një shërbim të ri e demokratik të policisë së Kosovës, i cili do të mbështeste sundimin e ligjit dhe për me tepër të respektojë të drejtat e njeriut.

1.3 Trajnimet, duke qenë të rëndësishme për cilëndo organizatë, sigurojnë që njerëzit të fitojnë shkathtësi dhe njohuri, për të kryer me efektivitet detyrat për të cilat ata janë rekrutuar. Kurset bazike njohin hyrjen e madhe të kandidatëve për policë, në rrugën e gjatë për shkollim, edukim, aftësim dhe trajnim, me qëllim të arritjes së njohurive dhe përgatitjes së policisë së Kosovës, në trendin e zhvillimeve policore të rajonit e më gjerë. I tërë procesi i aftësimit dhe trajnimit ka kaluar në fazat që duhet kaluar një trajnim profesional dhe modern.

1.4 Gjenerata e parë e kandidatëve për pjesëtarë të këtij shërbimi, që filloi trajnimin në këtë qendër, numëronte 176 pjesëtarë të cilët me sukses përfunduan trajnimin. Në këtë mënyrë ata filluan ushtrimin e veprimtarisë policore në tërë territorin e Kosovës, si policët e parë të këtij shërbimi të ri, të krijuar në bazat e një policie demokratike dhe profesionale. Përkundër të arriturave të mëdha në fushën e trajnimit, kjo fushë edhe më tutje mbetet një sfidë për policinë.

1.5 Qëllimi i inspektimit është që të bëhen rekomandime për menaxherët policor, se si mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave policore, në fushën e trajnimeve dhe realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmërinë me standardet relevante të Kodit të Etikës Policore (KEEP);
- Pajtueshmërinë me Planin Strategjik të MPB-së 2007-2010;
- Pajtueshmërinë me Planin Strategjik të policisë 2008-2010;
- Identifikimin e nevojave lidhur me trajnimet e pjesëtarëve të policisë;

- Organizimin/ mirëvajtjen e trajnimeve në bazë të plan- programeve trajnuese.

1.6 Gjatë inspektimit të zakonshëm, nga inspektorët policor u intervistuan:

- Asistenti i Zëvendës Komisarit për Administratë;
- Kryesuesi i Departamentit të Trajnimeve;
- Drejtori i Drejtorisë për Trajnime Obligative;
- Drejtori i Drejtorisë për Trajnime të Specializuara;
- Drejtori i Administratës dhe Mbështetjes së Trajnimeve;
- Komandantët Regjional;
- Komandantët e Stacioneve Policore;
- Koordinatorët Regjional të Trajnimeve;
- Shefat e njësjive, mbikëqyrësit e sektorëve dhe zyrtarë tjerë të trajnimeve.

1.7 Zonat e inspektimit:

- Organizimi struktural;
- Politikat dhe strategjia;
- Burimet njerëzore;
- Trajnimet e personelit policor;
- Buxheti dhe logjistika;
- Përmirësimi i performancës

1.8 Raporti është përgatitur në bazë të Parimit të Përgjegjshmërisë dhe Transparencës Publike, parim ky i mbështetur nga neni 19, i Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP).




## 2. ORGANIZIMI STRUKTURAL

2.1 Departamenti i Trajnimeve, i strukturuar në kuadër të Shtyllës së Administratës, i formuar në janar të vitit 2004, ka për qëllim krijimin e kadrove profesionale, përmes programeve trajnuese cilësore. Ndërtimi i strukturës organizative të Departamentit të Trajnimeve është bërë duke i analizuar nevojat e këtij departamenti, për të mundësuar funksionimin efikas të policisë. Përmes kësaj strukture, është vënë qëllimi i ndërtimit të kapaciteteve të brendshme trajnuese, në mënyrë që të përcillen në vazhdimësi pjesëtarët policor, gjatë kryerjes së detyrave në përgjithësi dhe në veçanti gjatë zhvillimit të karrierës. Me kalimin e kohës, para policisë ishte imperativ krijimi i një strukture organizative, e cila do të ishte funksionale në aspektin e burimeve njerëzore. Për këtë qëllim, në departament është përfshirë personeli që ka për detyrë e përgjegjësi të merret me krijimin e kadrove përmes programeve trajnuese cilësore.

2.2 Në kuadër të Departamentit të Trajnimeve bëjnë pjesë këto drejtori:

- **Drejtoria e Administratës dhe Mbështetjes së Trajnimeve (DAMT)**
  - Njësia e Administrimit të Trajnimeve;
  - Njësia për Planifikim e Zhvillim.
- **Drejtoria e Trajnimeve Obligative (DTO)**
  - Njësia për Planifikim e Vlerësim;
  - Njësia e Trajnimeve Bazike;
  - Njësia për Zhvillimin e Karrierës.
- **Drejtoria e Trajnimeve të Specializuara (DTS)**
  - Njësia e Trajnimeve të Specializuara.



Skema 1: Organizimi struktural i Departamentit të Trajnimeve

2.3 Struktura organizative është e ndërtuar në mënyrë që të ketë sa më shumë shtrirje vertikale, deri në nivel stacionesh. Në kuadër të regjioneve funksionojnë zyrat e trajnimeve, në përbërjen e të cilave aktivitetet i zhvillojnë nga tre (3) zyrtarë trajnimesh: një (1) koordinator regional i trajnimeve, një (1) zyrtarë i trajnimeve dhe një (1) ndihmës i trajnimeve. Zyrat në fjalë raportojnë tek Zëvendës Komandantët

Regjional për Administratë. Në nivel stacionesh policore, përgjegjës për trajnime janë policet e trajnimit.

2.4 Shkolla e Shërbimit Policor (SHSHK) me lokacion në Vushtrri, si qendër trajnuese policore, është transformuar në Qendër të Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH), në janar të vitit 2006, kurse me hyrjen në fuqi të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut, të datës 26 mars të vitit 2008, ka kaluar në Agjencion Ekzekutiv të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

2.5 Departamenti i Trajnimeve ka funksionalizuar Njësitin për Planifikim dhe Vlerësim në kuadër të Drejtorisë së Trajnimeve Obligative (DTO), i cili ka për qëllim të rishqyrtoj plan- programet trajnuese, të cilat iu ofrohen pjesëtarëve policor, si në kuadër të qendrës trajnuese, po ashtu dhe në nivel të stacioneve. Kompetencë tjetër e këtij njësi është edhe vlerësimi dhe mbikëqyrja e performancës së instruktorëve, të cilët mbajnë trajnime në kuadër të qendrës trajnuese dhe në nivel të stacioneve policore.

2.6 Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH) është institucion që iu ofron përkrahje teknike, administrative, edukative, të gjitha agjencioneve të sigurisë publike si: policisë, doganës, shërbimit emergjent dhe atij korrektues. Drejtorja e Trajnimeve Obligative, organizon dhe zhvillon trajnimet në këtë qendër, sipas analizave të nevojave për trajnime të pjesëtarëve policor, duke dizajnuar edhe lloje të kurseve të posaçme, për të cilat paraqitet nevoja në proces e sipër.

### **3. POLITIKAT DHE STRATEGJIA**

3.1 Angazhimet e Departamentit të Trajnimeve janë mjaft mbresëlënëse në drejtim të përpjekjeve për ngritjen e nivelit të ofrimit të shërbimeve cilësore, për përfituesit e trajnimeve. Një propozim konkret ka ardhur nga ky departament lidhur me zgjatjen trajnimit bazik (themelor) nga periudha njëzet (20) javore, në dyzet e tetë (48) javore. Do të ketë rëndësi të madhe për pjesëtarët policor, ngase iu ofron atyre mundësi të mëdha në marrjen e njohurive më të gjera në punët policore, duke ndikuar në ngritjen e efikasitetit të tyre. Departamenti në fjalë, herë pas here zhvillon inspektime në kuadër të autorizimeve, nëpër regjione dhe stacione, në lidhje me mbajtjen e trajnimeve të obligueshme.

3.2 Departamenti i Trajnimeve nuk ka pasur Plan Strategjik, deri në momentin e funksionalizimit të inspektimit, por ka prezantuar një Draft Plan Strategjik për periudhën 2008-2010. Është nevojë e menjëhershme përfundimi i këtij dokumenti, ngase deri më sot departamenti ka punuar në bazë të planeve. Për këtë vit, Departamenti i Trajnimeve ka përgatitur Planin Vjetor për vitin 2008, në të cilin janë prezantuar prioritetet, bazuar në objektivat e Planit Strategjik të SHPK-së. Ndër prioritetet vlen theksuar ndërtimin e kapaciteteve, zhvillimin e programeve trajnuese dhe ofrimin e trajnimeve të veçanta.

3.3 Departamenti ka ndërmarre procesin e identifikimit të nevojave për trajnim, me qëllim të identifikimit të zbrazëtirave në trajnim, përmirësimit të metodave, avancimin e programeve, zhvillimin e programeve të reja dhe atyre aktuale trajnuese. Si rezultat i tërë këtij aktiviteti, departamenti ka pranuar numër të madh kërkesash për trajnime të ndryshme, të identifikuar nga analiza e nevojave për trajnim. Pas analizës së nevojave të trajnimit, janë identifikuar fushat të cilat kanë nevojë për mbështetje nga programet e trajnimeve që departamenti i mbanë si dhe trajnime

të reja të cilat synohen të realizohen përmes përpilimit të programeve të reja dhe projekteve të trajnimit me organizata qeveritare dhe joqeveritare, brenda dhe jashtë vendit. Kërkesat për numrin e kurseve janë shumë më të mëdha se mundësitë e departamentit për realizimin e tyre, njëjtë sikur që edhe kërkesat për numrin e pjesëmarrësve në trajnime janë shumë më të mëdha se mundësitë e departamentit për trajnim të tyre<sup>1</sup>.

#### Rekomandimi nr. 1

Inspektorati Policor rekomandon Departamentin e Trajnimeve, të fillojë të ndërtojë një strategji afatgjate, me orientime të qarta në fushën e trajnimeve.

3.4 Në fushën e plan-programeve mësimore që hartohen nga Departamenti i Trajnimeve, duhet pasur kujdes në mbajtjen e kontinuitetit të planeve dhe programeve mësimore, duke përcjellë trendet e zhvillimit të policive bashkëkohore dhe duke futur këto risi në kuadër të plan- programeve.

3.5 Kur flitet për trajnimet, lidhen çështjet me qendrën trajnuese (QKSPEZH), si Agjencion Ekzekutiv i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Edhe pse ka bërë kërkesë për certifikim, në mungesë të Agjencionit Kosovar për Akreditim, ka aplikuar vitin e kaluar për akreditim në agjencionin e zgjedhur nga OSBE-ja, në Agjencionin për Certifikim dhe Akreditim të Gjermanisë (AQAS). Grupi i ekspertëve të këtij agjencioni ka kryer një vizitë në qendër dhe pritet që kah mesi i shtatorit, t'i prezantojë OSBE-së, një raport përfundimtar të vlerësimit të qendrës.

## 4. BURIMET NJERËZORE

4.1 Burimet njerëzore në kuadër të Departamentit të Trajnimeve janë një ndër segmentet më të rëndësishme për realizimin me sukses të punëve. Në Departamentin e Trajnimeve, personeli është i shpërndarë në mënyrë funksionale dhe pjesa dërmuese e tij, rreth 66 % është koncentruar në Drejtorinë për Trajnime Obligative. Kjo drejtori është e vendosur në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH) (shih tabelën 1).

Drejtoria	Kol	N/ kol	Maj	Kap	Tog	Rr	Polic	Civil	Totali
Zyra e Kryesuesit	1	-	-	-	-	1	-	1	3
DTO	-	1	1	1	9	16	48	2	78
DTS	-	-	2	-	2	3	16	-	23
DAMT	-	-	-	2	3	3	2	4	14
<b>Gjithsej:</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>14</b>	<b>23</b>	<b>66</b>	<b>7</b>	<b>118</b>

4.2 Në paragrafin 2.3, u cek shtrirja vertikale e personelit të trajnimeve deri te niveli i stacioneve policore. Personeli tjetër i shpërndarë jashtë Departamentit të

<sup>1</sup> Shih tabelën nga Plani Vjetor i Punës 2008, faqe 11.

Trajnimeve arrin numrin prej gjithsej 52 të inkuadruarve:

- Departamenti i Shërbimeve të Personelit (1);
- Departamenti i Njësive Speciale (1);
- Departamenti i Policisë Kufitare (5);
- Regjioni i Prishtinës (13);
- Regjioni i Prizrenit (6);
- Regjioni i Gjilanit (5);
- Regjioni i Pejës (6);
- Regjioni i Ferizajt (5) dhe
- Regjioni i Mitrovicës (10).

4.3 Përgatitja profesionale e personelit të Departamentit të Trajnimeve paraqet çështje me rëndësi, në drejtim të krijimit të një policie demokratike, sipas sistemeve moderne të shteteve perëndimore. Kjo nënkupton nevojën që në kuadër të stafit të ketë njerëz profesional, njohës të mirë të praktikave policore si dhe pedagogë të mirëfilltë në dhënien e njohurive mbi punët policore. Duke analizuar nivelin e përgatitjes profesionale të stafit të këtij departamenti, konstatojmë se është e domosdoshme të përcaktohen qartë niveli dhe kriteret e personelit që angazhohet drejtpërdrejtë në procesin e dhënies së trajnimeve. Departamenti numëron personelin prej 118 pjesëtarëve, përfshirë këtu shtatë (7) pjesëtarë të personelit civil. Nga ky numër, 84 punonjës janë me përgatitje të mesme shkollore, dhjetë (10) me përgatitje të lartë shkollore dhe 24 me përgatitje superiore. Në anën tjetër, Qendra Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH) si institucion që u ofron përkrahje teknike, administrative dhe edukative, të gjitha agjencioneve të sigurisë publike, në kuadrin e saj numëron gjithsej 172 punonjës. Nga ky numër, 21 kanë përgatitje superiore, 20 janë duke vijuar studimet, dy (2) me përgatitje të lartë shkollore, 123 me përgatitje të mesme shkollore, 6 (gjashtë) me shkollim fillor.

## Rekomandimi nr. 2

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që në të ardhmen ti kushtojë rëndësi të veçantë përzgjedhjes së kuadrit sa më profesional dhe të kualifikuar, gjithnjë me qëllim të arsimimit, edukimit dhe trajnimit të policisë, në përputhje me zhvillimet dhe rrethanat shoqërore në Kosovë.

4.4 Me gjithë kompetencat e qartësuara të Departamentit të Trajnimeve dhe QKSPEZH-it, vërehet një pakënaqësi lidhur me statusin e qendrës. Këto pakënaqësi shpesh përcillen me pengesa në respektimin e vijave zinxhimore komanduese. Duke parë këtë klimë të panevojshme, është e rrugës të kërkohen variante më të përshtatshme të definimit të këtyre pakënaqësive. Meqenëse, një pjesë e Departamentit të Trajnimeve (Drejtoria për Trajnime Obligative) zhvillon aktivitetin e saj në Qendrën Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim dhe meqë jemi

në kohën kur pritet të aprovohet skema e re e organizimit policor, të shqyrtohet mundësia e kalimit të një pjese të personelit të Departamentit të Trajnimit në kuadër të qendrës. Edhe pse dihet se, Drejtoria e Trajnimeve Obligative në përbërjen e saj ka zyrtarë policor, të shikohet mundësia e rregullimit edhe të statusit të tyre, meqë si pjesë e mundshme e qendrës do të mund të vijë deri tek shkëputja e tyre nga policia, meqenëse qendra është agjencion në kuadër të ministrisë dhe i raporton ministrit. Kështu, do të bëhej edhe një ndarje më e qartë e detyrave, ku personeli i Departamentit të Trajnimeve do të merrej me identifikimin e nevojave, analizimin e tyre dhe planifikimin e programeve trajnuese, kurse qendra do të merrej plotësisht me implementimin e atyre programeve.

4.5 Në kuadër të Drejtorisë së Administratës dhe Mbështetjes së Trajnimeve (DAMT), funksionon edhe Sektori për Zhvillimin e Instruktorëve, kompetencë e së cilës është që të zhvillojë nivelin e përgatitjes profesionale dhe të ndihmojë në ngritjen dhe në paraqitjen sa më profesionale të instruktorëve, duke i freskuar herë pas here njohuritë e tyre me më të rejat nga lëmi i policisë moderne dhe duke ofruar trajnime çdo tre vjet për trajnerë (pra një lloj ricertifikimi për trajnerët). Gjatë inspektimit është konstatuar se ka instruktorë të cilët mbajnë trajnime edhe pse ende nuk janë ricertifikuar, pas skadimit të periudhës trevjeçare të paraparë me rregullat në fuqi, në bazë të të cilave vepron policia.

### Rekomandimi nr. 3

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor të organizojë dhe mbajë trajnime për ricertifikim të rregullt të trajnerëve, sipas rregullave të parapara për ricertifikim.

4.6 Përzgjedhja e instruktorëve bëhet përmes konkurseve, në të cilët paraqiten kriteret e përzgjedhjes. Duket sikur kriteret janë të „buta”, andaj duhet shqyrtuar mundësinë e rigorizimit të kushteve profesionale të aplikimit dhe përzgjedhjes, me arsyetimin që instruktorët e ardhshëm të jenë profesionalisht më të përgatitur.

## 5. TRAJNIMET E PERSONELIT POLICOR

### 5.1 Organizimi i trajnimeve (Fazat e trajnimit)

5.1.1 Policia luan rol të rëndësishëm si mbrojtëse e shoqërisë dhe duhet të ndajë të njëjtat vlera me vetë shtetin demokratik. Forcimi i vlerave demokratike në polici është për këtë arsye esenciale dhe trajnimi është një nga mjetet e rëndësishme në promovimin e vlerave në radhët e personelit policor. Trajnimi i policisë, i cili duhet të bazohet në vlerat themelore të demokracisë, shtetin ligjor dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duhet të forcohet në përputhje me objektivat e policisë<sup>2</sup>.

5.1.2 Trajnimi bazik (themelor) në Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK) është një trajnim me standarde të larta duke përfshirë: Kodin e Etikës Policore,

<sup>2</sup> Neni 26 i Kodit Evropian të Etikës Policore

legjislaturën e aplikueshme në Kosovë, hetimin e krimit, grumbullimin e evidencave dhe metodën e intervistave, politikën demokratike dhe fokusimi në besueshmërinë e rregullave të ligjit demokratik, përdorimin e armëve të zjarrit, forenzikën dhe evidencën, kontrollin e trafikut, etj.

5.1.3 Bazuar në të dhënat e përgjithshme statistikore të Sistemit Informativ të Administrimit të Kurseve të Qendrës Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH), deri tani në këtë qendër kanë:

- diplomuar 8.159 pjesëtarë policor;
- të përjashtuar janë 201;
- dorëheqje kanë dhënë 101;
- të suspenduar janë 8;
- të kthyer janë 10;
- kanë hequr dorë nga vijimi i trajnimeve 744.

5.1.4 Në tabelën e mëposhtme prezantojmë të dhënat e Sistemit Informativ të Administrimit të Kurseve, lidhur me numrin e të diplomuarve në trajnimin bazik, në 35 gjeneratat e kaluara (shih tabelën 2). Gjenerata me më së shumti të diplomuar është gjenerata e 32-të, me 393 të diplomuar, derisa gjenerata me më së paku të diplomuar është ajo e 23-të, me 23 të diplomuar. Vështruar nga këndi gjinor, femrat në totalin prej 8.159 të diplomuarve, përfaqësohen me 15.17 %, kundrejt meshkujve me 84.83 %.

Tabela 2: Struktura gjinore e të diplomuarve <sup>2</sup>					
Gjenerata	Femra	%	Meshkuj	%	Totali
I	38	21.59	138	78.41	176
II	32	18.5	141	81.5	173
III	56	24.35	174	75.65	230
IV	20	9.26	196	90.74	216
V	30	10.87	246	89.13	276
VI	49	15.61	265	84.39	314
VII	65	20.83	247	79.17	312
VIII	54	19.22	227	80.78	281
IX	69	25.75	199	74.25	268
X	53	18.15	239	81.85	292
XI	57	18.39	253	81.61	310
XII	65	22.73	221	77.27	286
XIII	55	21.15	205	78.85	260
XIV	55	22.00	195	78.00	250
XV	50	24.88	151	75.12	201
XVI	29	11.20	230	88.80	259
XVII	13	4.58	271	95.42	284
XVIII	19	6.42	277	93.58	296
XIX	17	5.99	267	94.01	284
XX	10	4.20	228	95.80	238
XXI	22	27.50	58	72.50	80
XXII	47	18.95	201	81.05	248

XXIII	0	0.00	21	100.0	21
XXIV	13	14.29	78	85.71	91
XXV	23	11.79	172	88.21	195
XXVI	22	10.89	180	89.11	202
XXVII	26	14.05	159	85.95	185
XXVIII	52	15.85	276	84.15	328
XXIX	34	10.09	303	89.91	337
XXX	20	6.01	313	93.99	333
XXXI	61	17.53	287	82.47	348
XXXII	55	13.99	338	86.01	393
XXXIII	0	0.00	28	100.0	28
XXXIV	10	12.35	71	87.65	81
XXXV	17	20.48	66	79.52	83
<b>Gjithsej:</b>	<b>1.238</b>	<b>15.17</b>	<b>6.921</b>	<b>84.83</b>	<b>8.159</b>

5.1.5 Policia e Kosovës është e njohur si polici shumëetnike, ngase në strukturën e saj përfaqësohen pjesëtarë të shumë komuniteteve etnike. Të diplomuarit me përkatësi shqiptare përfaqësohen me 83.18 % (6.787 sish), kundrejt të diplomuarve të përkatësive tjera që përfaqësohen me 16.82 % (1.372). Në pjesën të tjerët, përfaqësohen pjesëtarët policor të përkatësive si: ashkalinjë, boshnjakë, çerkezë, kroatë, egjiptianë, goranë, romë (për më tepër shih tabelën 3)

Nr	Përkatësia	Totali	%
1	Shqiptarë	6.787	83.18
2	Serb	890	10.91
3	Boshnjakë	214	2.62
4	Turqë	101	1.24
5	Të tjerë	167	2.05
	<b>Gjithsej:</b>	<b>8.159</b>	<b>100.0</b>

5.1.6 Kosova është e njohur si vend me moshë të përshtatshme mesatare të popullatës, andaj edhe të dhënat pasqyrojnë këtë vlerësim. Është bërë një kategorizim në tetë (8) grupmosha. Grupmosha 25-29 vjet përfaqësohet me një përqindje prej 26.6 %, dukshëm më e lartë se grupmoshat tjera, derisa grupmosha 55-59 vjet përfaqësohet me 0.42 %<sup>3</sup>.

5.1.7 Pas përfundimit me sukses të trajnimit bazik në Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës, pjesëtarët e këtij shërbimi vazhdojnë me programin e trajnimit fushor në stacionet policore me trajnerë të certifikuar. Qëllimi i programit të trajnimit dhe vlerësimit është të lehtësojë kalimin kandidatit nga ambienti shkollor në atë praktik, ku nevojitet aplikimi drejtpërdrejtë i aftësive gjatë kryerjes së detyrave, përfshirë këtu gjashtë fusha të gjera veprimi si: patrullimi, hetimi, arrestimi, intervenimi në incidentesh, komunikacioni dhe detyra të stacionit policor. Trajnimi fushor zhvillohet gjatë tri fazave, në kohëzgjatje prej 32 javëve (10 plus 2 plus 20 javë), duke kompletuar kështu trajnimin bazik dhe praktik prej 52 javëve (20 javë trajnim bazik plus 32 javë trajnim praktik).

2 Të dhëna të marra nga Qendra Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH)

3 Grupmosha 20-24 vjet (24.21 %), 25-29 vjet (26.67 %), 30-34 vjet (18.15 %), 35-39 vjet (14.02), 40-44 vjet (10.49 %), 45-49 vjet (4.2%), 50-54 vjet (1.84 %), 55-59 vjet (0.42 %).

5.1.8 Në vazhden e kompletimit të trajnimit të përgjithshëm, Komandantët Regjional përmes të Koordinatorëve Regjional për Trajnime, bazuar në nenin 8.15, të Parimeve dhe Procedurave të SHPK-së, deri me datën 31 mars, ofrojnë kërkesat në nivel qendror për aprovim të tyre, për periudhën e ardhshme trajnuese në formë të planit vjetor trajnues. Pas sistemimit të kërkesave, me miratimin e Kryesuesit të Departamentit të Trajnimeve (KTD), lejohet implementimi i programeve, në bazë të orarit të përgatitur<sup>4</sup>. Programet trajnuese vjetore fillojnë prej 1 korrikut deri 30 qershor të vitit të ardhshëm. Trajnimin e realizojnë trajnerët regjional, kurse raportimin në baza tremujore e bën Koordinatori Regjional i Trajnimeve. Në këtë fazë të realizimit të trajnimeve, Departamenti i Trajnimeve bën monitorimin e kohëpaskohshëm të këtyre aktiviteteve. Secili polic nën komandën e Komandantit Regjional, duhet të ndjekë së paku 40 orë në vit.

5.1.9 Qëllimi i trajnimeve në nivel regjional, është që të punësuarit të mbahen në hap me kohën, secili regjion identifikon fushën për të cilën kanë nevojë të trajnohen apo të organizohen trajnime të caktuara për pjesëtarët e tij. Ky identifikim mbështetet në mangësitë e identifikuar gjatë vitit apo në çështjet në të cilat të punësuarit kanë vështirësi gjatë ushtrimit të veprimtarisë policore.

5.1.10 Është vërejtur një dukuri e mosinteresimit të policëve për vijimin e trajnimeve të tilla, për shkak të rënies së nivelit profesional të instruktorëve, demotivimit për shkak të kushteve të rënda materiale të policëve, mosmarrjes parasysh të kurseve të kryera në zhvillimin e karrierës, etj. Kjo dukuri, ka ardhur në shprehje sidomos tek personeli policor i shtyrë në moshë, tek disa policë të gjinisë femërore, dhe kategori tjera policësh<sup>5</sup>. Inspektorët policor në disa regjione kanë vërejtur shqetësimin e policëve lidhur me kushtet nën të cilat zhvillohen trajnimet. Ata kanë potencuar mungesën e sallave të përshtatshme për mbajtjen e trajnimeve (Prizren, Gjilan) si dhe mungesën e pajisjeve teknike mbështetëse.

#### **Rekomandimi nr. 4**

Inspektorati Policor i rekomandon menaxhmentit policor të sigurojë hapësirat të nevojshme për zhvillimin e trajnimeve, të cilat po ashtu duhet të jenë të pajisura me pajisje të nevojshme teknike mbështetëse.

5.1.11 Progresi i vijuesve të trajnimeve rrallë herë vlerësohet me organizim të testeve. Ky nuk është shembull i mirë. Ligjëruesit në disa kurse kur e shohin të nevojshëm përgatimin e testeve me shkrim e në disa raste fare nuk bëjnë një gjë të tillë. Gjatë kurseve më shumë praktikohet që në fund të zhvillohen anketa mbi perceptimet e vijuesve mbi trajnimet, lidhur me trajnerët, etj. Sikur të përdoren testet e vlerësimit atëherë vijuesit do ta kenë të qartë se do të vlerësohen në mënyrë që të jenë më aktiv gjatë mbajtjes së kurseve.

#### **Rekomandimi nr. 5**

Inspektorati Policor rekomandon që aftësitë dhe njohuritë individuale të fituara gjatë trajnimit, të vlerësohen përmes testeve standarde, në drejtim të rritjes së efikasitetit të pjesëmarrësve në trajnime.

4 Është prezantuar shembulli i aprovimit të Plan-programit vjetor 2008/2009, nga Departamenti i Trajnimeve për Regjionin e Ferizajt.

5 Informacion nga Raporti i Inspektimit në Regjionin e Gjilanit, Prizrenit.



5.1.12 Policia duhet të sigurojë trajnim të specializuar pjesëtarëve të saj, kur pozita e detyrës së caktuar të tyre kërkon një gjë të tillë. Këto trajnime janë të lidhura me fusha si: forenzika, hetimet, krimi i organizuar, krimet e rënda, etj. Zyrtarët policor janë të obliguar që pas kryerjes së këtyre trajnimeve, të përmbushin një periudhë të caktuar kohore në njësitin e specializuar, për të cilin janë trajnuar. Kjo bëhet me qëllim që punonjësit të cilët i nënshtrohen trajnimit të specializuar me shpenzimet e shërbimit, të shërbejnë në fushën e tyre të specializuar për një periudhë të caktuar kohore.

### Rekomandimi nr. 6

Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon menaxhmentit policor që të respektojë në përpikëri Parimin P-8.13, të Parimeve dhe Procedurave, lidhur me trajnimet e specializuara, në rastet kur punonjësit nuk përmbushin angazhimin e zotuar në njësitin e specializuar, heqin dorë apo e ndërprejnë punën<sup>6</sup>.

## 5.2 Trajnimet brenda vendit

5.2.1 Trajnimet e realizuara brenda vendit për pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës kanë qenë të ndryshme, por si trajnim i domosdoshëm ka qenë trajnimi bazik apo themelor. Trajnimi bazik për dallim nga vitet e para të fillimit të shkollës, që është zhvilluar në kohëzgjatje prej gjashtë (6) javësh, që më vonë është zgjatuar në nëntë (9) javë, në fazën e fundit të trajnimeve të zyrtareve policor (nga viti 2004) është zhvilluar përgjatë periudhës njëzet (20) javore, duke përfshirë 800 orë akademike (ligjërata dhe ushtrime). Plan- programi i realizuar deri më tani mbështetet në parimet e kryerjes së punëve policore në demokraci, në respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe në aftësimin shumëdimensional për shkathtësitë e policisë në një shtet demokratik. Ky plan- program përfshinë në vete tema nga këto lëmi: hetimi i krimit, mbledhja e dëshmive forenzike, detyrat patrulluese, armët e zjarrit, ligjet e aplikueshme si dhe teknikat e intervistimit. Këto tema si pjesë e plan- programit trajnues, janë në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

5.2.2 Plan- programet në kuadër të Departamentit të Trajnimeve rishqyrtohen varësisht prej nevojave, nga Njësitit për Planifikim dhe Zhvillim si dhe rifreskohen me risi të cilat aplikohen në policitë moderne të shteteve, që kanë traditë të gjatë në funksionimin e institucionit të policisë. Kjo bëhet me qëllim që policia të jetë sa më profesionale dhe në përputhje me të priturat e popullsisë, në kryerjen e detyrave policore.

5.2.3 Meqenëse inspektorët policor gjatë prezantimit të të dhënave kanë vërejtur mospërputhje të tyre në raportet vjetore të Departamentit të Trajnimeve për vitin 2006 dhe 2007, në këtë raport final të inspektimit do të prezantojmë informacione nga Raporti i Punës për vitin 2007. Janë të dhëna këto, lidhur me trajnimet e organizuara nga Departamenti i Trajnimeve në Shkollën e Shërbimit Policor.

Nr.	Trajnime brenda vendit	2006	2007
1.	Llojet e kurseve të trajnimit	52	53
2.	Kurse të zhvilluara	419	406
3.	Pjesëmarrës në trajnime	9.027	6.905

6 Parimi P-8.13 i Parimeve dhe Procedurave „Zotimi i pjesëtarit të SHPK-së”, faqe 335.

### 5.3 Trajnimet jashtë vendit

5.3.1 Kryesuesi i Departamentit të Trajnimeve është përgjegjës për gjetjen e programeve relevante për trajnime jashtë vendit, gjegjësisht, atëherë kur një trajnim nuk është i mundshëm në Kosovë. Sipas Parimit P-8.16, të Parimeve dhe Procedurave mbi trajnimet jashtë vendit, pas miratimit nga KDT-ja, Shefi i Sektorit të Programeve dhe Seminareve Bilaterale (SHSPSB) është përgjegjës për të siguruar se për çdo cikël trajnimi janë zgjedhur kandidatët e përshtatshëm, përmes një procesi të hapur dhe transparent. Veç tjerash, SHSPSB-ja është përgjegjës edhe për të gjitha aranzhimet e nevojshme, përfshirë udhëtimin, akomodimin, ushqimin, kohëzgjatjen dhe të siguruarit për udhëtim.

5.3.2 Ka raste kur autoritetet apo organizatat ndërkombëtare, OJQ-të, ofrojnë mundësi për trajnime jashtë vendit. Pranimi i këtyre ofertave bëhet pasi të verifikohet rëndësia e trajnimit për policinë, pajtueshmëria me modelin e policisë së Kosovës, realizueshmëria e tij brenda vendit dhe implikimi i mundshëm buxhetor.

5.3.3 Departamenti i Trajnimeve i ka kushtuar rëndësi të veçantë trajnimeve dhe seminareve jashtë vendit, me qëllim të avancimit, profesionalizimit, krijimit të raporteve të reja rajonale dhe shkëmbimit të përvojave të ndërsjella. Në vitin 2006, në trajnimet e organizuara jashtë vendit, janë trajnuar 71 kandidatë, në 12 shtete të ndryshme (SHBA, Gjermani, Angli, Zvicër, Francë, Turqi, etj), kurse në seminarët e organizuara kanë marrë pjesë 112 pjesëmarrës. Në vitin 2007, trajnimet e organizuara i kanë ndjekë 238 zyrtar policor. Nga krahasimi i trajnimeve dhe seminareve të zhvilluara në 2006 dhe 2007, shihet se ka një rritje të vazhdueshme të këtyre trajnimeve dhe seminareve.

Tabela 5: Krahasimi i trajnimeve dhe seminareve për vitin 2006/ 2007

Nr.	Trajnime dhe seminare jashtë vendit	2006	2007
1.	Trajnime	21	32
2.	Seminare	38	55
	<b>Totali</b>	<b>59</b>	<b>87</b>

5.3.4 Lidhur me mënyrën e organizimit dhe përcaktimit të kriterëve për pjesëtarët e SHPK-së, të cilët përzgjidhen për të marrë pjesë në trajnimet jashtë vendit, ka mjaft pakënaqësi brenda institucionit të SHPK-së. Nga dokumentacioni del se përfitues më të mëdhenj të këtyre trajnimeve dhe seminareve janë pjesëtarët nga menaxhmenti i lartë. Inspektorati Policor i Kosovës konsideron se në të ardhmen duhet që nivelet regjionale të kenë një hapësirë më të madhe për të ndjekur trajnime dhe seminare jashtë vendit, varësisht nga pozitat për të cilat organizohen ato. Gjatë intervistave me menaxherët e Departamentit të Trajnimeve, inspektorët policor kanë marrë informacione lidhur me pjesëmarrjen e disa menaxherëve të lartë të SHPK-së në trajnimet dhe seminarët e organizuara jashtë vendit, ku trajnimi i organizuar nuk ka qenë adekuat për pozitat e tyre.

#### Rekomandimi nr. 7

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që në të ardhmen t'i ofroj mundësinë e pjesëmarrjes në trajnimet dhe seminarët e organizuara edhe personelit nga regjionet por edhe personave që natyra e trajnimeve i përshtatet pozitave (vendeve) të tyre të punës.

## 5.4 Partneriteti me organizatat tjera

5.4.1 Departamenti i Trajnimeve përveç trajnimeve të cilat i organizon vetë brenda dhe jashtë vendit, organizon edhe trajnime të tjera në bashkëpunim me organizatat tjera të cilat veprojnë në Kosovë. Kryesisht këto trajnime organizohen mbi bazën e analizimit të nevojave për trajnime, për të cilat Departamenti i Trajnimeve nuk ka kapacitete të ndërtuara për zhvillimin dhe mbajtjen e tyre. Trajnimet organizohen në bashkëpunim me përfaqësuesit e shtyllave, departamenteve dhe drejtorive në kuadër të ShPK-së.

5.4.2 Përdoren metoda teorike dhe praktike të zhvillimit të trajnimeve nga kontribuues të brendshëm dhe të jashtëm të tyre. Derisa kontribuues të brendshëm janë trajnerët e brendshëm, kontribuues të jashtëm mund të jenë konsulentë të jashtëm (prokurorë, profesorë universitarë, etj)<sup>6</sup>.

5.4.3 Në formë të partneritetit, Departamenti i Trajnimeve për vitin 2006 dhe 2007 ka organizuar dhe zhvilluar trajnime me këto organizatat:

- Institutin Kosovar të Administratës Publike (IKAP),
- Njësinë Mbështetëse ushtarake (MSU)
- Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM),
- Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK),
- Agjencionin Evropian për Rindërtim (AER),
- Qendrën „George Marshall”,
- Agjencionin Austriak për Zhvillim (ADA), etj.

5.4.4 Nga paraqitja tabelore shihet qartë se ka një rritje të theksuar, veçanërisht të numrit të pjesëmarrësve në ndjekjen e trajnimeve në formën e partneritetit të organizuara ndërmjet departamentit të trajnimeve dhe organizatave tjera të cilat veprojnë në Kosovë dhe jashtë saj (shih tabelën).

Nr.	Organizatat partnere	Kurse		Pjesëmarrës	
		2006	2007	2006	2007
1.	IKAP	44	10	70	29
2.	FIU	1	-	22	-
3.	MSU	1	-	22	-
4.	IOM	1	1	14	103
5.	IGJK	7	5	75	39
6.	ICITAP	-	6	-	26
7.	ADA	-	5	-	235
8.	OSBE	-	5	-	110
9.	KFOR	-	2	-	191
10.	Europol	-	2	-	40
11.	Armata Britaneze	-	2	-	10
12.	TMK	-	1	-	12
13.	CARDS	-	1	-	20
14.	CARPO	-	1	-	10
15.	UNDP	-	1	-	44

<sup>6</sup> Informacion nga Raporti i Inspektimit në Regjionin e Prizrenit

16.	Guardia di Financia	-	1	-	20
17.	MEF	-	1	-	1
	<b>Totali</b>	<b>54</b>	<b>44</b>	<b>203</b>	<b>890</b>

## 6. BUXHETI DHE LOGJISTIKA

6.1 Buxheti i aprovuar i Departamentit të Trajnimeve, ka pësuar ndryshim shumë të madh për dy vitet e fundit. Buxheti i aprovuar i këtij departamenti për vitin 2006 është shumë më i madh në krahasim me vitin 2007. Paraqitja tabelore sqaron këtë konstatim të dhënë (shih tabelën). Buxheti total i Departamentit të Trajnimeve përfshihet në kuadër të programit të shtatë, njëherit përfshinë kategoritë ekonomike "shërbime e mallra" dhe "investime kapitale" të Trajnimeve Mandatore dhe Trajnimeve tjera, kurse pagat/shtesat dhe transferët/ subvencionet nuk janë pjesë e këtij buxheti, ngase figurojnë si pjesë e buxhetit të Burimeve Njerëzore, të programit 5, të Shërbimeve Administrative. Buxheti i aprovuar i vitit 2007 për kategoritë e cekura është për 52.39 % më i ulët se ai i vitit paraprak, njëjtë është edhe me buxhetin e shpenzuar të vitit 2007, i cili është në shkallë më të ulët për 63.49 % se ai i vitit paraprak. Në aspektin vertikal, në vitin 2006, buxheti është shpenzuar vetëm 69.26 %, derisa në vitin 2007, buxheti është shpenzuar vetëm 53.11 %. Lidhur me mosshfrytëzimin e këtyre mjeteve buxhetore, Inspektorati Policor shprehë shqetësimin për rrezikun e mosrealizimit të projekteve të planifikuara, meqë shkalla e shfrytëzimit të mjeteve është shumë e ulët.

Nr	Gjendja buxhetore	2006	2007	Ndryshimi
1.	Buxheti i aprovuar	1.450.600,00	690.672,00	- 52.39 %
2.	Buxheti i shpenzuar	1.004.740,03	366.786,66	- 63.49 %

6.2 Meqenëse trajnimet dhe seminarët jashtë vendit bëjnë pjesë të vetes edhe shpenzime të mëdha, me vendim të Qeverisë së Kosovës, të datës 20.03.2008, është marrë vendim që të gjitha seminarët që organizohen me mjete të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, të mbahen brenda territorit të Kosovës.

6.3 Qendra Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH) financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe ka linjën e vet buxhetore nën Ministrinë e Punëve të Brendshme. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2008/17, buxheti i qendrës mund të plotësohet nga fondet e donatorëve. Çdo vit, propozimi fillestar buxhetor planifikohet nga Sektori i Buxhetit dhe Financave i qendrës në konsultim me shefat e sektorëve dhe menaxhmentin e lartë të saj.

6.4 Meqenëse deri vonë qendra trajnuese ka qenë nën mbikëqyrjen e OSBE-së, pajisjet të cilat janë përdorur për konkretizimin dhe funksionalizimin e trajnimeve kanë qenë pronë e saj. Pas transformimit të shkollës në qendër trajnuese, ka filluar edhe bartja e pronësisë së tyre nga OSBE-ja, tek Qendra Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim. Sipas zyrtarëve të qendrës, pajisjet janë dhënë në formë të donacioneve, gjatë tri fazave, duke filluar nga muaji prill dhe maj të vitit 2007 dhe muaji janar i vitit 2008. Kjo dëshmohet edhe me dokumentet e nënshkruara nga Drejtori i QKSPEZH-it dhe Ushtruesi i Detyrës së Shefit të Logjistikës të Misionit të OSBE-së në Kosovë. Informacionet relevante mbi pajisjet e cekura janë evidentuar në Modulën e Aseteve në Sistemin Free-Balance, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF).



# PLANIFIKIMI PËR REAGIM POLICOR NË SITUATA EMERGJENTE



## Raport i inspektimit të zakonshëm nr. 5/2008

### PLANIFIKIMI PËR REAGIM POLICOR NË SITUATA EMERGJENTE

#### 1. HYRJE

1.1 Bazuar në Ligjin mbi Inspektoratin Policor të Kosovës, Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës ka autorizuar inspektimin e zakonshëm, lidhur me planifikimin për reagim policor në situata emergjente. Inspektimi i zakonshëm i funksionalizuar nga Departamenti i Inspektimit është kryer nga data 30.06.2008 deri më 03.07.2008. Inspektimi i kësaj fushe të menaxhimit shënon një hap të rëndësishëm, ngase inspektohet për herë të parë nga zyrtarët e IPK-së.

1.2 Ofrimi i ndihmës gjatë fatkeqësive natyrore dhe rasteve tjera emergjente<sup>1</sup> është potencuar në Ligjin e Policisë, në mesin e detyrave të përgjithshme policore. Policia e Kosovës duhet të demonstrojë rritje të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve në drejtim të përmbushjes së objektivave të saj. Duke patur parasysh se situatat emergjente mund të ndodhin në çdo kohë dhe mund të jenë nga më të ndryshmet, si për nga natyra e rastit, hapësira dhe numri i qytetarëve të përfshirë nga këto ngjarje, konsiderojmë se planifikimi për reagim në këto situata është sfidë shumë e madhe për menaxhmentin policor.

1.3 Planifikimi i emergjencave përfshinë planifikimin e menaxhimit të ngjarjeve të paparashikueshme dhe të atyre që janë të ndërlidhura me pika të identifikuar ose ngjarje ku rreziqet mund të planifikohen dhe vlerësohen që më parë. Shumë situata gjatë veprimtarisë së përditshme policore janë që më parë të njohura dhe për këtë ka një rrjedhë rutinore të punës policore (demonstrata, protesta), por Policia e Kosovës mund të gjendet në situata kur duhet reaguuar ndaj incidenteve të befasishme të cilat nuk varen nga faktori njeri por nga faktori natyror (tërmetet, vërshimet, zjarret, epidemitë, etj). Matja e efikasitetit të policisë në kryerjen e detyrave varet edhe nga mënyra e planifikimit dhe implementimit të planeve me rastin e reagimit emergjent<sup>2</sup>.

1.4 Prej periudhës së pasluftës, institucionet e Kosovës përfshirë këtu edhe policinë, janë përballur me një situatë të sigurisë jo me pak probleme, si në kontekstin politik ashtu edhe në atë ekonomik e social. Në këtë mënyrë, Policia e Kosovës është gjendur para sfidave ku është kërkuar nga ajo që të hartojë plane emergjente për mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe futjen nën kontroll të situatave deri te kthimi në gjendje normale.

1.5 Qëllimi i inspektimit është që të bëhen rekomandime për menaxherët policor, se si mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave policore, në fushën e planeve për reagim në situata emergjente dhe realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmërinë me standardet relevante të Kodit të Etikës Policore (KEEP);

1 Neni 10 (Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë)

2 „Reagimi emergjent” nënkupton veprimet e kryera në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera nga autoritetet qendrore, komunale dhe nga shërbimet emergjente për zvogëlimin dhe lehtësimin e dëmeve të shkaktuara në njerëz, në pronë ose në mjedis.

- Pajtueshmërinë me Planin Strategjik të Policisë 2008-2010;
- Pajtueshmërinë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- Pajtueshmërinë me Ligjin e Policisë së Kosovës;
- Pajtueshmërinë me Ligjin për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera;
- Nxitjen për përgatitjen e planeve për reagim emergjent;
- Identifikimin e nevojave lidhur me planet emergjente dhe përhapjen e praktikave më të mira.

1.6 Gjatë inspektimit, nga inspektorët policor u intervistuan:

- Asistenti i Zëvendës Komisarit për Operativë;
- Kryesuesi i Departamentit të Rendit Publik;
- Drejtori i Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim;
- Udhëheqësi i Qendrës Operative;
- Mbikëqyrësit e Ndërrimeve në Qendrën Operative;
- Zëvendës Komandantët Regjional për Operativë;
- Komandantet e stacioneve policore,
- Shefat e ndërrimeve në stacione policore,
- Zyrtarët në Zyrat e Komunikimit në stacione policore.

1.7 Zonat e inspektimit:

- Roli dhe qasja e institucioneve ndaj emergjencave;
- Politikat dhe strategjia;
- Burimet njerëzore;
- Planifikimi;
- Implementimi i planeve;
- Partneriteti;
- Komunikimi.

1.8 Raporti është përgatitur në bazë të Parimit të Përgjegjshmërisë dhe Transparencës Publike, parim ky i mbështetur nga neni 19, i Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP).



## 2. ROLI DHE QASJA E INSTITUCIONEVE NDAJ EMERGJENCAVE

2.1 Përgatitja për tu ballafaquar me fatkeqësi natyrore<sup>3</sup> dhe incidente të rënda i kontribuon në masë të madhe sigurisë kolektive të një shoqërie dhe minimizimin e pasojave në aspekte të ndryshme. Deri vonë kjo fushë nuk ka qenë e mbuluar me ligje, kurse pas aprovimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera<sup>4</sup> është një situatë më e favorshme pasi janë definuar detyrat dhe përgjegjësitë. Ky ligj përcakton dhe rregullon sistemin e mbrojtjes dhe shpëtimit të njerëzve, të shtazëve, të pasurisë, të trashëgimisë së kulturës dhe natyrës nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Qëllimi i mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera është parandalimi dhe zvogëlimi i numrit të fatkeqësive, pengimi ose zvogëlimi i viktimave dhe i pasojave tjera.

2.2 Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Ajo zbaton së bashku me institucionet tjera politikën e qeverisë, në fushën e planifikimit dhe përballimit të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, bashkërendon veprimet e të gjitha palëve në planifikimin dhe përballimin e fatkeqësive tjera për përmbushjen e detyrave që u përkasin atyre si dhe bashkërendon punët me organet e qeverisjes vendore për përballimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, në bashkëpunim me ministrinë, institucionet dhe entet e ndryshme të vendit, bën vlerësimin e rreziqeve mbi të cilat bazohet hartimi i planit të përgjithshëm për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera në Kosovë dhe e paraqet atë për miratim në Qeveri.

2.3 Për kryerjen e detyrave të parapara për MPB-në, përgjegjës është Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave (DME) e që është kompetent për menaxhimin e situatave emergjente. Departamenti merr pjesë gjatë vendosjes për projektet hulumtuese dhe zhvillimore në programin qeveritar për hulumtime, në mënyrë që të mund të propozojë projekte hulumtuese dhe zhvillimore në lëmin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

## 3. POLITIKAT DHE STRATEGJIA

3.1 Sipas ligjit, MPB-ja nxjerrë udhëzim administrativ për përgatitjen e planit të përgjithshëm për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Bazuar në Planin Strategjik të Policisë së Kosovës për periudhën 2008-2010, objektiv dhe prioritet strategjik i Shtyllës Operative është edhe përgatitja për situata emergjente e cila në vete përfshinë zhvillimin e kapaciteteve dhe mundësive në bashkëpunim me qeverinë dhe komunitetin. Enkas strategji veprimi për reagim emergjent në bashkëpunim me mekanizmat relevant për menaxhimin e këtyre situatave nuk ekziston.

3.2 Për hartimin e planeve / urdhërave operativ, në përgjithësi menaxhmenti policor shërbehet me Udhëzuesin „Hartimi i urdhërave / planeve operative” (DRP/DPZH/0249/ 07), dokument ky i miratuar nga Shtylla e Operativës. Ky dokument

3 „Fatkeqësitë natyrore” nënkupton tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e borës, bora e madhe, era e fortë, breshëri, akulli, thatësia, paraqitja masive e sëmundjeve ngjitëse të njerëzve, të shtazëve dhe fatkeqësi tjera, që i shkakton natyra.

4 „Fatkeqësitë e tjera” nënkupton fatkeqësitë e mëdha në trafikun rrugor, ajror dhe hekurudhor, zjarret, fatkeqësitë në xeherore, shkatërrimi i digave dhe fatkeqësi tjera ekologjike dhe industriale që i shkakton njeriu me punë dhe me sjellje, gjendja e jashtëzakonshme, emergjente, temperaturat e larta, kolapsi teknik i sistemeve energjike të furnizimit me rrymë, telekomunikacioni dhe teknologjisë informative, aktet terroriste dhe mënyrat tjera të rrezikimit masiv.

ofron udhëzime për hartimin e planeve dhe urdhërave të ardhshëm operativ, duke ofruar një pasqyrë të aktiviteteve policore dhe masat që do të ndërmerren gjatë një operacioni policor. Udhëzuesi në mënyrë të përgjithësuar ofron udhëzime për të gjitha ngjarjet që mund të ndodhin duke mos specifikuar natyrën e incidentit. Sipas udhëzuesit, planet / urdhërat operative të nivelit të lartë duhet të ofrojnë një pasqyrë të përgjegjësive të cilat do të duhej të përmbusheshin gjatë operacionit, ndërsa ato të nivelit të ulët duhet të përmbajnë informacione të hollësishme në lidhje me detyrat e caktuara dhe masat që duhet ndërmarrë për të siguruar përfundim të suksesshëm të operacionit të planifikuar.

3.3 Është prezantuar Plani Operativ „Reagimi i SHPK-së në situata emergjente / fatkeqësive (incidenteve të mëdha dhe incidenteve kritike) me numër të referencës DRP / DPZH / 0172 / 07, i hartuar nga Drejtoria për Planifikim e Zhvillim (DPZH). Ky dokument përmban përshkrimin e të gjitha hapave që duhet ndërmarrë në rast të situatave emergjente dhe është destinuar për të gjitha nivelet e organizimit, duke filluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë e deri tek stacionet policore. I kualifikuar si plan i përgjithësuar, u përgjigjet situatave emergjente duke mos specifikuar natyrën e ngjarjes, por më tepër duke vënë theksin në mënyrën e organizimit emergjent dhe mekanizmave veprues në vendngjarje. Plani përcakton edhe subjektet përgjegjëse për zbatimin e tij si dhe detyrat e tyre të kyçura në operacion. Sipas tij, detyrat e policisë në këto situata janë: vendosja e pikave të kontrollit, ofrimi i ndihmës së domosdoshme në kërkim - shpëtim, sigurimi i transportit të lirë dhe të sigurt për automjetet emergjente, sigurimin e lokacioneve të vendtakimeve, vendkalimeve, vendgrumbullimeve, për të gjitha agjencionet reaguese, patrullimi në perimetrin e jashtëm për të parandaluar vjedhjet dhe grabitjet në vendngjarjen emergjente, sigurimin e vendit të ngjarjes, identifikimin e viktimave, kontrollimin e turmës.

#### **Rekomandimi nr. 1**

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që të hartoj plane të veçanta në bazë të natyrës së ngjarjeve të ndryshme emergjente, konform ligjeve në fuqi.

## **4. BURIMET NJERËZORE**

4.1 Personeli policor paraqet vlerën më të rëndësishme dhe më të shtrenjtë të Policisë së Kosovës. Si në çdo organizatë tjetër edhe në Policinë e Kosovës, shkalla e suksesit në arritjen e qëllimeve në masë të madhe varet nga niveli i aftësive, motivimit dhe profesionalizmit të personelit. Diku në rreth 95 % të rasteve, personeli policor është i pari që arrin të ballafaqohet me situata të tilla. Në këtë mënyrë sa më shpejt që është e mundur të arrihet në vendin e ngjarjes, personeli policor është i obliguar të bëjnë vlerësimin e situatës, duke përshkruar llojin e ngjarjes dhe vlerësuar shkallën e rrezikut. Kjo kërkon përgjegjësi të lartë në radhët e personelit, sepse natyra e llojeve të ndryshme të ngjarjeve kërkon përgatitje me njohuri të mjaftueshme në fusha të caktuara, varësisht nga lloji i ngjarjes (situatës emergjente / incidentit).

4.2 Nisur nga kjo përgjegjësi, janë realizuar programe trajnuese për personelin policor. Çështja e përgatitjes profesionale duhet shikuar nga prizmi i përgatitjes së personelit menaxherial në përgatitjen e planeve për situata emergjente dhe nga ai i përgatitjes për implementimin e tyre. Në rastin e parë, nëse i referohemi Drejtorisë për Planifikim e Zhvillim në përgatitjen e planeve për situata të tilla, mund të thuhet se pjesëtarët e saj kanë të kryer disa nivele të trajnimeve në fushën e planifikimit, përfshirë këtu edhe atë emergjent, kurse sa i përket rastit të dytë mund të thuhet se

janë realizuar programe trajnuese duke filluar nga policët, komandantët taktik, të cilët janë të përfshirë direkt në situata të natyrave emergjente. Plotësimi me trajnime shtesë është evident sidomos pas paraqitjes së situatës emergjente në kohën e shfaqjes së zjarreve.

4.3 Personeli policor në stacione policore është vërejtur se nuk është i pajisur me trajnime adekuate për trajtim dhe ballafaqim me situata emergjente. Mungesë e trajnimeve adekuate vërehet edhe tek personeli i angazhuar në qendrat e komunikimit (trajtimi i informatave, thirrjet emergjente, përdorimi i teknologjisë informative, menaxhimi i bazës së të dhënave). Rast konkret kemi personelin në regjion dhe stacione policore të Mitrovicës, ku si pasojë e mungesës së trajnimeve të kryera, por edhe ndërhyrjes së disa operatorëve ilegal të Serbisë, ka pasur raste kur janë dhënë koordinata të gabuara dhe patrullat policore kanë qenë të keq informuara. Vërejtje lidhur me pamjaftueshmërinë e trajnimeve në këtë fushë të planifikimit paraqesin edhe zyrtarët policor të Regjionit të Pejës, ku sipas tyre trajnimet e organizuara lidhur me planet janë të përgjithshme dhe nuk kanë synim përgatitjen e personelit për reagim në situata emergjente.

#### **Rekomandimi nr. 2**

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që të organizoj trajnime adekuate për personelin policor të kyçur në përgatitjen e planeve dhe ndërhyrje emergjente si dhe personelin e inkuadruar në qendrat e komunikimit.

4.4 Për të vlerësuar nivelin e gatishmërisë së implementimit të planeve për raste emergjente, gjatë vitit të kaluar, Shtylla e Operativës ka realizuar dy ushtrime me qëllim të verifikimit të mobilizimit të efektivave policore në rast ballafaqimi me situata dhe incidente të natyrave të ndryshme. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (DPP) është përgatitur skenari dhe është lëshuar urdhëri për mobilizim të personelit policor dhe reagim në situata emergjente. Sipas informacioneve të Drejtorive Rajonale të Policisë (DRP) dhe zyrtarëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, është konstatuar se brenda një ore pas lëshimit të urdhërit për mobilizim, rreth 60 % e personelit të paraparë për ndërhyrje është paraqitur në detyrë. Në Regjionin e Ferizajt për mobilizimin deri në nivelin 70 % të efektives policore, mesatarja e kohës sillet diku 20 - 30 minuta që llogaritet si përqindje e mjaftueshme për intervenime fillestare emergjente kur kemi parasysh distancën e largët të policëve ku jetojnë nga stacionet e tyre policore. Ushtrime të kësaj natyre janë paraparë edhe për vitin 2008, ku katër prej tyre vetëm se janë realizuar në bashkëpunim me DPP-në dhe DRP-të. Praktika e organizimit të ushtrimeve të përbashkëta me agjencionet relevante është e evidente edhe në Regjionin e Gjilanit, në të cilin së paku një herë në vit organizohen ushtrime të përbashkëta me KFOR-in, TMK-në, DME-në dhe ekipet spitalore. Në nëntor të vitit 2006, në Regjionin e Prishtinës është realizuar ushtrimi i përbashkët në aeroport. Mandej me iniciativë të Kuvendit Komunal të Prizrenit në qershor të vitit 2006 është realizuar një ushtrim i përbashkët me shërbimet emergjente.

#### **Rekomandimi nr. 3**

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që të organizoj raste të simulimit (ushtrimit) të reagimit në bashkëpunim me shërbimet tjera emergjente në drejtim të vlerësimit të aftësive për të ndërhyrë në situata emergjente.

## 5. PLANIFIKIMI

5.1 „Ne nuk dëshirojmë që të ndodhin fatkeqësitë por ato ndodhin. Me jetën vijnë edhe fatkeqësitë e katastrofat. Zhvillimet industriale sjellin edhe aksidentet teknologjike. Ndryshimet dhe zhvillimet politike dhe socio - ekonomike sjellin deri te pakënaqësitë, terrorizmi dhe lufta. Përgatitjet e duhura dhe planifikimet u mundësojnë shoqërisë që të zvogëloj fuqinë shkatërruese dhe viktimat nga këto fatkeqësi dhe katastrofa”<sup>5</sup>

5.2 Praktikisht lidhur me emergjencat Policia e Kosovës mund të gjendet para dy situatave: **e para**, kur ngjarja është e njohur paraprakisht dhe është bërë planifikimi dhe përgatitjet e nevojshme për t'u përballur me këtë situatë dhe **e dyta**, kur situata mund të rrjedhë në mënyrë spontane dhe të papritur dhe policia mund të gjendet në situatë pa informata paraprake, që si pasojë ka mosplanifikimin për situatën e tillë. Në rastin e parë aktivitetet, detyrat dhe përgjegjësitë konkrete janë të detajuara në planet përkatëse operative të hartuara, kurse në rastin e dytë ndihet nevoja e hartimit të planeve ad hoc dhe duhet të vëhet në funksion „sistemi i alarmimit emergjent”<sup>6</sup>. Sipas këtij sistemi, koha e nevojshme për rigrupimin e personelit është 35 - 45 minuta. Sa i përket këtyre dy situatave kemi pasë raste nga të dy gjendjet: kanë ekzistuar planet operative lidhur me emergjencat në sezonin dimëror, por kanë munguar planet për emergjencat në kohën e zjarreve gjatë sezonit veror (vitin e kaluar në sezonin e përhapjes së zjarreve, ka qenë sfidë e madhe për institucionet dhe mekanizmat relevant përfaqësues këtu edhe policinë, menaxhimin e situatës emergjente.

5.3 Plani është kornizë e përgjithshme dhe mbështetet në njohuritë teorike, përvojën dhe masat të cilat duhet ndërmarrë në mënyrë që të ndalohen, zvogëlohen apo trajtohen viktimat në njerëz dhe humbjet materiale të shkaktuara nga krizat natyrore, teknologjike dhe socio - ekonomike. Planet e detajuara duhet të përpilohen në çdo shërbim emergjent, në të gjitha nivelet e organizimit (lokal, regjional, qendror), por të cilat nuk duhet të jenë në kundërshtim me planin e përgjithshëm. Asnjë plan nuk mund të jap plotësisht zgjidhje në çdo fatkeqësi, ngase ato nuk mund të parashikohen plotësisht.

5.4 Është i njohur në praktikë klasifikimi i planeve për situata të jashtëzakonshme (emergjente) në plane të përgjithshme, plane specifike në bazë të vendit, plane specifike në bazë të llojit të incidentit, etj. Në grupin e parë hyjnë planet që japin vetëm kornizën e përgjithshme dhe janë të hartuara në atë mënyrë që përmbajnë sa më shumë lloje dhe tipe të fatkeqësive (plani operativ „Reagimi i Shtabit të Përgjithshëm të Policisë, Komandave Regjionale dhe stacioneve policore në rastet e emergjencave / fatkeqësive”). Në grupin e dytë hyjnë planet e hartuara që lidhen për vendet e caktuara: fabrika, aeroporte, stadione, etj (plani operativ për reagim emergjent për aksidentet ajrore „Shqiponja”). Në grupin e tretë përfaqësohen planet në rast të vërshimeve, tërmeteve, epidemive, aksidentet industriale, zjarret, etj (plani operativ „Zjarret”).

5.5 Planifikimi i mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe situata emergjente bazohet në vlerësimin e rrezikshmërisë. Këtë vlerësim të rrezikshmërisë në nivel të vendit e bën Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave (DME), kurse kur kemi të bëjmë me vlerësimin e shkallës së rrezikut lidhur me planet policore, këtë e bën Drejtoria e Analizës së Krimit (DAK) dhe Njësia Qendrore e

5 J. F. Weackler: „Disaster planning and response”, 1991

6 Procedurat Standarde të Operimit në Qendrën Komanduese dhe Sistemi i Alarmimit Emergjent: „Reagimi policor në situata emergjente”, Komanda Rajonale e Policisë - Prizren, ripunuar më 13.05.2007.

Intelegjencës (CIU)<sup>7</sup>. Sipas Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave ekzistojnë pesë nivele të emergjencës që kërkojnë pozicionimi i burimeve dhe koordinimi i aktiviteteve<sup>8</sup>: niveli katastrofik i emergjencës, niveli serioz i emergjencës, niveli i ngritur i emergjencës, niveli i mbrojtur i emergjencës, niveli i ulët i emergjencës. Mirëpo, varësisht nga kategoria, lloji dhe përmasat e emergjencës, sipas Policisë së Kosovës ekzistojnë tri nivele apo shkallë të rrezikshmërisë shoqërore:

- Niveli i lartë i rrezikshmërisë (e ashpër, e lartë);
- Niveli i mesëm i rrezikshmërisë (e ngritur, e mbrojtur);
- Niveli i ulët i rrezikshmërisë (e ulët).

5.6 Planifikimet për menaxhim në situata emergjente apo incidente kritike që kërkojnë reagim nga Policia e Kosovës bëhen nga ana e Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim (DPZH), në kuadër të Departamentit të Rendit Publik (DRP). Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Planifikim e Zhvillim korrespondojnë në planifikimin, organizimin, funksionimin, kontrollin dhe vlerësimin e sektorit operativ në kuadrin e aktiviteteve policore në ruajtjen, mbrojtjen dhe avancimin e rendit dhe sigurisë publike. Drejtorja, përveç bashkëveprimit me sektorët operativ të regjioneve, stacioneve, njësitë, sektorët e ndryshëm brenda policisë, bashkëpunon edhe me agjencionet tjera emergjente si: DME-në, TMK-në, KFOR-in, etj.

5.7 Në raportin e Inspektoratit Policor të Kosovës të publikuar kohë më parë lidhur me administrimin e planeve policore, është potencuar se planet hartohen nga niveli qendror nga ana e Departamentit për Planifikim dhe Zhvillim dhe janë obligative për të gjitha drejtoritë rajonale dhe stacionet policore. Këto plane udhëhiqen dhe implementohen nga niveli qendror. Kjo nënkupton që kur niveli qendror (në këtë rast DPZH-ja) harton planin operativ, për një ose më shumë regjione, atëherë drejtorja rajonale me njësitë përfshirëse në plan duhet të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme për implementimin e tij. Në këtë rast kur niveli qendror harton urdhrin operativ për një ose më shumë drejtori rajonale, atëherë drejtorja rajonale duhet të hartoj planin operativ me detyra konkrete për të gjitha njësitë pjesëmarrëse në operacion bazuar në urdhrin operativ qendror, saktësisht në detyrat dhe kërkesat brenda atij urdhri të përpiluar sipas modelit pesë pikësh (informata, qëllimi, metoda, administrata dhe komunikimi). Planet operative të drejtorive rajonale të hartuara në bazë të urdhërave operative nuk duhet pësuar ndryshime, udhëhiqen nga drejtoritë rajonale kurse implementimi i tyre mbikëqyret nga niveli qendror.

5.8 Në mesin e planeve operative, IPK-ja ka siguruar numër të konsideruar të planeve emergjente në Drejtorinë për Planifikim e Zhvillim. Numri i planeve emergjente të hartuara për vitin 2006 arrinë në 6 sosh (niveli qendror nuk ka pasë asnjë plan operativ emergjent të hartuar), përderisa në vitin 2007 vërehet mobilizim në këtë drejtim dhe ky numër është dukshëm më i madh (19 sosh). Numri i planeve emergjente të hartuara për vitin 2008 ka arritur në 14 sosh. Drejtorja Rajonale e Prishtinës prinë dukshëm me numrin e planeve të hartuara gjatë tri viteve të fundit (shih tabelën).

<sup>7</sup> Udhëzuesi „Hartimi i urdhërave / planeve operative”

<sup>8</sup> Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave: „Procedurat Standarde Operative për emergjencat civile në Kosovë”, faqe 2.

Tabela 1: Planet emergjente të hartuara për periudhën 2006-2008				
Nr	Departamenti / Drejtoria	2006	2007	2008
1	Departamenti për Planifikim e Zhvillim	-	2	1
2	Drejtoria Rajonale e Prishtinës	3	4	4
3	Drejtoria Rajonale e Mitrovicës	-	2	2
4	Drejtoria Rajonale e Pejës	-	3	1
5	Drejtoria Rajonale e Prizrenit	1	3	1
6	Drejtoria Rajonale e Gjilanit	1	3	3
7	Drejtoria Rajonale e Ferizajt	1	2	2
Gjithsej:		6	19	14 <sup>1</sup>

5.9 Edhe drejtoritë rajonale (zyrat e operativës regjionale) hartojnë plane për zonat e tyre të përgjegjësisë, e të cilat shqyrtohen nga Grupi Punues për Planifikim Permanent. Edhe stacionet policore hartojnë plane për zonën e tyre të përgjegjësisë të cilat dorëzohen për shqyrtim në nivel të drejtorisë rajonale (shih tabelën).

Tabela 2: Planet e hartuara nga drejtorite rajonale në vitin 2006				
Drejtoria Rajonale	Plani / Ngjarja	Kohëzgjatja	Organizator	Rrezikshm.
Prishtinë	Plani operativ „Dimri”	41 javë	KR-Prishtinë	I ulët
	Plani operativ „Vjeshta”	31 javë	Lipjan	I ulët
	Plani operativ „Gushti”	7 ditë	Lipjan	I ulët
Prizren	Parapërgatitja për sezonin e dimrit	42 ditë	KR-Prizren	I ulët
Ferizaj	Plani operativ „Rrëshqitja e dheut”	210 ditë	Ferizaj	I ulët
Gjilan	Parapërgatitja për sezonin e dimrit	41 ditë	NJTR	I ulët

5.10 Bazuar në dokumentin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (90-08-DRP/KD), Policia e Kosovës aktualisht mbulon fushën emergjente me këto plane:

- Plani i përgjithshëm për situata emergjente dhe incidente kritike;
- Plani kundër zjarreve;
- Plani i koduar „Halorët”;
- Plani kundër gripit të shpezëve „avian influenza”;
- Plani për shfrytëzimin racional të ujit të pijshëm;
- Plani për reagimet emergjente për aksidentet ajrore.

<sup>1</sup> Numri 14 i referohet vetem periudhes nëntë mujore të vitit 2008

Tabela 3: Planet e hartuara nga DPZH-ja dhe drejtorite rajonale në vitin 2007				
Depart. / Drejtoria	Plani / Ngjarja	Kohëzgjatja	Organizator	Rrezikshm.
DPZH	Plani operativ „Flaka”	365 ditë	Shtabi	Mesëm
	Plani operativ „Reagimi në emergj.”	365 ditë	Shtabi	Mesëm
Prishtinë	Plani operativ „Zjarret”	154 ditë	KR-Prishtinë	I ulët
	Parapërgatitja për sezonin e dimrit	126 ditë	Prishtinë	I ulët
	Plani operativ „Halorët”	144 ditë	Lipjan	I ulët
	Plani operativ „Halorët”	135 ditë	Drenas	I ulët
Mitrovicë	Plani aktiv „Halorët”	165 ditë	KR-Prishtinë	I ulët
	Plani aktiv „Sezoni i verës”	165 ditë	KR-Prishtinë	I ulët
Pejë	Zinxhiri i sigurisë	271 ditë	KR-Pejë	I ulët
	Plani operativ „Halorët”	195 ditë	KR-Pejë	Mesëm
	Plani operativ „Parandalimi zjarreve”	28 ditë	Deçan	I ulët
Prizren	Plani operativ „Halorët”	191 ditë	KR-Prizren	I ulët
	Kujdesi i shtuar për incidente zjarri	63 ditë	KR-Prizren	I ulët
	Parapërgatitja për sezonin e dimrit	126 ditë	KR-Prizren	I ulët
Ferizaj	Plani operativ „Pajisjet dimërore”	39 ditë	NJTR	I ulët
	Plani operativ „Dimri”	140 ditë	Shtërpcë	I ulët
Gjilan	Plani operativ „Kujdesi për sez. dim”	137 ditë	NJTR	I ulët
	Mbrojtja e KEK-ut dhe antenave të PTK-së nga zjarret	133 ditë	Viti	Mesëm
	Rritja e masave sigurisë nga zjarret	112 ditë	Gjilan	Mesëm

## 6. IMPLEMENTIMI I PLANEVE EMERGJENTE

6.1 Qeveria dhe komunat organizojnë mbrojtjen dhe shpëtimin nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si sistem unik i tërësishëm në Kosovë. Për angazhimin e forcave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera vendos qeveria. Për aktivizimin e forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në nivel lokal vendos Komiteti Komunal për Mbrojtje e Shpëtim (KKMSH), kurse në nivel qendror Komiteti Ndërmintor për Mbrojtje dhe Shpëtim (KNMSH).

6.2 Lidhur me reagimin në situata emergjente mund të thuhet se aty ku nuk ka pasur paralajmërim të incidentit, reagimi ndaj krizës do të fillohet nga reaguesit e emergjencës që arrijnë në vendngjarje, i njohur ky si reagim nga poshtë - lartë. Aty ku informacioni apo parashikimi e ka paralajmëruar një ngjarje dhe aktivitetet përgatitor apo një reagim i hershëm është i kërkuar, atëherë kjo është e njohur si reagim nga lartë - poshtë. Të dyja këto mënyra do të përdorin procedurat e njëjta, por për reagimin lartë - poshtë, grupet duhet të mbledhen periodikisht më parë në mënyrë që të zhvillojnë strategji, politika dhe duke drejtuar planifikimin para incidentit.



6.3 Njësitë dhe shërbimet të cilat marrin pjesë në këto aktivitete udhëhiqen nga udhëheqësit e tyre në përputhje me rregullat e parapara me ligj. Në mesin e forcave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera hyn edhe Policia e Kosovës. Rendin dhe sigurinë publike në rast të këtyre situatave në rajonin e goditur e siguron Policia e Kosovës. Varësisht nga natyra e situatës emergjente përcaktohet edhe agjencioni apo mekanizmi, i cili ka primatin për menaxhimin e situatës. Në rast të situatave të ballafaqimit me zjarre, rolin përgjegjës të menaxhimit e merr njësia e zjarrfikësve, në rastet e ndonjë epidemie ky rol i takon ekipeve shëndetësore, kurse roli i policisë është mbështetës që t'iu dal në ndihmë qytetarëve, të ndalojë kryerjen e veprimeve kriminale dhe të ruajë pasurinë e qytetarëve në situata të tilla. Policia e Kosovës funksionon dhe koordinon veprimet në bashkëpunim me agjencione dhe mekanizma kompetent për trajtimin dhe menaxhimin me situata të ndryshme emergjente. Bashkëpunimi dhe funksionimi me shërbimet emergjente<sup>9</sup> është i përcaktuar mbi bazën e Ligjit për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.

6.4 Bazuar në metodën e ndërhyrjes policore në situata emergjente dhe incidente mund të themi se ky intervenim i nënshtrohet disa fazave. Janë të njohura faza e reagimit fillestar, faza e konsolidimit, faza e ringjalljes dhe faza e rivendosjes së gjendjes normale. Këto faza përfshijnë ndërmarrjen e veprimeve në kushtet e sigurimit të vendit të ngjarjes, funksionalizimit të të gjitha niveleve organizative të përfshira në incident, intervenimin sipas planeve deri tek kthimi në gjendje normale.

6.5 Inspektorati Policor ngrehë shqetësimin lidhur me faktin se nuk është hasur në ndonjë vlerësim dhe analizë të ndonjë plani, pas implementimit të tyre lidhur me mbarëvajtjen e operacioneve në kohën e reagimit emergjent, me qëllim të identifikimit të rezultateve. Veç tjerash meqenëse disa plane janë që më parë të përpiluara, ato kanë nevojë të rishikohen dhe riformulohen ngase kanë ndryshuar kushtet nën të cilat janë hartuar me qëllim të përshtatjes me ligjet e hyra në fuqi.

#### Rekomandimi nr. 4

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që pas implementimit të planeve operative lidhur me situatat emergjente të aplikojë metodën e analizimit dhe vlerësimit të punës dhe aktiviteteve policore.

6.6 Për kryerjen me sukses të aktiviteteve policore gjatë ballafaqimit me incidente, padyshim është i nevojshëm edhe posedimi i pajisjeve adekuate. Edhe sot e kësaj dite Policia e Kosovës nuk posedon pajisje të përsosura për ballafaqim me situata të tilla. Rast konkret cekim mungesën e pajisjeve adekuate për ballafaqim me situatat e trazirave, protestave të dhunshme të qytetarëve dhe ngjarjeve tjera (mungon tubi i ujit, automjetet e blinduara, helikopteri, automjetet mobile komanduese, etj). Gjithashtu kur bëhet fjalë për komunikimin, ndihet mungesë e radiolidhjeve, pajisjet janë të vjetruara, një numër i tyre janë jashtë funksionit (përmendim këtu shqetësimet e zyrtarëve policor në Regjionin e Pejës dhe Mitrovicës).

<sup>9</sup> „Shërbimet emergjente” nënkuptojnë shërbimet e siguruara nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës, Shërbimi Policor i Kosovës, shërbimet emergjente mjekësore spitalore dhe paraspitalore të Kosovës, shërbimet komunale zjarrfikëse dhe të shpëtimit, shërbimet emergjente mjekësore komunale dhe OJQ-të përkatëse.



#### Rekomandimi nr. 5

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që urgjentisht t'i kushtojë rëndësi furnizimit me mjete dhe pajisje të nevojshme policore, kurse aty ku është e mundur të përmirësohet gjendja aktuale e tyre me qëllim të rritjes së efikasitetit.

## 7. PARTNERITETI

7.1 Në situatat emergjente krijohet nevoja për veprime të ndryshme dhe të ndjeshme. Andaj në këto situata nevojitet një mobilizim i të gjitha institucioneve relevante të cilat janë të obliguara për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pasurisë së njerëzve. Pra, është i domosdoshëm partneriteti në mes institucioneve relevante. Për t'i përballuar emergjencave është e pamundur që policia si e vetme të mund të sfidojë rreziqet pa një bashkëpunim dhe partneritet me organizatat dhe agjencionet tjera që janë të dedikuara për reagim emergjent. Kjo nënkupton se për të arritur objektivat e saj në fushën e menaxhimit të emergjencave, Policia e Kosovës duhet të ndërtojë marrëdhënie të forta me të gjithë mekanizmat që kanë të bëjnë me menaxhimin e katastrofave dhe emergjencave civile në tërë vendin.

7.2 Sipas zyrtarëve të Drejtorisë për Planifikim e Zhvillim, në suaza të partneritetit me agjencione tjera, zhvillohen takime konsultative në drejtim të bashkëpunimit me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë dhe ballafaqimit me situata të ndryshme emergjente. Kurse sipas zyrtarëve policor të nivelit regjional dhe lokal mungojnë konsultimet rreth planifikimit që ka rezultuar me hartim të planeve pa një pjesëmarrje të të gjitha agjencioneve që mund të kontribuojnë në situata emergjente (evidente në Regjionin e Pejës). Ka indikacione të një bashkëpunimi jo të kënaqshëm në nivel lokal në mes të Policisë së Kosovës dhe institucioneve, siç është rasti në Regjionin e Prizrenit (evidente është mospërkrahja e duhur në rast të fatkeqësive me lëndime dhe neglizhenca e personelit shëndetësor nga ana e Shtëpisë së Shëndetit, në Ferizaj ku janë potencuar vonesat e ndihmës mjekësore në raste të aksidenteve në trafik, etj).

#### Rekomandimi nr. 6

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që të rrisë bashkëpunimin me shërbimet tjera, si në formën e konsultimeve në përgatitjen e planeve po ashtu edhe në drejtim të koordinimit të aktiviteteve për ndërhyrje emergjente.

## 8. KOMUNIKIMI

8.1 Informimi, komunikimi dhe koordinimi i veprimeve në rastet e situatave emergjente dhe incidenteve në mes të niveleve të menaxhimit, agjencioneve dhe njësisë reflektojnë fuqishëm në efikasitetin dhe rezultatin e punës. Pranimit, selektimi, kualifikimi dhe distribuimi i informatës është pika më e rëndësishme e punës policore nga e cila varet edhe i tërë sistemi i veprimit policor. Nga momenti i parë i pranimit të informatës vihet në veprim një mekanizëm i tërë reagues, si në aspektin operativ poashtu edhe në atë teknik, taktik, logjistik dhe atë numerik të efektives

policore. Në kuadër të Shtyllës së Operativës vepron Qendra e Komunikimit, e cila ka rolin e informimit, koordinimit dhe komandimit të të gjitha aktiviteteve operative policore. Për vlerësimin e informatës, varësisht nga natyra e incidentit parashihet edhe niveli komandues i cili duhet të njoftohet. Qendra e Komunikimit punon me orar 24 orësh dhe pranon informata nga të gjitha drejtoritë rajonale. Qendrat e komunikimit ekzistojnë edhe në kuadër të drejtorive rajonale dhe stacioneve policore.

8.2 Policia e Kosovës nuk posedon sistemin e përsosur të teknologjisë së orientimit në hapësirë dhe ende orientohet në bazë të sistemit klasik koordinativ hartografik. I mungon Sistemi i Pozicionimit Global (GPS) i cili do të lehtësonte orientimin e njëjësive policore dhe do të kishte përmirësuar shumë më shumë kohën e reagimit policor.

#### **Rekomandimi nr. 7**

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që të shqyrtoj mundësinë e futjes në funksion të Sistemit të Orientimit Global (GPS), në drejtim të rritjes së performancës policore.

8.3 Sipas Drejtorisë së Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK), momentalisht, Policia e Kosovës përdorë disa sisteme të teknologjisë informative dhe të komunikimit, që në fakt disa nga to janë në fazën e ndërtimit të plotë. Përdoret Sistemi Analog i Radiokomunikimit që mbulon pothuajse 95 % të territorit ku veprojnë pjesëtarët e policisë dhe përfshinë rreth 7.000 radio të dorës, 500 radio mobile të instaluar në automjete policore, më shumë se 90 radiobaza dhe afërsisht 60 repetitor, përmes të cilëve transmetohet sinjali. Veç këtij sistemi përdoret edhe Sistemi i Telefonisë VOIP, i ndërtuar në bazë të teknologjisë së shpërndarjes së sinjalit përmes linjave mikro valore dhe instalimit të centraleve telefonike në çdo stacion policor, sistem ky që ka shtrirje në mbi 90 % të stacioneve policore. Këto stacione shfrytëzojnë teknologjinë më të fundit në komunikimin e brendshëm. Investimet në këto sisteme kanë kursyer në masë të madhe shpenzimet telefonike.


8.4 Drejtoritë rajonale kanë qendrat operative të komunikimit, në të cilat ekzistojnë linjat emergjente, ku qytetarët mund të lajmërohen pa shpenzime. Këto linja deri vonë kanë qenë vetëm në kodin „112”, kurse tash ato janë zëvendësuar me kodin „911”, „922” si dhe „092” për linjat fikse. Prefiksi „112”, i cili është ende në shërbim të qytetarëve për thirrje në ndihmë, nuk është në dispozicion të të gjitha qendrave policore të komunikimit, ngase në disa regjione është në posedim të DME-së, por prapëseprapë në bashkëpunim shumë serioz me këtë shërbim në rast të thirrjeve eventuale në këtë numër, njoftohet qendra operative komunikuese e regjionit. Për të qenë shpejtësia e komunikimit në nivel të lartë kundrejt reagimit në situata emergjente, janë aktivizuar edhe linjat „hot line” që janë në funksion në të gjitha drejtoritë rajonale dhe drejtoritë rajonale kufitare.

#### **Rekomandimi nr. 8**

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që të bëjë unifikimin e linjave (kodeve) të hapura për qytetarët dhe njëherit të bëjë publikimin e tyre përmes njoftimeve dhe fushatave të ndryshme mediale.

8.5 Njësitë policore nëpër stacione janë të parat që ballafaqohen me situatat e të gjitha natyrave. Me të arritur në vendin e ngjarjes, njësitë policore duhet të bëjnë vlerësimin e situatës në vendin e ngjarjes dhe duhet menjëherë të plasoj informatën në

qendrën e komunikimit të stacionit policor, sipas zinxhirit komandues. Pas vlerësimit të informatës, ajo plasohet tutje në Qendrën e Komunikimit të Drejtorisë Rajonale, e më vonë edhe pas një vlerësimi që i bëhet, informata përcillet deri në Qendrën Operative të Drejtorisë së Përgjithshme. Në këtë mënyrë, sipas nevojës, bëhet vlerësimi i informacionit nga tri nivelet e menaxhimit. Nga vlerësimi i informacionit varet edhe niveli i reagimit apo angazhimit të njësive konform natyrës së ngjarjes. Ka raste kur varësisht nga natyra e ngjarjes, dispeçeri posa të pranojë informatën, fillimisht njofton ekipet patrulluese që gjenden në terren për ngjarjen e njoftuar. Çdo pjesëtar i policisë, i cili do të jetë në situatë të shpallë incidentin kritik, duhet ta komunikojë lokacionin e ngjarjes, llojin e incidentit, nurmin e të lënduarve, rreziqet, kërkesat për ndërhyrje dhe pikë-takimet.





# MENAXHIMI I POLICISË KUFITARE



### MENAXHIMI I POLICISË KUFITARE

#### 1. HYRJE

1.1 Bazuar në Ligjin mbi Inspektoratin Policor të Kosovës, Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës ka autorizuar inspektimin e gjashtë të zakonshëm, lidhur me menaxhimin e policisë kufitare. Inspektimi i zakonshëm i funksionalizuar nga Departamenti i Inspektimit është kryer nga data 22 shtator deri më 1 tetor të vitit 2008. Inspektimet janë zhvilluar në Departamentin e Policisë Kufitare, në Drejtoritë Rajonale të Policisë Kufitare dhe në vendkalimet kufitare (me përjashtim të portave 1 dhe 31).

1.2 Policia e Republikës së Kosovës (PK) e formuar në bazë të parimeve demokratike, të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të sundimit të ligjit, përgjithësisht është duke kaluar në një fazë të rëndësishme të zhvillimit të saj. Në këtë kohë kur shumë nga funksionet policore janë transferuar të policia vendore, shtrohen shumë detyra dhe sfida për menaxherët e lartë të PK-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës (MPB), për të funksionalizuar një polici në pajtim me kushtetutën, ligjet e aprovuara dhe me standardet e Bashkimit Evropian.

1.3 Në tetor të vitit 2004, Komisioni Evropian hartoi "Udhëzimet mbi Menaxhimin e Integruar të Kufijve (MIK) në Ballkanin Perëndimor" për të ofruar bazën e zbatimit në vazhdimësi të veprimtarive që lidhen me problemet e menaxhimit kufitar në Ballkanin Perëndimor. Në përputhje me këtë dokument, Kuvendi i Republikës së Kosovës në muajin maj të këtij viti ka miratuar Ligjin për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror (03/L-065). Sipas ligjit, Menaxhimi i Integruar i Kufirit nënkupton bashkërendim dhe bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjitha autoriteteve përkatëse dhe agjencive të përfshira në sigurinë kombëtare dhe lehtësimin e tregtisë, për vendosjen e sistemeve të efektshme dhe me rendiment të menaxhimit të integruar të kufirit, me qëllim arritjen e objektivit të kufijve të hapur, por mirë të kontrolluar dhe të sigurt.

1.4 Inspektorati Policor i Kosovës i orientuar në mbledhjen e të dhënave në lidhje me performancën aktuale të policisë kufitare dhe aftësinë e tyre për të ofruar shërbime efikase, do t'i përpunoj ato që të përdoren për të drejtuar funksionin e Ministrisë lidhur me definimin e synimeve kryesore policore në fushën e policisë kufitare, në drejtim të përmirësimit të sigurisë kufitare. Qëllimi i këtij inspektimi është që të jepen rekomandime për mënyrën se si menaxherët e lartë të PK-së mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave në fushën e policisë kufitare dhe realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmërinë me standardet relevante të Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP);
- Pajtueshmërinë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 128, pika 5);
- Pajtueshmërinë me dispozitat relevante të ligjeve në fuqi dhe Parimet dhe Procedurat e SHPK-së;

- Të inkurajojë strategjitë më të mira policore proaktive dhe reaktive, për të ofruar siguri në kufi dhe për të kontrolluar migrimin;
- Të inkurajojë strategjitë me të mira policore për të luftuar krimin e organizuar në vendkalimet kufitare, dhe
- Të identifikojë dhe përhapë praktikatat me të mira.

1.5 Gjatë inspektimit, nga inspektorët policor u intervistuan:

- Asistenti i Zëvendës Komisarit për Polici Kufitare;
- Kryesuesi i Departamentit të Policisë Kufitare;
- Udhëheqësi i Drejtorisë për Mbështetje Administrative;
- U.d. së Udhëheqësit të Drejtorisë për Operativë;
- Drejtori i Drejtorisë për të Huaj dhe Migrim;
- Udhëheqësi i Njesisë për Akte Normative dhe Ndërlidhje;
- Udhëheqësi i Njesisë për Incidente Ndërkufitare dhe Inspektim;
- Shefi i Hetimeve Regjionale;
- Komandantët Regjional (Drejtorët Rajonal) të Policisë Kufitare;
- Kryesuesi i Policisë Kufitare në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës;
- Zyrtarët përgjegjës në vendkalime kufitare;
- Shefat e Operativës në vendkalimet kufitare;
- Mbikëqyrësit e ndërrimeve në vendkalimet kufitare.

1.6 Zonat e inspektimit:

- Udhëheqja;
  - Organizimi i brendshëm,
  - Burimet njerëzore,
  - Infrastruktura dhe pajisjet,
  - Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit,
- Strategjia dhe politikat;
- Performanca e policisë kufitare;
- Partneriteti

1.7 Raporti është përgatitur në bazë të Parimit të Përgjegjshmërisë dhe Transparencës Publike, parim ky i mbështetur nga neni 19 i Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP).



## 2. UDHËHEQJA

### 2.1 Organizimi i brendshëm

2.1.1 Sipas ligjit, Menaxhimi i integruar dhe kontrolli kufitar (MIK) është kompetencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, kurse detyrat e menaxhimit të integruar dhe kontrollit të kufirit shtetëror<sup>1</sup> i kryen kryesisht policia kufitare, e ndihmuar nga agjencitë tjera shtetërore relevante. Ligji përcakton se policia kufitare është përgjegjëse<sup>2</sup> për:

- menaxhimin dhe kontrollin në Pikat e Kalimit Kufitar (PKK);
- menaxhimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen përgjatë Kufirit të Gjelbër<sup>3</sup>;
- menaxhimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen përgjatë Kufirit të Kaltër<sup>4</sup>;
- menaxhimin dhe kontrollin brenda Republikës së Kosovës, lidhur me çështjet kufitare;
- lëshimin e dokumenteve të përkohshme të udhëtimit siç përcaktohet nga MPB-ja;
- sigurinë në aeroportet ndërkombëtare në bashkëpunim me operatorin e aeroportit dhe autoritetet relevante të autorizuara;
- parandalimin e akteve terroriste në partneritet me të gjitha agjencitë për zbatimin e ligjit;
- përcaktimin e të drejtës së çdo personi që dëshiron të hyjë apo të lëshoj Kosovën lidhur me kërkesat për viza dhe hyrje;
- mbylljen e përkohshme të kufijve, sipas vendimit ministror;
- dhënien e autorizimit të përkohshëm për të kaluar Kufirin e Gjelbër dhe të Kaltër sipas vendimit.

2.1.2 Misioni dhe objektivat e Shtyllës së Policisë Kufitare janë ofrimi i shërbimeve cilësore në pikat kufitare dhe mundësimi i lëvizjes së lirë të qytetarëve e mallrave, ruajtja dhe kontrollimi i kufirit dhe brezit kufitar të vendit, ofrimi i shërbimeve kualitative dhe profesionale për të gjithë shtetasit e vendit dhe të huaj që hyjnë dhe dalin nga Republika e Kosovës. Shtylla e Policisë Kufitare është themeluar në qershor të vitit 2006, në bazë të vendimit për transferimin e kompetencave të këtij funksioni policor të rëndësishëm, nga Policia Civile e UNMIK-ut tek SHPK-ja (tani Policia e Kosovës).

2.1.3 Udhëzuesi i MIK-ut parasheh që policia të jetë e ndarë nga të ashtuquajturat rojat kufitare, përderisa tek ne nuk është bërë një dallim i tillë. Derisa rolin e

1 Republika e Kosovës ka shtrirje në qendër të pjesës perëndimore të Gadishullit Ballkanik, me sipërfaqe prej 10.887 km<sup>2</sup>, me një dendësi të popullsisë prej 193 banorë në një km<sup>2</sup>. Gjatësia e vijës kufitare me Serbinë në veri dhe lindje është 351.6 km, me Maqedoninë në jug është 158.7 km), me Shqipërinë në jugperëndim është 111.8 km dhe Malin e Zi në veriperëndim është 78.6 km. Gjatësia e vijës kufitare në total e Republikës së Kosovës është 700.7 km.

2 Ligji për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror (neni 5, pika 5.3)

3 "Kufiri i gjelbër" nënkupton çdo vijë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera me përjashtim të pikave zyrtare të kalimit.

4 „Kufiri i kaltër” nënkupton çdo hapësirë me ujë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera me përjashtim të pikave zyrtare të kalimit.

mbikëqyrjes dhe kontrollit kufitar ia përcakton rojave kufitare, në vendin tonë sipas ligjit në fuqi, këtë funksion e kryen Policia Kufitare si pjesë integrale e Policisë së Kosovës<sup>5</sup>.

2.1.4 Shtylla e Policisë Kufitare brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (DPP) ka një strukturë të organizimit të hartuar pa një vlerësim real të nevojave dhe kërkesave, si dhe pa këshillat e specialistëve të kësaj fushe<sup>6</sup>. Ndërrimi i shpeshtë i përfaqësuesve ndërkombëtarë që kanë udhëhequr me policinë, ka bërë që të vijë në shprehje ndryshime të kohëpaskohshme në strukturën e organizimit, pa ndonjë rishqyrtim serioz të bazuar në vlerësim të nevojave. Në kuadër të shtyllës janë të strukturuar:

- Departamenti i Policisë Kufitare;
- Drejtorati i Operativës;
- Drejtorati i Administratës dhe
- Drejtorati për të Huaj e Migrim.

2.1.5 Në nivel regjional funksionojnë drejtoritë rajonale të Policisë Kufitare (DRPK), si:

- Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare “Veriu” (PKK-të 1, 3, 4 dhe 31);
- Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare “Lindja” (PKK-të 5, 6, Hani i Elezit dhe Gllloboçicë);
- Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare “Perëndimi” (PKK-të ne Vërmicë, Qafa e Prushit, Qafa e Morinës dhe Kulla) dhe
- Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës.

2.1.6 Në kuadër të drejtorive rajonale kufitare veprojnë togjet patrulluese që kanë për detyrë mbikëqyrjen e vijës kufitare dhe luftimin apo minimizimin e krimit ndërkufitar (kontrabandën me armë, kontrabandën me kafshë, kontrabandën me mallra të ndryshme, trafikimin me qenie njerëzore). Togjet patrulluese kanë një strukturë organizative të ndarë në sektorë dhe zona patrulluese, varësisht nga gjatësia e vijës kufitare që kanë në zonën e përgjegjësisë. Në ndërrime punohet nga 12 orë, njëjtë sikurse personeli tjetër policor që është i vendosur në vendkalime kufitare.

## 2.2 Burimet njerëzore

2.2.1 Gjendja momentale e burimeve njerëzore ndryshon me gjendjen që e parasheh struktura organizative. Në kuadër të shtyllës janë të inkuadruar 1.129 pjesëtarë policor dhe nëpunës civil, që është për 179 të inkuadruar më pak në krahasim me strukturën e aprovuar. Në veçanti vërehet një mosplotësim i strukturës tek kategoritë: rreshter, polic patrullues dhe nëpunës civil. Kur kemi parasysh gjatësinë e vijës kufitare, ndihet nevojë e ballafaqimit me këtë problematikë, ngase informacionet nga terreni flasin për një pamundësi të mbulimit të zonës së përgjegjësisë me numrin aktual të rreshterëve dhe policëve patrullues. Personeli civil nuk ka pësuar ndryshime

<sup>5</sup> Sipas “Udhëzuesit të MIK-ut”, derisa rojet kufitare janë përgjegjëse ekskluzivisht për kontrollin në PKK dhe përgjatë vijës kufitare, forcat e rregullta policore janë përgjegjëse për kontrollin në brendësi të territorit; d.m.th, ushtrimi i rregullt i pushtetit policor nuk ka si objektiv kontrollin kufitar.

<sup>6</sup> Ky vlerësim përkrahët gjithashtu edhe nga “Strategjia e Policisë Kufitare 2008-2011” e hartuar nga Policia e Kosovës, faqe 3.

nga viti i kaluar dhe përfaqësohet me 3.5 %, kundrejt personelit të planifikuar sipas strukturës me pjesëmarrje prej 6.6 %. Raporti i inspektimit të zhvilluar vitin e kaluar ka potencuar nevojën e shqyrtimit të mundësisë së zgjerimit të rolit të nëpunësve civil në funksione mbështetëse. Po ashtu vërehet një ekzistim strukturash të ndryshme të organizimit, gjë të cilën e dëshmojnë informacionet e ndryshme lidhur me këtë fushë. Derisa analiza e bërë më lartë është e nxjerrë nga informacionet e marra nga niveli qendror, në anën tjetër Inspektoratit Policor iu është bërë e njohur edhe një strukturë e modifikuar, e muajit nëntor të vitit 2007, që parasheh numër edhe më të madh të të inkuadruarve në krahasim me të dhënat e pasqyruara në tabelë (shih tabelën 1).

Tabela 1 – Burimet njerëzore të Policisë Kufitare (dhjetor 2008)										
DRPK/PKK	Gj/m	Kol	N/k	Maj	Kap	Tog	Rr	Pol	Civ	Total
Shtabi	1	1	3	1	4	10	10	37	9	76
“Veriu”	-	-	-	-	2	4	18	136	3	163
Porta 1	-	-	-	-	-	1	2	26	3	32
Porta 3	-	-	-	-	1	-	5	37	1	44
Porta 4	-	-	-	-	-	1	3	24	1	29
Porta 31	-	-	-	-	1	1	2	14	1	19
“Perëndimi”	-	-	-	1	2	4	19	65	6	97
Vërmicë	-	-	-	-	1	1	7	62	2	73
Qafë Prush	-	-	-	-	-	-	6	25	1	32
Qafë Morinë	-	-	-	-	-	1	4	23	1	29
Kulla	-	-	-	-	-	1	5	37	-	43
“Lindja”	-	-	-	1	2	4	9	95	4	115
Gllloboqicë	-	-	-	-	-	1	4	30	1	36
Hani i Elezit	-	-	-	-	1	1	9	84	3	98
Porta 5	-	-	-	-	-	1	6	50	1	58
Porta 6	-	-	-	-	-	1	3	46	1	51
“Aeroporti”	-	-	-	1	-	3	14	114	2	134
<b>Numri aktual</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>14</b>	<b>35</b>	<b>126</b>	<b>905</b>	<b>40</b>	<b>1.129</b>
Struk. aprovuar	1	1	5	5	15	46	169	980	86	1.308
Ndryshimi	-	-	-2	-1	-1	-11	-43	-75	-46	-179

### Rekomandimi nr. 1

Inspektorati Policor i rekomandon menaxhmentit policor që të përcaktoj se cila strukturë është funksionale, ose në të kundërtën, në mungesë të një strukture të mirëfilltë organizative dhe në bazë të analizave mbi burimet njerëzore, të hartojë dhe funksionalizoj një strukturë të qartë të organizimit të brendshëm struktural.

2.2.2 “Spektri i kontrollit” mbi numrin e vartësve që në mënyrë të drejtpërdrejtë raportojnë tek mbikëqyrësit, nuk jep rezultate që sinjalizojnë për ndryshime në drejtim pozitiv. Tek nivelet e përgjithshme të spektrit të kontrollit për një numër gradash, ekziston një mostër e ndryshme në nivel regjionesh, që nënkupton se fare nuk ka trend të përmirësimit nga viti i kaluar. Në nivel të përgjithshëm, ky spektër i pa përmirësuar duket kështu: kapiten (2.5), toger (3.6) dhe rreshter (7.2). Përkujtojmë nga inspektimi i kaluar se spektri optimal i kontrollit në nivele të rëndësishme të menaxhimit duhet të diktohet nga një numër faktorësh, e jo vetëm nga përsëritja e punës që në mënyrë të qartë tregon fushëveprimin dhe natyrën e funksioneve mbikëqyrëse të këtyre

zyrtarëve. Inspektorati Policor rikujton rekomandimin për menaxhmentin policor të dhenë vitin e kaluar, që të rishikoj strukturën organizative duke u përpjekur të arrijë një spektër të njëtrajtshëm kontrolli për disa nivele të menaxhimit.

2.2.3 Për menaxhim sistematik të burimeve njerëzore është e nevojshme vendosja e një politike të qartë për burimet njerëzore. Zhvillimi i karrierës duhet bazuar jo vetëm në kontrollin e rendimentit vetjak nga ana e mbikëqyrësve, por duhet mbështetur edhe nga një strategji dhe politikë koherente trajnimi, që do të duhej të përfshijë trajnimin teorik dhe praktik si dhe trajnimin e vazhdueshëm të specializuar. Zyrtarët që kryejnë detyrat e policisë kufitare duhet të jenë profesionist të specializuar e të trajnuar, dhe se trajnimi i tyre duhet bazuar në nivel qendror (themelor) që paraqet minimumin e kërkesave për trajnimin e policisë kufitare, specializim rajonal dhe trajtim individual i çështjeve me rëndësi të veçantë. Derisa niveli i parë paraqet bazën, dy të fundit paraqesin nivele të specializuara të trajnimit. Trajnimet e policisë kufitare duhet të përqendrohen në shtjellimin e temave mbi njohuritë e përgjithshme për dokumentet e udhëtimit (vizat, lejet e qëndrimit), njohuritë mbi Ligjin e Azilit dhe trajtimin e emigrantëve, njohuri mbi trajtimin e rasteve dhe incidenteve kriminale, njohuri mbi kompetencat në rast të shkeljeve administrative lidhur me kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, etj.

2.2.4 Në vitin 2007 dhe në gjashtëmujorin e parë të këtij viti janë bërë investime të vazhdueshme për trajnimin e policisë kufitare. Janë mbajtur numër i konsiderueshëm i trajnimeve dhe vetëm gjatë vitit të kaluar në trajnime të ndryshme kanë marrë pjesë 902 zyrtarë policor me 8.037 ditë të vijuara në trajnim, kurse në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, në trajnime të ndryshme kanë marrë pjesë 621 zyrtarë policor, me 5.070 ditë të vijuara. Gjatë intervistave, nga zyrtarët policor u vu në pah nevoja e domosdoshme e trajnimit të personelit të policisë kufitare në fushat si: trajnimi në kontrollin e dokumenteve, trajnimi për përdorimin e armëve të gjata (për personelin që ka përfunduar këtë trajnim të bëhet ricertifikimi) si dhe trajnimi për vëzhgimin e vijës kufitare, sidomos për personelin e togjeve patrulluese. Nga të dhënat e siguruar, del se 502 zyrtarë policor (46%) nga i tërë personeli në kuadër të policisë kufitare janë të certifikuar për përdorimin e armëve të gjata (AK-47). Nuk është vërejtur se janë organizuar kurse të gjuhëve të huaja, kur dihet se aftësitë gjuhësore janë faktor vendimtar në lehtësimin e bashkëpunimit ndërkufitar si dhe në shkëmbimin e informacionit në nivel ndërkombëtar. Inspektorati Policor inkurajon menaxhmentin policor të ofrojë mundësi për mbajtjen e kurseve të gjuhëve të huaja, veçanërisht të gjuhëve të vendeve fqinje dhe gjuhës angleze.

2.2.5 Menaxhimi i Integruar i Kufirit si pjesë të politikës dhe strategjisë së personelit, potencon nevojën e monitorimit të rregullt të kryerjes së detyrave në përputhje me "kodin etik". Për të siguruar vijueshmëri kontrollesh dhe për të zbuluar shkeljet e mundshme, menaxhimi mund të mbështetet në aplikimin e sistemit të kontrolleve. Me qëllim që të bëhet vlerësimi i performancës policore, në kuadër të Zyrës së Asistentit të Zëvendës Komisarit për Polici Kufitare është themeluar Njësi të Inspektimit dhe Incidente Ndërkufitare. Qëllimi kryesor i inspektimeve të kryera nga ky njësi është mbikëqyrja e punës si dhe mënyra e menaxhimit të punëve, personelit dhe pronës nga ana e mbikëqyrësve të policisë, me synim të identifikimit të dukurive negative. Derisa gjatë vitit të kaluar ka realizuar 97 inspektime, kjo njësi në gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 ka realizuar 43 inspektime lidhur me kryerjen e detyrave policore në regjione, stacione dhe njësi të policisë kufitare. Lidhur me inspektimet e kryera mbi gjendjen faktike në terren, janë përgatitur raporte inspektimi ku janë cekur vërejtjet mbi të gjeturat. Vërejtjet janë të shumëllojshme dhe u adresohen pothuajse të gjitha vendkalimeve kufitare, Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës si dhe togjeve patrulluese.

2.2.6 Në dhjetor të vitit 2006, Asistenti i Zëvendës Komisarit për Administratë ka aprovuar Parimin P-3.27, mbi "transferimin dhe rotacionin e pjesëtarëve të SHPK-së",

i cili iu është shpërndarë komandantëve regjional, kryesuesve të departamenteve: të Rendit Publik, Krimin, Njësi Speciale, Policisë Kufitare, Shërbimeve Mbështetëse, Trajnimit. Qëllimi i implementimit të këtij parimi është ngritja e efikasitetit, cilësisë së punës, përmirësimit të kushteve të punëtorëve dhe përparimit të shërbimit. Kjo formë transferimi (rotacioni) është e kufizuar në kohëzgjatje prej 3-6 muaj. Sipas Procedurave Standarde të Operimit (PSO) mbi "Trajnimin në rotacion"<sup>7</sup>, trajnimi iu mundëson të punësuarve në Polici Kufitare të këmbëjnë përvojat me njësitet ku ata do të shërbejnë gjatë periudhës rotative, të njihen me natyrën e punës në ato njësi, në mënyrë që varësisht nga rrethanat të kenë njohuri për t'u ballafaquar me specifikat e secilës punë kufitare. Sipas këtyre PSO-ve, trajnimi bën zhvillimin e zyrtarëve policor dhe ofron mundësi të barabarta për të punësuarit. Trajnimi realizohet duke i lëvizur me rotacion zyrtarët policor dhe rreshterët në kuadër të policisë kufitare nga një pozitive në tjetrën. Trajnimet në kuadër të programit zgjasin dy (2) muaj për çdo pozitive rotative, kurse pas përfundimit të programit trajnues, mbikëqyrësit janë të obliguar të bëjnë vlerësimin e performancës për periudhën të cilës iu kanë nënshtruar zyrtarët policor. Sipas zyrtarëve policor, me gjitha anët pozitive të këtij lloj trajnimi, është evidente edhe shmangia nga vijimi në trajnim pasi që ka raste kur kjo fazë shfrytëzohet me marrje pushimesh, qoftë vjetore apo pushime tjera. Ka edhe shqetësime që ky trajnim ka sjellë vetëm huti dhe çrregullim të mirëvajtjes së punëve të përditshme policore.

## Rekomandimi nr. 2

Inspektorati Policor inkurajon menaxhmentin policor të gjejë një zgjidhje, në mënyrë që trajnimin rotativ t'i nënshtrohen zyrtarët policor në mënyrë efektive.

2.2.7 Inspektimi ka vënë në pah menaxhimin jo të duhur të orareve të patrullimeve nga ana e togjeve patrulluese. Togjet patrulluese para se të bëjnë pranimin e detyrave ditore, paraqiten në drejtoritë rajonale të policisë kufitare dhe njëjtë veprojnë edhe me rastin e dorëzimit të detyrës në fund të orarit. Periudha kohore nga përfundimi i orarit, dorëzimi i detyrës, pranimi i detyrës e deri tek paraqitja në terren, shkakton në disa vende vonesë disa orëshe. Kjo paraqet shqetësim mbi pamundësinë e mbulimit sistematik të zonës së përgjegjësisë nga togjet patrulluese, e që si rrjedhojë mund të ketë mundësinë e kalimeve ilegale dhe kontrabandimit të mallrave. Problematikë tjetër është paraqitur edhe pamundësia e mbulimit të zonës së përgjegjësisë me numrin aktual të policëve të togjeve patrulluese. Vështirësitë në mbulimin e terrenit dhe kryerjen e detyrave të përcaktuara thellohen edhe më tej kur shtohet fakti i mungesës së personelit në detyrë, qoftë për shkak të pushimeve mjekësore (dukuri në rritje), apo për shkak të angazhimeve në trajnime të ndryshme. Gjatë një vizite të bërë vendkalimeve kufitare dhe togjeve patrulluese në orët e vona është hasur në një tog patrullues që në detyrë kishte vetëm tetë (8) pjesëtarë. Në këto situata Inspektorati Policor është skeptik në efikasitetin e njësiteve patrulluese. IPK-ja është e brengosur edhe për sigurinë e vetë policëve, kur dihet fakti se ky numër i vogël i policëve në patrulla është hasur në vijën kufitare me Serbinë. Është detyrë e menaxherëve të lartë të policisë kufitare të hartojnë politika të cilat do të jenë më të përshtatshme dhe më efikase në përpilimin e orareve dhe shpërndarjen e personelit, që për asnjë moment vija kufitare të mos mbetet e pambuluar për të pamundësuar në masë të madhe aktivitetet kriminale. Është e nevojshme të ndryshohet gjendja edhe pse IPK-ja ka parasysh mundësitë e kufizuara të burimeve njerëzore dhe logjistike. Duhet të bëhet plotësimi i strukturës në kuadër të regjioneve, e sidomos duhet shtuar numri i policëve patrullues në kuadër të togjeve.

<sup>7</sup> (DA/DPK-003/08), të datës 20.05.2008,

### Rekomandimi nr. 3

IPK-ja rekomandon menaxhmentin që në drejtim të ngritjes së efikasitetit të punës së togjeve patrulluese dhe një mbikëqyrjeje / kontrolli sistematik të vijës së gjelbër, të shqyrtoj mundësinë e vendosjes së togjeve patrulluese në kuadër të Pikave të PKK-ve

## 2.3 Infrastruktura dhe pajisjet

2.3.1 Hapësirat për punë dhe pajisjet janë të nevojshme për punë në kufi dhe për këtë arsye duhet arritur disa standarde minimale në harmoni me standardet evropiane. Në të shumtën e rasteve policia kufitare dhe doganore janë të vendosura në PKK. Udhëzuesi i MIK-ut potencon nevojën e përshtatjes së infrastrukturës në atë mënyrë që të lejoj kontroll të integruar brenda të njëjtës godinë, me qëllim që të mënjanohet dublimi i kontrolleve dhe kontrollet e dyfishta nga agjencitë e ndryshme.

2.3.2 Infrastruktura në të cilën është e vendosur policia kufitare në përgjithësi është në gjendje jo të kënaqshme. Objektet në vendkalimet kufitare në të shumtën e rasteve janë baraka (kontejnerë), ku kushtet për punë nuk janë të mira me hapësira të vogla. Nga 13 PKK-të zyrtare, shtatë (7) prej tyre janë të vendosura në "kontejnerë"; PKK-të 1, 4 dhe 31 në Regjionin Kufitar "Veriu", PKK-të 5, 6 dhe Gllloboçicë në Regjionin Kufitar "Lindja" dhe PKK "Kulla" në Regjionin Kufitar "Perëndimi".

2.3.3 Bazuar në "Ligjin mbi Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror", zyrtarët e autorizuar munden përkohësisht të ndalojnë dhe arrestojnë personat në rast se synojnë të kalojnë ose kanë kaluar vijën kufitare dhe ka dyshim të bazuar se kanë kaluar ilegalisht kufirin shtetëror si dhe janë persona të huaj që nuk përmbushin kushtet për hyrje ose për qëndrim në Republikën e Kosovës, por që për shkaqe të arsyeshme nuk mund të largohen menjëherë nga Republika e Kosovës<sup>8</sup>. Kryerja e aktiviteteve policore të lartcekura ngrit nevojën e ekzistimit të dhomave të ndalimit. Stacionet e policisë kufitare në të shumtën e rasteve nuk kanë dhoma të ndalimit. Sipas zyrtarëve policor pasi të jenë plotësuar procedurat për arrestim, personat e arrestuar dërgohen në dhomat e ndalimit të stacioneve policore më të afërta. Kjo mënyrë e punës me të ndaluarit, policisë kufitare i kushton me humbje kohe dhe resurse. Policia Kufitare nuk ka objekte të kënaqshme ndaluese dhe kjo shpesh ia pamundëson asaj përputhjen me standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut, kur ata i arrestojnë njerëzit. Ekzistojnë vetëm disa objekte në stacionet e policisë kufitare dhe asnjëra nga to nuk i përmbushë standardet minimale.

### Rekomandimi nr. 4

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që të angazhohet në sigurimin e dhomave të ndalimit në Pikat e Kalimeve Kufitare (PKK), duke u dhënë prioritet vendkalimeve me frekuentim më të madh udhëtarësh dhe pikave me kalime më të shpeshta ilegale dhe kontrabandimi ilegal.

2.3.4 Niveli i pajisjeve personale që iu është ofruar policisë kufitare duket të jetë i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm. Gjithashtu, Policia Kufitare gjatë vitit 2008 është

<sup>8</sup> Neni 26, pika 26.1

pajisur me numër të konsiderueshëm të armëve të gjata të tipit AK-47, duke ngritur në 224 copë numrin e tyre.

2.3.5 Policia Kufitare këtë vit numëron gjithsej 131 automjete për ndryshim nga viti i kaluar kur numëronte 97 sosh. Sikur në vitin e kaluar, edhe këtë vit zyrtarët policor ankohen se nuk kanë automjete të mjaftueshme në kontekst të sasisë dhe llojit të nevojshëm. Një numër i konsideruar i automjeteve (rreth 30 %) janë jashtë përdorimit si pasojë e gjendjes së tyre për shkak të shkaktimit të aksidenteve / defekteve tjera teknike. Sipas zyrtarëve policor ka shumë rajone të brezit kufitar ku nuk mund të kalohet me automjetet me të cilat shërbehet policia kufitare. Autoparku përbën kryesisht tipin e automjeteve Kia, Toyota dhe Wolksvagen. Këtë vit policia kufitare është pajisur me një numër të kombi-busëve që kryesisht përdorën për transportin e personelit.

#### **Rekomandimi nr. 5**

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor të shqyrtojë mundësinë e pajisjes me lloje të automjeteve, duke pasur parasysh specifikat e terrenit (konfiguracionit) në të cilin kalon vija kufitare.

## **2.4 Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit**

2.4.1 Objektiv kryesor në lidhje me komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit është rregullimi dhe standardizimi i një rrjedhe të shpejtë dhe efikase të informacionit dhe i procedurave të dokumentimit. Është me rëndësi forcimi i teknologjisë informative (TI-së) dhe rrjetit të komunikimit ndërmjet kufirit, brendësisë së territorit dhe zyrave rajonale. Intraneti i Policisë Kufitare duhet të jetë i disponueshëm në nivel vendor, që të siguroj komunikimin dhe shpërndarjen e shpejtë të informacionit ndërmjet PKK-ve dhe nivelit qendror. Sipas Udhëzuesit të MIK-ut, është nevojë e menjëhershme që vendet e Ballkanit Perëndimor të përqendrohen në zhvillimin e sistemeve të integruara të informacionit për policinë apo rojat e tyre kufitare. Disponueshmëria e sistemit modern të TI-së do të sigurojë shkëmbim informacioni dhe komunikim të automatizuar brenda një sistemi të unifikuar, një sistemi efikas që në kohë të duhur të bëhet mbledhja dhe përpunimi, si dhe shpërndarja e informacionit mbi të gjitha veprimtaritë kufitare. Gjithashtu, kjo do të mundësonte menaxhim më të mirë të rrjedhës së të dhënave, si dhe do të përfshinte mundësinë e krijimit të përmbledhjeve statistikore.

2.4.2 Komunikimi në aspektin teknik në kuadër të "Veriut" është i vështirësuar duke përfshirë mungesën e radiolidhjeve, mirëmbajtjen e tyre, mosfunksionimin e tyre për shkak të konfiguracionit të terrenit dhe mungesës së antenave. Këto bëjnë që në pjesën më të madhe të zonës së gjelbër mos të ketë komunikim me bazën. Inspektorati Policor vërejtë se edhe këtë vit, sikurse në vitin e kaluar, sistemi i komunikimit të policisë kufitare dhe sistemi i menaxhimit të të dhënave nuk është përmirësuar. Policia Kufitare e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, PKK "Hani i Elezit" dhe PKK "Vërmica" janë të pajisura me sistemin e integruar për menaxhimin e të dhënave 'PISCES' (donacion i qeverisë amerikane). Kur funksionon si duhet, ky sistem ofron mundësi për të mbledhur, sistemuar dhe transferuar të dhënat nga dhe në secilin vendkalim zyrtar të kufirit dhe në Qendrën Komanduese në Shtabin e PK-së. Kjo ndihmon PK-në shumë në funksionet e saj për kontrollimin e lëvizjeve të personave e automjeteve dhe gjithashtu në luftimin e formave të ndryshme të krimeve përtej kufirit. Fatkeqësisht i tërë potenciali që ky sistem ka nuk është realizuar



plotësisht. Sipas menaxherëve të policisë kufitare, sistemi nuk funksionon në një masë të madhe për shkak të një numri të defekteve në sistemin e TI-së dhe lidhjeve të papërshtatshme. Derisa tri vendkalimet kufitare të lartcekura janë të pajisura me këtë sistem, vendkalimet tjera kufitare ende shërbehen me sistemin "KPIS", sistem ky që nuk ofron mundësinë e shpërndarjes së informatës me qendrën dhe pikat tjera kufitare.

2.4.3 Kohë më parë është publikuar "Raporti i progresit në Kosovë" i Komisionit të Komuniteteve Evropiane<sup>9</sup> (më 05.11.2008), ku në pjesën që i kushtohet policisë kufitare, potencohet shqetësimi mbi mungesën e një sistemi të duhur të komunikimit mbi mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave për hyrje-daljet, mungesa e qasjes në të dhënat për krimet e personave që dëshirojnë të hyjnë ose dalin nga Kosova, si dhe mosfunksionimi i sistemit të integruar me të cilin janë të pajisura tri vendkalimet kryesore kufitare.

#### **Rekomandimi nr. 6**

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që të vejë në funksion një sistem të unifikuar të komunikimit dhe shkëmbimit të informacioneve (të dhënave).

### **3. POLITIKAT DHE STRATEGJIA**

3.1 Në nëntor të vitit 2007, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Strategjinë për menaxhimin e Integruar të Kufirit, kurse në maj të këtij viti është aprovuar Ligji për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror. Ministria e Punëve të Brendshme ka publikuar planin e saj strategjik për periudhën kohore 2007 - 2010. Një numër karakteristikash të planit strategjik janë të lidhura drejtpërsëdrejti me Policinë Kufitare, ku veçanërisht potencohet synimi strategjik 5, që ka të bëjë me menaxhimin e integruar të kufijve dhe bashkëpunimin me policinë kufitare.

3.2 Që nga themelimi, Shtylla e Policisë Kufitare inspektohet nga Inspektorati i Policisë së Kosovës për herë të dytë. Inspektimi i parë i kësaj fushe është ndërmarrë në gusht të vitit të kaluar ku Inspektoratit Policor nuk iu kishte prezantuar ndonjë strategji e shkruar për policinë e kufirit nga menaxhmenti, pasi që një strategji e tillë nuk ekzistonte. Tani kjo situatë ka ndryshuar pozitivisht ngase janë hartuar dokumente me rëndësi, përfshirë këtu Planin Strategjik të SHPK-së (2008 - 2010 dhe Strategjinë e Policisë Kufitare (2008 - 2011). Në dokumentin strategjik të Policisë Kufitare 2008-2011, në mënyrë konkrete janë vënë objektivat dhe prioritetet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të Policisë Kufitare për pikat në vijim: legjislacioni, edukimi dhe trajnimi, pajisjet dhe infrastruktura, bashkëpunimi kombëtar, bashkëpunimi ndër-kufitar dhe ndërkombëtar. Inkurajohet puna e Shtyllës së Policisë Kufitare në drejtim të përgatitjes së prioritetëve strategjike, meqë karakteristika të shumta të saj kanë bazë në "Udhëzuesin e MIK-ut" dhe "Ligjin mbi Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollit të Kufirit Shtetëror".

<sup>9</sup> Komisioni i Komuniteteve Evropiane: „ Raporti i progresit në Kosovë” (Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2008-2009), SEC (2008) 2697



## 4. PERFORMANCA E POLICISË KUFITARE

4.1 Ligji për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror rregullon çështjet mbi kontrollimin e personave, mallrave dhe mjeteve të transportit<sup>10</sup>. Inspektorati Policor është përcaktuar që të shërbehet me të dhënat e marra në nivel qendror, pasi të dhënat e marra nga drejtoritë rajonale të policisë kufitare nuk përputhen me të dhënat e nivelit qendror. Dukuria e mospërputhjes së të dhënave është përsëritur që nga viti i kaluar. Me shqetësimin e inspektorëve pajtohen edhe vet menaxherët duke theksuar se “një gjë e tillë vërtetë po ndodhë”.

### Rekomandimi nr. 7

Inspektorati Policor i rekomandon menaxhmentit policor që t'i kushtoj rëndësi të veçantë mbledhjes dhe sistematizimit të të dhënave, në mënyrë që ato të jenë të sakta dhe të besueshme.

4.2 Tabelat 2 dhe 3 paraqesin të dhënat e marra nga niveli qendror në lidhje me frekuentimin e automjeteve dhe personave në vendkalimet zyrtare kufitare të Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2006, në vendkalimet zyrtare kufitare janë kontrolluar gjithsej 9.647.124 persona dhe 3.044.272 automjete, kurse në vitin 2007 janë kontrolluar 8.743.313 persona dhe 2.588.338 automjete. Derisa në vitin 2006, frekuentimin më të madh të personave dhe automjeteve në hyrje-daljet e vendkalimeve kufitare të Republikës së Kosovës e kishte “Veriu” me 3.914.888 persona të kontrolluar (40.5%) dhe 1.423.011 (46.7%) automjete të kontrolluara, në vitin 2007 frekuentimin më të madh të personave dhe automjeteve në hyrje-daljet e vendkalimeve kufitare të Republikës së Kosovës e kishte “Lindja” me 3.438.391 persona të kontrolluar (39.3%) dhe 1.166.754 (45.1%) automjete të kontrolluara (shih tabelën 2 dhe 3)

Tabela 2 – Frekuentimi i personave dhe automjeteve (janar-dhjetor 2006)

DRPK	Persona të kontrolluar		Persona të refuzuar		Automjete të kontrolluara		Automjete të refuzuara	
	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje
Veriu	2038010	1876878	409	407	701887	721124	273	183
Lindja	1612769	1593868	282	491	574906	618044	596	214
Perëndimi	785866	779780	638	1466	216159	212152	213	220
Aeroporti	506216	453737	138	243	-	-	3	-
<b>Totali</b>	<b>4942861</b>	<b>4704263</b>	<b>1467</b>	<b>2607</b>	<b>1492952</b>	<b>1551320</b>	<b>1085</b>	<b>617</b>

Tabela 3 - Frekuentimi i personave / automjeteve (janar-dhjetor 2007)

DRPK	Persona të kontrolluar		Persona të refuzuar		Automjete të kontrolluara		Automjete të refuzuara	
	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje
Veriu	1205943	1082452	100	133	458076	411579	36	26
Lindja	1773113	1665278	125	117	587878	578876	927	321
Perëndimi	1006186	1016901	456	714	290015	261914	182	237
Aeroporti	491789	501651	372	377	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>4477031</b>	<b>4266282</b>	<b>1053</b>	<b>1341</b>	<b>1335969</b>	<b>1252369</b>	<b>1145</b>	<b>584</b>

<sup>10</sup> Neni 24.

4.3 Frekuentimi i personave dhe automjeteve në vendkalimet kufitare ndryshon varësisht nga sezoni. Gjatë sezonit veror, konkretisht gjatë muajve korrik dhe gusht, kur edhe fillon sezoni i pushimeve, në vendkalimet kufitare kemi frekuentim më të madh në krahasim me muajt tjerë të vitit. Muaji gusht i vitit të kaluar në vendkalimet kufitare ka qenë më i frekuentuari, me 1.299.838 persona apo 14.9% dhe 345.413 automjete apo 13.3%, të numrit të gjithëmbarshtëm të personave dhe automjeteve që kanë kaluar në vendkalimet kufitare. Në anën tjetër muaji shkurt i vitit të kaluar, ka qenë më se pak i frekuentuar me 456.740 persona apo 5.2% dhe 131.671 automjete apo 5.1%, të numrit të gjithëmbarshtëm të personave dhe automjeteve që kanë kaluar në vendkalimet kufitare. Ky ndryshim i madh i qarkullimit gjatë muajve të verës është një sfidë në vete në menaxhimin e burimeve njerëzore, sidomos kur dihet se në këtë periudhë kohore shumica e personelit policor preferon shfrytëzimin e pushimeve vjetore.

4.4 Tabela 4 duke pasqyruar numrin e personave që kanë hyrë dhe dalë në vendkalimet zyrtare kufitare, ofron analizë të produktivitetit të Policisë Kufitare. Duke pasur parasysh se me kontrollin e automjeteve dhe personave të cilët kalojnë në vendkalimet zyrtare kufitare ballafaqohet kryesisht personeli policor i vendosur në këto vendkalime (duke mos llogaritur policët patrullues), atëherë për analizë të produktivitetit të Policisë Kufitare jemi bazuar në këtë numër të paraqitur të personelit policor. Derisa gjatë vitit 2006, "Veriu" ka pasur frekuentimin më të madh (31.828 persona të kontrolluar ose 87 persona në ditë për një polic), në vitin 2007 edhe pse shifrat janë sjellë ndryshe dhe frekuentimin më të madh e ka pasur "Lindja" (me 19.317 persona të kontrolluar ose 53 persona në ditë për një polic), me numrin prej 47 policëve "Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës" është treguar me i efektshëm me një produktivitet më të lartë (21.137 persona të kontrolluar për një polic apo 58 persona në ditë për një polic). Në anën tjetër, në vitin 2006, "Perëndimi" ka pasur numrin më të ulët të kontrollimit të personave (11.861 persona të kontrolluar për një polic apo 32 persona të kontrolluar në ditë, derisa në vitin 2007 është 15.326 persona për një polic apo 42 persona në ditë për një polic.

Tabela 4 – Produktiviteti i Policisë Kufitare për periudhën 2006 / 2007				
Aktivitetet	Lindja	Perëndim	Veriu	Aeroporti
Personeli në PKK	178	132	123	47
Analiza e kryer për vitin 2006				
Persona të kontrolluar	3.206.637	1.565.646	3.914.888	959.953
Persona të kontrolluar për një polic	18.015	11.861	31.828	20.425
Persona të kontrolluar në ditë për polic	49	32	87	56
Analiza e kryer për vitin 2007				
Persona të kontrolluar	3.438.391	2.023.087	2.288.395	993.440
Persona të kontrolluar për një polic	19.317	15.326	18605	21.137
Persona të kontrolluar në ditë për polic	53	42	51	58

4.5 Tabela e prezantuar më poshtë tregon numrin e rasteve kriminale të regjistruara dhe incidentet jo-kriminale sipas muajve me të cilat është marrë policia kufitare. Shihet një rënie e rasteve kriminale dhe incidenteve jo-kriminale në krahasim me vitin 2006 për 7.1%, gjegjësisht 26.3%. Ekzaminimi më i hollësishëm i këtyre ndryshimeve ofron të dhëna të dobishme për marrjen e masave parandaluese nga ana e menaxhmentit të policisë kufitare. Rastet më të shumta me karakter kriminal janë: falsifikimi i dokumenteve me 516 raste (39%) për vitin 2006 dhe 493 raste (40%)

për vitin 2007, kalimi ilegal i kufirit me 249 raste (19%) për vitin 2006 dhe 187 raste (15.3%) për vitin 2007, kontrabandimi i mallrave me 119 raste (9%) për vitin 2006 dhe 206 raste (16.7%) për vitin 2007, raste tjera kriminale me 435 raste (33%) për vitin 2006 dhe 339 raste (28%) për vitin 2007. Nga incidentet më të shumta jo-kriminale janë refuzimet e hyrje-daljeve me 1.233 raste (62%) për vitin 2006 dhe 343 raste (24%) për vitin 2007, deportime me 372 raste (18.7%) për vitin 2006 dhe 660 raste (46%) për vitin 2007, incidente tjera jo-kriminale me 385 raste (19.3%) për vitin 2006 dhe 430 raste (30%) për vitin 2007.

Muaji	Raste kriminale				Incidente jo-kriminale			
	2006	%	2007	%	2006	%	2007	%
Janar	131	9.9	99	8.1	139	7.0	204	14.2
Shkurt	119	9.0	120	9.8	128	6.4	192	13.4
Mars	120	9.1	99	8.1	172	8.6	243	17.0
Prill	120	9.1	113	9.2	237	11.9	213	14.9
Maj	114	8.6	121	9.9	220	11.1	243	17.0
Qershor	92	7.0	117	9.6	185	9.3	197	13.7
Korrik	103	7.8	85	6.9	163	8.2	52	3.6
Gusht	103	7.8	107	8.7	165	8.3	26	1.8
Shtator	124	9.4	101	8.2	178	8.9	24	1.7
Tetor	88	6.7	93	7.6	127	6.4	14	1.0
Nëntor	109	8.3	90	7.3	122	6.1	13	0.9
Dhjetor	96	7.3	80	6.6	154	7.8	12	0.8
Gjithsej:	1.319	100.0	1.225	100.0	1.990	100.0	1.433	100.0

4.6 Informacionet nga terreni japin pasqyrë të papranueshme sa i përket kontrabandimit me kafshë, derivate dhe mallra tjera komerciale. Fatkeqësisht, dyshohet për përfshirje në vepra kontrabandimi të disa zyrtarëve policor. “Lindja” është e njohur për dukurinë e kontrabandimit me kafshë dhe mallra tjera, “Veriu” me kontrabandimin e derivateve dhe mallrave të ndryshme, kurse “Perëndimi” për prerjen ilegale të pyjeve. Kohë më parë, Inspektorati Policor ka kryer një inspektim të jashtëzakonshëm lidhur me “përfshirjen e mundshme të zyrtarëve policor në kontrabandimin e mallrave”, me theks të veçantë në Regjionin e Mitrovicës. Rezultatet e inspektimit japin pasqyrë negative mbi nivelin e kontrabandimit të mallrave në këtë pjesë të vendit.

4.7 Policia kufitare (rojat kufitare) duke luajtur rol thelbësor në procesin e migrimit, kontrollojnë kufijtë dhe përcaktojnë statusin e personave që kalojnë kufijtë, verifikojnë dhe kontrollojnë ligjshmërinë e hyrjes së njerëzve, etj. Nisur nga kjo, del se funksion i rëndësishëm i Policisë Kufitare është edhe kontrollimi i lëvizjes së të huajve dhe ballafaqimi me azil kërkuesit. Rregullorja e UNMIK-ut 2005/16 për “qarkullimin e lirë të personave brenda dhe jashtë Kosovës” është legjislacioni i parë në këtë fushë. Kompletimi i kësaj fushe me legjislacion të nevojshëm ka vazhduar në maj të këtij viti kur është miratuar Ligji për Azil kurse është në procedim e sipër Ligji për Migrim. Kompletimi i kësaj fushe me ligje të nevojshme do të lehtësoj punën e policisë kufitare. Tabela 6 ofron të dhëna krahasuese lidhur me numrin e refugjatëve dhe personave të deportuar në bazë të kushteve të ligjit të aplikueshëm. Derisa numri i personave të deportuar shënon një ngritje, në anën tjetër numri i refugjatëve është në rënie.

Tabela 6 – Të dhënat për të deportuarit dhe refugjatët në periudhën 2006/07		
Numri	Periudha krahasimore	
	2006	2007
Persona të deportuar	2.942	4.356
Refugjatë të kthyer	1.170	785

## 5. BASHKËPUNIMI


5.1 Vendorsja e sistemeve funksionale të MIK-ut përbën element me rëndësi për vendet candidate në përafrimin me standardet evropiane dhe praktikat e mira, gjë që do t'i orientonte vendet e Ballkanit Perëndimor drejt integritimit evropian. Është me rëndësi që kufijtë të jenë të hapur për tregti dhe lëvizje të njerëzve, por të mbyllura për veprimtaritë kriminale që rrezikojnë stabilitetin rajonal. Kufijtë duhet të jenë të hapur si brenda rajonit, ashtu edhe midis rajonit dhe BE-së. Kur thuhet se parimi i MIK-ut përmbledhet si bashkërendim dhe bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjitha autoriteteve përkatëse dhe agjencive të përfshira në sigurinë kufitare dhe lehtësimin e tregtisë, atëherë del se nevojitet bashkëpunimi në nivel brenda shërbimit (brenda një ministrie apo shërbimi), bashkëpunimi në nivel ndër-agjencie (bashkëpunimi në kufi në mes ministrive ose organizmave shtetëror me detyra të ndryshme lidhur me menaxhimin kufitar si operacionet dhe kontrollet e përbashkëta me doganat, shërbimin fito-sanitar, shërbimin veterinar) dhe bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar, i cili nënkupton bashkëpunimin në mes shteteve në fushat e përbashkëta (luftimi i krimit ndërkufitar, trafikimi me qenie njerëzore, terrorizmi, etj).

5.2 Marrëveshjet ndër-agjenci hartohen për të ndihmuar në qartësimin e legjislacionit dhe në mbështetje të marrëveshjeve të bashkëpunimit në përgjithësi në nivel vendor, ndërmjet autoriteteve të ndryshme të kufirit. Këto marrëveshje do të lehtësojnë një bashkërendim më të ngushtë ndër-veprimi ndërmjet shërbimeve, duke qartësuar çdo veprim që duhet ndërmarrë, sidomos ndarjen e përgjegjësisë kur bëhet fjalë për kontrabandimin e mallrave, armëve, etj. Kur flitet për bashkëpunimin brenda shërbimit dhe ndër-agjenci, vijnë në shprehje edhe patrullimet dhe operacionet e përbashkëta të shërbimeve. Gjatë vitit të kaluar Policia Kufitare ka kryer një numër të theksuar të patrullimeve / operacioneve të përbashkëta me Shërbimin Doganor, KFOR-in, Stacionet Policore, Njësinë K-9 dhe shërbime tjera (shih tabelën 7). Shihet qartë funksionalizimi i 1.394 operacioneve / patrullimeve të përbashkëta me shërbimet e përmendura, ku vërehet një bashkëpunim më i theksuar me forcat e KFOR-it (gjithsej 299 sosh).

Tabela 7 – Bashkëpunimi brenda shërbimit dhe ndër-agjenci (2007)						
Muaji	KFOR	Doganat	St. Policor	K-9	Të tjera	Gjithsej
Janar	21	12	9	3	-	45
Shkurt	19	5	7	13	-	44
Mars	24	13	9	11	-	57
Prill	25	-	2	12	-	39
Maj	28	11	10	18	-	67
Qershor	28	14	12	5	3	62
Korrik	12	-	-	-	77	89

Gusht	17	4	-	1	82	104
Shtator	27	-	-	1	94	122
Tetor	30	5	5	4	252	296
Nëntor	38	9	8	1	178	234
Dhjetor	30	11	1	1	192	235
<b>Gjithsej:</b>	<b>299</b>	<b>84</b>	<b>63</b>	<b>70</b>	<b>878</b>	<b>1394</b>

5.3 Policia Kufitare bashkëpunon me Shërbimin Doganor dhe agjencitë tjera të përfshira në menaxhimin e integruar kufitar. Departamenti i Policisë Kufitare ka nënshkruar një numër të marrëveshjeve të mirëkuptimit me Shërbimin Doganor, Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kurse në nivelin ndërkombëtar ekziston bashkëpunimi me shërbimet përkatëse të Shqipërisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Malit të Zi. Në mënyrë të veçantë, Policia Kufitare implementon Marrëveshjen e Mirëkuptimit të arritur nga UNMIK-u dhe Republika e Shqipërisë në shtator të vitit 2002. Kjo marrëveshje kërkon bashkëpunim në luftimin e krimit të organizuar, terrorizmit, trafikimit të narkotikëve, trafikimit të qenieve njerëzore dhe shpëlarjes së parave. Marrëveshje e njëjtë ekziston edhe në mes UNMIK-ut dhe Qeverisë së Malit të Zi. Bashkëpunimi i theksuar midis PKK-ve të Republikës së Kosovës dhe Serbisë nuk ekziston, mirëpo realizohen disa kontakte sipas nevojës në mes palëve, përmes Policisë së UNMIK-ut.





# MENAXHIMI I TRAFIKUT RRUGOR NGA POLICIA E KOSOVËS





### MENAXHIMI I TRAFIKUT RRUGOR NGA POLICIA E KOSOVËS

#### 1. HYRJE

1.1 Bazuar në Ligjin mbi Inspektoratin Policor të Kosovës, Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës ka autorizuar inspektimin e shtatë të zakonshëm, lidhur me menaxhimin e kryerjes së detyrave policore në trafikun rrugor. Inspektimi i zakonshëm, i funksionalizuar nga Departamenti i Inspektimit, është kryer nga data 29 tetor deri më 3 nëntor të vitit 2008. Është hera e tretë që kjo fushë kyçe është inspektuar dhe paraqet mundësinë për të kontrolluar nivelin në të cilin zyrtarët e lartë policor veprojnë në bazë të rekomandimeve të IPK-së.

1.2 Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike kërkon bashkërendim dhe angazhim të gjithë strukturave dhe shërbimeve të policisë. Ligji për Policinë cekë në detyrat e përgjithshme të Policisë “ofrimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit për sigurinë në komunikacion”<sup>1</sup>. Për kryerjen e kësaj detyre është organizuar dhe funksionon Policia e Trafikut Rrugor si shërbim i specializuar që ushtron atributet e tij në tërë territorin e vendit. Kryerja e detyrave në trafikun rrugor është synim i Policisë së Kosovës në drejtim të ruajtjes së një ambienti të sigurtë për të gjithë qytetarët. Legjislacioni në këtë fushë përcakton rregullat dhe normat bazë që duhet të zbatohen përdoruesit e rrugës, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë ata që qarkullojnë në rrugët e Republikës së Kosovës me ose pa mjete dhe ata persona apo subjekte që kanë të bëjnë me rrugët.

1.3 Qëllimi i inspektimit është të bëhen rekomandime për mënyrën se si menaxhmenti policor mund të përmirësojë kryerjen e detyrave policore lidhur me menaxhimin e trafikut rrugor në realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmërinë me standardet relevante të Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP);
- Pajtueshmërinë me synimet strategjike të Ministrisë së Punëve të Brendshme (Plani Strategjik 2007-2010);
- Të inkurajojë strategji më të mira policore proaktive dhe reaktive për të zvogëluar vdekjet dhe lëndimet në trafikun rrugor;
- Të ndihmojë në përdorimin e masave efektive që në mënyrë të suksesshme të zbulojë dhe parandalojë shpejtësinë dhe kundërvajtjet tjera në trafikun rrugor; dhe
- Të identifikojë dhe përhapë praktikatat më të mira.

<sup>1</sup> Neni 10 (Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë)

1.4 Gjatë rrjedhës së inspektimit, Inspektorati Policor përveç inspektimit të disa patrullave të rastit, intervistoi edhe:

- Drejtorin e Drejtoratit të Trafikut Rrugor;
- Shefin për Zhvillim dhe Planifikim Strategjik (Drejtoria e Trafikut);
- Drejtorin për Planifikim dhe Zhvillim (Departamenti i Rendit Publik);
- Drejtorin e Departamentit të Infrastrukturës Rrugore (Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit);
- Drejtorin e Departamentit për Automjete (Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit);
- Shefin e Administratës Mbështetëse (Drejtoria e Trafikut);
- Komandantët Regjional (Drejtorët Rajonal);
- Komandantët e Njësive Regjionale të Trafikut;
- Komandantë të stacioneve policore.

1.5 Zonat e inspektimit:

- Udhëheqja;
  - Organizimi struktural,
  - Burimet njerëzore,
  - Pajisjet,
  - Menaxhimi i informatave,
- Politikat dhe strategjia;
  - Iniciativat e reja,
  - Nevoja për zhvillimin e legjislacionit mbi trafikun në lidhje me policinë,
  - Procedura e hetimit të aksidenteve,
  - Zinxhiri komandues,
- Gjendja aktuale në trafikun rrugor;
  - Aksidentet në trafikun rrugor,
  - Faktorët e aksidenteve në trafikun rrugor,
- Performanca policore;
- Sfidat në sigurinë e rrugëve

1.6 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike, i cili parim është i mbështetur në nenin 19 të Kodit Evropian të Etikës Policore.

## 2. UDHËHEQJA

### 2.1 Organizimi struktural

2.1.1 Policia e Trafikut është pjesë e Policisë së Kosovës, përgjegjësia kryesore e së cilës është të zbatojë ligjet e komunikacionit dhe të reagojë ndaj aksidenteve të komunikacionit, brenda dhe jashtë zonave urbane. Njësitë e Trafikut Regjional bëjnë hetimet mbi aksidentet e komunikacionit ku ka lëndime të rënda ose vdekje, brenda zonave urbane / qytete dhe ndaj të gjitha aksidenteve jashtë zonave urbane. Sikurse në vitin 2007, nuk ka arritur të ketë një strukturë organizative funksionale. Detyrat e trafikut rrugor në Kosovë vazhdojnë të organizohen përmes Njësive të Trafikut Regjional (NJTR), që ndahen me autoritetet menaxhuese të ndara nga Drejtoria e Trafikut. NJTR-të operacionalisht shfrytëzohen dhe veprojnë brenda kompetencave të Drejtorive Rajonale Policore.

2.1.2 Në kuadër të Njësive të Trafikut Regjional operojnë: Njësitë e Hetimeve të Aksidenteve, Njësitë Patrulluese si dhe Njësitë e Motoristëve. Inspektorati Policor vërejt se disa njësi të trafikut u janë marrë Njësitë e Motoristëve nga ana e Drejtorisë së Trafikut, për arsye të përcjelljes së zyrtarëve të lartë të Kosovës. Aktualisht, këto njësi i posedon vetëm Regjioni i Pejës (3) dhe ai i Ferizajt (2). Meqë këto njësi luajnë rol shumë të madh në sigurinë rrugore, duhet sa më shpejt të shikohet mundësia e pajisjes për të gjitha regjionet me këto njësi, pasi që mund të jenë shumë më efikase dhe efektive në rregullimin e komunikacionit rrugor.

2.1.3 Në kuadër të Drejtorisë së Trafikut vepron Njësia për Përcjelljen e Mjeteve që bartin Materie të Rrezikshme, si e vetmja njësi që është e autorizuar të bëjë përcjelljen e mjeteve civile që bartin materie të rrezikshme. Në këtë njësi nuk është gjendja aq e kënaqshme, sepse ajo ballafaqohet me probleme të mëdha, sa i përket pajisjeve për mbrojtje nga materiet e rrezikshme. Ky njësit nuk posedon pajisjet elementare të domosdoshme për kryerjen e detyrave. Urgjentisht shprehet nevoja e furnizimit me pajisje të domosdoshme të kësaj njësie, kur dihet se vetëm gjatë periudhës janar-shtator 2008 kjo njësi ka bërë 198 përcjellje të materieve të rrezikshme “eksploziv”.

### 2.2 Burimet njerëzore

2.2.1 Nëse analizohet shpërndarja e personelit të NJTR-ve për vitet 2006-2008, del se personeli i përgjithshëm ka ndryshuar nga viti në vit. Numri i përgjithshëm i punonjësve në vitin 2007 është ngritur për 3 % në krahasim me vitin 2006, kurse këtë vit ka pësuar rënie për 8.9 % në krahasim me vitin 2007. Numri i punonjësve civil është gradualisht në rënie ngase në vitin 2007 është reduktuar për 4 punonjës derisa këtë vit është reduktuar edhe për 18 punonjës. Numri i personelit policor në vitin 2007 ka shënuar ngritje për 4.4 % në krahasim me vitin 2006, kurse këtë vit ka rënë për 6 % në krahasim me vitin 2007. NJTR në Mitrovicë ballafaqohet me mungesë të personelit për arsye të bojkotimit të punës nga zyrtarët policor të nacionalitetit serb dhe deri diku arrin t'i përmbushë detyrat policore në trafikun rrugor. Përqindja e femrave është shumë më e ulët se në njësitë tjera policore. Femrat në këto njësi kanë përfaqësim simbolik dhe meshkujt dominojnë më tepër në numër. IPK-ja vlerëson që menaxhmenti duhet të analizuar objektivisht në kuadër të personelit, arsyet që kanë shtyrë në një përfaqësim të tillë

gjinor, ngase këto njësi duhet të pasqyrojnë pjesëmarrje më të dukshme të tyre në strukturën gjinore.

Tabela 1 – Shpërndarja e personelit në NJTR (tetor 2008)			
NJTR	Zyrtarë policor	Staf civil	Totali
Prishtinë	107	8	115
Pejë	96	11	107
Prizren	79	7	86
Mitrovicë	59	8	67
Gjilan	67	8	75
Ferizaj	59	7	66
<b>Totali '2008</b>	<b>467</b>	<b>49</b>	<b>516</b>
'2007	495	67	562
'2006	474	71	545

2.2.2 Përveç trajnimeve bazike të kryera në Qendrën Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH), zyrtarëve policor që merren me aktivitete të trafikut u mungonin trajnimet e avancuara, sidomos në fushën e menaxhimit të aksidenteve, drejtimit të komunikacionit, njohurive për llojet e dokumentacionit të shteteve tjera, tabelave të huaja të regjistrimit (diplomatike e konsullore), etj, të cilat paraqesin vështirësi në kryerjen e punëve policore në trafikun rrugor. Përpilimi i raporteve të aksidenteve në komunikacion akoma paraqet një sfidë për zyrtarët policor edhe përkundër trajnimeve bazike mbi përpilimin e shkresave zyrtare. Nga inspektimi i zhvilluar vërehet se në shkresat zyrtare apo raportet e aksidenteve të përpiluara nga policët e trafikut vërehen të meta dhe një mbikëqyrje jo e mjaftueshme nga mbikëqyrësit. Si rezultat i këtyre të metave, nga Drejtoria e Trafikut është lëshuar një shkresë me 22.09.2008, që raportet e aksidenteve të reflektojnë profesionalizëm dhe kërkohet nga mbikëqyrësit që t'i mbikëqyrin raportet e policëve të trafikut. Kjo është shumë me rëndësi pasi që vendimet e gjykatave dhe kompanive të sigurimeve bazohen në shënimet zyrtare të policisë.

2.2.3 Pas fillimit të implementimit të ligjit të ri të komunikacionit, kanë ngecur përgatitjet dhe përsosjet e trajnimeve ekzistuese dhe të reja për policët e trafikut, të cilat janë të parapara edhe në Planin Vjetor 2008. Ne po i cekim vetëm disa prej tyre si: trajnimet në fushat e analizimit të statistikave, zhvillimit dhe implementimit të strategjive, shkathtësitë e shkrimit të raporteve, shikimi i vendit të ngjarjes së incidentit, përdorimi i automjeteve në rastet emergjente dhe të përcjelljes të VIP-ave dhe delegacioneve, ndalimi dhe kontrolli i automjeteve / personave, kontrolli i dokumenteve, kontrolli dhe përcjellja e automjeteve që bartin materie të rrezikshme sipas Konventës (ADR), puna në udhëkryqe dhe rregullimi i trafikut në udhëkryqe, njohja e Ligjit në fuqi për sigurinë e trafikut dhe ligjet tjera për trafik, puna në rastet e incidenteve në trafik, ku pjesëmarrës janë automjetet që bartin materie të rrezikshme, etj.

#### Rekomandimi nr. 1

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që Departamenti i Trajnimeve të shqyrtojë mundësinë e zhvillimit të trajnimeve të avancuara, për paraqitjen e një performance më të mirë të zyrtarëve policor që merren me aktivitetet e trafikut rrugor.

2.2.4 Si në vitet e kaluara, ende nuk ekziston sistem i identifikimit dhe shpërblimit të kryerjes së mirë të detyrave në trafikun rrugor. Vlerësimi i performancës policore nuk kishte ndryshime dhe procedurat e vlerësimit ishin të njëjta me vitet e kaluara.

## 2.3 Pajisjet

2.3.1 Aktualisht, imazhi i njësive të trafikut qëndron shumë më mirë sa i përket automjeteve dhe pajisjeve në krahasim me vitet e kaluara. Ato tani janë pajisur edhe me automjete të reja Golf 5, të cilat janë shpërndarë në numër të kënaqshëm në regjione, duke pasë parasysh specifikat e secilit regjion (numri i policëve, gjendja e sigurisë, numri i kilometrave të mbuluara). Momentalisht, policia e trafikut është e pajisur me 24 GPS<sup>2</sup>. Po ashtu edhe sa i përket alko-testeve është një përmirësim i dukshëm. Nga një donacion i kontingjentit të policisë turke, njësitë janë pajisur me 500 alko-teste.

2.3.2 Inspektorati Policor ka vërejtur se menaxhmenti policor ka organizuar një lloj trajnimit të veçantë për specifikat dhe ngasjen e automjeteve të reja me të cilat janë furnizuar<sup>3</sup>. Derisa në disa regjione kjo është kuptuar si diçka pozitive në përkushtimin policor për mbikëqyrje strikte të automjeteve, në anën tjetër Inspektorati Policor vlerëson se mund të vie në pah një “diskriminim” nga ana e menaxhmentit policor. Ky vlerësim bazohet në atë se do të kishte qenë përkushtim me vend nëse trajnimit të tillë do t’i ishte nënshtruar numër më i madh policësh apo policë që kanë aksidentuar më parë automjetet policore e jo siç po ndodhë, që trajnimit t’i nënshtrohet numër i kufizuar i policëve. Inspektorati Policor konsideron se në këto situata do të ishte më e drejtë që të përpilohen udhëzues të thjeshtë mbi mënyrën e përdorimit të automjeteve të reja.

2.3.3 Një kontroll i pajisjeve dhe burimeve materiale që ka në dispozicion NJTR-ja konfirmon shqetësimet e personelit. Kur automjetet e NJTR-ve u inspektuan nga Inspektorati Policor, u vërejt se në përgjithësi janë të pastra por jo edhe të pajisura. Përkundër deklarimeve të menaxherëve të lartë policor për furnizim me pajisje të mjaftueshme, gjatë kontrollimit kemi vërejtur mungesë pajisjesh në automjete policore, si: radar, alko-teste, mjete matëse, kone dhe shirita rrethues. Inspektorati po ashtu bëri një kontroll të pajisjeve që i kanë apo duhet t’i kenë me vete policët e trafikut dhe nga kontrolli u vërejt se u mungonin pajisjet, si: radiolidhje dhe pipa fishkëllues. Vërehet një shqetësim nga policët e trafikut për cilësinë e këtyre pajisjeve (mjeteve për matje, baterive të dorës, jelekëve reflektues, etj). Është vërejtur mungesë pajisjesh përcjellëse të automjeteve dhe dokumentacionit të automjeteve. Përkundër këtyre mungesave, ne gjatë inspektimit u njoftuam nga Drejtoria e Trafikut se NJTR-të janë të pajisura me pajisje të theksuara nga drejtoria. Këto mjete të rëndësishme të NJTR-së në masë të madhe nuk janë në dispozicion për policët dhe arsyeja nuk është plotësisht e qartë. Ndihet nevoja për të qartësuar mungesën e këtyre pajisjeve gjatë inspektimit.

2 GPS (Sistemi i Pozicionimit Global) është pajisje e cila bënë mbledhjen e të dhënave në vendndodhjen e aksidentit, përcakton koordinatat e aksidenteve.

3 Mendohet për automjetet e reja të furnizuara (Golf 5) për Njësitë e Trafikut Regjional.

## Rekomandimi nr. 2

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që brenda një kohe të shkurtë të bëjë kompletimin e automjeteve policore, me pajisje të domosdoshme.

2.3.4 IPK-ja vërejtë përmirësim në implementimin e rekomandimit<sup>4</sup>, mbi një standard më të mirë të performancës së NJTR-ve, mbi pajisjet për matjen e shpejtësisë dhe pajisjeve për zbulimin e alkoolit. Përdorimi i radarëve ka ndikuar dukshëm në uljen e aksidenteve. Në një të ardhme të afërt duhet shqyrtuar mundësinë e instalimit të kamerave për matjen e shpejtësisë në pikat e caktuara të rrugëve, që do të kishin ndikuar pozitivisht në uljen e shpejtësisë tek drejtuesit e automjeteve. Gjendja aktuale sa i përket sigurimit të pajisjeve në NJTR, mund të përshkruhet më e mirë. Gjendja është dukshëm më e mirë sa i përket alko-testeve dhe automjeteve, ndërsa e radarëve deri diku është e kënaqshme. Rreth 64 % e radarëve janë jashtë përdorimit, sidomos gjendja e radarëve nuk është e pranueshme në Regjionin e Mitrovicës, Ferizajt dhe Prishtinës. Problemet në lidhje me kalibrimin rutinor dhe mirëmbajtjen e matësve të shpejtësisë mbesin të pazgjidhura. Në tabelën 2 janë paraqitur pajisjet e njësive të trafikut duke mos përfshirë stacionet policore të cilat kanë një numër të caktuar të pajisjeve të nevojshme.

Tabela 2 - Pajisjet në dispozicion në Njësitë e Trafikut Regjional (tetor 2008)

Regjioni	Radar		Alko-test		Automjete	
	Në përdorim	Jashtë përdorimi	Në përdorim	Jashtë përdorimi	Në përdorim	Jashtë përdorimit
Prishtinë	4	16	25	4	16	3
Pejë	5	6	33	1	14	4
Mitrovicë	2	10	15	1	13	1
Gjilan	12	4	14	1	11	0
Ferizaj	4	12	15	3	11	1
Prizren	6	10	23	5	14	0
Gjithsej:	33	58	125	15	79	9

## Rekomandimi nr. 3

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor për një standard më të lartë të performancës së njësive të trafikut, sa i përket pajisjeve për matjen e shpejtësisë.

## 2.4 Menaxhimi i informatave

2.4.1 Inspektorati Policor vërejtë përmirësim edhe në implementimin e rekomandimit të Inspektoratit Policor, mbi nevojën e përmirësimit të sistemit të menaxhimit të informatave në lidhje me aksidentet në trafikun rrugor<sup>5</sup>. Formularët e rinj të përgatitur për mbledhjen e statistikave për aksidentet e trafikut, të cilët kohët

4 Raporti i inspektimit të zakonshëm nr. 6/2007: "Mënyra e kryerjes së detyrave të menaxhmentit të SHPK- së në trafikun rrugor", tetor 2007.

5 Raporti i inspektimit të zakonshëm nr. 6/2007: "Mënyra e kryerjes së detyrave të menaxhmentit të SHPK-së në trafikun rrugor", tetor 2007.

e fundit kanë filluar të përdoren, ofrojnë informata më të shumta mbi aksidentet, faktorët shkaktues, kundërvajtësit, gjendjet klimatike, kohët dhe ditët e aksidenteve, viktimat, etj.

2.4.2 Departamenti i Rendit Publik së bashku me Drejtorinë e Trafikut kanë mundësuar instalimin e bazës së re të të dhënave të aksidenteve të komunikacionit (Sistemi MAAP), në të gjitha komandat regjionale (gjegjësisht NJTR). I financuar nga Banka Botërore me iniciativën e MTPT-së, do të bëjë të mundur regjistrimin e numrit dhe vendit të çdo aksidenti, të shërbejë si instrument për analizat dhe masat që do të propozohen për përmirësimin e gjendjes. MAAP<sup>6</sup> është softuer i dizajnuar për të regjistruar të dhënat për aksidente dhe për të analizuar informatat për qëllime të sigurisë rrugore. Rrjedha e të dhënave sipas këtij sistemi kalon në disa faza si: ndodhja e aksidentit, pjesëmarrja e policies / raportimi i aksidentit, formulari i plotësuar, dorëzimi i formularit në njësitë rajonale, futja e të dhënave në kompjuter, dërgimi i të dhënave tek baza kombëtare. Për MAAP-in, nga Drejtoria e Trafikut janë përpiluar edhe „Procedurat Standarde të Operimit” që priten të aprovohen autoritetet policore. Sistemi MAAP ka hyrë në funksion si proces testimi për t’i vërejtur të metat e funksionimit të saj, nga 10.11.2007. Si pjesë e këtij sistemi, kanë ndryshuar edhe formularët e aksidenteve që tani ofrojnë të dhëna më të shumta lidhur me aksidentet dhe shkaktarët e tyre. Për funksionim të sistemit kërkohet një angazhim më i madh nga policia e trafikut në bazë për hedhjen e të dhënave të aksidenteve rrugore, me qëllim të funksionimit sa më të saktë të sistemit të kompjuterizuar të raportimit. Informatizimi i procesit të përpunimit dhe transmetimit të të dhënave me institucione të tjera, bënë të mundur njohjen me situatën e sigurisë rrugore dhe për analizën e shkaqeve të ndodhjes së aksidenteve.

#### **Rekomandimi nr. 4**

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin në përmirësimin e performancës policore lidhur për regjistrimin e të dhënave të aksidenteve rrugore, analizimit dhe të raportimit të aksidenteve rrugore, me qëllim të funksionimit sa më të saktë të sistemit të ri të Bazës së të Dhënave dhe paraqitjes së të dhënave më të besueshme.

### **3. POLITIKA DHE STRATEGJIA**

#### **3.1 Iniciativat e reja**

3.1.1 Në gusht të vitit 2007, MPB-ja ka publikuar planin e saj strategjik për periudhën kohore 2007-2010. Një numër karakteristikash të këtij plani drejtpërdrejt kanë të bëjnë me Drejtorinë e Trafikut të Policisë së Kosovës. Zhvillimi dhe implementimi i një strategjie gjithëpërfshirëse, për të zvogëluar numrin e vdekjeve dhe lëndimeve që rezultojnë nga aksidentet rrugore, është çështje e rëndësishme për Ministrinë dhe ky raport do të jetë burim primar i dëshmimeve në procesin e rishikimit nga ana e Ministrisë.

3.1.2 Siguria në rrugët e Kosovës paraqet sfida të madhe për Ministrinë e Punëve të

<sup>6</sup> Micro Computer Accident Analysis Package

Brendshme, Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe institucionet tjera. Ende nuk ekziston strategji kombëtare mbi sigurinë në komunikacionin rrugor. Andaj, nevojë e menjëhershme del që këta mekanizma duhet të përpilojnë një strategji të mirë mbi komunikacionin rrugor, që paraqet një aspekt të zgjidhjes së problemeve në trafikun rrugor.

3.1.3 Në vitin 2006, Drejtoria e Trafikut ka përpiluar Planin Strategjik për periudhën 2007-2009, në të cilën janë të paraparë objektivat për trafikun rrugor. Plani në lidhje me sigurinë në trafikun rrugor, duhet të bazohet në një përshkrim të qartë të gjendjes aktuale të çështjeve në Kosovë. Problemi që plani kërkon ta rregullojë apo zgjidhë, duhet të jetë i definuar në mënyrë të duhur. Për këtë arsye, procesi i sajimit të strategjisë për trafikun rrugor duhet të fillojë me të dhëna të sakta në lidhje me numrin, llojin, vendin dhe shkaqet e aksidenteve. Sidoqoftë, për të mundësuar një punë efikase në sigurinë rrugore, është me rëndësi edhe sistemi i raportimit të saktë të aksidenteve.

3.1.4 Inspektorati Policor ka qenë i impresionuar nga një numër i iniciativave të ndërmarra nga Drejtoria e Trafikut dhe regjionet gjatë vitit të fundit, në formë të planeve operative dhe projekteve. Këto iniciativa në lidhje me sigurinë në rrugë, përfshijnë kontrollin e transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave, mallrave të rrezikshme, mbipeshat, regjistrimin e shenjave rrugore që mungojnë apo që janë vjedhur, etj. Disa prej këtyre planeve, policia i ka realizuar në bashkëpunim edhe me MTPT-në ("Fëmijët në komunikacion", "Rritja e sigurisë në komunikacion" dhe "Fushata për informimin e opinionit publik" për implementimin e ligjit të ri të komunikacionit). Vërehet se ekzistojnë shumë pak informata dhe dëshmi dokumentuese në lidhje me atë se sa janë implementuar këto plane (përfshirë rezultatet dhe të arriturat).

3.1.5 Jo të gjithë të intervistuarit nga ana e Inspektoratit Policor e kanë pasur të qartë strategjinë dhe planin operativ të Drejtorisë së Trafikut. Sikur në vitin 2007, këto dokumente akoma nuk u transmetohen personelit vartës. Menaxhmenti i lartë i trafikut duhet bërë më shumë në komunikimin me personelin e tyre, në lidhje me prioritetet e planeve policore për trafikun rrugor. Inspektorati Policor nuk ka mundur të gjej dëshmi që menaxhmenti të ketë bërë përpjekje në komunikimin e strategjisë apo planeve tek personeli i trafikut dhe që tregojnë se sa është bërë implementimi i strategjisë dhe planeve për sigurinë rrugore nga ana e NJTR-së.

3.1.6 Inspektorati Policor ka vërejtur përparim në implementimin e rekomandimit të Inspektoratit Policor<sup>7</sup>, mbi përcaktimin e funksioneve dhe marrëdhënieve të qarta të Drejtorisë së Trafikut me komandantët regjional. Inspektorati Policor për dallim nga vitet e kaluara, ka siguruar një dokument<sup>8</sup> të nënshkruar nga Asistenti i Zëvendës Komisarit për Operativë, që tregon saktësisht marrëdhëniet e Drejtorisë së Trafikut në relacion me NJTR-të. Sipas tij, Drejtoria e Trafikut ka një mori autorizimesh në relacion me NJTR-të.

## **3.2 Nevoja për zhvillimin e legjislacionit mbi trafikun në lidhje me policinë**

3.2.1 Janë bërë hapa të rëndësishëm në aspektin e kompletimit me kuadër ligjor dhe akte të tjera nënligjore si dhe implementimin e tij, për përmirësimet e nevojshme

<sup>7</sup> Raporti i inspektimit, nr. 6/2007: „Mënyra e kryerjes së detyrave të menaxhmentit të SHPK-së në trafikun rrugor”, tetor 2007.

<sup>8</sup> Procedurat Standarde të Operimit, maj 2008



të sigurisë rrugore. Nga janari i vitit 2008 është në zbatim Ligji i ri mbi Sigurinë në Komunikacionin Rrugor (LSKR). Ligji kërkon, para së gjithash, që ky kuadër të njihet jo vetëm nga përdoruesit e rrugës, por dhe nga specialistët e punonjësit e institucioneve qendrore e vendore që mbulojnë problemet e sigurisë rrugore, si kusht i domosdoshëm për të arritur në zbatimin e detyrave që burojnë nga legjislacioni. Pas fillimit të implementimit të LSKR-së është formuar Grupi Punues në bashkëpunim me MPB-në, MTPT-në, PK-në dhe OSBE-në, në mënyrë që të zhvillohen fushata për informimin e opinionit publik dhe atë përmes broshurave, spoteve, reklamave dhe bill-bordeve.

3.2.2 Drejtoria e Trafikut ka organizuar fushatë nëpërmes mediave të shkruara dhe elektronike, si dhe takimeve në terren, me drejtues të automjeteve dhe këmbësorë, për implementimin e LSKR - së. Kjo është fushata e parë sensibilizuese që përqendrohet në një grup të caktuar njerëzish për sensibilizimin e drejtuesve të automjeteve dhe këmbësorëve në lidhje me LSKR - në, në mënyrë që të bëhen më të vetëdijshëm për rrezikun e lartë që bartin aksidentet dhe mosrespektimi i rregullave ligjore. Megjithatë, ka ende shumë punë për t'u bërë në ndërgjegjësimin e drejtuesve dhe këmbësorëve, në mënyrë që fushata të jetë sa më e efektshme.

3.2.3 Drejtoria e Trafikut ka hasur në shumë probleme për implementimin e LSKR-së, andaj ajo ka propozuar edhe ndryshimet dhe plotësimet e tij. Si të meta të këtij ligji, të cilat i ka identifikuar policia e trafikut, janë: mosharmonizimi i LSKR-së me Ligjin për Kundërvajtjet, i cili u pamundëson policëve në realizimin e dispozitave që kanë të bëjnë me shqiptimin e pikëve; mosharmonizimi me Ligjin mbi Financat Publike në çështjen e pagesave në vend të ngjarjes, mosharmonizimi i kompetencave me organet komunale dhe qendrore lidhur me mbikëqyrjen / kontrollin dhe rregullimin e komunikacionit sipas përgjegjësisë dhe kompetencave të tyre, mosharmonizimi i ndëshkimeve në raport me rrezikshmërinë e kundërvajtjes, etj. Mirëpo, nuk është kurrë vonë marrja e masave nga MTPT-ja dhe MPB-ja, për përmirësimin dhe vënien në zbatim të tij, sepse përmirësimet e legjislacionit kanë ndikim të pa kontestueshëm në përmirësimin e sigurisë rrugore.

3.2.4 Aktualisht, vërehen dy forma të keqpërdorimit të autorizimeve ligjore të përdorura më së shpeshti nga policia, p.sh, heqja e tabelave të regjistrimit nga automjetet të cilat janë të parkuara në mënyrë joligjore dhe konfiskimi i pasaportave / letërnjoftimeve / patentë shoferëve / dokumenteve të regjistrimit, në mënyrë që të sigurohet pagesa e gjobave të shqiptuara për kundërvajtje. LSKR-ja ka përcaktuar në mënyrë të qartë veprimet të cilat duhet të ndërmerren sa i përket zhvendosjes së automjeteve, të cilat janë të ndaluara ose të parkuara në rrugë në mënyrë të gabuar. Drejtoria e Trafikut ka lëshuar një shkresë zyrtare për të gjithë komandantët regjional, ku kërkohet nga të gjitha regjionet implementimi i këtyre dispozitave, pasi që vërehet se në praktikë nuk po zbatohen ngase ka raste kur policët bëjnë heqjen e targave të automjeteve të ndaluara ose të parkuara në kundërshtim me rregullat e trafikut. Po ashtu, ligji ka paraparë pagesën e tiketave në vendin e ngjarjes dhe nuk parasheh marrjen e dokumentacionit, në mënyrë që të sigurohet pagesa e gjobës. Mirëpo, akoma marrja e dokumentacionit aplikohet nga policët e trafikut edhe pse nga zyrtarët e lartë potencohet se në rastet kur dihet qartë adresa e banimit të kundërvajtësit, nuk i merren dokumentet.

### Rekomandimi nr. 5

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor, që të mos praktikohet marrja e dokumentacionit të kundërvajtësit, në rastet e shqiptimit të gjobave në komunikacion

## 3.3 Procedura e hetimit të aksidenteve

3.3.1 Inspektorati Policor vërejt se politika e tanishme në lidhje me kategorizimin e aksidenteve dhe dëmeve duhet të rishikohet. Akoma është brengë e zyrtarëve policor të trafikut çështja e klasifikimit të aksidenteve me dëme materiale dhe fizike. Me aksidentet ku përfshihen vdekjet apo lëndimet e rënda, automjetet e policisë, dëmet e konsiderueshme, merret NJTR-ja. Me të gjitha aksidentet tjera, në pjesën më të madhe merren stacionet policore. Pyetja se “vetëm deri në çfarë mase të dëmit në aksidente merret NJTR-ja”, duket të jetë shkak i konfliktit në mes të NJTR-ve dhe kolegëve të tyre të cilët patrollojnë nga stacionet e tyre lokale. Në bazë të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), aksidentet ku përfshihet dëmi mbi 15,000,00 €, duhet t’i referohen prokurorit publik dhe kjo formon bazën për kriter të angazhimit të NJTR-ve. Natyrisht se një rregull i tillë është pothuajse i pamundur të aplikohet në praktikë. Policët nuk janë të kualifikuar që të vlerësojnë vlerën e dëmit në automjete. Nuk është e pranueshme që policët e NJTR-ve të trajnuar shumë mirë të qëndrojnë në një anë, në vend se të veprojnë në aksidentet rrugore me dëme nën 15,000,00 €, aksidente këto që shpesh bllokojnë rrugët kryesore duke shkaktuar vonesa në trafik.

### Rekomandimi nr. 6

Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon menaxhmentin policor që të rregullojnë çështjen e mënyrës së klasifikimit të aksidenteve me dëme materiale dhe fizike, në mes të stacioneve policore dhe NJTR-ve, pasi që zyrtarët policor nuk janë kompetent të përcaktojnë vlerën e dëmit material dhe dëmtimeve fizike.

## 3.4 Zinxhiri komandues

3.4.1 Ekziston një shkallë paqartësish lidhur me fushat e përgjegjësive dhe zinxhirin komandues. Me përpilimin e PSO-ve, sado pak janë rregulluar marrëdhëniet e Drejtorisë me NJTR-të. Ky perceptim është i mbështetur nga Drejtoria e Trafikut, por akoma struktura aktuale kërkon që Drejtoria të përdorë një zinxhir komandues të gjatë. Ky zinxhir i gjatë vepron në dy drejtime dhe ngadalëson sistemin e menaxhimit. Në qendër të këtij problemi qëndron mungesa e një strukture organizative adekuate, në definimin e funksioneve të drejtorisë, lidhjen e saj me NJTR-të dhe nivelin e autorizimit që ka të bëjë me funksionet e definuar të saj. Për dallim nga vitet e kaluara, veprimet e Drejtorisë nuk mund të injorohen shumë lehtë. Drejtoria e Trafikut dhe NJTR-të bashkërisht kanë takime të rregullta mujore por edhe më shpesh nëse paraqitet nevoja.

## 4. GJENDJA AKTUALE NË TRAFIKUN RRUGOR

### 4.1 Aksidentet në trafikun rrugor

4.1.1 Aksidentet automobilistike përveç dëmeve fizike, psikologjike dhe shpirtërore, bartin me vete edhe një kosto financiare për shoqërinë. Në Kosovë nuk ka raport të mirëfilltë për dëmet e mëdha ekonomike që shkaktojnë këto aksidente. Nëse do të kemi një pasqyrë të përafërt të këtyre shifrave, atëherë do të shihnim qartë se sa shpenzime shkaktojnë këto aksidente. Më shumë se 1 milion njerëz vdesin nëpër rrugë çdo vit në botë, 24 milion tjerë lëndohen. Në vitin 2005, më shumë se 41.000 njerëz vdiqën në aksidente rrugore brenda Bashkimit Evropian. Në vitin 2001, Komisioni Evropian përpiloi një plan veprues që përmbante masa të ndryshme në të gjitha nivelet për luftimin e aksidenteve në rrugë. Statistikat e fundit tregojnë se progresi drejt reduktimit të shkallës së vdekshmërisë në rreth 25.000 është mjaft ambicioz dhe i arritshëm.

4.1.2 Gjendja e sigurisë në komunikacionin rrugor dhe e aksidenteve, veçanërisht e personave të vdekur dhe të lënduar nga aksidentet në Kosovë, nuk është e pranueshme përkundër rënies në krahasim me vitin 2007<sup>9</sup>. Në nëntëmujorin e vitit 2007, janë regjistruar 12.601 aksidente komunikacioni. Shkalla e aksidenteve për vitin 2008, në raport me vitin 2007 është më e volitshme, si nga numri i aksidenteve ashtu edhe nga pasojat. Në periudhën e njëjtë të vitit 2008, janë regjistruar 11.568 aksidente, 8.1% më pak se në periudhën e njëjtë të vitit 2007. Sipas analizave të nëntëmujorit të vitit 2007, rezulton se në rrugët e Kosovës kanë ndodhur afërsisht 46 aksidente në ditë, përderisa kjo mesatare në vitin 2008 bie në 42. Numri i aksidenteve fatale, aksidenteve me lëndime dhe kategoria 'godit dhe ik' në nëntëmujorin e vitit 2008 ka shënuar rënie për 7%, 17% dhe 6%. Në vitin 2008 Regjioni i Pejës ka shënuar ngritje në numrin e aksidenteve fatale për 12.5%, ndërsa ai i Ferizajt për 10% (shih tabelën 3).

**Tab. 3 – Aksidentet në trafikun rrugor sipas regjioneve (janar-shtator 2007/08)**

Lloji	Aksidente me fatalitet		Aksidente me lëndime		Aksid. me dëme mater.		„Godit dhe ik”		Totali	
	'07	'08	'07	'08	'07	'08	'07	'08	'07	'08
Prishtinë	29	17	954	814	3.967	3.664	178	138	5.128	4.637
Pejë	16	18	492	501	1.483	1.419	23	10	2.014	1.948
Prizren	16	16	631	634	1.046	936	116	137	1.809	1.723
Mitrovicë	15	12	349	290	726	618	53	46	1.143	966
Gjilan	7	3	337	317	1002	861	76	82	1.422	1.263
Ferizaj	10	11	269	263	732	685	74	76	1.085	1.035
<b>Totali</b>	<b>93</b>	<b>77</b>	<b>3.032</b>	<b>2.819</b>	<b>8.956</b>	<b>8.183</b>	<b>520</b>	<b>489</b>	<b>12.601</b>	<b>11.568</b>

4.1.3 Në nëntëmujorin e vitit 2008, ka pasur rënie në numrin e personave të vdekur në aksidente fatale për 12.6%, po ashtu ka pasur edhe rënie në numrin e këmbësorëve të vdekur për 22%. Këtë vit, numri i personave të lënduar në aksidente ka rënë

<sup>9</sup> Të dhënat e paraqitura janë nxjerrë nga statistikat e ofruara nga Drejtoria e Trafikut të Policisë së Kosovës, duke shfrytëzuar kategoritë përkatëse.

për 4.83%, ndërsa këmbësor të lënduar për 6.9%. Numri i aksidenteve me pasojë „vdekjen”, duket kështu: Prishtina (21), Peja (20), Prizreni (18), Ferizaj (14), Mitrovica (13) dhe Gjilani (4), duke mos përfshirë këtu numrin e këmbësorëve të vdekur në aksidente. Regjioni i Prizrenit dhe i Ferizajt ka pasur një rritje në numrin e personave të vdekur në aksidente rrugore, ndërsa Regjioni i Pejës dhe ai i Ferizajt kanë pasur një rritje të numrit të personave të lënduar në aksidente rrugore (shih tabelën 4).

**Tab. 4 – Pasojat e aksidenteve në trafik sipas regjioneve (janar-shtator 2007/8)**

Regjioni	Viti	Kategoria		Gjith.	Kategoria		Gjith.
		Persona të vdekur	Këmbësor të vdekur		Persona të lënduar	Këmbës. të lënduar	
Prishtinë	2007	32	14	46	1.501	291	1.792
	2008	21	7	28	1.254	262	1.516
Pejë	'07	21	7	28	826	48	874
	'08	20	7	27	907	73	980
Prizren	'07	17	6	23	1.042	189	1.231
	'08	18	10	28	1.032	182	1.214
Mitrovicë	'07	15	7	22	566	115	681
	'08	13	6	19	506	118	624
Gjilan	'07	8	3	11	529	133	662
	'08	4	1	5	506	105	611
Ferizaj	'07	10	4	14	419	97	516
	'08	14	1	15	442	73	515
Gjithsej:	2007	103	41	144	4.883	873	5.756
	2008	90	32	122	4.647	813	5.460

4.1.4 Tabela 5 ofron një analizë të të dhënave të aksidenteve dhe pasojave në komunikacionin rrugor nga viti 2002 deri në 2008. Kjo periudhë fillimisht përcillet me një rritje të vazhdueshme të numrit të aksidenteve fatale deri në vitin 2007, kur fillon një rënie e numrit të aksidenteve fatale (shih tabelën 5).

**Tabela 5: Aksidentet sipas kategorive për periudhën 2002-2008**

Aksidenti / pasoja	Periudha						
	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008 <sup>10</sup>
Aksid. me fatalitet	107	107	141	145	156	127	77
Persona të vdekur	132	130	170	155	178	138	90
Këmbësorë të vdekur	32	14	41	49	65	54	32
Aksid. me lëndime	1.153	1.415	1.326	2.506	3.013	3.901	2.819
Persona të lënduar	1.983	2.012	2.053	4.206	4.789	6.264	4.647
Këmbësor të lënduar	292	117	444	833	1.069	1.162	813

4.1.5 Numri i aksidenteve, viktimave dhe shkeljeve të rregullave të trafikut rritet gjatë muajve të verës për arsye se ardhja e emigrantëve e dyfishon numrin e automjeteve në qarkullim. Rritja e theksuar e numrit të aksidenteve rrugore prekë veçanërisht qytetet e mëdha (sidomos kryeqytetin ku jeton thuhetse 1/3 e popullsisë së vendit). Pasqyra e aksidenteve sipas intervalit kohor pasqyron atë se aksidentet më shpesh ndodhin në intervalin kohor prej orës 14.00-18.00 dhe 10.00-14.00 (shih tabelën 6).

10 Të dhënat e paraqitura për vitin 2008 përfshijnë periudhën janar-shtator 2008

Tab. 6 - Aksidentet sipas intervalit kohor për periudhën janar-shtator 2007/08				
Intervali kohor	Krahasimi			
	2007	%	2008	%
22.00 - 02.00	950	7.5	860	7.4
02.00 - 06.00	318	2.5	288	2.4
06.00 - 10.00	1.630	13.0	1.582	13.6
10.00 - 14.00	3.313	26.2	3.122	27.0
14.00 - 18.00	3.683	29.2	3.446	29.7
18.00 - 22.00	2.709	21.4	2.270	19.6

4.1.6 Tabela 7 paraqet aksidentet sipas vendit të ngjarjes apo kategorisë rrugore për periudhën janar-shtator 2007/08. Numri më i madh i aksidenteve ndodhin në qytete, në rrugët magjistrale dhe fshatra. Edhe përkundër asaj se në rrugët e qytetit kemi numrin më të madh të aksidenteve, sipas të dhënave, vërehet se në Regjionin e Gjilanit dhe të Mitrovicës, numri më i madh i aksidenteve ndodhin në rrugët magjistrale. Kjo gjendje kërkon në rrugët e tilla angazhim më të madh të Njësive të Trafikut Regjional.

Tabela 7 - Aksidentet sipas kategorisë së rrugëve (janar - shtator 2007 / 08)				
Kategoria rrugore	Numri i aksidenteve		Numri i aksidenteve	
	2007	%	2008	%
Rrugë magjistrale	3.476	27.6	2.961	25.6
Rrugë regjionale	922	7.3	980	8.4
Qytet / urban	6.419	51.0	6.128	52.3
Fshat / rural	1.487	11.8	1.300	11.2
Rrugë tjera	299	2.3	199	1.7

4.1.7 Përkundër uljes së aksidenteve, për reduktimin e aksidenteve / pasojave të tyre, duhet ndërmarrë më shumë masa preventive, që do të përfshinin fushata sensibilizuese mbi pasojat e aksidenteve, rëndësinë e respektimit të rregullave të komunikacionit, etj. Mungesa e mbikalimeve, nënkalimeve dhe shenjave sinjalizuese të nevojshme kanë favorizuar shkaktimin e aksidenteve në rrugë. Në këto kushte, rol të rëndësishëm kanë policët e trafikut të cilët duhet të rrisin kontrollin në pikat e ndjeshme të akseve rrugore.

#### Rekomandimi nr. 7

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor të kërkoj nga NJTR-të dhe stacionet policore lokale që të rrisin prezencën në rrugët magjistrale dhe regjionale, të qytetit dhe fshatrave, në mënyrë që të zvogëlohet numri i aksidenteve rrugore.

4.1.8 Në bazë të analizave të Drejtorisë e Trafikut, është konstatuar se koha e arritjes në vendin e ngjarjes nga momenti i thirrjes në rastet e aksidenteve të komunikacionit sillet prej dy (2) deri në pesëdhjetë (50) minuta, varësisht nga lokacioni ku ka ndodhur aksidenti.

## 4.2 Faktorët (shkaktarët) e aksidenteve në trafikun rrugor

4.2.1 Shkaqet e aksidenteve që ndikojnë në sigurinë rrugore janë të ndryshëm. Nga analiza e aksidenteve në rrugë për periudhën janar-shtator të këtij viti, shkaqet kryesore të ndodhjes së aksidenteve, radhiten:

- **98%**, nga faktori njeri (drejtues) për shkelje të rregullave të qarkullimit nga drejtuesit e automjetit;
  - manipulimi i pasigurt me automjet (27%),
  - mosmbajtja e distancës (12.2%),
  - mospërshtatja e shpejtësisë (7.6%),
  - tejkalimi / anashkalimi i parregullt (6.36%),
  - mosrespektimi i përparësisë së kalimit (5.1%),
  - tejkalim i shpejtësisë (4.9%),
  - kycja e pasigurt në rrugë (4.7%),
  - radhitja e parregullt / ndërrimi i shiritit (4.5%),
  - dalja / hyrja nga parkingu (3%),
  - mosrespektimi i shenjave të komunikacionit (2%), etj.
- **1%** faktori klimatik (diell, shi, borë, mjegull, etj.);
- **0.22%** faktori njeri (këmbësor) për shkelje të rregullave të qarkullimit nga këmbësorët (alkooli, droga, mosrespektimi i shenjave të komunikacionit, mos kalimi në vendkalim për këmbësor, dalja papritmas në rrugë, etj);
- **0.19%** infrastruktura rrugore (mungesa e sinjalizimeve, rruga e dëmtuar, pengesa në rrugë, etj.);
- **0.08%** gjendja teknike e automjetit (sistemi i frenimit, drejtimit, pneumatikët, vjetërsia, etj);
- **0.51%** të tjera.

### Rekomandimi nr. 8

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që në bazë të analizës mbi identifikimin e shkaktarëve të aksidenteve, të përpilohen strategji dhe plane operative për parandalimin dhe zvogëlimin e aksidenteve.

4.2.2 Faktorë kritikë të cilët ndikojnë në sigurinë rrugore në Kosovë, në përgjithësi janë: legjislacioni i komunikacionit rrugor mjaft kompleks (mos harmonizimi me Ligjin për Kundërvajtjet dhe Financat Publike), rritja e vrullshme e numrit të automjeteve, aftësitë e dobëta të vozitjes, gjendja teknike e automjeteve, (kontrolli teknik jo i rreptë mbi automjetet), infrastruktura rrugore (kryqëzimet e parregulluara, mungesa e semaforëve dhe shenjave horizontale dhe vertikale) dhe mosmirëmbajtja e rrugëve.

## 5. PERFORMANCA POLICORE

5.1 Nga inspektimi i zhvilluar, është vërejtur se përkundër angazhimeve të udhëheqësve të NJTR-ve, ende mbetet shumë për t'u bërë në efikasitetin e tyre. IPK-ja konstaton se shpesh policët e trafikut nuk vërehen në akset rrugore apo pikat e ndjeshme të komunikacionit rrugor, në udhëkryqe ku bëhen ngarkesat më të mëdha dhe në vendet ku shpesh kemi bllokim të komunikacionit si pasojë e mosekzistimit të semaforëve apo mosfunksionimit të tyre për shkak të mungesës së rrymës.

5.2 Inspektorati Policor kohë më parë ka zhvilluar inspektimin e jashtëzakonshëm të patrullave policore gjatë ndërrimit të natës, në pesë (5) regjione policore. Nga ky inspektim është konstatuar se ka lëshime të mëdha në kryerjen e detyrave. Shumë pak është vërejtur prezenca e policëve në rrugët e Kosovës, ndërsa disa prej patrullave policore janë marrë edhe me aktivitete jo policore gjatë detyrës. Në tri (3) regjione janë hasur vetëm nga një (1) patrullë policore, si Prishtina, Prizreni, dhe Peja. Nga inspektimet e zhvilluara nga Drejtoria e Trafikut me datë 03.11.2008 dhe 04.11.2008 në Regjionin e Prishtinës, mbi zbatimin e shkresës zyrtare me numër të referencës SHPZHS 95/08, të lëshuar nga Shtylla e Operativës për mbulimin me njësi policore të pikave të caktuara, zyrtarët e lartë të Drejtorisë së Trafikut kanë konstatuar se pikat e caktuara në kohën e caktuar nuk kanë qenë të vendosura ashtu siç është kërkuar. Bazuar në të dhënat, nga mbikëqyrësit kërkohet një menaxhim më i mirë i patrullave policore, si të NJTR-ve, ashtu edhe të stacioneve policore, për arsye se kjo paraqet menaxhim jo të duhur të detyrave policore.

### Rekomandimi nr. 9

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor që policia të angazhohet më tepër në ndërmarrjen e masave proaktive (preventive) si: patrullime më të shpeshta në këmbë, patrullime me automjete dhe motoçikleta, në mënyrë që të parandalohen kundërvajtjet dhe veprat penale në komunikacion.

5.3 IPK-ja gjatë inspektimit vërejt se NJTR-të në masë të madhe janë të ngarkuara në punët që nuk i përkasin përgjegjësive të tyre dhe si pasojë e mungesës së personelit ato nuk arrijnë t'i kryejnë me efikasitet detyrat policore, t'u asistojnë stacioneve policore. Problem të veçantë paraqesin stacionet policore, pasi që zyrtarët e tyre policor nuk kanë të kryer trajnime të duhura për t'u marrë me aksidente të komunikacionit. Zyrtarët policor të stacioneve policore në rastet e aksidenteve të trafikut më tepër kujdesen për rolin e tyre primar si policë të rendit, ndërsa rolin e detyrave të trafikut e shohin si dytësor. Nga zyrtarët e lartë policor të trafikut potencohet se është e domosdoshme të krijohen njësite të veçanta të trafikut në kuadër të stacioneve apo të rritet numri i policëve në NJTR, që do të merren edhe me rastet e aksidenteve brenda qyteteve, sidomos në Prishtinë pasi që është e ngarkuar me numrin më të madh të automjeteve dhe përbënë përafërsisht 1/3 e popullsisë së Kosovës. Pothuajse hasëm në kërkesat identike të të gjithë menaxherëve të lartë policor për krijimin e njësite të veçanta të trafikut në kuadër të stacioneve, pasi policët e rendit nuk kanë njohuri të mjaftueshme për menaxhimin e aksidenteve dhe rregullimin e komunikacionit. Kjo kërkesë rrjedhë edhe prej numrit të madh të aksidenteve që ndodhin në qytete dhe fshatra, të cilat janë në kompetencë të stacioneve policore që nuk kanë kontroll dhe vëmendje të mjaftueshme për trafikun rrugor.

## Rekomandimi nr. 10

Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin policor të shqyrtoj mundësinë e formimit të njësive të trafikut në kuadër të stacioneve policore, në mënyrë që të rritet niveli i sigurisë në trafik dhe efikasiteti i menaxhimit të aksidenteve në qytete / fshatra.

5.4 Në tabelën 8 kemi paraqitur të dhëna për tiketat e lëshuara dhe anuluar nëpër regjione dhe stacione policore gjatë periudhës janar-shtator 2007/08. Ekziston një rënie prej 1.7% në numrin e tiketave të lëshuara në nëntëmujorin e vitit 2008, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2007. Gjatë nëntëmujorit të vitit 2007, janë shqiptuar gjithsej 193.785 tiketa, ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit 2008, janë shqiptuar 190.457 tiketa. Për periudhën e njëjtë 2007, janë anuluar 378 tiketa, ndërsa në 2008 janë anuluar 196 tiketa, që tregojnë se ka rënie të numrit të tiketave të anuluar prej 48%. Gjatë periudhës janar-shtator 2008, mesatarja e shqiptimit të gjobave për polic të NJTR-së duket kështu: NJTR-Prizren (1.7 tiketa në ditë), NJTR-Prishtinë (2.2), NJTR-Pejë (1.5), NJTR-Mitrovicë (1), NJTR-Gjilan (1.4), NJTR-Ferizaj (1.5). Sidoqoftë, kundërvajtja për tejkalim të shpejtësisë kërkon përdorimin e pajisjes së kalibruar për zbulimin e shpejtësisë dhe kjo duket të jetë faktori kryesor në rënien e numrit të përgjithshëm të tiketave të lëshuara.

Tabela 8: Kundërvajtjet në trafikun rrugor (janar-shtator 2007/8)

Regjioni / stacioni / njësia	2007		2008	
	Shqiptuar	Anuluar	Shqiptuar	Anuluar
<b>Prishtinë</b>	<b>59.657</b>	<b>116</b>	<b>59.001</b>	<b>85</b>
Trafiku Regjional	31.180	12	33.944	7
„Qendra”	4.855	50	4.599	27
„Veriu”	2.183	5	2.729	-
„Jugu”	3.829	26	4.199	26
Fushë Kosovë	1.270	5	1.182	-
Obiliq	1.081	-	707	-
Podujevë	4.878	5	3.893	5
Glllogvc	4.135	6	3.692	9
Lipjan	4.589	7	3.394	8
Graçanicë	1.657	N/A	662	3
<b>Mitrovicë</b>	<b>21.307</b>	<b>63</b>	<b>14.508</b>	<b>22</b>
Trafiku Regjional	9.787	18	7.719	8
„Jugu”	2.397	9	2.411	7
Vushtrri	3.643	12	1.991	4
Skënderaj	2.838	2	2.203	-
„Veriu”	779	15	79	2
Leposaviq	659	5	64	1
Zveçan	455	-	28	-
Zubin Potok	749	2	13	-
<b>Prizren</b>	<b>26.535</b>	<b>40</b>	<b>33.918</b>	<b>16</b>
Trafiku Regjional	15.598	-	19.096	4
„Alfa”	4.185	5	4.712	-
Suharekë	1.982	8	2.111	2
Rahovec	1.634	4	3.699	5



Malishevë	1.890	11	3.110	4
Dragash	963	12	1.023	1
NJMOR	283	-	167	-
<b>Ferizaj</b>	<b>27.347</b>	<b>30</b>	<b>22.946</b>	<b>20</b>
Trafiku Regjional	18.869	13	16.745	11
Ferizaj	3.895	6	3.377	5
Kaçanik	1.816	8	1.369	3
Shtime	2.505	1	1.222	1
Shtërpçë	262	2	233	-
<b>Gjilan</b>	<b>26.840</b>	<b>106</b>	<b>24.385</b>	<b>45</b>
Trafiku Regjional	17.414	31	17.588	21
Gjilan	5.018	16	4.044	6
Kamenicë	1.722	53	1.100	16
Viti	2.686	6	1.653	2
<b>Pejë</b>	<b>32.099</b>	<b>23</b>	<b>35.699</b>	<b>08</b>
Trafiku Regjional	22.010	11	25.398	5
Pejë	3.540	8	4.603	1
Gjakovë	859	-	1.270	1
Deçan	1.155	4	870	-
Klinë	2.510	-	2.396	-
Istog	1.847	-	882	-
NJMOR	178	-	280	1

5.5 Sipas të dhënave vërehet numër i madh i tiketave të anuluar në Regjionin e Gjilanit, përkatësisht në Stacionin Policor të Kamenicës dhe Trafikun Regjional, të cilët kanë anuluar numër të madh të tiketave. Vetëm për periudhën janar-shtator 2007, nga Stacioni Policor i Kamenicës janë anuluar gjithsej 53 tiketa. Po ashtu, duhet të përmendet edhe Regjioni i Prishtinës, përkatësisht Stacioni Policor „Qendra” dhe „Jugu”, të cilët kanë anuluar numër të madh të tiketave. Ndërsa, është për t’u përsëritur Regjioni i Pejës, Prizrenit dhe Ferizajt, të cilët kanë numrin më të vogël të tiketave të anuluar. Sipas doracakut operacional për trafik ekzistojnë tri opsione të anulimit të tiketës së trafikut: **e para**, kur tiketa bëhet e palexueshme për shkak të gabimeve në tiketë, **e dyta**, nëse për ndonjë arsye dhe me kërkesë drejtuar komandantit të stacionit policor kërkohet anulimi i tiketës apo të shpallet e pavlefshme dhe **e treta** pasi të jetë dorëzuar në gjykatë, kërkohet me shkrim që gjykata të anulojë tiketën, sepse vetëm ajo ka autoritetin të anulojë apo shpallë të pavlefshme tiketën.

#### Rekomandimi nr. 11

Inspektorati Policor përsëritë nevojën për rishikim të përgjithshëm të dobësive dhe përmirësimin e mundshëm në përdorimin e tiketave, pasi që vërehen të meta në lëshimin e tiketave që kanë si pasojë anulimin e tyre dhe nëse ka pasur shkelje të mundshme të iniciohen procedura disiplinore ndaj zyrtarëve policor të caktuar.

5.6 Gjatë vitit 2007 vetëm nga tiketat jo-mandatore<sup>10</sup> është inkasuar shuma prej 3,711,002.01 € për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, pa përfshirë tiketat që u janë drejtuar gjykatave. Me shumën më të madhe të mjeteve financiare të inkasuara nga

10 Tiketat jo-mandatore përfshijnë gjobën deri 40 € dhe mbahen në stacion policor për 15 ditë, ndërsa tiketat mandatore dërgohen për gjykatë.

tiketat prinë Prishtina me 898.036,50 €, Prizreni- 535,920,00 €, Ferizaj- 440,798,00 €, Gjilani- 369.087,00 €, Mitrovica 294,121,00 €, Peja- 256,059,00 €, Gjakova- 161,910,00 €.

## 6. SFIDAT NË SIGURINË E RRUGËVE

6.1 Problemet që lidhen me sigurinë rrugore janë shqetësim për të gjithë sektorët e shoqërisë. Para se të merret parasysh performanca e Drejtorisë së Trafikut dhe e NJTR-ve dhe stacioneve policore është me rëndësi të vendoset puna e tyre në një kontekst global për çështjen e sigurisë në rrugët e Kosovës. Në këtë mënyrë mund të shihet se policia është vetëm një pjesë e zgjidhjes së problemit të zvogëlimit të vdekjeve dhe lëndimeve në rrugë (shih tabelën).

Vendi	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Popullsia (000)	Numri		
			Aksidente	Vdekje	Lëndime
Shqipëria	28.748	3.120	801	315	820
Bullgaria	110.994	7.761	7.612	943	9.308
Kroacia	56.542	4.412	17.140	608	24.271
Greqia	131.957	11.062	15.547	1.670	20.179
Hungaria	93.030	10.098	20.957	1.296	28.054
Italia	301.318	58.462	224.553	5.625	316.630
Sllovenia	20.273	1.998	12.721	274	18.723
Maqedonia	25.713	2.032	1.988	155	2.927
Mbretëria e Bashkuar	242.900	59.834	207.410	3.221	277.619
Shtetet e Bashkuara	9.363.520	293.655	1.899.870	42.836	2.788.000
Austria	83.858	8.207	42.657	878	55.857
Finlanda	338.145	5.237	6.767	375	8.791
Gjermania	357.022	82.501	339.310	5.842	440.126
Irlanda	70.273	4.044	5.781	374	7.867
Luksemburgu	2.586	455	692	49	1.079
Federata Ruse	17.075.400	143.474	208.558	34.506	251.386
Zvicra	41.285	7.415	22.891	510	28.746
Suedia	449.964	9.011	18.029	480	26.582
<b>KOSOVA<sup>13</sup></b>	<b>10.878</b>	<b>2.100</b>	<b>141</b>	<b>170</b>	<b>2.053</b>

12 Economic Commission for Europe: "Statistics of Road Traffic Accidents in Europe and North America".

13 Statistikat e aksidenteve, vdekjeve dhe personave të lënduar janë të siguruar nga Drejtoria e Trafikut, KKP-Prishtinë. Në tabelë janë të përfshira statistikat vetëm për aksidentet fatale, personat e vdekur dhe të lënduar, ndërsa këmbësor të vdekur dhe të lënduar nuk janë të përfshirë. Numri i saktë i banorëve nuk dihet dhe ky numër është bazuar në numrin e përafërt të banorëve prej 2.1 milion banorë.

6.2 Sipas Ligjit të ri të Komunikacionit Rrugor i cili ka hyrë në zbatim në vitin 2008, Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe Policia e Kosovës janë autoritet për të mbikëqyrë administrimin e komunikacionit rrugor në rrugë publike, përveç rrugëve lokale. Kuvendet Komunale dhe Policia e Kosovës janë autoritet për të mbikëqyrë administrimin e komunikacionit rrugor në rrugët publike lokale në kuadër të kompetencave të tyre. Sipas këtij ligji, Qeveria duhet të themelojë Këshillin për Siguri në Komunikacionin Rrugor me propozimin e MTPT-së. Mirëpo, aktualisht akoma nuk është themeluar ky këshill i cili do të jepte kontribut të madh në çështjen e sigurisë rrugore.

6.3 Është vështirë të caktohet numri i saktë i automjeteve që përdorin rrugët në Kosovë. Numri i përgjithshëm i automjeteve për vitin 2007/08 llogaritet rreth 188.817 automjete. Këtij numri duhet t'i shtohet edhe numri i panjohur i automjeteve të përdorura nga KFOR-i, organizatat ndërkombëtare, vizitorët e përkohshëm, etj. Sipas të dhënave, numri i aksidenteve fatale gjatë periudhës janar-shtator 2008 ka qenë 77 aksidente fatale. Analiza tregon se mesatarja e aksidenteve fatale sillet rreth 4 aksidente fatale për 10.000 automjete. Po të krahasojmë numrin e përafërt të këtyre automjeteve me aksidentet fatale të vitit 2007, të cilat kanë numëruar 127 aksidente fatale, atëherë mesatarja e aksidenteve fatale për 10.000 automjete sillet rreth 6.7 aksidente fatale.

6.4 Që nga viti 2000, ndryshimet e mëdha të cilat kanë ndodhur në Kosovë kanë sjellë zhvillime të shpejta edhe në transportin rrugor, duke e rritur ndjeshëm numrin e automjeteve në rrugë. Rritja e përditshme e numrit të automjeteve që lëvizin në rrugët e vendit tonë, pa dyshim se rrisin edhe numrin e aksidenteve rrugore. Viteve të fundit roli i transportit rrugor është gjithnjë në rritje gjë që ka bërë që edhe investimet në infrastrukturën e transportit rrugor të jenë të konsiderueshme. Gjendja e trafikut dhe sinjalistikës rrugore në të gjithë rrjetin rrugor, nuk i përgjigjet plotësisht kërkesave të këtij zhvillimi. Ky zhvillim i shpejt i gjithanshëm ka nxjerrë në dukje nevojat për kompletimin e infrastrukturës rrugore, garantimin e sigurisë rrugore dhe veçanërisht mungesat në fushën e sinjalistikës. Për të përmirësuar gjendjen e vështirë të trafikut, sidomos në qytete të mëdha, duhet urgjentisht të kryhet edhe studimi i planeve urbane të trafikut.

6.5 Problemet në dendësinë e trafikut dhe infrastrukturën e dobët kanë të bëjnë me shenjat joadekuate në trafikun rrugor, mungesat e vijave në sipërfaqe të rrugës dhe shenjave vertikale dhe horizontale, sidomos brenda në qytete. Sipas Drejtorisë së Trafikut, këto probleme janë keqësuar nga dëmtimet e shenjave të trafikut dhe tendenca e rritur e vjedhjes së shenjave dhe pushtave në rrugë. Policia e Trafikut ka identifikuar të gjitha të metat në sinjalistikën vertikale dhe horizontale në rrugët e Kosovës dhe ka bërë informimin e MTPT-së, Drejtorinë e Rrugëve dhe drejtoritë përkatëse të komunave të Kosovës për vendosjen e shenjave të cilat mungojnë dhe rregullimin e shenjave të dëmtuara. Me gjithë vlerësimet pozitive për bashkëpunimin e ndërsjellë me këto institucione, akoma kërkohet vazhdimësi e një bashkëpunimi edhe më të thellë, në realizimin e objektivave të përbashkëta, për një siguri më të mirë në komunikacionin rrugor. Si rezultat i kësaj krijohet nevoja e zhvillimit të një strategjie që përmban synimet që kanë për qëllim të përmirësojnë sigurinë në trafikun rrugor, përfshirë nevojën për bashkëpunim të afërt në mes të Policisë, MPB-së, MTPT-së dhe autoriteteve komunale.

## Rekomandimi nr. 12

IPK-ja rekomandon menaxhmentin policor, që të gjitha strukturat e policisë së trafikut të rrisin bashkëpunimin me institucionet lokale dhe qendrore përmes krijimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke specifikuar qartë detyrat / përgjegjësitë e tyre.

6.6 Sipas disa të dhënave, në tërë Kosovën janë përafërsisht mbi 60 kompani private që bëjnë kontrollimin teknik të automjeteve. Sistemi aktual i kontrolleve teknike për verifikimin e gjendjes së automjetit është joefektiv dhe ka mungesë kredibiliteti, për shkak të mungesës së kontrollit. Me gjithë arritjet për kryerjen e kontrolleve teknike nga kompanitë private, mbetet akoma për të bërë për kryerjen e plotë dhe cilësore të kontrollit të automjeteve, si dhe në rritjen e përgjegjësisë së personelit përkatës në qendrat e kontrollit teknik, ku kërkohet të vërtetohet realisht gjendja teknike e çdo automjeti. Ndoshta në një të ardhme të afërt për të pasur një mbikëqyrje dhe kontrollë më të mirë, duhet shqyrtuar mundësinë e kalimit të kontrolleve teknike nga MTPT-ja në MPB.

6.7 Sipas zyrtarëve të lartë të MTPT-së, gjatë vitit 2007 në kontrollë teknike kanë kaluar rreth 202.361 automjete, ndërsa vetëm gjatë nëntëmuajorit 2008 në kontrollë teknike kanë kaluar rreth 154.992 automjete. Për të përmirësuar cilësinë dhe përgjegjësinë në kontrollet teknike po punohet për përgatitjen e një "sistemi on - line" për qendrat e kontrollit teknik si dhe për kompletimin me pajisjet e instalimit të rrjetit të kamerave, për dokumentimin e kryerjes së kontrollit teknik të automjeteve dhe për regjistrimin dhe arkivimin e të dhënave si dhe shkëmbimin e këtij informacioni me institucionet e tjera.

6.8 Inspektorati Policor është njoftuar për shembuj të mungesës së bashkëpunimit me MTPT-në, lidhur me kontrollet teknike të automjeteve, megjithëse ka pasur bashkëpunim të mirë në rastet e tjera. Pasi që statistikat tregojnë se një numër i konsiderueshëm i aksidenteve fatale shkaktohen si pasojë e gjendjes jo të rregullt teknike të automjeteve, nga Drejtoria e Trafikut është përpiluar Plani Operativ "Automjetet e rregullta-ngasja e sigurt", që ka qenë i paraparë të organizohet në bashkëpunim me MTPT-në, gjegjësisht, Departamentin e Automjeteve dhe Inspektoratit për kontrollimin e automjeteve, të cilat dyshohet se nuk janë në gjendje të rregullt teknike dhe të dërgohen në kontrollë të jashtëzakonshme teknike. Ky plan nuk ka hasur në mirëkuptim nga Kryeinspektori i Inspektoratit të MTPT-së. Pasi që nga MTPT-ja është kërkuar që ky plan të implementohet duke filluar prej orës 16.00 deri në ora 23.00 e në anën tjetër, plani nuk mundëson kontrollimin teknik të automjeteve dhe është anuluar nga Drejtoria e Trafikut.

6.9 Përkundër faktit se mungon asistimi i inspektorëve të MTPT-së për kryerjen e kontrolleve teknike të automjeteve, policia e trafikut nuk shmanget nga përgjegjësia pasi në kuadër të Ligjit të ri mbi Sigurinë në Komunikacionin Rrugor (më tutje LSKR), mund të realizojë edhe vet plane në lidhje me kontrollet teknike të automjeteve. Zyrtarët policor të trafikut paraqesin shqetësimin se në rast se automjetet e dërguara për kontrollim të jashtëzakonshëm teknik dalin në gjendje të rregullt, atëherë policia duhet të bëjë pagesën e kontrollit teknik e që në këtë rast shkakton hezitim të zyrtarëve policor për t'i dërguar automjetet në kontrollë teknike. Gjatë realizimit të Planit Operativ "Kontrolli i jashtëzakonshëm teknik i automjeteve" nga data 19.03.2007 deri 30.03.2007, të cilin e kanë implementuar të gjitha regjionet, në përjashtim të Regjionit të Pejës dhe atij të Mitrovicës, prej numrit të përgjithshëm të automjeteve

që janë dërguar në kontrollim të jashtëzakonshëm teknik, rezultatet kanë treguar se 79 % e automjeteve kanë qenë në gjendje jo të rregullt teknike.

6.10 Sipas zyrtarëve policor, aftësia e drejtuesve të automjeteve nuk është në nivelet që kërkohet. Kjo pjesërisht është si rezultat i kontrolleve jo të mjaftueshme të auto-shkollave, por dhe nga mënyrat e mësimit në auto-shkolla. Sipas zyrtarëve të MTPT-së, në auto - shkollat e Kosovës gjatë vitit 2007 rreth 102.377 aplikantë e kanë kaluar testin teorik, ndërsa atë praktik rreth 98.428 aplikantë, të cilët pajisen me patentë shofer. Monitorimi i cilësisë në auto-shkolla, monitorimi i organizimit të testimit për marrjen e patentë shoferit, do të konsiderohen si masa të domosdoshme për një punë të përgjegjshme, rigoroze dhe cilësore në pajisjen e qytetarëve me patentë shofer.

6.11 Nga inspektimi i bërë është konstatuar se faktori i edukimit dhe kulturës së përgjithshme mbi qarkullimin rrugor të të gjithë përdoruesve të rrugës tregon se është një nga shkaqet kryesore të aksidenteve dhe pasojave të tyre. Për edukimin në qarkullimin rrugor të drejtuesve të automjeteve dhe përdoruesve të rrugëve është bërë diçka nëpërmjet disa programeve të realizuara nëpër shkolla dhe pika të kalimeve për këmbësor në rrugë, nga ana e policisë dhe institucionet tjera relevante. Rol të rëndësishëm në edukatën rrugore luan edhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Është më se e qartë se do të kishim më pak aksidente në rast se përdoruesit e rrugës do të kishin një kulturë të përgjithshme mbi rregullat e qarkullimit rrugor, si p.sh. respektimi nga këmbësorët i normave të sjelljes në rrugë, ku mund të përmendim respektimin e vendkalimeve të rrugës apo të sinjalistikës rrugore, etj.

6.12 Për të nxitur njohuritë e të rinjve në fushën e sjelljes rrugore dhe të sigurisë së trafikut e të qarkullimit, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Transportit dhe Ministri i Arsimit në bashkëpunim me institucione tjera duhet të përpilojnë programe dhe projekte të posaçme për njohjen e parimeve të sigurisë rrugore si dhe të rrugëve, të sinjalizimit, të normave të përgjithshme për drejtimin e mjeteve dhe të rregullave të sjelljes së përdoruesve të rrugëve.





# HETIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR





### HETIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR

#### 1. HYRJE

1.1 Bazuar në Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës, Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës ka autorizuar inspektimin e tetë të zakonshëm, lidhur me menaxhimin e kryerjes së detyrave policore në hetimin e krimit të organizuar<sup>1</sup>. Ky inspektim i funksionalizuar nga Departamenti i Inspektimit është zhvilluar nga data 24 nëntor deri më 5 dhjetor të vitit 2008. Është hera e parë që kjo fushë është inspektuar dhe paraqet mundësinë për të kontrolluar nivelin në të cilin zyrtarët e lartë policor kryejnë detyrat e parapara.

1.2 Ndryshimet e mëdha të ndodhura pas viteve të 90'ta, kanë sjellë ndryshime të mëdha në situatën sociale dhe ekonomike të Kosovës, duke shtyrë që vendi sot të ballafaqohet me sfida të mëdha ekonomike dhe sociale. Kosova është një nga vendet ekonomikisht më të varfra të Evropës, me nivel të lartë të papunësisë. Këta tregues social-ekonomik, ilustrojnë kontradiktat zhvillimore të vendit të cilat kanë gjeneruar jo vetëm probleme ekonomiko-sociale por edhe probleme që lidhen me krimin e organizuar. Kur i shtojmë edhe faktorët tjerë si procesi i tranzicionit të shoqërisë kosovare, kompetencat e rezervuara në sferën e sigurisë, kufijtë e hapur, strukturat paralele në pjesë të caktuara të vendit, del se shumë elemente kanë hapur rrugë në zhvillimin dhe forcimin e krimit të organizuar. Krimi i organizuar ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik të vendit, duke shkaktuar pasiguri në investimet e huaja që në fund ka si rrjedhojë rënien e nivelit të jetesës, shtytjen në veprime kriminale, shkatërrim të ekonomisë, korrupsion, etj. Janë të njohura shumë forma të krimit të organizuar por më të njohura në praktikë janë: kontrabandimi me narkotikë, kontrabandimi dhe trafikimi i armëve, kontrabandimi dhe trafikimi i qenieve njerëzore<sup>2</sup>, krimet ekonomike/financiare dhe korrupsioni, kontrabandimi i mallrave, krimet kompjuterike, vjedhjet e organizuara të automjeteve, etj.

1.3 Krimi i organizuar meriton vëmendje të madhe për faktin se përbën një kërcënim të drejtpërdrejtë për shtetin, duke pasur për objektiv sistemin politik, ekonomik dhe shoqëror. Rreziku potencial që paraqet krimi i organizuar është se përdorë mjete të sofistikuara për zbulim dhe kundër-zbulim, bën përpjekje për t'u angazhuar në rrethet politike. Suksesi në luftën kundër krimit të organizuar kërkon shpejtimin e ritmeve në kuadrin ligjor, organizim dhe menaxhim të kësaj lufte, infrastrukturë dhe pajisje efektive, bashkëpunim ndërmjet shërbimeve që operojnë dhe bashkëpunim

1 Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, "krimin e organizuar" e përkufizon si krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar për të përfituar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore a financiare.

2 Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, "trafikimin e personave" e përkufizon si rekrutim, transferim, strehim ose pranim të personave, përmes kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të detyrimit, të abuzimit, të mashtrimit, të gënimit, ose abuzimit të pushtetit, ose pozitës së vështirë, ose përbërjen apo pranimit të pagesave apo përfitimeve të tjera për të marrë pëlqimin e personit që ka kontroll mbi një person tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.

ndërkombëtar. Parandalimi dhe dënimi i krimit të organizuar duhet të mbështetet gjerësisht në një njohje të thellë të këtyre fenomeneve, në vullnet politik të qartë dhe të vendosur, politikë kombëtare dhe strategji kundër krimit në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Pa një njohje të thellë të krimit të organizuar, policia do të mund të dështoj në parandalimin dhe luftimin e saj. Krimi i organizuar kërcënon shtetin, demokracinë, liritë dhe të drejtat e njeriut, ekonominë dhe shoqërinë në tërësi, kështu që përbën sfidë për qeveritë demokratike në gjithë botën. Edhe tek ne, lufta kundër krimit të organizuar mbetet një ndër prioritetet kryesore të qeverisë dhe policisë.

1.4 Pavarësisht eksperiencës së re, rezultatet e viteve të fundit kanë treguar sukses të policisë në luftimin e këtyre dukurive. Lufta kundër krimit të organizuar nuk duhet parë si përgjegjësi vetëm e policisë dhe nuk mund të realizohet vetëm nga ajo pa pasur një mbështetje edhe nga institucionet të tjera që kanë detyrime në këtë fushë. Suksesi i policisë në luftën kundër krimit të organizuar do të sjellë pa dyshim një përmirësim të imazhit të policisë në sytë e publikut, reputacion në ngritje të vetë organizatës policore, një partneritet më të mirë me të gjithë mekanizmat relevant, si dhe përmirësim të cilësisë të jetës së qytetarëve. Faktorë me rëndësi në këtë drejtim për të arritur rezultate në këtë mision është rritja e rolit të policisë duke i dhënë asaj përkrahjen financiare, logjistike dhe duke përcaktuar kritere të sakta dhe obliguese në përzgjedhjen e personelit, duke i krijuar asaj mundësinë që ajo të menaxhoj burimet financiare dhe burimet tjera.

1.5 Qëllimi i këtij raporti të dalë nga inspektimi i kësaj fushe të menaxhimit policor është që të jepen rekomandime se si menaxherët policor do të mund të përmirësonin paraqitjen policore në arritjen e qëllimeve, si:

- Pëlqimi me standardet relevante brenda Kodit Evropian të Etikës Policore
- Të inkurajohen strategjitë më të mira pro-aktive dhe reaktive në polici për luftimin e krimit të organizuar;
- Të ndihmoj furnizimin me masat më efektive që në mënyrë të suksesshme të hetohet dhe të zbulohet krimi i organizuar, dhe
- Të identifikoj dhe përhapë praktikrat më të mira.

1.6 Gjatë inspektimit u intervistuan këta zyrtarë policor:

- Asistenti i Zëvendës Komisarit për Shtyllën e Krimit;
- Kryesuesi i Departamentit të Hetimit të Krimit;
- Drejtori i Drejtorisë Kundër Krimit të Organizuar (DKKO);
- Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Analizës së Krimit (DAK);
- Shefat e sektorëve të:
  - Hetimeve të Krimit të Organizuar,
  - Shërbimeve Mbështetëse,
  - Trafikimit me Qenie Njerëzore,
  - Hetimeve Qendrore të Narkotikëve;
- Shefat e njësive në kuadër të sektorëve;

- Komandantët Regjional / Zëvendës Komandantët Regjional për Hetime;
- Mbikëqyrësit e Inteligjencës Regjionale;
- Shefat e Hetimeve të Specializuara Regjionale;
- Mbikëqyrësit e Skuadrave Regjionale të:
  - Hetimit të Narkotikëve,
  - Hetimit të Trafikimit të Qenieve Njerëzore;
- Hetues të krimit.

#### 1.7 Zonat e inspektimit:

- Udhëheqja;
- Strategjia dhe politikat;
- Performanca policore;
- Partneriteti.

1.8 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike, i mbështetur në nenin 19 të Kodit Evropian të Etikës Policore.

## 2. UDHËHEQJA

### 2.1 Organizimi i brendshëm struktural

2.1.1 Në vitin 2001 nga Policia Ndërkombëtare e UNMIK-ut është formuar KOCB (Kosovo Organised Crime Bureau) që në kuadër të saj kishte të angazhuar polic ndërkombëtar dhe si e tillë ka funksionuar deri në shtator të vitit 2003, kur edhe ka filluar rekrutimi i policëve vendor nga Policia e UNMIK-ut. Ndërsa, deri në vitin 2006 njësia si e tillë ka vepruar si DOC (Departament of Organised Crime) ku Policia e Kosovës (ish SHPK-ja) ka pasur kompetenca të rezervuara. Në vazhden e transferimit të kompetencave nga ndërkombëtarët tek vendorët, ky proces ka prekur edhe DOC-in e cila më pas është emëruar si Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar (DKKO) e cila si e tillë vepron edhe sot në kuadër të Departamentit të Krimit, e pa tranzicionuar tërësisht. Disa pozita dhe njësi në DKKO ende nuk janë tranzicionuar, si: Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i DKKO-së dhe Sektori Mbështetës (Njësia e Përgjimit Ligjor), ku policët ndërkombëtarë kanë fuqi ekzekutive.

2.1.2 Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar (DKKO) si njëra nga katër drejtoritë e Departamentit të Krimit, në kuadër të saj numëron katër (4) sektor:

- Sektori i Hetimeve të Krimit të Organizuar,
- Sektori për Shërbime Mbështetëse,
- Sektori Qendror i Hetimeve të Narkotikëve, dhe
- Sektori i Hetimeve të Trafikimit me Qenie Njerëzore.

2.1.3 Sektori i Hetimeve të Krimit të Organizuar, përbëhet prej tri (3) njësive të cilat konform Procedurave Standarde të Operimit<sup>3</sup> kryejnë aktivitetet e tyre:

- Njësia e Hetimeve Ndër-Kufitare, ka për qëllim të kryej hetimet dhe zbulimin e të gjitha rasteve të krimit të organizuar, brenda vendit dhe në bashkëpunim të duhur me policitë e shteteve tjera edhe krimin e organizuar që kalon kufijtë e Kosovës;
- Njësia e Inteligjencës dhe Analizës së Krimit, detyrat thelbësore të së cilës janë: regjistrimi në bazën e të dhënave të të gjitha informacioneve të pranuar në kuadër të DKKO-së, bashkëpunimi me njësitë tjera brenda policisë dhe jashtë saj, analizimi i informatave të ndryshme, verifikimi i të kaluarës së personave që konkurrojnë në pozita me përgjegjësi, etj. Kjo njësi u shërben të gjitha sektorëve tjerë, ndërsa është e vendosur në kuadër të Sektorit të Hetimeve. Ky strukturim paraqet shqetësim tek udhëheqësit e sektorëve tjerë, të cilët sugjerojnë që kjo njësi të jetë sektor i veçantë, që do t'u shërbente të gjithë sektorëve në kuadër të DKKO-së.
- Njësia e Hetimeve Financiare, ka për qëllim të bëjë hetimin e të gjitha rasteve të krimit ekonomik dhe financiar të organizuar, të gjitha rastet të cilat janë të strukturuar dhe kanë shtrirje të aktiviteteve kriminale brenda dhe jashtë territorit të Kosovës, si dhe të bëjë identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e përkohshëm të të gjitha pronave dhe pasurive të përfituara nga ato vepra penale si dhe veprat që kanë për qëllim përfitimin financiar.

2.1.4 Sektori për Shërbime Mbështetëse, përbëhet prej pesë (5) njësive:

- Njësia e Trajtimit me Informatorë, ka për qëllim mbajtjen dhe përpunimin e informatorëve në drejtim të luftimit të krimit, por procedurat aktuale që rregullojnë këtë veprimtari policore, nuk specifikojnë sa duhet çështjet për trajtimin e informatorëve.
- Njësia e Vëzhgimit si njësi mbështetëse e sektorëve dhe njësive tjera, aktivizohet në raste të aplikimit të masave të fshehta;
- Njësia e Forenzikës dhe Teknologjisë Informative, ka për detyrë të bëjë ekzaminimin e pajisjeve elektronike në laborator të cilat janë konfiskuar dhe t'i ofrojë asistencë teknike njësive në vend-ngjarje. Kjo njësi bënë edhe rregullimin e kompjuterëve të DKKO-së, e cila me numrin aktual të personelit paraqet vështirësi në mirëmbajtjen e rregullt të tyre;
- Ekipi i Përgjimit Ligjor, është përgjegjës për realizimin teknik të aktiviteteve të përgjimit ligjor të telekomunikimeve për njësitë hetuese të Kosovës;
- Ekipi për Mbështetje dhe Inteligjencë ndaj të Arratisurve (EMIPA), është përgjegjës për lokalizimin dhe arrestimin e kriminelëve të rrezikut të lartë që kanë kryer krime brenda dhe jashtë Kosovës;

<sup>3</sup> Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar "Procedurat Standarde të Operimit", aprovuar më 16 korrik 2007.

- Njësia për Mbështetje Teknike, ka për detyrë t'iu jap mbështetje të specializuar teknike të vëzhgimit, njësive tjera kërkuese hetimore, të trajnoj operativët e vëzhgimit në lidhje me mjetet teknike dhe përdorimin e tyre.

2.1.5 Sektori Qendror i Hetimeve të Narkotikëve (SQHN), kryen dhe koordinon aktivitetet në luftimin e drogës në tërë Kosovën. Më herët është njohur si Njësiti Anti-Drogë, kurse gjatë riorganizimit të Shtyllës së Krimin (në nëntor të vitit 2004) është vendosur nën autoritetin e Kryesuesit të Njesisë për Krim të Organizuar dhe është emëruar si Seksioni për Hetime të Narkotikëve (SHN). Më pas, është riemëruar si Sektori Qendror për Hetime të Narkotikëve (SQHN), si rezultat i tranzicionit në regjione duke filluar me 1 nëntor 2005, që ka funksionuar si unike në model centralist me Njësiti Rajonale të Narkotikëve (SRHN). Sipas PSO-ve, ky sektor duhet të veproj si qendër komanduese dhe e koordinimit me gjashtë (6) Skuadrat Regjionale për Hetimin e Narkotikëve (SRHN), të cilat duhet të jenë nën ombrellën e SQHN-së.

2.1.6 Sektori i Hetimeve të Trafikimit me Qenie Njerëzore (SHTQNJ), merret me hetimin e të gjitha rasteve të trafikimit me qenie njerëzore që janë të strukturuar si dhe grupeve kriminale të krimin të organizuar në dukurinë e trafikimit me njerëz dhe që kanë shtrirje të aktiviteteve kriminale brenda dhe jashtë territorit të Kosovës, si dhe të bëjë identifikimin e viktimave të trafikimit dhe shpëtimin e tyre me të gjithë partnerët e kësaj fushe. Ky sektor vepron në tërë Kosovën, i ndarë në regjione që sipas PSO-ve duhet të jenë në një komandë të vetme qendrore. Sektorët regjional merren me raste të vogla si prostitucion, mundësim në prostitucion, d.m.th. të nivelit të ulët dhe duhet të jenë në dispozicion të SQHTQNJ-së në rastet e operacioneve të përbashkëta.

2.1.7 Procedurat Standarde të Operimit nuk janë në përputhje me gjendjen aktuale sa i përket centralizimit të njësive të specializuara regjionale për hetimin e trafikimit me qenie njerëzore, pasi që ato janë nën mbikëqyrjen e komandave regjionale (drejtorive rajonale), të cilat kërkojnë të respektohet zinxhiri komandues.

#### Rekomandimi nr. 1

IPK-ja rekomandon që menaxhimi i njësive regjionale të specializuara (të hetimit të trafikimit me qenie njerëzore dhe të hetimit të narkotikëve), duhet të bëhet direkt nga niveli qendror, konform Procedurave Standarde të Operimit.

2.1.8 DKKO-ja në kuadër të Shtyllës së Krimin, vepron në bazë të një strukture të paqartë dhe konfuze. Pra, DKKO-ja nuk vepron mbi bazën e një strukture të qartë dhe unike. Sipas kësaj strukture ka shumë shkallë (nivele) të zinxhirit komandues, ku duhet të kalohet diku rreth gjashtë (6) apo shtate (7) nivele për të realizuar apo dërguar një shkresë nga stacionet policore deri në DKKO. Si rezultat i kësaj, kërkohet ndërtimi dhe funksionimi i brendshëm i një strukture të Departamentit të Krimin, me një ndarje të qartë funksionesh dhe kompetencash, për t'i rezistuar e përshtatur çdo situatë apo shfaqjeje të krimin të organizuar. Kjo mënyrë e tanishme funksionimi, bie ndesh me parimet e Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP)<sup>4</sup>, që flet për zinxhirin komandues.

<sup>4</sup> Kodi Evropian i Etikës Policore, Kapitulli IV (Strukturat organizative të policisë, parimi 17): "Organizimi i policisë duhet të bëhet sipas një sistemi të qartë të komandimit brenda policisë. Duhet të jetë gjithnjë e mundshme të konkludohet se të cili epror qëndron përgjegjësia për veprimet ose

## Rekomandimi nr. 2

IPK-ja rekomandon që të bëhet ristrukturimi i Shtyllës së Krimin në drejtim të forcimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të Drejtorisë Kundër Krimin të Organizuar, ristrukturim ky që duhet të përfshijë edhe njësitë regjionale të hetimeve.

2.1.9 Regjionet janë të organizuara në bazë të strukturës organizative të vitit 2005 të aprovuar nga Kai Vittrup. Në bazë të kësaj strukture, në kuadër të Hetimeve Rajonale që i përgjigjet Komandës Rajonale, funksionon Sektori i Hetimeve të Specializuara në kuadër të të cilit funksionojnë:

- Njësia Rajonale për Hetimin e Narkotikëve;
- Njësia Rajonale kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, dhe
- Njësia për Hetimin e Personave të Zhdukur.

2.1.10 Njësitë Regjionale të Hetimeve të Specializuara deri në vitin 2005 kanë qenë të centralizuara dhe nuk kanë pas kurrfarë lidhje me komandën regjionale, kurse me strukturën organizative e cila është aktuale (2005), këto njësi janë decentralizuar dhe janë nën komandën regjionale, çka do të thotë se detyrat i marrin nga komanda regjionale dhe për çdo aktivitet të tyre i përgjigjen komandës regjionale. Drejtuesit e këtyre njësive mbajnë takime të rregullta javore në Drejtorinë Kundër Krimin të Organizuar. Po ashtu këto njësi me kërkesën e qendrës, kryejnë asistime të ndryshme.

2.1.11 Njësitë e Hetimeve të Specializuara edhe pse janë të decentralizuara, për aktivitetet e veta në kuadër të regjionit (veç raportimit në komandën regjionale) raportojnë edhe në Drejtorinë Kundër Krimin të Organizuar. Ky dualizëm i raportimit sipas zyrtarëve policor në regjione mund t'i dëmtoj hetimet dhe shumica e zyrtarëve policor mendojnë se forma centraliste e funksionimit të këtyre njësive do të ishte më e mirë në luftimin e këtyre dukurive negative.

2.1.12 Sipas menaxhmentit të DKKO-së, në zbatim të misionit të saj duhet krijuar sektor të veçantë për zbulimin e krimin të organizuar dhe plotësimin e saj me Njësinë e Auto-Krimeve dhe Korrupsionit.

2.1.13 Të flitet për krimin e organizuar është e pamundur të mos shtjellohet edhe rëndësia e Drejtorisë së Analizës së Krimin (DAK). Kjo drejtori vepron në kuadër të Shtyllës së Krimin dhe ka adoptuar modelin britanik të inteligjencës, i njohur si "modeli kombëtar i inteligjencës". DAK-u ka në dispozicion dy (2) sektor pa njësi fushore: analiza e inteligjencës dhe analiza e krimin. Si pasojë e mos posedimit të sektorit fushor, DAK-u është në gjendje të siguroj vetëm raporte inicuese analitike. Këto i siguron nga njësitë regjionale të inteligjencës dhe burimet e hapura. Njësitë regjionale të inteligjencës janë nën komandat e zëvendës komandantëve regjional për operativë dhe si rezultat i kësaj DAK-u pranon informata të dorës së tretë nga regjionet, duke krijuar probleme të mëdha.

2.1.14 Drejtorja e Analizës së Krimin është qendër e mbledhjes, krahasimit, analizimit dhe shpërndarjes së të gjitha informatave të "inteligjencës kriminale"<sup>5</sup>, tek njësitë përkatëse. Në kuadër të kësaj ekziston edhe Njësia e Statistikave të Krimin, që ka

---

mosveprimet e personelit"

<sup>5</sup> Inteligjencë kriminale konsiderohet informata e përpiluar, analizuar dhe shpërndarë për të parashikuar, parandaluar apo monitoruar aktivitetin kriminal.

për qëllim përcjelljen e trendit të krimit, identifikimin e pikave të nxehta të krimit dhe zhvendosjet e tyre. Këto të dhëna janë udhërrëfyese i analistëve të inteligjencës kriminale të kësaj drejtorie. Mirëpo, kjo drejtori më tepër merret me analizat e rasteve kriminale se sa me analizat e grupeve kriminale apo krimit të organizuar dhe trendet e saj. Në konsultim me faktorët tjerë duhet bërë analizimin e krimit të organizuar, trendeve të krimit të organizuar, rrethanat në të cilin operon krimi i organizuar, gjithashtu grupet profesionale dhe teknologjitë e përfshira, etj.

### **Rekomandimi nr. 3**

IPK-ja rekomandon ngritjen e kapaciteteve njerëzore për studimin dhe analizimin e krimit të organizuar dhe nivelin e ekspozimit të tij në shoqëri.

## **2.2 Burimet njerëzore**

2.2.1 Luftimi efikas i krimit të organizuar kërkon personel të mjaftueshëm dhe profesional policor. Përzgjedhja e personelit në njësitë e DKKO-së është çështje mjaft brengosëse që kërkon rishqyrtim të menjëhershëm dhe krijimin e një procesi me kritere më të larta apo rigoroze, që do të mundësonte identifikimin e personelit me kualitete më të larta. Rekrutimi i personelit bëhet kryesisht duke shpallur vende të lira të punës përmes zinxhirit komandues në Drejtorinë e Përgjithshme. Në raste të jashtëzakonshme një oficer policor mund të emërohet drejtpërdrejtë nga ndonjë njësit tjetër ose kuadro tjera të policisë, pas marrjes së pëlqimit nga DKKO-ja. Përzgjedhja bëhet përmes bordeve, ku shefi i njësisë përkatëse ose zëvendësi duhet të jenë të përfshirë në procesin e seleksionimit. Shefi i njësisë ka disa të drejta në procesin e seleksionimit. Veç aftësive profesionale, në rekrutim theks i veçantë i kushtohet edhe kapaciteteve të kandidatit për të punuar në grup, besueshmërisë, tipareve të sigurisë dhe integritetit personal. Secilit kandidat i bëhet verifikimi i të kaluarës.

2.2.2 Nuk ka kritere specifike dhe procedura të veçanta për pranim në DKKO. Përzgjedhja dhe pranimi i kandidateve për punonjës policor të DKKO-së duhet të bazohet në kriteret e caktuara, në mënyrë që të rritet interesi i oficerëve policor për pjesëmarrjen në konkurrim dhe kjo do të arrihet përmes transparencës dhe objektivitetit në konkurrim. Pranimi duhet të bëhet mbi bazën e një sistemi vlerësues bashkëkohor me sisteme teorike dhe praktike. Është e rëndësishme të theksohet se lufta kundër krimit të organizuar kërkon burime të nevojshme si dhe aftësi për të trajtuar këtë fenomen. Kërkohen metoda dhe modele të reja në menaxhimin e këtyre burimeve si dhe rritje të aftësive të punonjësve të policisë që merren me luftën ndaj këtij fenomeni. Drejtori i DKKO-së ka qasje në selektimin dhe pranimin e zyrtarëve policor në DKKO.

### **Rekomandimi nr. 4**

IPK-ja rekomandon nxjerrjen e akteve të veçanta të cilat do të përcaktojnë kriteret dhe procedurat e qarta për rekrutimin, formimin, kualifikimin dhe rregullimin e brendshëm të personelit policor të DKKO-së.

2.2.3 Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar (DKKO) përbëhet aktualisht prej 99<sup>6</sup> zyrtarëve policor, prej tyre 84 të gjinisë mashkullore dhe 15 të asaj femërore. Nga ky numër, 98 janë të përkatësisë shqiptare ndërsa një (1) i përkatësisë serbe. Me përgatitje superiore janë 18 zyrtar policor, studime pasdiplomike (5), shkollim të lartë (5), student (24) dhe shkollim i mesëm (53). Kjo gjendje e kualifikimit arsimor është pasojë e pranimeve pa kritere të caktuara në DKKO-ja, edhe pse disa kritere që kërkohen janë vetëm të dëshirueshme. Në tabelën 1 dhe 2, paraqesim strukturën policore sipas gradave dhe personelin në njësitë e specializuara regjionale.

Gjendja	Grada						
	N/k	Maj.	Kap.	Tog.	Rr.	Pol	Totali
Situata aktuale	1	2	2	10	23	61	99
Struktura e paraparë	1	3	3	10	28	81	126
Ndryshimi (-/+)	0	-1	-1	0	-5	-20	-27

Nr.	Regjioni	SRHN	SRKTQNJ	Gjithsej
1.	Prishtinë	6	4	10
2.	Mitrovicë	2	3	5
3.	Pejë	5	3	8
4.	Prizren	5	5	10
5.	Ferizaj	2	3	5
6.	Gjilan	5	3	8
Totali		25	21	46

2.2.4 Lëvizjet e shpeshta të personelit paraqesin vështirësi në luftim më efikas të krimit të organizuar. Numri prej 104 të punësuarve në vitin 2006, është ngritur rënie në 114 në vitin 2007, derisa këtë vit, ka rënie në 99, duke bërë që 26 vende pune apo pozita të jenë të lira në DKKO. Kërkesat e DKKO-së për plotësimin e vendeve të lira të punës nuk hasin në mbështetje nga menaxhmenti policor edhe pse disa konkurse janë në proces e sipër. Mungesat e personelit në disa njësi krijojnë probleme të mëdha si p.sh, mungesat në Njësinë e Trajtimit me Informatorë kanë shkaktuar humbjen e kontaktit me informator, po ashtu ka pasur dorëheqje vullnetare të personelit nga hetimet financiare dhe njësi tjera, të cilat kanë krijuar vështirësi në rekrutimin e personelit të kualifikuar.

2.2.5 Profesionalizmi dhe motivimi si një nga vlerat më specifike të policisë, ndonëse të zbehura për shumë arsye kohëve të fundit, mbeten në nivele të pranueshme në pjesën dërmuese të personelit. Përvoja e pamjaftueshme menaxhuese në nivelet drejtuese të DKKO-së dhe sektorëve të saj mund të ngadalësojë efikasitetin e lartë në luftimin e krimit të organizuar, me gjithë vullnetin dhe ambiciet shumë të larta të tyre për të luftuar krimin e organizuar. Përvoja e shumicës së personelit në këta sektor

<sup>6</sup> Bazuar në të dhënat e Entit Statistikor të Kosovës sipas të cilit Kosova ka rreth 2.100.000 banorë, DKKO-ja ka të angazhuar rreth 5 hetues policor për 100.000 banorë, në fushën e luftimit të krimit të organizuar. Sipas Raportit të Zyrës kundër Drogave dhe Krimit të OKB-së, ky numër në vendet tjera sillet si vijon: Shqipëria (1.5), Sllovenia (2.1), Italia (0.4), Bullgaria (0.4), Rumania (9.9), Turqia (0.1), Lituania (1.7), etj.



dhe njësi nuk kalon 3-5 vite. Megjithatë, në DKKO ekzistojnë kapacitete dhe potenciale specialistësh të aftë, guximtar që mund të garantojnë rezultat konkret në realizimin e misionit të saj. Ndryshimet në strukturën organizative dhe mbështetja me burime njerëzore, financiare dhe teknike do të përbëjnë një bazament të qëndrueshëm për arritjen e synimeve.

2.2.6 Ende vërehet mos vlerësim real i performancës dhe kualifikimit të vazhdueshëm të personelit. Në strukturën e saj duhet të ketë specialist që të bëjnë vlerësime profesionale për ecurinë e personelit në punë, për rezultatet e arritura, mangësitë, promovimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të tyre. Duhet të punohet për të realizuar standardet e kërkuara si: përzgjedhja, vlerësimi real, trajnimet, promovimet, etj.

2.2.7 Në Njësinë e Vëzhgimit, numri i personelit nuk është i kompletuar dhe mungon personeli me grada. Në këtë njësi ka mungesë të zyrtarëve policor të gjinisë femërore. Nuk ekziston një sistem i mirëfilltë i mbrojtjes së identitetit dhe prezencës së hetuesve vëzhgues në lokacione të caktuara. Praktika e zbatimit të orarit të rregullt të punës në këtë njësi krijon vështirësi dhe si rezultat i kësaj ndoshta duhet shqyrtuar zbatimin e orarit fleksibil. Mungesë e personelit vërehet edhe në njësitë regjionale të hetimeve të specializuara të cilat nuk kanë arritur t'i përmbushin vendet e përcaktuara me strukturë. Ka mungesë të personelit të graduar. Disa njësi regjionale për hetimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore kanë mungesë të personelit të gjinisë femërore. Këto njësi kanë nevojë të kenë më tepër personel të gjinisë femërore, pasi që viktimat e trafikimit kanë nevojë që të bisedojnë me hetueset femra.

2.2.8 Trajnimet në kuadër të DKKO-së organizohen brenda dhe jashtë vendit. Trajnimet më të shumta organizohen në Qendrën Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH). Këto trajnime të brendshme deri diku janë kualitative. Mungojnë programe për trajnime të avancuara, ndërsa trajnimet e ofruara nga shkolla megjithëse paraqesin bazamentin themelor të njohurive, nuk ofrojnë njohuri më të thella në luftimin e fushave të ndjeshme të krimit të organizuar. Shtrohet nevoja e krijimit të një sistemi të përshtatshëm trajnimi që do të ofronte njohuri më të mëdha, që konsiderohet si çelës i suksesit në parandalimin dhe goditjen e këtij fenomeni.

#### **Rekomandimi nr. 5**

IPK-ja rekomandon që Departamenti i Trajnimeve të zhvilloj apo përmirësoj programet e trajnimit specifik për personelin, në parandalimin, zbulimin dhe luftimin e krimit të organizuar.

2.2.10 Sipas PSO-ve, çdo njësi qendrore dhe regjionale duhet që në kuadër të saj të organizoj trajnime dhe ligjërata për personelin e vet. Ne nuk kemi hasur në ndonjë dokument që do të vërtetonte mbajtjen e këtyre trajnimeve. Të gjitha trajnimet lidhur me trafikimin me qenie njerëzore organizohen përmes SHTQNJ-së. Në vazhdim paraqesim trajnimet e organizuara nga departamenti i Trajnimeve, për hetuesit e DKKO-së, që kanë të bëjnë me luftimin e krimit të organizuar: kursi bazik i krimit të organizuar (89 persona), kursi bazik i hetimit të narkotikëve (23), kursi bazik i hetimit kriminal (77), kursi i avancuar i hetimeve kriminale (32), kursi i trafikimit të qenieve njerëzore (11), kursi i hetimeve financiare (10), kursi i avancuar i hetimeve të narkotikëve (3), kursi për negociator në rastet e peng-marrjes (3), kursi i menaxhimit të hetimeve kriminale (2), kursi për drogat (11), kursi për parandalimin e krimit (2), njohuritë mbi

vjedhjet e veturave dhe drogat (5), njohuritë mbi legjislacionin kundër trafikimit me qenie njerëzore (4), kursi i analizës së inteligjencës (9), kursi i inteligjencës operative (2), kontrabandimi i armëve dhe cigareve (10), kursi “Forensic IT” (2), mjetet e ‘TI’ për analizë (1), koncepti i hetimeve ndërkombëtare (9).

2.2.11 Në Policinë e Kosovës akoma vërehet zbatimi i praktikës, në të cilën trajnimet i ndjekin personat jo kompetent për fushat e caktuara. Gjatë inspektimit vërejtëm se personali i njësive regjionale të hetimeve të specializuara posedon trajnime të kënaqshme, që i kanë vijuar si brenda ashtu edhe jashtë vendit, mirëpo ndihet nevoja e vazhdimit të këtyre trajnimeve, sidomos të atyre të avancuara dhe specifike.

2.2.12 Takimet e menaxherëve të Shtyllës së Krimin me Departamentin e Krimeve dhe drejtoritë tjera në kuadër të departamentit, janë javore dhe dyjavore, varësisht prej nevojave. Në baza javore dhe mujore mbahen takime me hetimet regjionale, policinë kufitare dhe qendrat e inteligjencës. Gjatë intervistave me personelin e njësive të DKKO-së, janë vërejtur shqetësime për vizitat e pamjaftueshme të menaxherëve me hetuesit, për dëgjimin e shqetësimeve të tyre. Mungesa e dukshme e interesimit është e paarsyeshme dhe IPK-ja vlerëson që menaxhmenti në nivelet më të larta të jetë shembull në parimin e parë të lidhshimit dhe motivimit, duke i vizituar hetuesit dhe duke dëgjuar shqetësimet e tyre.

## 2.3 Infrastruktura dhe pajisjet

2.3.1 DKKO-ja është e vendosur në një objekt të përbashkët me Prokurorinë Speciale dhe gjendja e saj është e keqe, me mungesë të theksuar të hapësirave për punë. Ndërtesat aktuale nuk janë të përshtatshme dhe nuk ofrojnë hapësira të mjaftueshme për punë. Në nivel regjional, hapësirat e punës nuk janë të mjaftueshme dhe të kënaqshme, bile disa prej tyre gjenden në kontejner apo hapësira të vogla, të cilat nuk janë të përshtatshme për punë.

### Rekomandimi nr. 6

IPK-ja rekomandon që të sigurohen dhe rregullohen hapësirat e punës për sektorët dhe njësitë që merren me luftimin e krimit të organizuar.

2.3.2 Ndërtesa ku zhvillon aktivitetet Ekipi i Përgjimit Ligjor është në vend të sigurt dhe dyert e saj janë të sigurta, mirëpo hapësira e punës është e kufizuar. Të gjitha hyrjet në hapësirat e Përgjimit Ligjor duhet të aprovohen nga drejtori i DKKO-së. Të gjitha hyrjet daljet e personave regjistrohen në listat e caktuara. Çdo përgjim e ka dosjen e vet, sistemi regjistron secilin zyrtar policor që futet në përgjim dhe çdo keqpërdorim mund të identifikohet.

2.3.3 Njësia e Vëzhgimit është e vendosur jashtë objekteve policore e cila shumë lehtë mund të jetë e zbuluar. Maskimi i veprimtarisë së tyre do të ndihmonte në mos identifikimin e tyre. Kohëzgjatja e qëndrimit në ato hapësira nuk duhet të jetë e gjatë.

2.3.4 Shumica e pajisjeve janë donacion nga ndërkombëtarët. Janë ngritur kapacitete në pajisjet e përgjimit ligjor dhe blerjen e automjeteve. Janë blerë pajisje moderne në

njësitë e DKKO-së. Këto janë pajisje mjaft të reja dhe moderne. Pajisjet e blera për përgjim ligjor duhet të pasohen edhe me mbajtjen e trajnimit për shfrytëzimin e tyre (priet të filloj në fillim të vitit të ardhshëm). Ekzistojnë probleme të vogla të furnizimit me rrymë në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike. Përgjimi mund të kryhet në të gjithë hapësirën apo territorin e Kosovës edhe pse më herët në disa pjesë të vendit ka pasur pengesa, mirëpo tani janë bërë disa përmirësime nga operatori dhe ekziston mundësia e përgjimit në tërë territorin. Personeli i kësaj njësie ka trajnime të mjaftueshme dhe është i përgatitur profesionalisht për përdorimin e sistemit të përgjimit dhe nuk ka vështirësi në përdorimin e tij. Sistemi është i mbrojtur.

2.3.5 DKKO-ja aktualisht posedon 44 vetura, të cilat janë të pashënuara. Gjatë inspektimit vërejtëm se nuk respektohen procedurat mbi përdorimin e veturave të pashënuara sa i përket mbushjes me derivate, parkimit dhe rregullimit teknik të tyre. Furnizimi me derivate dhe rregullimi teknik i tyre është i ngjashëm me ato të njërive tjera policore. Kjo përbën vështirësi dhe rrezik serioz në identifikimin e personelit policor dhe veturave të tyre. Veturat e njëjta shfrytëzohen në shumë raste, gjë që shkakton identifikimin e tyre nga kriminelët dhe informatorët. Nuk ka procedura të cilat do të rregullonin kohëzgjatjen e përdorimit të veturave dhe veturat e tyre përdoren për një kohë të gjatë. Për funksionim sa më të mirë, këto vetura duhet të ndërrohen në periudha kohore, në mënyrë që të mos vërehen lehtë sepse kjo krijon pasiguri të zyrtarëve policor dhe mos efikasitet në luftimin e krimit të organizuar.

2.3.6 Njësitë e specializuara të hetimeve në kuadër të hetimeve regjionale kanë vështirësi t'i luftojnë grupet kriminale sepse ata shpesh janë të njohur në rrethet ku punojnë. Veturat e tyre të pashënuara janë të njohura edhe për publikun pasi që shfrytëzohen për një kohë të gjatë. Ekzistojnë vështirësi në shfrytëzimin e njërive të specializuara regjionale nga niveli qendror ngase ekzistojnë procedura të gjata rreth komunikimit dhe arsyetimit të angazhimit të tyre.

2.3.7 Në disa regjione, përkatësisht njësi të specializuara ekzistojnë linjat telefonike, faksi dhe linja të internetit, ndërsa në disa regjione këto nuk funksionojnë. Gjendja e kompjuterëve mund të thuhet se është deri diku e kënaqshme. Ndërsa gjendja aktuale e pajisjeve për hetime nuk është e pranueshme, vërehen mungesa të theksuara në pajisje. Njësitë përkatëse të Sektorit për Shërbime Mbështetëse të DKKO-së i ofrojnë njërive rajonale të specializuara mbështetje teknike në rastet e hetimeve..

2.3.8 Pajisjet aktuale edhe pse janë të teknologjisë më moderne, duhet mbështetur iniciativat në drejtim të pajimit me aparatura të domosdoshme për luftimin e krimit të organizuar. Nuk ka personel të mjaftueshëm dhe të përgatitur për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e pajisjeve të dhëna në përdorim. Duhet ndërmarrë të gjitha masat e duhura për mbrojtjen e sistemeve të TI-së. Në kuadër të komunikimit dhe shkëmbimit të Informacionit duhet bërë integrimin e sistemeve aktuale dhe të ardhshme të TI-së, në mënyrë që të mundësohet përdorimi i përbashkët i informacionit sipas nevojave.

#### **Rekomandimi nr. 7**

IPK-ja rekomandon përkrahje materiale për të mbështetur iniciativat për blerjen e pajisjeve të nevojshme.

2.3.9 Në kuadër të policisë funksionon baza e të dhënave "KPIS" e cila tani është transformuar në "Sistem Informativ të Policisë së Kosovës" (SIPK) (vepron në kuadër

të Shtyllës së Operativës). Është bazë e të dhënave të të gjitha shënimeve kriminale policore në Kosovë dhe është krijuar gjatë vitit 1999, nga Policia e UNMIK-ut. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e këtij sistemi kryesisht bëhet nga një njësi e veçantë e Policisë së UNMIK-ut e njohur si Njësia e KPIS-it. Kjo bazë momentalisht funksionon në nivelin regional dhe atë qendror, ndërsa nivelit të stacioneve iu është marrë. Për rrjedhojë, çdo njësi ka sistemin e saj të komunikimit të brendshëm. Secili sektor posedon me bazën e vet të të dhënave edhe pse këto nuk janë të koordinuara mes veti. Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të integruar sistemet aktuale, në mënyrë që të bëhet një shkëmbim më efikas dhe i centralizuar i informacionit. Informacioni mbi identifikimin e anëtarëve dhe grupeve kriminale nuk është i disponueshëm. Ky informacion duhet të jetë i disponueshëm për të gjitha njësitë e inteligjencës dhe policinë kufitare. Komunikimi ndërmjet këtyre njësive dhe policisë kufitare duhet të orientohet të kryhet përmes rrjetit të tyre të brendshëm. Ende nuk bëhet një grumbullim i centralizuar i informacionit apo të dhënave, që do të lejonte angazhim më të madh në zbulimin dhe parandalimin e krimit të organizuar. Mungesa e të dhënave dhe statistikave të sakta për fenomenin dhe angazhimi relativisht jo i mjaftueshëm i policisë në këtë fushë, ka penguar dukshëm zbulimin dhe luftimin e kësaj dukurie.

2.3.10 Teknologjia me të cilën funksionon “KPIS”-i, është mjaft e vjetruar, pasi kjo bazë është e krijuar në programin access, ndërsa funksionimi i saj bëhet vetëm përmes internetit. Sistemi i sigurisë të kësaj baze është i nivelit të ulët. Ka të meta në futjen apo regjistrimin e të dhënave në sistem, si në rastet e regjistrimit fillestar të të dhënave, ku gjatë regjistrimit të rasteve nga personat përgjegjës bëhen shumë gabime si në emërtime të emrave dhe mbiemrave të personave dhe lokacioneve, koordinatave në harta, datat e incidentit dhe raportimit, dyfishimi i rasteve, etj. Sistemi i mbrojtjes dhe sigurimit të të dhënave dhe pajisjeve të DKKO-së nuk është akoma mjaft funksional.

2.3.11 “KPIS”-i ka shumë mangësi tjera në kategorizimin e personave lidhur me personat e përfshirë, po ashtu ka mos përputhje me Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale, ku statusi i lëndëve është mjaft i komplikuar dhe i paqartë dhe është pothuajse e pamundur që të identifikohen rastet që janë të pakryera dhe të kryera (edhe pse kah fundi i vitit 2006 është arritur që të bëhen disa ndryshime). Kjo bazë e të dhënave është edhe në kundërshtim me të drejtat e njeriut, pasi që personat që figurojnë si të dyshuar në këtë bazë, edhe nëse lëndët kanë përfunduar në gjykatë dhe personat e tillë janë shpallur të pafajshëm apo janë dënuar, ka raste kur akoma figurojnë si të dyshuar. Është shqetësuese ngase të dhënat nga kjo bazë shpesh merren parasysht gjatë verifikimit të personave. Kjo shtron nevojën e rifreskimit të vazhdueshëm të të dhënave në këtë bazë.

## 2.4 Koordinimi dhe shkëmbimi i informatave

2.4.1 Ekziston një mungesë koordinimi mes njësive të inteligjencës si dhe ka paqartësi në drejtim të decentralizimit apo centralizimit të tyre. Vërehen shqetësime për vonesë të shpërndarjes së informatave të inteligjencës. Nuk ka një sistem të qartë të mbledhjes dhe shkëmbimit të informatave ndërmjet njësive, nuk ka centralizim<sup>7</sup> të informatave, gjë e cila është edhe si pasojë e asaj që njësitë fushore të Inteligjencës sipas strukturës organizative janë në kuadër të shtyllës së Operativës, ndërsa Drejtoria e Analizës së Krimit, që është qendër e mbledhjes së të gjitha informatave

<sup>7</sup> Mbledhja e të gjitha informatave nga të gjitha njësitë në një pikë të vetme.

është në kuadër të Shtyllës së Krimit. Kjo rezulton me një vonesë të madhe të pranimit të raporteve të Inteligjencës në Drejtorinë e Analizës së Krimit, pasi që para se të dërgohen në drejtori, njësitë fushore të inteligjencës duhet marrë pëlqimin e komandantëve regional, pasi që kërkohet të respektohet zinxhiri komandues. Pengesë tjetër është që njësitë fushore të inteligjencës përdoren nga ana e tyre edhe për qëllime të ndryshme operative, që nuk kanë të bëjnë fare me inteligjencë.

#### **Rekomandimi nr. 8**

IPK-ja rekomandon një funksionim të mirëfilltë dhe të plotë të inteligjencës kriminale dhe është e nevojshme që të bëhet centralizimi i të gjitha informatave nga niveli regjional në atë qendror, të cilat do të mund të krahasohen, vlerësohen dhe shpërndahen njësisë hetimore apo edhe atyre operative.

2.4.2 Decentralizimi i informatave pamundëson një pasqyrë të përgjithshme të sigurisë dhe aktiviteteve kriminale si dhe pamundëson analizë precize dhe të saktë. Duhet angazhuar në mbledhjen dhe analizën e informacioneve mbi elementet, grupet, lëvizjet dhe organizatat kriminale, si dhe të monitoroj zhvillimet në lidhje me fenomenin e krimit të organizuar. Ky informacion duhet rifreskuar dhe të shkëmbehet me autoritet kompetente të shteteve të tjera, sipas kufizimeve të parapara në marrëveshje. Nuk ekzistojnë kapacitetet njerëzore të analizimit të rrezikut nga krimi i organizuar dhe raportimit të paralajmërimit të hershëm.

2.4.3 Në të shumtën e rasteve raportet e inteligjencës apo informatat e njësisë regjionale të inteligjencës nuk janë kualitative dhe nuk i plotësojnë standardet, andaj si pasojë e kësaj, DAK-u ballafaqohet me vështirësi të mëdha gjatë përpilimit të raporteve analitike, që shpeshherë rezultojnë të mangëta. Shumë informata përcillen nëpër zinxhirin komandues pa u bërë pastrimi i tyre, duke shkaktuar rrezik potencial për zbulimin e burimit. Njësitë e specializuara nuk sjellin fare raporte të inteligjencës në DAK

#### **Rekomandimi nr. 9**

IPK-ja rekomandon ngritjen e kapaciteteve të njohurive analizuese të raporteve regjionale të inteligjencës, në orientimin për mbledhjen e informatave dhe analizimin e tyre.

2.4.4 Disa stacione policore dhe pika të kalimeve kufitare (PPK) nuk kanë të caktuar oficerë përgjegjës për çështje të Inteligjencës, andaj është e nevojës urgjente që secili stacion policor dhe pikë kalim kufitar të caktoj oficer policor që do të jenë përgjegjës në mbledhjen e informatave të Inteligjencës si dhe informatave tjera nga policët në terren si dhe nga burimet tjera. Është më se e rëndësishme dhe e nevojshme që edhe drejtoritë rajonale të policisë kufitare, përfshirë edhe Aeroportin e Prishtinës, të kenë njësi regjionale të inteligjencës, të cilat do të ishin përgjegjëse për koordinimin e punëve me njësitë tjera në regjionin e tyre si dhe me Drejtorinë e Analizës së Krimit. Në bazë të inspektimit mbi policinë kufitare ne kemi konstatuar se nuk ka sistem të mirëfilltë që do të bëjë identifikimin e hyrjes së personave në pikat e kalimeve kufitare. Komunikimi i policisë kufitare me njësitë tjera policore është shumë i vështirë.

#### **Rekomandimi nr. 10**

IPK-ja rekomandon ngritjen e një rrjeti të integruar të bazës së të dhënave, të koduar, me një sistem unik qendror të lidhur dhe koordinuar, me të gjitha data bazat tjera policore.

2.4.5 Informatat të cilat u dërgohen njësive të caktuara policore nga DAK-u, nuk pasqyrohen me informata kthyesë lidhur me zhvillimin e mëtutjeshëm të asaj inteligjence apo masat e ndërmarra nga hetuesit në atë rast. Policia e Kosovës momentalisht ka strategjinë e qartë (2008-2010), lidhur me inteligjencën kriminale, mirëpo kjo kërkon vullnet dhe përkushtim për implementimin e saj. Edhe pse në kuadër të policisë ekzistojnë shumë njësi të inteligjencës si në rajone, drejtori dhe departamente, akoma nuk ekziston një koordinim i mirëfilltë mes tyre. Mungon raporti kthyes nga njësitë policore në lidhje me informatën e pranuar (p.sh. nga Njësia për Trajtimin e Informatorëve). Po ashtu mungon Njësia Ndërlidhëse (Flaging Cell) në DAK dhe në Policinë e Kosovës që do të jepte një pasqyrë se cilat njësi merren me rastin duke bërë shpërndarje të informatave, njësive përkatëse. Në mungesë të kësaj njësie, ka dyfishim të hetimeve dhe ndërhyrje mes njësish.

#### **Rekomandimi nr. 11**

IPK-ja rekomandon rishqyrtimin e strukturës së inteligjencës kriminale dhe krijimin e një strukture sa më efikase dhe efektive në realizimin e synimeve të saj.

2.4.6 Shkëmbimi i informacionit në shkallë të gjerë, analiza e përmirësuar e informacionit kriminal si dhe një bashkëpunim më i ngushtë ndërkombëtar kanë ngritur shqetësim të madh lidhur me krimin e organizuar. Është hasur që në mes Njesisë së Hetimeve Ndër-kufitare dhe Sektorit Qendror për Hetime të Narkotikëve ndonjëherë ka edhe përzierje apo paqartësi të kompetencave, sa i përket hetimit dhe luftimit të krimeve të drogës.

#### **Rekomandimi nr. 12**

IPK-ja rekomandon që të qartësohen rolet dhe përgjegjësitë midis Sektorit Qendror për Hetime të Narkotikëve dhe Njesisë së Hetimeve Ndër-kufitare brenda DKKO-së.

## **2.5 Buxheti**

2.5.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit është një ndër elementet kryesore të menaxhimit të policisë, për të realizuar misionin dhe detyrat institucionale që i përcakton ligji. Buxheti i DKKO-së gjatë vitit 2008 ka qenë rreth 1.900.000,00 €, që sipas zyrtarëve të lartë të DKKO-së është i pamjaftueshëm për realizimin e synimeve. Sipas tyre, buxheti i pamjaftueshëm mund të lë pa plotësuar kërkesat e domosdoshme materiale, në realizimin e synimeve për luftën kundër krimit të organizuar.

2.5.2 Pagat e punonjësve policor që merren me luftimin e krimit të organizuar janë të ulëta. Niveli i ulët i trajtimit financiar të personelit të DKKO-së mund të zbehë motivin për arritjen e synimeve të kësaj drejtorie.

### Rekomandimi nr. 13

IPK-ja rekomandon trajtimin e duhur financiar të punonjësve policor që drejtpërdrejt merren me luftimin e krimit të organizuar, në raport me përgjegjësitë dhe rrezikshmërinë.

2.5.3 Shpenzimet e veshjes civile të personelit që merren me luftimin e krimit të organizuar nuk kompensohet nga shërbimi. Në rastet e caktuara hetuesit detyrohen të vishen në uniformë policore, e cila paraqet rrezik potencial të identifikimit të tyre nga publiku. Kjo mënyrë e praktikuar duhet të ndryshoj në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e identitetit të hetuesve.

2.5.4 Ekzistojnë Procedurat Standarde të cilat rregullojnë çështjen e shpërblimit të informatorëve. Njësia për Trajtimin e Informatorëve përmes Përgjegjësit për Fondin e Fshehtë, menaxhon me një shumë parash për shpenzimet në rastet e kontakteve me informator.

## 3. STRATEGJIA DHE POLITIKAT

3.1 Republika e Kosovës si një shtet i ri ka mungesë të legjislacionit dhe strategjive mbi luftimin e krimit të organizuar, por ka lëvizje pozitive në drejtim të kompletimit të legjislacionit dhe strategjive. Deri më tani është miratuar Strategjia Nacionale dhe Plan i Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2008-2011.

3.2 Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) në Planin e saj Strategjik 2007-2010, prioritet ka vënë parandalimin dhe reduktimin e krimit. Në kuadër të këtij prioriteti, parashihet përgatitja e planeve/programeve strategjike dhe operacionale të MPB-së dhe të Policisë së Kosovës në: parandalimin dhe reduktimin e krimit të organizuar, korrupsionit, drogave, trafikimit me qenie njerëzore, terrorizmit, etj. Veç tjerash, MPB-ja ka ndërmarrë iniciativa në inicimin e hartimit të strategjisë kundër krimit të organizuar 2009 - 2011". Përpilimi i strategjisë nacionale të luftës kundër drogës mbetet një ndër prioritet kryesore të ministrisë.

3.3 MPB-ja tashmë ka hartuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore. Është kjo një strategji sektoriale dhe mbështetet në prioritetet e qeverisë për luftën kundër krimit të organizuar, dhe rritjen e nivelit të sigurisë në vend. Misioni i strategjisë nacionale në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore është "të përcaktoj prioritetet strategjike të luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore, të përcaktoj objektivat specifike të institucioneve që marrin detyrime në luftën kundër trafikimit, si dhe të harmonizoj veprimet ndër-institucionale për arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu, misioni i strategjisë është të siguroj rritjen e cilësisë së shërbimeve, duke reduktuar dëmet e trafikimit ndaj shoqërisë si dhe të intensifikoj ndjekjen, persekutimin dhe dënimin e shkelësve të ligjit". Koordinatorin Nacional kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore është Zëvendës Ministri i Punëve të Brendshme, mandati i të cilit është të koordinoj, bashkërendoj, monitoroj dhe raportoj mbi implementimin e politikave kundër trafikimit me qenie njerëzore, si dhe të kryesoj takimet me grupet punuese ndër-ministore.

3.4 DKKO-ja ka përpiluar Planin e Veprimit për vitin 2008 dhe Strategjinë për hetimin dhe zbulimin e kriminalitetit të organizuar në Kosovë, të datës 18.07.2007. Kjo



strategji më tepër është e nivelit të brendshëm se sa një strategji nacionale, megjithëse duhet përshëndetur iniciativën e tillë. Mision i kësaj strategjie është “parandalimi i kriminalitetit të organizuar, zbulimi dhe hetimi i kriminalitetit të organizuar përmes mbledhjes dhe paraqitjes së fakteve, dëshmive dhe provave që dëshmojnë fajësinë dhe pafajësinë e personave të dyshuar për vepra penale, vënia e tyre para drejtësisë si dhe konfiskimi i pasurisë”.

3.5 Ndër prioritetet e DKKO-së për zhvillimin e strategjive për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, janë:

- zhvillimi i strategjisë për parandalimin, zbulimin dhe kapjen e kryerësve të veprave penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandës me njerëz si dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit,
- zhvillimi i strategjisë për parandalimin, zbulimin dhe kapjen e kryerësve të veprave penale të trafikimit me narkotikë,
- zhvillimi i strategjisë për parandalimin e akteve terroriste dhe bashkëpunimi rajonal e më gjerë për luftimin e terrorizmit,
- zhvillimi i strategjisë të trajtimit me informatorë,
- zhvillimi i strategjisë dhe mekanizmave institucional për trajtimin e dëshmitarëve të mbrojtur.

3.6 Aktualisht, aktiviteti i sektorëve të DKKO-së bazohet në disa procedura standarde të bartura nga policia ndërkombëtare ose të krijuara më vonë. Jo në pak raste këto procedura janë të vjetruara dhe komplekse, andaj kërkohet urgjentisht të bëhet rishikimi dhe plotësimi i tyre. Për këtë, duhet të përgatitet një rregullore, që do të përcaktojë procedura më të thjeshta, por rezultative në luftimin e krimit të organizuar. Procedurat duhet të jenë të sakta dhe të përcaktuara qartë, me qëllim që njësitë policore të zbatojnë detyrat e tyre, por të kenë edhe një koordinim dhe shkëmbim informacioni më të mirë mes veti.

3.7 Lidhur me strukturimin e brendshëm qendror dhe regjional, PSO-të nuk janë në përputhje me gjendjen aktuale sa i përket centralizimit të njësive të specializuara regjionale për hetimin e narkotikëve, pasi që ato njësi janë nën mbikëqyrjen e drejtorive rajonale, të cilat kërkojnë të respektohet zinxhiri komandues. SQHN raporton direkt tek Zëvendës Drejtori i DKKO-së dhe ka për detyrë të kryej dhe koordinoj aktivitetet për luftimin e drogës në tërë territorin, të organizoj dhe luftoj me efikasitet kundër krimeve të drogës në koordinim dhe bashkëpunim me regjionet e prekura, të mbështes aktivitetet anti-drogë në nivel rajonal ballkanik, të zhvilloj aktivitetet anti-drogë në nivel të mesëm dhe të lartë në tërë Kosovën, etj.

3.8 Infrastruktura ligjore në shumë fusha të caktuara nuk është përmbyllur me sukses, ka mungesë legjislacioni përkatës. Nga institucionet vendore nuk është miratuar projektligji për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, si dhe nuk është krijuar Agjensioni për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.



## 4. PERFORMANCA POLICORE

4.1 Drejtoria Kundër Krimittë Organizuar harton raportet tremujore, gjashtë mujore, nëntë mujore dhe vjetore të punës, përmes të cilave merr në shqyrtim dhe analizon realizimin e parashikimeve dhe objektivave të vendosura. Niveli i përpilimit të raporteve të punës nuk është i kënaqshëm dhe ka mungesë të profesionalizmit, ngase ato janë të paqarta, jo unike dhe me informacione të pamjaftueshme. Mungesa e statistikave të besueshme dhe unike ka pamundësuar analizimin më të thuktë të rezultateve të këtyre sektorëve dhe njërive. Të dhënat e prezantuara në këtë raport janë të nxjerrura nga raportet e punës së DKKO-së.

### Rekomandimi nr. 14

IPK-ja rekomandon që të krijohet një strukturë e qartë dhe profesionale e përpilimit të raporteve të punës, të cilat do të ofronin të dhëna unike dhe të qarta për analizim dhe matje të performancës së punës, bazuar në një plan trajnues për zyrtarët përgjegjës.

4.2 Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur rezultatet e Sektorit të Hetimeve. Në vitin 2008, të dhënat flasin për një paraqitje më të suksesshme të këtij sektori në krahasim me vitin 2007 (shih tabelën 3). Sukses evident shihet sidomos në fushën e hetimeve financiare, ku gjatë operacioneve të ndryshme, njësitë e këtij sektori kanë konfiskuar shuma të mëdha të mjeteve financiare.

Aktivitetet	Vitet	
	2007	2008
Raste të bartura	5	2
Raste të hapura	7	15
Raste të përfunduara	6	12
Të arrestuar të dyshimtë	31	43
Raste të dërguara në prokurori	6	14
Konfiskim armësh	550	62
Konfiskim municioni	15.000	12.004
Para të konfiskuara në euro (·)	42.500	137.000

4.3 Sipas analizave dhe raporteve vendore e ndërkombëtare, Kosova mbetet një zonë e origjinës, transitit dhe destinimit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Kosova vazhdon të jetë një vend destinacioni dhe transiti për viktimat të huaja të trafikimit, me një rritje të dukshme të trafikimit të brendshëm të qenieve njerëzore. Numri i shtetasve të huaj si viktimat të trafikimit është në rënie e sipër, ndërsa i atyre vendore ka treguar rritje. Sektorit të Hetimeve të Trafikimit me Qenie Njerëzore gjatë vitit 2007 ka identifikuar 32 viktimat të supozuara të trafikimit, prej tyre 28 viktimave u është ofruar mbështetja dhe asistencë e plotë, kurse 3 viktimat të huaja të trafikuar janë riatdhesuar. Në periudhën janar-shtator të vitit 2008 janë identifikuar 26 viktimat, ku prej tyre janë asistuar 20 dhe riatdhesuar 6 sosh. Numri i personave të arrestuar

si të dyshuar për kryerje të veprës penale, ka pësuar ngritje. Numri i lokaleve që janë mbyllur nën dyshimin për aktivitete të ndryshme kriminale, ka pësuar rënie graduale (prej 137 në vitin 2006, ka rënë në 109 në vitin 2007, kurse në periudhën janar- shtator të vitit 2008, ky numër ka rënë në 78 (shih tabelën 4)

Tabela 4: Të dhënat e rezultateve të Sektorit Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore		
Aktivitetet	Vitet	
	2007	2008
Raste të hapura	48	71
Raste të mbyllura	20	45
Raste të dorëzuara në prokurori	56	49
Raste nën hetime	13	6
Të arrestuar të dyshimtë	72	89
Lokale të mbyllura	109	78

4.4 Sipas raportit të Zyrës kundër Drogave dhe Krimin, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të publikuar në mars të këtij viti, ekzistojnë tri rrugë kryesore të kontrabandës (kalimi jugor, qendror dhe verior) që janë mirë të njohura dhe që derivojnë nga Bullgaria. Një nga rrugët që kalon nëpër Kosovë është kalimi jugor që përfshinë vijën Afganistan- Pakistan- Iran- Turqi- Bullgari- Maqedoni- Kosovë- Shqipëri- Itali. Kohë më parë, zyrtar të Interpolit kishin dëshmuar para Kongresit Amerikan se „rrjeti shqiptar kontrollon rreth 70 % të tregut të heroinës në Zvicër, Gjermani, Austri dhe shtetet skandinave”. Lidhur me grupet kriminale të shqiptarëve u diskutua edhe në publikimin e Evropolit për vitin 2006, me titull “Kërcënimi nga krimi i organizuar”. Sipas raportit të Këshillit të Evropës, grupet kriminale të shqiptarëve janë në mënyrë të përsëritshme, përgjegjës për pjesën më të madhe të shitjes së përgjithshme dhe distribuimit të heroinës në Evropë<sup>8</sup>.

4.5 Grupet kriminale të përfshira në trafikimin e lëndëve narkotike përdorin territorin e Kosovës si vend transit për kalimin e narkotikëve, me destinacion vendet perëndimore. Një pjesë e kësaj sasive mbetet në vendin tonë me qëllim plotësimin e nevojave të brendshme e cila lidhet me numrin gjithnjë në rritje të përdoruesve vendor të narkotikëve. Në tabelat 5 dhe 6, prezantojmë të dhënat mbi sasinë e konfiskuar të narkotikëve dhe të arriturat e Sektorit Qendror të Hetimeve të Narkotikëve dhe Njësisve Regjionale.

Tabela 5: Konfiskimet e narkotikëve nga SQHN-ja dhe SRHN (shprehur në gram)						
Viti	Heroin	Marihuan	Bimë kanabis	Kokainë	Hashash	Tjera
2007	47.765,6	32.123,4	21.712	1.920,7	4,7	1.618,9
2008	44.644,3	177.490,3	9.249	2.150	-	52,4

<sup>8</sup> Raporti i Zyrës kundër Drogave dhe Krimin të OKB-së: “Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan”, mars 2008.

Tabela 6: Të dhënat mbi rezultatet e Sektorit të Narkotikëve		
Aktivitetet	Vitet	
	2007	2008
Raste të hapura	306	203
Raste të mbyllura	38	19
Raste të dorëzuara në prokurori	268	174
Raste nën hetime	-	10
Të arrestuar	524	336

4.6 Aktivitetet e njësive të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse janë prezantuar në tabelën 7.

Tabela 7: Të dhënat mbi suksesin e Sektorit Mbështetës		
Njësia	Vitet	
	2007	2008
Forenzika e TI-së (raste)	20	48
Përgjimi Ligjor (linja telefonike)	553	425
Vëzhgimi (raste)	37	103
Trajtimi i informatorëve (procedimi i raporteve)	62	91
EMIPA (raste)	26	20
Mbështetja teknike (raste)	20	3

## 5. PARTNERITETI

5.1 Partneriteti në luftimin e krimit të organizuar si element i domosdoshëm nuk është në nivelin e duhur sa i përket agjencive të përfshira dhe kjo duhet përmirësua. Në mënyrë që të rritet efikasiteti duhen rishikuar marrëveshjet aktuale të bashkëpunimit, si dhe duhen hartuar e zbatuar marrëveshje të reja. Këto duhet të përcaktojnë fusha të qarta kompetencash dhe përgjegjësish. Pavarësisht progresit të bërë, ende kërkohet angazhim dhe mbështetje në luftë kundër krimit të organizuar. Për drejtimin e luftës kundër krimit të organizuar, duhet bërë identifikimin e përvojave të vendeve më të përparuara në këtë drejtim. Policia duhet të bashkëpunojë dhe koordinojë veprimet me shtetet e tjera, në veçanti me vendet fqinje.

5.2 Përgjegjësia në luftën kundër krimit të organizuar, nuk mbetet thjeshtë vetëm përgjegjësi e policisë, por është edhe detyrim i përbashkët i institucioneve të tjera që kanë përgjegjësi në këtë fushë. Nuk ekziston bashkëpunim i mjaftueshëm me prokurorinë, ngase Policia zyrtarisht nuk merr informata kthyesë për rastet të cilat i ka iniciuar. Policia më tepër informohet nga mediat se sa nga prokuroria apo gjykata. Nga menaxherët policor theksohet se “prokurorët dhe gjyqtarët nuk janë mjaft të përgatitur apo të specializuar për t’u marrë me format e krimit të organizuar”.

5.3 Edhe pse policia ka të nënshkruara disa marrëveshje bashkëpunimi me vendet e rajonit, vërehet një bashkëpunim i pamjaftueshëm rajonal dhe ndërkombëtar. Shkëmbimi i informacionit me shtetet tjera më tepër bëhet mbi baza vullnetare.

5.4 Aktualisht, nuk ekzistojnë memorandume të nënshkruara të bashkëpunimit

me Shërbimin Doganor, Administratën Tatimore, Qendrën e Inteligjencës Financiare, etj. Republika e Kosovës nuk është pjesëtare në një sërë nismash rajonale e me gjerë si dhe nuk është anëtare e organizatave ndërkombëtare policore. Policia e Kosovës duhet të krijoj dhe forcoj marrëdhëniet ndër-policore me organizmat ndërkombëtarë, si Interpolin dhe Evropolin, për të synuar në arritjen e bashkëpunimit konkret në luftën kundër krimit ndër-kufitar e ndërkombëtar.

#### **Rekomandimi nr. 15**

IPK-ja rekomandon ngritjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit me të gjitha mekanizmat relevant vendor dhe ndërkombëtar, që kanë për synim parandalimin, hetimin dhe luftimin e krimit të organizuar.

5.5 Drejtoria e Analizës së Krimit (DAK) edhe pse vepron në kuadër të Shtyllës së Krimit, varet nga bashkëpunimi i ndërsjellë me të gjitha njësitë e policisë, si dhe me agjensionet tjera të zbatimit të ligjit. Për funksionim sa më të mirë të Inteligjencës Kriminale kërkohet një bashkëpunim më i theksuar edhe me agjensionet tjera të zbatimit të ligjit.

# PJESA II:

## AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË HETIMEVE


- Krijimi i bazave ligjore për disiplinën policore dhe procedurën e ankesave është një hap i rëndësishëm në përpjekje për të arritur një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për Policinë e Kosovës. Shoqëria demokratike kërkon që punonjësit policor të jenë përgjegjës për sjelljen e tyre dhe për mënyrën se si i kryejnë detyrat e tyre. Kjo kërkesë duhet të plotësohet në bazë të një legjislacioni të fuqishëm, të bazuar në nevojat për integritet, sjellje profesionale dhe respekt për të drejtat themelore të njeriut. Neni 20 i Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP) e bënë të qartë këtë me fjalët në vijim: “Organizata policore duhet të bazohet në masa të efektshme për të garantuar objektivitetin dhe sjelljen profesionale të personelit policor, veçanërisht për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të cilat janë qartësisht të sanksionuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.
- Dispozitat e Ligjit të Inspektoratit Policor dhe Ligjit të Policisë së Kosovës kërkojnë të arrijnë këto qëllime nëpërmes një varg dispozitash që sanksionojnë shkeljet dhe një sistemi efektiv për hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj punonjësve të Policisë së Kosovës. Në të njëjtën kohë është obligim ligjor që gjatë procedurës së hetimeve disiplinore, të njihen dhe respektohen të drejtat e policëve dhe të respektohet parimi që punonjësi i Policisë së Kosovës është “i pafajshëm derisa të shpallet fajtor”. Ligji i IPK-së dhe Ligji i Policisë së Kosovës janë hartuar në pajtim të plotë me Kodin Evropian të Etikës Policore (KEEP), në të cilin theksohet se “masat disiplinore kundër personelit policor duhet t’i nënshtrohen shqyrtimit nga një organ i pavarur ose nga një gjykatë”.
- Bazuar në Ligjin e IPK-së (neni 22), IPK-ja është autoriteti kompetent për shqyrtimin e të gjitha ankesave të qytetarëve dhe inicimet e brendshme ndaj të gjithë punonjësve të Policisë së Kosovës, pa dallim grade. Pas pranimit të lëndëve në IPK, bëhet regjistrimi, vlerësimi, dhe kategorizimi i tyre. Nëse IPK-ja vlerëson se ankesa ka të bëjë me shkelje të rëndë disiplinore, brenda 14 ditëve të punës fillon hetimi disiplinor. Nëse pas hetimit, IPK-ja vlerëson se ka të gjetura që dëshmojnë kryerjen e një shkeljeje të caktuar, lënda i referohet Këshillit për Emërime të Larta dhe Disiplinë Policore për dëgjim disiplinor, si një organ i pavarur i cili do të vendos për fajësinë apo pafajësinë e zyrtarëve të akuzuar IPK-ja. Nëse gjatë shqyrtimit të lëndës, IPK-ja vlerëson se ankesa apo iniciimi i procedurës së brendshme ka të bëjë me shkelje të lehtë disiplinore, lënda i referohet Njesisë së Hetimeve të Brendshme Disiplinore Policore për hetim të mëtejshëm. Në rast se shkelja përmban elemente të veprës penale, rasti i referohet prokurorit publik, nëse kjo gjë nuk është bërë më parë.



Departamenti i Hetimeve i procedon rastet e pranuar në dy mënyra: bazuar në ankesat e qytetarëve ndaj punonjësve të Policisë së Kosovës dhe kur iniciohet procedurë e brendshme nga vet punonjësit e Policisë së Kosovës. Departamenti i Hetimeve mund të inicioj raste edhe në bazë të detyrës zyrtare “ex officio”.

Aktiviteti	Periudha			
	tetor-dhjetor 2007	%	janar-dhjetor 2008	%
Ankesat nga qytetarët	122	48.8	789	38.9
Inicimi i hetimeve të brendshme	128	51.2	1.235	61.1
<b>Totali</b>	<b>250</b>	<b>100</b>	<b>2.024</b>	<b>100</b>


Në tabelë janë prezantuar të dhënat mbi lëndët e pranuar dhe të proceduara për dy periudha kohore (periudhën e fundit tremujore të vitit 2007 dhe periudhën vjetore 2008). Në këtë raport janë përfshirë edhe të dhënat për periudhën tetor-dhjetor të vitit 2007, pasi ato nuk kemi patur rastin t'i publikojmë në raportin e vitit 2007. Këto të dhëna paraqesin punën që nga momenti i certifikimit të inspektorëve policor të Departamentit të Hetimeve. Kjo tabelë pasqyron se në vitin 2008, nga gjithsej 2.024 raste të proceduara, kemi 1.235 raste si rezultat i inicimit të hetimeve të brendshme, që në totalin e përgjithshëm përfaqësohen me 61.1 %, kurse përqindja e mbetur prej 38.9 % përfaqëson ankesat e pranuar nga qytetarët.



Paraqitja grafike e lëndëve të pranuar dhe të proceduara nga Departamenti i Hetimeve

Nëse marrim parasysh tabelën dhe diagramin e paraqitur më poshtë vërehet se brenda vitit, numri më i madh i rasteve është pranuar dhe proceduar në muajin mars, gjatë të cilit janë proceduar gjithsej 474 raste që përfaqësojnë 23.42 % të rasteve në totalin e përgjithshëm. Në anën tjetër, muaji i ngarkuar me numrin më të ulët të rasteve është muaji prill me gjithsej 89 raste, me një përfaqësim prej 4.40 %. Numri i madh i rasteve që e bën të dalloj muajin mars nga muajt tjerë është se në këtë periudhë, pas Shpalljes së Pavarësisë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka ardhur deri te bojkotimi i punës nga ana e disa zyrtarëve policor të nacionalitetit serb. Nëse analizohet tutje tabela me të dhënat e paraqitura, del se nga 474 raste sa janë proceduar në muajin mars, si inicim i hetimeve të brendshme janë 83.8 % e rasteve.

Muaji	Lëndët				Totali	
	Ankesa të qytetarëve		Inicimi i hetimeve të brend.			
	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Janar	64	55.7	51	44.3	115	100
Shkurt	55	34.6	104	65.4	159	100
Mars	77	16.2	397	83.8	474	100
Prill	45	50.6	44	49.4	89	100
Maj	56	38.9	88	61.1	144	100
Qershor	68	42.8	91	57.2	159	100
Korrik	71	53.8	61	46.2	132	100
Gusht	67	66.3	34	33.7	101	100
Shtator	114	64	64	36	178	100
Tetor	80	48.2	86	51.8	166	100
Nëntor	58	36.7	100	63.3	158	100
Dhjetor	34	22.8	115	77.2	149	100
<b>Totali</b>	<b>789</b>	<b>44.2 %</b>	<b>1235</b>	<b>55.8 %</b>	<b>2024</b>	<b>100</b>



Paraqitja grafike e lëndëve të pranuar dhe të proceduara gjatë vitit 2008

Të dhënat mbi gradat policore ndaj të cilave janë paraqitur ankesa dhe ato mbi llojin e ankesave në kategori të gjëra (akuza) janë prezantuar në tabelat e mëposhtme. Nga totali prej 2.024 ankesave, janë prekur gjithsej 2.346 zyrtar policor (98 %) dhe 47 punonjës civil (2 %). Në totalin prej 2.393 të graduarve ndaj të cilëve është paraqitur ankesë, më së shumti janë prekur “zyrtarët policor” me 85.8 %, derisa grada “gjeneral” përfaqësohet me 0.1 %. Lloji më i shpeshtë i ankesave ka të bëjë me “sjellje të pahijshme” që përfaqësohet me 878 raste apo 43.4 %




Të dhënat statistikore sipas muajve mbi gradat e punonjësve policor ndaj të cilëve është paraqitur ankesë


Muaji	Grada policore																		Totali	
	Gjeneral		Kolonel		N/kolonel		Major		Kapiten		Toger		Rreshter		Zyrtar pol		Staf civil		Nr	%
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%		
Janar	0	0	0	0	0	0	0	0	0.7	5	3.6	7	4.9	128	90.1	1	0.7	142	100	
Shkurt	0	0	0	1	0.5	2	1	3	1.5	9	4.5	5	2.5	176	89	2	1	198	100	
Mars	0	0	0	4	0.7	3	0.5	3	0.5	20	4.8	22	4.2	430	84.5	25	4.8	507	100	
Prill	1	1	1	0	0	0	0	3	3	7	7	8	8	79	79	1	1	100	100	
Maj	0	0	0	1	0.5	1	0.5	0	0	7	3.7	14	7.3	166	86.9	2	1.1	191	100	
Qershor	0	0	0	0	0	0	0	4	1.6	9	4.1	16	7.3	184	85.8	3	1.2	216	100	
Korrik	0	0	0	0	0	0	0	3	1.9	8	5.1	8	5.1	134	86	3	1.9	156	100	
Gusht	0	0	0	0	0	2	1.4	3	2.2	10	8.2	11	9.1	92	77.7	2	1.4	120	100	
Shtator	1	0.5	0	0	2	1	2	2	1	2	1	5	2.6	182	91.9	2	1	198	100	
Tetor	0	0	1	0.4	0	0	0	0	0	11	5.3	19	9.2	171	83.7	3	1.4	205	100	
Nëntor	0	0	3	1.7	0	0	1	0.6	2	1.2	6	3.5	9	5.3	149	87.1	1	0.6	171	100
Dhjetor	0	0	0	0	0	0	1	0.5	1	0.5	6	3.2	17	9	162	85.7	2	1.1	189	100
<b>Totali</b>	<b>2</b>	<b>0.1</b>	<b>5</b>	<b>0.2</b>	<b>8</b>	<b>0.3</b>	<b>12</b>	<b>0.5</b>	<b>25</b>	<b>1</b>	<b>100</b>	<b>141</b>	<b>5.9</b>	<b>2053</b>	<b>85.8</b>	<b>47</b>	<b>2</b>	<b>2393</b>	<b>100</b>	

Të dhënat statistikore mbi llojin e ankesave në kategori të gjëra (akuza)

Muaji	Akuza														Totali			
	Sjellje e pahijshme		Përdorim i forcës		Tejkalim i pushimit		Vepra penale		Korrupsion		Moskryerje e detyrës		Dëmtim i pronës		Akuza tjera		Nr	%
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%		
Janar	35	30.5	15	13	3	2.6	8	7	5	4.3	24	20.9	16	13.9	9	7.8	115	100
Shkurt	42	26.4	14	8.8	0	0	6	3.8	4	2.5	65	40.8	12	7.6	16	10.1	159	100
Mars	78	16.4	15	3.2	1	0.2	6	1.3	5	1.1	342	72.2	13	2.6	14	3	474	100
Prill	51	57.3	16	18	1	1.1	6	6.7	1	1.1	10	11.3	3	3.4	1	1.1	89	100
Maj	71	49.3	21	14.6	0	0	6	4.2	1	0.7	32	22.2	5	3.4	8	5.6	144	100
Qershor	65	40.9	16	10.1	0	0	7	4.4	1	0.6	48	30.2	16	10.1	6	3.7	159	100
Korrik	61	46.2	16	12.1	0	0	7	5.3	2	1.5	31	23.5	15	11.4	0	0	132	100
Gusht	55	54.8	9	8.9	0	0	3	3	1	0.5	17	16.9	14	13.9	2	2	101	100
Shtator	142	79.8	15	8.4	0	0	7	3.9	1	0.6	12	6.7	1	0.6	0	0	178	100
Tetor	101	60.8	22	13.4	0	0	11	6.6	5	3	9	5.4	16	9.6	2	1.2	166	100
Nëntor	101	63.9	14	8.9	0	0	14	8.9	1	0.6	9	5.7	19	12	0	0	158	100
Dhjetor	76	51	16	107	0	0	16	10.7	1	0.7	13	8.7	21	14.1	6	4.1	149	100
<b>Totali</b>	<b>878</b>	<b>43.4</b>	<b>189</b>	<b>9.3</b>	<b>5</b>	<b>0.2</b>	<b>97</b>	<b>4.8</b>	<b>28</b>	<b>1.4</b>	<b>612</b>	<b>30.2</b>	<b>151</b>	<b>7.5</b>	<b>64</b>	<b>3.2</b>	<b>2024</b>	<b>100</b>




Paraqitja grafike mbi gradat e punonjësve policor ndaj të cilëve është paraqitur ankesë



Paraqitja grafike mbi llojin e ankesave në kategori të gjëra (akuza)

Lidhur me statusin e rasteve më të cilat ka proceduar Departamenti i Hetimeve, nga numri i përgjithshëm prej 2.024 rasteve, 781 prej tyre (38.6 %) janë dërguar në Njësinë e Hetimeve të Brendshme Policore (NJHBP), 491 raste (24.26 %) janë mbyllur si “të hedhura poshtë si të paargumentuara” dhe “të pushuara pas hetimit”, 482 raste (23.81 %) janë përgatitur për KELDP, përfshirë edhe rastet e punonjësve serb dhe 270 raste (13.33 %) janë raste të bartura në vitin 2009 si raste “në hetim” dhe “raste të pezulluara”.

Statusi i rasteve (lëndëve)		Viti 2008	
		Numri	%
Dërguar në Njësinë e Hetimeve të Brendshme Policore		781	38.6
Të mbyllura	Të hedhura poshtë si të paargumentuara	323	15.9
	Të pushuara pas hetimit	168	8.3
Raste për KELDP	Rastet e kompletuara për KELDP	157	7.8
	Raste të punonjësve serb	325	16.1
Rastet e bartura në vitin 2009	Në hetim	130	6.4
	Të pezulluara	140	6.9
Totali		2024	100



Paraqitja grafike e statusit të rasteve të punuara nga Departamenti i Hetimeve për vitin 2008





**Inspektorati Policor i Kosovës**

**Rr. "Lidhja e Pejës", p.n  
12000, Fushë Kosovë  
038 552 510 / 038 200 185 10  
info.ipk@ks-gov.net**